

ZBORNİK RADOVA SA NAUČNOG SKUPA
POVODOM 101. GODIŠNJICE ALBANOLOGIJE
NA UNIVERZITETU U BEOGRADU

PËRMBLEDHJE PUNIMESH NGA TUBIMI
SHKENCOR ME RASTIN E 101 VJETORIT TË
ALBANOLOGJISË NË UNIVERSITETIN E BEOGRADIT



ZBORNIK RADOVA SA NAUČNOG SKUPA POVODOM 101. GODIŠNJICE
ALBANOLOGIJE NA UNIVERZITETU U BEOGRADU

PËRMBLEDHJE PUNIMESH NGA TUBIMI SHKENCOR ME RASTIN E 101 VJETORIT
TË ALBANOLOGJISË NË UNIVERSITETIN E BEOGRADIT

Edicija

Naučni skupovi

ZBORNİK RADOVA SA NAUČNOG SKUPA POVODOM 101. GODIŠNJICE ALBANOLOGIJE NA
UNIVERZITETU U BEOGRADU
PËRMBLEDHJE PUNIMESH NGA TUBIMI SHKENCOR ME RASTIN E 101 VJETORIT TË
ALBANOLOGJISË NË UNIVERSITETIN E BEOGRADIT

Izdavač

Univerzitet u Beogradu – Filološki fakultet
Studentski trg 3
11000 Beograd

Za izdavača

Prof. dr Iva Draškić Vićanović, dekan

Urednici

Nailje Malja Imami
Merima Krijezi
Đorđe Božović
Marija Hrkalović

Grafička priprema

Predrag Žižović

Korice

Srđan Đurđević

Tiraž

10 CD-ROM

Štampa

MAB, Beograd

ISBN 978-86-6153-760-8

<https://doi.org/10.18485/albanolog101.2025>

Beograd, 2025



Radovi su licencirani pod uslovima i odredbama licence
Creative Commons Attribution-ShareAlike 4.0 International License.

**ZBORNIK RADOVA SA NAUČNOG SKUPA
POVODOM 101. GODIŠNJICE ALBANOLOGIJE
NA UNIVERZITETU U BEOGRADU**

**PËRMBLEDHJE PUNIMESH NGA TUBIMI SHKENCOR
ME RASTIN E 101 VJETORIT TË ALBANOLOGJISË NË
UNIVERSITETIN E BEOGRADIT**



BEOGRAD, 2025

Recenzenti zbornika

Prof. dr Berton Suljejsmani, Univerzitet u Tetovu, Severna Makedonija

Prof. dr Dragana Grujić, Univerzitet u Beogradu, Srbija

Prof. dr Gordana Đoković, Univerzitet u Beogradu, Srbija

Prof. dr Merima Krijezi, Univerzitet u Beogradu, Srbija

Prof. dr Nailje Malja Imami, Univerzitet u Beogradu, Srbija

Doc. dr Rezearta Murati, Fakultet društvenih nauka, Univerzitet „Luid Gurakući” u Skadru, Albanija

Prof. dr Seljajdin Saljihu, Univerzitet u Tetovu, Severna Makedonija

Doc. dr Đorđe Božović, Univerzitet u Beogradu, Srbija

Organizacioni odbor

Prof. dr Borko Kovačević, Filološki fakultet Univerziteta u Beogradu, Srbija

Prof. dr Nailje Malja Imami, Filološki fakultet Univerziteta u Beogradu, Srbija

Doc. dr Đorđe Božović, Filološki fakultet Univerziteta u Beogradu, Srbija

Prof. dr Merima Krijezi, Filološki fakultet Univerziteta u Beogradu, Srbija

Mast. Marija Hrkalović, Filološki fakultet Univerziteta u Beogradu, Srbija

Sekretar Katedre ta albanologiju Agron Bakiu, Filološki fakultet Univerziteta u Beogradu, Srbija

Naučni odbor

Prof. dr Arben Prendi, Fakultet društvenih nauka, Univerzitet „Luid Gurakući” u Skadru, Albanija

Prof. dr Aljulja Jubani, Fakultet istorije i filologije, Univerzitet u Tirani, Albanija

Prof. dr Mimoza Priku, Fakultet društvenih nauka, Univerzitet „Luid Gurakući” u Skadru, Albanija

Prof. dr Šaban Sinani, Albanska akademija nauka, Albanija

Prof. dr Aleksandr Novik, Filološki fakultet, Državni Univerzitet Sankt Peterburg, Muzej antropologije i etnologije „Petar Veliki”, Ruska akademija nauka, Rusija

Prof. dr Đuzepina Turano, Univerzitet „Ca’ Foscari”, Venecija, Italija

Prof. dr Nailje Malja Imami, Filološki fakultet Univerziteta u Beogradu, Srbija

Prof. dr Borko Kovačević, Filološki fakultet Univerziteta u Beogradu, Srbija

Doc. dr Đorđe Božović, Filološki fakultet Univerziteta u Beogradu, Srbija

Prof. dr Merima Krijezi, Filološki fakultet Univerziteta u Beogradu, Srbija

Dr Genc Ljafa, Univerzitet u Salentu, Italija

Dr Oljimbi Veljaj, Učiteljski fakultet, Univerzitet „Aleksandër Moisiu”, Drač, Albanija

Doc. dr Rezearta Murati, Fakultet društvenih nauka, Univerzitet „Luid Gurakući” u Skadru, Albanija

SADRŽAJ – PËRMBAJTJE

UVODNA REÇ — 8

FJALA HYRËSE — 9

EMIL LAFE

“FJALOR SERBOKROATISHT-SHQIP – SRPSKOHRVATSKI-ALBANSKI REÇNIK”
(INSTITUTI I STUDIMEVE. TIRANË, 1947, 407 FQ.) DHE VLERAT E TIJ PËR
HISTORINË E SHQIPES LETRARE DHE TË LEKSIKOGRAFIKË SHQIPE — 10

ĐORĐE BOŽOVIĆ

MBI SHUMËSIN E SHQIPES NË KONTEKSTIN BALLKANIK — 19

ARBEN PRENDI

TJETËRSIMI I IDENTITETIT, SHPRISHJA E TRADITËS DHE PËRPLASJET ME
IDEOLOGJITË E REJA, NË ROMANET E MARTIN CAMAJT — 27

NAILE MALA IMAMI

GRUPE FJALËSH TË BASHKËLIDHURA ME FRAZELOGJIZMA SOMATIKË — 41

MERIMA KRIJEZI

SEMANTIKA E PARAFJALËS NGA DHE REALIZIMET E SAJ NË KONSTRUKTET
SINTAGMATIKE E FRAZELOGJIKE NË GJUHËN SHQIPE — 59

ANĐELA M. MARKOVIĆ

IMENICE SA PREPOZITIVNIM ČLANOM U ALBANSKOM JEZIKU — 74

BERTON SULEJMANI

NDIKIMET NDËRGJUHËSORE TË SHQIPES E TË MAQEDONISHTES NË FUSHËN E
LEKSIKUT (NË RRAFSHIN DIALEKTOR) — 88

EVALDA PACI

ELEMENTE TË NJË LASHTËSIE KOMPLEKSE NË STUDIME MBI BOTËN
INDOEVIROPIANE E ATË BALLKANIKE — 104

GENC LAFE

PASQYRË E PËRGJITHSHME E NDIKIMIT TË ITALISHTES
NË GJUHËN SHQIPE — 115

MARIJA HRKALović

REKSIONI I DYFISHTË I FOLJES *NDIHMOJ* NË GJUHËN
SHQIPE DHE SERBE — 132

MATĚJ KŘEPINSKÝ

ALBANIAN STUDIES AT CHARLES UNIVERSITY IN PRAGUE AS PART OF
CZECHOSLOVAK-ALBANIAN CULTURAL RELATIONS IN THE 1950S — 144

MIMOZA PRIKU

ARHIV ZA ARBANSKU STARINU, JEZIK I ETNOLOGIJU-TRIBUNË E PROMOVIMIT TË
ALBANOLOGJISË — 160

ORKIDA BACKUS BORSHI

JAN URBAN JARNIKU DHE KONTRIBUTI I TIJ NË LIDHJE ME ALBANOLOGJINË E
PRAGËS — 168

REZEARTA MURATI

“HYLLI I DRITËS” PËR INSTITUCIONET ZYRTARE ME NDIKIM NË PLANIFIKIMIN
GJUHËSOR TË SHQIPES — 174

VALBONA KARAKAÇI & RREZARTA DRAÇINI

ANTON ÇETTA: INTELEKTUALI DHE MISIONARI I PAQES — 187

АГРОН А. БАКИУ

РАЗВОЈ БИБЛИОТЕКЕ КАТЕДРЕ ЗА АЛБАНОЛОГИЈУ ФИЛОЛОШКОГ
ФАКУЛТЕТА У БЕОГРАДУ – ОСВРТ НА СТОЛЕЋЕ ПОСТОЈАЊА — 202

UVODNA REČ

Sa velikim zadovoljstvom vam predstavljamo zbornik radova sa konferencije povodom 101. godišnjice albanologije na Univerzitetu u Beogradu, održane 28.10.2022. godine u prostorijama Filološkog fakulteta Univerziteta u Beogradu.

Ovaj zbornik okuplja radove istaknutih istraživača, mladih naučnika i stručnjaka iz različitih oblasti jezika, književnosti i kulture iz zemlje i inostranstva. Naša konferencija je za cilj imala pokretanje dijaloga i razmenu ideja između istraživača različitih oblasti. Imajući u vidu da odavno postoji potreba za objedinjavanjem savremenih filoloških istraživanja i u želji da obeležimo 101. godinu nastave na ovom odseku, pozvali smo lingviste iz zemlje i regiona da učestvuju u njoj.

Zbornik radova obuhvata širok spektar tema, jezik, književnost i kulturu. Svaki rad je prošao ozbiljan proces recenzije kako bi se osigurala naučna relevantnost i visok kvalitet sadržaja. Nadamo se da će ovi radovi inspirisati dalja istraživanja i produbiti naše razumevanje jezika, književnosti i kulture.

Zahvaljujemo se svim autorima na njihovom trudu i doprinosu, kao i recenzentima na njihovoj stručnosti i posvećenosti. Posebnu zahvalnost upućujemo organizatorima i svim volonterima, bez čije podrške ova konferencija ne bi bila moguća. Nadamo se da će ovaj zbornik postati značajan izvor informacija i inspiracije za sve koji se bave filološkim istraživanjima, i da će doprineti unapređenju naučne zajednice.

UREDNIKA ZBORNIKA
Nailje Malja Imami

FJALA HYRËSE

Me kënaqësi të madhe ju prezantojmë punimet nga konferenca me rastin e 101-vjetorit të albanologjisë në Universitetin e Beogradit, e mbajtur më 28.10.2022, në ambientet e Fakultetit Filologjik të Universitetit të Beogradit.

Kjo përmbledhje punimesh i përmban punimet e studiuesve të shquar, shkencëtarëve të rinj dhe ekspertëve nga fusha të ndryshme të gjuhës, letërsisë dhe kulturës. Konferenca jonë pati për qëllim nxitjen e dialogut dhe shkëmbimin e ideve ndërmjet studiuesve të këtyre fushave të ndryshme. Duke pasur parasysh faktin se prej kohësh ka pasur nevojë për bashkimin e kërkimeve bashkëkohore filologjike dhe duke pasur dëshirë që ta festojmë 100-vjetorin e mësimdhënies në këtë katedër i ftuam gjuhëtarët e vendit dhe të rajonit që të marrin pjesë në të.

Përmbledhja me punime përfshin një gamë të gjerë temash, duke përfshirë gjuhësinë, letërsinë dhe kulturën. Çdo punim i është nënshtruar procesit rigoroz të recensimit që ta sigurojë rëndësinë shkencore dhe cilësinë e lartë të përmbajtjes. Shpresojmë që këto punime të frymëzojnë kërkime të mëtejshme për gjuhën, letërsinë dhe kulturën.

I falënderojmë të gjithë autorët për përpjekjet dhe kontributet e veta, si dhe recensentët për kontributin dhe përkushtimin e tyre. Veçanërisht u jemi mirënjohës organizatorëve dhe të gjithë kolegëve studentë që ishin vullnetarë, pa mbështetjen e të cilëve kjo konferencë nuk do të ishte e mundur. Shpresojmë që kjo përmbledhje punimesh të bëhet burim i rëndësishëm informacioni dhe frymëzimi për të gjithë ata që merren me kërkime gjuhësore dhe të kontribuojë në përmirësimin e komunitetit shkencor.

KRYEREDAKTORE
Naile Mala Imami

Emil LAFE¹

Profesor në pension

“FJALOR SERBOKROATISHT-SHQIP – SRPSKOHRVATSKI-ALBANSKI REČNIK” (INSTITUTI I STUDIMEVE. TIRANË, 1947, 407 FQ.) DHE VLERAT E TIJ PËR HISTORINË E SHQIPES LETRARE DHE TË LEKSIKOGRAFIË SHQIPE

Fjalët kyçe: gjuha shqipe, gjuha serbokroate, fjalor, leksikografi, normë letrare, drejtshkrim.

Vepra e parë leksikografike për gjuhën shqipe pas Luftës II Botërore është një fjalor serbokroatisht-shqip i botuar më 1947. Ky fjalor u hartua në kohën e lulëzimit të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave për të përmbushur nevojat e mësimit të serbokroatishtes në shkollat e Shqipërisë dhe të komunikimit ndërmjet dy popujve. Menjëherë pas luftës serbokroatishtja u bë gjuha e huaj kryesore që mësohej në shkollat e mesme të Shqipërisë në vend të italishtes e frëngjishtes që mësoheshin më parë. Më 1947 filloi edhe mësimi i rusishtes. Fjalori është vepër kolektive. Hartuesit e tij janë paraqitur të ndarë në një komision redaktues (Vojislav S. Dančetović, Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Eqrem Çabej) dhe në bashkëpunëtorë (Pashko Geci, Zagorka Filipović, Mark Ndoja, Aleks Buda, Ivan Brabec). Ndërprerja e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë në verën e vitit 1948 bëri që ky fjalor të mbetet në harresë dhe pa ndonjë recension në Shqipëri².

Me sa jemi në dijeni, leksikografia e shqipes me serbishten i ka fillimet me *Rečnik od četiri jezika: srpski-arbanski, arbansko-arnautski-turski, turski-grčki*. (Beograd, 1873) të Đorđe Puljevskit. Në gjysmën e parë të shek. XX dalin edhe dy fjalorë të tjerë: *Srpsko-arnautski rečnik (Đuhtar srpošiptarče)* (Beograd, 1902, 138 f.), nga L. Kujundžić dhe *Rečnik Kosovsko-Metohijskog dijalekta* (Beograd, 1932, 297 f.) nga Gliša Elezović. Fjalori që po shqyrtojmë, ndryshe nga të mësipërmit,

¹ emilafe1@gmail.com

² Në Kosovë, me sa kemi mundur të ndjekim, është shkruar pas pesë vjetës një recension nga Hasan Kaleshi : *Jeta e re* 4/1952, nr. 2, f. 227-232.

është vepër e një grupi autorësh (shqiptarë e serbë) dhe e hartuar në një institut shkencor. Më pas dolën edhe fjalorë të tjerë, si *Rečnik srpskoga ili hrvatskoga jezika (A–O)* i Henrik Barić-it (Zagreb, 1950, 672 f.), *Rečnik srpskohrvatski-albanski* i Sokol Dobroshiti (Prishtinë, 1953, 757 f.). Vetëm pas njëzet vjetësh vjen *Fjalor serbokroatisht-shqip*, vepër kolektive e punuar në Institutin Albanologjik³. Sot leksikografia e shqipes me gjuhët e ish-republikave jugosllave ka përparuar shumë si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë. Hulumtimet në këtë fushë përbëjnë një temë studimore me interes të veçantë për të dyja gjuhët dhe Katedra e gjuhës shqipe në Universitetin e Beogradit me siguri do ta ketë në vëmendjen e saj. Ia vlen të bëhen krahasime p.sh. si është dhënë shqip në fjalorë të ndryshëm kjo ose ajo fjalë e serbishtes dhe të bëhen shpjegime e kritika për këtë.

Fjalori për të cilin do të flasim në këtë kumtesë, ka karakter thjesht praktik, për t'u shërbyer nevojave të para të zyrës dhe shkollës, prandaj nuk janë përfshirë shumë terma dhe as frazeologjia. Sipas një llogaritjeje të përafërt fjalori ka rreth 20.000 fjalë të serbishtes (do të ishte me shumë interes të dihej se sa fjalë të gjuhës shqipe u përgjigjen atyre). Nuk dihet se kush e ka hartuar fjalësin serbisht të këtij fjalori. Ndoshta V. Dančetović-i, por emri i tij shënohet te grupi i redaktorëve, ndërsa te grupi i bashkëpunëtorëve shënohen edhe dy gjuhëtarë të tjerë serbë: Zagorka Filipović, Ivan Brabec, që janë të panjohur për mua. Në parathënie pohohet se te ky fjalor është shtuar "një sasi fjalësh aktuale që u mungojnë fjalorëve të tjerë". Në këtë vështrim fjalori mund të hulumtohet edhe për ndonjë të re që sjell në leksikografinë e serbishtes. Është me interes të dihet se cilët janë fjalorët e tjerë serbisht - gjuhë e huaj që janë hartuar në Jugosllavinë e pasluftës me sistem politik socialist. Apo mos ndoshta fjalori serbokroatisht-shqip është i pari? E them këtë sepse dihet që kthesat politike pasqyrohen shpejt edhe në fjalorin e gjuhës, veçanërisht në leksikun politiko-shoqëror, prandaj është vlen të zbulohet cila është ajo "sasi fjalësh aktuale që u mungojnë fjalorëve të tjerë". Po kështu është me interes të shihet edhe përbërja leksikore e fjalës shqipe: si janë dhënë shqip ato fjalët aktuale të serbishtes? Siç e përmenda, ky fjalor ka mbetur në harresë për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve midis Shqipërisë e Jugosllavisë në verën e vitit 1948. Por ai meriton të shqyrtohet për të ndriçuar fillimet e lëvizjeve leksikore në rendin e ri që u vendos në Shqipëri pas luftës. Ky fjalor mbetet i vetmi deri sot i hartuar me bashkëpunimin e gjuhëtarëve serbë e shqiptarë.

Sidoqoftë në këtë kumtesë nuk do ta shikojmë fjalorin nga ana leksikografike, por si dokument për ecurinë e shqipes letrare në periudhën kur u hartua. Në kohën kur u hartua fjalori, nuk kishte ende një gjuhë letrare shqipe të njëjtë e të përbashkët. Përdorshin varietete letrare sipas dy dialekteve

³ Abdullah Zajmi, Mehdi Bardhi, Sulejman Drini, Latif Mulaku, Gani Luboteni, Sitki Imami. *Fjalor serbokroatisht-shqip*. Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë, 1974, 1015 f.

kryesore: toskërishtes dhe gegërishtes. Është me rëndësi të vihet në dukje pohimi i mëposhtëm nga parathënia e fjalorit: “Si formë bazë në pjesën e shqipes është përdorur toskërishtja. Pranë saj janë vënë trajtat geqe sa herë që këto ndryshojnë shumë nga trajtat toske dhe sa herë që i mungon fjala toskërishtes”. Pranë trajtës së gegërishtes është, si rregull, shkurtimi *g* në kllapa (*g*). Në pajtim me këtë zgjedhje paskajorja e serbishtes është dhënë në pjesën shqipe me vetën e parë njëjës të së tashmes së dëftores: *boriti se - luftoj, zaustaviti - ndaloj, ndal, mbaj* etj. Me këtë rast le të kemi parasysh se ndër bashkëpunëtorët dhe redaktorët shqiptarë të fjalorit vetëm Eqrem Çabej e e ka pasur toskërishten si dialekt amtar (e folmja e Gjirokastrës), të tjerët janë Shkodra (Pashko Geci e Mark Ndoja) dhe nga Elbasani (Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Aleks Buda; nga këta A. Xhuvani përdori deri në fund elbanishten e tij tradicionale, kurse K. Cipoja dhe A. Buda atëherë po fillonin të shkruanin në toskërishten letrare, secili me parapëlqimet e veta fonetike e gramatikore).

Komisionit redaktues të fjalorit, përveç anës leksikografike, i është dashur të vendosë për disa çështje të drejtshkrimit dhe të trajtave gramatikore. Kështu që ky fjalor përbën një hap të parë të punës së kolegjinale të A. Xhuvanit, K. Cipos dhe E. Çabejt për dy udhëzuesit drejtshkrimorë që hartuan në bashkëpunim (1948, 1951), ku përveç drejtshkrimit, trajtohen edhe disa çështje të normës gramatikore. Por në këtë fjalor vihet re që redaktorët nuk u janë përmbajtur gjithnjë rregullave të drejtshkrimit të botuar më 1948, d.m.th. një vit pas daljes së fjalorit. Kështu, te drejtshkrimi 1948 përcaktohet se për toskërishten (duke ndjekur një praktikë mjaft të gjatë e të përhapur që nga Rilindja) në fund të fjalës do të shkruhen bashkëtingëllore të shurdhëta: *rop, bres, shtok, dhëmp, qeq, vent* etj., kurse në gegërishte këto fjalë shkruhen me bashkëtingëllore fundore të zëshme: *rob, brez, shtog, dhëmb, qeqj, vend*. Megjithatë te parathënia e fjalorit redaktorët kanë shpjeguar se bashkëtingëlloret e zëshme në fund të fjalës, që kthehen në të shurdhëta në toskërishte, u lanë të zëshme si në gegërishte “meqë në toskërishte ndërrimi nuk është i përgjithshëm, p.sh. *zog, djeg; vënd, tund; elb, trëmb; gaz, zbraz; bredh, i madh; div, hov*”. Pra, është zbatuar që atëherë rregulla e sotme, e vendosur përfundimisht te udhëzuesi drejtshkrimor i vitit 1956. Vlen të përmendet se udhëzuesi drejtshkrimor i vitit 1951 pranonte dy mënyra shkrimi për toskërishten: *elp, breth* etj., dhe *elb, bredh* etj., duke hedhur kështu një hap afrimi me trajtat e cilësuar si të gegërishtes. Por aty-këtu del edhe ndonjë trajtë e toskërishtes, p.sh. *trunk* (deblo) për *trung*.

Një tjetër pikë dallimi ndërmjet traditës letrare geqe dhe asaj toske është shkrimi me *e* ose me *ë* te fjalët ku kjo zanore ndodhet para një bashkëtingëllorej hundore (*vend - vënd*). Te drejtshkrimi 1948 nuk flitet shprehimisht për këtë kategori fjalësh, por jepen disa shembuj te paragrafi “Emnat oksitonë”, nga të cilët vërehet se edhe në toskërishte ato fjalë do të shkruhen me *e*: *denk - dengu*,

qenq - qengji, vent - vendi. Edhe te ky fjalor i botuar një vit para drejtshkrimit fjalët e kategorisë së mësipërme dalin të shkruara përgjithësisht me *e*, si p.sh.: *gjemb* (bodlja), *shemb* (rušiti), *shembëll* (primer), *shembullor* (primeran), *tremb* (uplašiti), *thembër* (peta), *zemër, i përzemërt, zemëroj* (srce, srdačan, srditi); *mbrenda, i mbrendshëm, mbrendi* (unutra, unutrašnji, unutrašnjost), *mend, i çmendë, çmendinë* (pamet, lud, ludnica), por *çmëndem* (ludeti), *i dendur* (gust), *dhenar, dhenare* (ovčar, ovčarica), por *dhënsh* (ovčji), *kuvend, kuvendoj* (skupština, razgovor, razgovoriti), *përmend* (spomenuti), *parmendë* (ralo), *qendër, qendror*, (centar, centrala), *të qenë* (biće), *vend* (mesto), *vendës* (meštanin). Por kemi gjetur edhe disa fjalë të shkruara me *ë* sipas traditës mbizotëruese të toskërishtes: (*më*) *dhëmb*, (boleti), *më dhëmb kryet, i shtrëmbët* (kriv), *shtëmbëroj* (kriviti, nakriviti); *argjënd* (srebro), *gjëndje* (stanje). Këto mund të shpjegohen si luhatje të rastit në përdorim, kurse zgjidhja njësuere për shkrimin me *e* si për gegërishten, ashtu edhe për toskërishten mund të quhet e vendosur që në atë kohë.⁴

Për emrat që në gegërishte kanë zanoren *a* të theksuar të ndjekur nga një bashkëtingëllore hundore dhe në toskërishte zanoren *ë* të theksuar, drejtshkrimi i vitit 1948 nuk mban qëndrim shprehimisht, por te paragrafi “Emnat oksitonë” jepen vetëm dy shembuj si: *dhëmb - dhëmbi* (t) – *dhamb - dhambi* (g), *lënk - lëngu* (t) – *lang - langu* (g). Këta shembuj lënë të kuptohet se pranoheshin dy mënyra shkrimi, me *a* për gegërishten dhe me *ë* për toskërishten.⁵

Në pajtim edhe me rregullat e Komisionit Letrar, një numër emrash mashkullorë (shumica e të cilëve kanë qenë dikur asnjans) janë shkruar me *ë* fundore sipas shqiptimit të toskërishtes (dikur edhe të gegërishtes), p.sh.: *brumë* (testo), *djathë* (sir), *drithë* (žito), *dyllë* (vosak), *grurë* (pšenica), por edhe *grur* (žito), *gjumë* (san), *lumë* (reka)⁶, *mjaltë* (med) etj.

Një çështje drejtshkrimore ku toskërishtja e gegërishtja kanë pasur dallime, është shkrimi i fjalëve me *sh/zh/ç* nistore (parashtesë ose jo) përpara një bashkëtingëlloresje të shurdhët. Toskërishtja tradicionalisht ka parapëlqyer shkrimin me *ç*-, në pajtim me shqiptimin e të folmeve (sidomos jugore) të saj, kurse gegërishtja shkrimin me *sh*-, përkatësisht *zh*-. Te udhëzuesit drejtshkrimorë 1948 e 1951 kjo çështje nuk trajtohet. *Fjalori i gjuhës shqipe* i vitit 1954 (më tej FGjSh) ka dy palë trajta, me *ç*- dhe me *sh*- a *zh*-, por trajtat me *sh*- dalin më të këshillueshme për t’u përdorur, pasi si rregull, te ato jepet dhe shpjegimi i fjalës.⁷

⁴ Krejt papritur te drejtshkrimi i vitit 1951 këto fjalë dalin të shkruara me *ë*: *qënaq/qëngj – qëngji, vënt/vënd – vëndi* (paragrafi 14, Emrat oksitonë).

⁵ Këtë praktikë ka ndjekur edhe “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954), ku gjejmë edhe kambë, lang edhe këmbë, lëng (shpjegimi i fjalës jepet zakonisht te trajtat e toskërishtes, ndonjëher në formë të shkurtuar edhe te trajtat e gegërishtes).

⁶ Te rregullat drejtshkrimore të vitit 1948 bëhet përjashtim vetëm për këtë fjalë: në gegërishte do të shkruhet *lum*, në toskërishte *lumë*

⁷ Çifte të tilla te ky fjalor janë: *çfaq - shfaq, çfaqje - shfaqje, çfaros - shfaros, çfarosje - shfarosje*,

Fjalori serbokroatisht-shqip që po shqyrtojmë, është një hap përpara në krahasim me FGjSh, sepse mbizotërojnë trajtat me *sh-*, si p.sh. *shfryj* (izduvati se), *shkarkim*, *shkarkoj* (istovar, istovariti), *shkëmbej* (razmeniti), *shkul* (gozhdën) (otkovati), *shkoq* (okruniti), *shkreh* (armët) (opaliti), *shkrij* (rastapati), *shkul* (čupati), *shpalos* (razviti), *shpall*, *shpallje* (objaviti, objava), *shpërblim* (nagrada), *shpërdorim* (pronevera), *shpërndaj* (rasturati), *shpif*, *shpifje* (kleveta, klevetati), *shpik*, *shpikje* (pronalaziti, pronalazak), *shpoj* (probušiti), *shprish* (rasplesti), *shqep* (rasporiti), *shqetësohem* (uznemiriti), *shthur* (rasplesti); *zhduk* (ukloniti) etj., dhe për këto nuk ka dysorë drejtshkrimorë me *ç-*. Kemi gjetur vetëm këto fjalë të shkruara me *ç-* nistore: *çfaqem* (pokazati), *çfaqje* (prikazivanje), *çfaros*, *çfarosje* (istrebiti, istrebljenje).

Dendur janë vërejtur (edhe vërehen) luhatje në shkrimin e zanores ë paratheksore te fjalët e prejardhura prej një teme më ë, kur prapashtesa pas saj nis me bashkëtingëllore. Në këtë fjalor është e dukshme prirja për ta ruajtur në shkrim zanoren ë, d.m.th. ashtu siç është rregulla e sotme, p.sh.: *anëtar* (član), *botëror* (svetski), *drejtësi drejtësisht* (pravda, pravo), *frikësoj* (strašiti), por edhe *friksoj* (uplašiti), *frymëzoj*, *frymëzim* (nadahnuti, nadahnuće), *gjatësi* (dužina), *gjerësi gjanësi* (širina), *gjithësi* (svemir), *hollësi* (tankoća), *këmbësor kambësuer* (pešak), *mirësi përmirësohem* (dobrota, poboljšati), *plotësoj plotësim* (popuniti, popunjavanje), *qetësi* (tišina), *shpejtësi* (brzina), *tokësor* (zemaljski), *trashësi* (debljina), *thatësirë* (suša), *thellësi* (dubina), *udhëtar* (putnik), *udhëtim*, *udhëtoj* (put, putovati), *vështirësi* (poteškoća) etj., por: *coptoj* (komadati), *puntor* (radnik).

çfryj - *shfryj*, *çfrytëzim* - *shfrytëzim*, *çfrytëzonjës* - *shfrytëzonjës* *shfrytëzues*, *çkallmoj* - *shkallmoj*, *çkalloj* - *shkalloj*, *çkarkim* - *shkarkim*, *çkatërraq* - *shkatërraq*, *çkatërrim* - *shkatërrim*, *çkatërrimtar* - *shkatërrimtar*, *çkatërroj* - *shkatërroj*, *çkëlqej* - *shkëlqej*, *çkëlqim* - *shkëlqim*, *çkëmbej* - *shkëmbej*, *çkëmbim* - *shkëmbim*, *çkëput* - *shkëput*, *çkëputje* - *shkëputje*, *çkërfitem* - *shkërfitem*, *çkoq* - *shkoq*, *çkoqit* - *shkoqit*, *çkoqitje* - *shkoqitje*, *çkreh* - *shkreh*, *çkrep* - *shkrep*, *çkrepëtimë* - *shkrepëtimë*, *çkrepëtim* - *shkrepëtim*, *çkrif* - *shkrif*, *çkriftoj* - *shkrifëtoj*, *çkrij* - *shkrij*, *çkrirje* - *shkrirje*, *çkrirës* - *shkrirës*, *çkrimb* - *shkrymb*, *çkujdesem* - *shkujdesem*, *çkujdesje* - *shkujdesje*, *çkul* - *shkul*, *çkundërmon* - *shkundërmon*, *çpabesem* - *shpabesem*, *çpalos* - *shpalos*, *çpall* - *shpall*, *çpallës* - *shpallës*, *çpallje* - *shpallje*, *çpenkoj* - *shpenkoj*, *çpërblej* - *shpërblej*, *çpërblesë* - *shpërblesë*, *çpërblestar* - *shpërblestar*, *çpërblim* - *shpërblim*, *çpërblimtar* - *shpërblimtar*, *çpërbljes* - *shpërbljes*, *çpif* - *shpif*, *çpifarak* - *shpifarak*, *çpifës* - *shpifës*, *çpifje* - *shpifje*, *çpihem* - *shpihem*, *çpik* - *shpik*, *çpikje* - *shpikje*, *çpim* - *shpim*, *çplaj* - *shplaj*, *çpoj* - *shpoj*, *çporr* - *shporr*, *çpronësim* - *shpronësim*, *çpronësoj* - *shpronësoj*, *çpyllëzim* - *shpyllëzim*, *çpyllëzoj* - *shpyllëzoj*, *çqep* - *shqep*, *çqetësim* - *shqetësim*, *çqetësoj* - *shqetësoj*, *çqit* - *shqit*, *çthur* - *shthur*, *i çthurur* - *i shthurur*. Me përjashtim të *çfaq*, *çfaqje*, *çfaros*, *çfarosje* te gjithë të tjerat shpjegimi jepet te trajta e shkruar me *sh-*. Nërsa për fjalët *çfajësim*, *çfajësohem*, *çfronësoj*, *çkishërim*, *çkishëroj*, *çkombëtarizoj*, *çkopsit*, *çkridhem*, *çkurdis*, *çkurorëzim*, *çkurorëzoj*, *çkyç*, *çpengoj*, *çpenguar* nuk ka trajtë dysore me *sh-*. Po kështu edhe për fjalët që shkruhen me *ç-/zh-*: *çdredh* - *zhdredh*, *i çdrejtë* - *i zhdrejtë*, *çduk* - *zhduk*, *çdukje* - *zhdukje* shpjegimi jepet te trajta me *zh-*. Por për fjalët *çvleftësim*, *çvleftësoj*, *çvulos* nuk është dhënë ndonjë trajtë me *zh-*, siç është vendosur me drejtshkrimin e sotshëm. Për *çbëj* është dhënë si dysor drejtshkrimor trajta *shbâj* e gegërishtes; trajta *zhbëj* nuk është përfshirë, por (te fjalori historik i S. E. Mann-it gjendet *zhbâj* si dysor drejtshkrimor i *shbâj*).

Po ashtu edhe te fjalët e prejardhura nga një temë më bashkëtingëllore, por që kanë një strukturë fonetiko-fjalëformuese të ngjashme me fjalët e grupit të mësipërm, p.sh.: *armiqësi* (neprijateljstvo), *besnikëri* (vernost), *bujqësi*, *bujqësor* (poljoprivreda, poljoprivredni), *fshatarësi* (seljaštvo), *hapësirë* (prostor), *keqësoj* (pogoršati), *kombësi* (nacionalnost), *kombëtar* (nacionalan), *lajmërim*, *lajmëroj* (objava, objaviti) - por *lajmtar* (glasnik), *ligësi* (pakost), *madhësi* (veličina), *malësor* (goranin), *miqësi*, *miqësor* (prijateljstvo, prijateljski), *mjekësi* (medicina), *pakësoj* (smanjiti), *plotësisht* (potpuno), *qytetëroj*, *qytetërim* (civilizovati, civilizacija), *shtetëror* (državni), *shtetëzoj*, *shtetëzim* (nacionalizovati, nacionalizacija), *trimëri* (hrabrost) etj., por *shëndetsor* (zdravstven), *shfrytzoj* (iskoristiti). Siç shihet, rastet kur nuk është shkruar zanorja ë janë shumë më pak sesa ato ku është shkruar.

Në drejtshkrimin e vitit 1948⁸ për fjalët e tipave të mësipërm përcaktohet se e ruajnë ë-në në trup të fjalës (p.sh.: *burrëri*, *mbarësi*, *mirësi*, *miqësi*, *pleqësi*, *shoqëri* etj.), ndërsa në gegërishte shkrimi i saj është fakultativ, d.m.th. *mbarësi*, *mirësi*, *pleqëni*, *burrëni*, *shoqëni* etj. ose *mbarsi*, *mirsi*, *pleqni*, *burrni*, *shoqni* etj. Në fjalor në raste të tilla trajta e gegërishtes ka shënimin (g), si p.sh. *anmiqsi*, *anmiqsor* (te neprijateljstvo, neprijateljski). Rregulla e sotme që përcakton shkrimin e zanores ë partheksore te tipat e mësipërm të fjalëve mbështet si te shqiptimi më i përgjithshëm letrar i pjesës më të madhe të tyre, ashtu edhe te synimi për të ruajtur strukturën morfologjike-fjalëformuese.

I përmenda këto për të treguar se ky fjalor është sprova e parë e gjuhësisë shqiptare për të ndërtuar dhe për të zbatuar rregulla më të përcaktuara drejtshkrimore, duke ndjekur vijën e pakësimit të dallimeve ndërmjet toskërishtes e gegërishtes atje ku ka qenë e mundshme, sa kohë që të dyja variantet letrare ishin në përdorim. Pas luftës, me zhdukjen e analfabetizmit dhe shtrirjen e rrjetit shkollor në mbarë vendin, me hapjen e shumë shkollave të mesme edhe atje ku më parë kishte pasur vetëm shkollë fillore, me ngritjen e arsimit të lartë, me shumëfishimin e tirazheve të shtypit e të botimeve, me shtrirjen e radiodifuzionit në mbarë vendin, zhvillimi i gjuhës letrare eci me ritme më të shpejta. Themelimi i Institutit të Shkencave, që u ngarkua nga shteti të merrej me gjuhën duke përcaktuar rregullat e drejtshkrimit, duke hartuar gramatikën shkencore, fjalorin (e parë) shpjegues dhe duke përpunuar terminologjinë e degëve të ndryshme të shkencës e të teknikës, ishte një faktor i rëndësishëm për planifikimin gjuhësor.⁹ Ecuria e këtij procesi dhe arsyet pse shqipja e sotme standarde është kjo që

⁸ E njëjta rregull ruhet edhe te drejtshkrimi i vitit 1951.

⁹ Maximilan Lambertz-i në recensionin për librin e Aleksandër Xhuvanit "Për pastërtinë e gjuhës shqipe" (Tiranë, 1956), ndër faktorët që sollën zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe në shtetin e pavarur shqiptar thekson edhe veprimtarinë e Institutit të Shkencave "që punon në mënyrë mjaft serioze e me rreptësi shkencore dhe që merret në radhë të parë me çështjen e gjuhës letrare, të gjuhës së shkollës, të drejtshkrimit, me studimin e dialekteve, me regjistrimin e fjalëve të pambledhura." *Lingua posnaniensis* VIII (1960), f. 293-302.

është, përbëjnë një temë tjetër, vërtet shumë tërheqëse e me interes shkencor të përhershëm, por që i kapërcen caqet e kësaj kumtese.

Por këtu do të përmend një pjesë nga paradhënia “Ortografisë” së vitit 1951: “... që prej Rilindjes e tëhu, duke u shkruar gjuha e duke u përdorur si mjet kulture e marrëdhëniesh shoqërore, ka marrë një rrugë të mbarë në punën e zhvillimit e të unifikimit të saj, janë kristalizuar, thuajse pakuptueshëm, disa rregulla të gjuhës dhe është bërë njëfarë afrimi në mes të toskërishtes e të gegërishtes, duke e influencuar e para të dytën në punë të morfologjisë dhe e dyta të parën në punë të leksikut.... Si bazë për caktimin e rregullave drejtshkrimore është marrë fonetika e gjuhës, rryma e zhvillimit të saj në këto kohë të fundit dhe tendenca për t’i afruar sa është e mundur më shumë të dy dialektet, toskërishten e gegërishten... Është marrë parasysh edhe rryma e zhvillimit të gjuhës, e cila lëkundet ende në shumë fluktuacione ... këto rregulla janë hartuar si të ngulitura për ato pika, që gjuha, duke u shkruar, i ka kristalizuar vetë në këtë gjeneratë të fundit.”¹⁰ Nga citati i mësipërm und të vërejmë disa tipare të ecursisë së zhvillimit të gjuhës letrare dhe të përcaktimit të rregullave drejtshkrimore: a) gjuha e shkruar ka ecur drejt afrimit të varianteve dialektore duke u përzgjedhur e duke u përhapur format më të përbashkëta; b) ky proces ka rrjedhur “thuajse pakuptueshëm”, d.m.th. jo me ndërhyrjen e gjuhëtarëve, por për meritë të “procesit të çkrahinarizimit dhe përgjithësimit”, siç e kishte quajtur K. Cipoja¹¹; c) është zhvilluar një lloj ndërveprimi dialektor, si në gjuhën e folur, ashtu edhe në gjuhën e shkruar, gjatë të cilit luhatjet e shumta të trajtave gramatikore në gegërishte janë thjeshtuar nën ndikimin e toskërishtes, e cila ndërkaq ka përvetësuar fjalë e klasa fjalësh nga gegërishtja; ç) në përcaktimin e rregullave të drejtshkrimit është zbatuar më fort parimi fonetik (“fonetika e gjuhës”) dhe prirja për t’i afruar sa më shumë toskërishten me gegërishten; d) gjuhëtarët kanë përcaktuar rregulla të prera për ato pika që gjuha i kishte kristalizuar vetë; në pikat ku vëreheshin ende luhatje të theksuara, kanë lënë në fuqi rregulla të veçanta për toskërishten e për gegërishten, duke ia lënë kohës të vepronte.

Në parathënien e mësipërme përmendet edhe serbokroatishtja si gjuhë ku rregullat drejtshkrimore nuk ishin ngulitur ende në atë kohë. Proceset e kristalizimit të normës drejtshkrimore e gramatikore në serbokroatishte, në njërën anë, dhe në gjuhën shqipe, në anën tjetër, janë zhvilluar në rrethana të veçanta historike-kulturore dhe gjuhësore, që janë hulumtuar e ndriçuar nga studiuesit e gjuhëve përkatëse. Por është e njohur se studimi i krahasuar i një dukurie në dy a më shumë gjuhë zbulon edhe anë të pavënare më parë. Prandaj mendoj që në

¹⁰ *Ortografia e gjuhës shqipe*. Punuar prej A. Xhuvanit, K. Cipos dhe E. Çabejt. Instituti i Shkencave. Tiranë, 1951, 27 f. Kuptohet lehtë nga stili se parathënia i përket penës së E. Çabejt.

¹¹ Kostasq Cipo, “Gjuhë dhe gramatikë”. - në: *Zëri i popullit*, 20 korrik 1949 (ribotuar te rev. *Gjuha jonë*, 2000, nr. 1–2).

veprimtarinë shkencore të kësaj katedre mund të përfshiheshin (së paku si tema diplomash) edhe vështrime të të tilla të krahasuara. Kodifikimi e stadardizimi i dy gjuhëve do të ishte besoj një temë tërheqëse.

Duke u rikthyer te fjalori serbokroatisht-shqip i vitit 1947, po përmendim se ai ka pa dyshim interes shkencor për historinë e leksikografisë shqipe. Pas tij, deri më 1954, janë botuar disa fjalorë dygjuhësh me rusishten (gjuha e vetme huaj që mësohej në shkollë deri nga fillimi i viteve '60)¹² dhe fjalori i parë shpjegues i shqipes¹³. Fjalori serbokroatisht-shqip dhe fjalorët e shqipes me rusishten (1950, 1951, 1954) janë burime të dorës së parë për të ndjekur pasurimin e leksikut të gjuhës shqipe, veçanërisht të leksikut politiko-shoqëror dhe tekniko-shkencor në periudhën 1945–1954. Ndoshta ndokujt nga studentët e kësaj katedre mund t'i pëlqejë si punim diplome tema "Vëzhgime mbi leksikun e shqipes në fjalorin serbokroatisht-shqip (1947)". Kjo jep dorë edhe për të bërë krahasime me serbishten, bie fjala për sa u përket turqizmeve dhe huazimeve moderne kulturore në të dyja gjuhët: ç'kanë të përbashkët, ç'kanë të ndryshme dhe pse, p.sh. *luga* dhe *uthulla* në shqipen janë fjalë vendi, ndërsa në serbishte *kašika* dhe *sirće* janë turqizma; po kështu mund të hetohen sllavizmat e shqipes sipas këtij fjalori dhe brenda tyre serbizmat. Kur të jetë i renditur fjalësi shqip alfabetikisht, vetvetiu do të ketë mundësi edhe për vështrime të tjera, p.sh. cilat janë fjalët shqipe të shënuara si të gegërishtes dhe si perceptohen ato në ndjenjën e sotme gjuhësore, cilat fjalë shqipe të këtij fjalori mungojnë në fjalorët e tjerë të shqipes dhe pse, me sa fjalë të shqipes u përgjigjet ky fjalor rreth 20 mijë fjalëve të serbishtes etj.

Rasti i mirëpritur i kësaj konference të vyer bëri që të vijë në vëmendjen e studiuesve, pas 75 vjetësh, vepra e parë e leksikografisë shqiptare të pasluftës, pikërisht ky fjalor i serbishtes me shqipen, në hartimin e të cilit ka marrë pjesë

¹² *Fjalor i shkurtër shqip-rusisht / Краткий албанско-русский словарь. Afro / около 12.000 fjalë / слов. Përpiluar nga / Составили R. D. Koçi dhe Dh. Skendi. Shtëpia botonjëse shtetërore e fjalorëve të huaj dhe nacionalë / Государственное издательство иностранных и национальных соварей. Moskë / Москва, 1950, 464 f.*

Fjalor i shkurtër shqip-rusisht / Краткий албанско-русский словарь. Përpiluar nga / Составители R. Koçi, A. Kostallari dhe Dh. Skendi. Botim i dytë, ripunuar e plotësuar nën redaktimin e / Издание второе, обработанное и дополненное под редакцией A. Kostallari. Përmban 13 fjalë / слов те shtojcën gramatikore të shkurtër të gjuhës shqipe përpiluar nga B. A. Serebrenjikov. Shtëpia botonjëse shtetërore e fjalorëve të huaj dhe nacionalë. / Государственное издательство иностранных и национальных соварей. Moskë / Москва, 1951, 547 f.

Fjalor rusisht-shqip. Punuar nga komisioni i fjalorit rusisht-shqip i Seksionit të gjuhës dhe letërsisë. Русско-албанский словарь. Составлен комиссией русско-албанского словаря при отделении языка и литературы. 25.000 fjalë/ слов. Redaktor A. Kostallari. Instituti i Shkencave të R.P. të Shqipërisë / Институт Наук Народной Рспублики Албани. Shtëpia botonjëse shtetërore e fjalorëve të huaj dhe nacionalë / Государственное издательство иностранных и национальных словарей. Moskë / Москва, 1954, 636 f.

¹³ *Fjalor i gjuhës shqipe. E punoi një komision i përbërë nga K. Cipo (kryetar), E. Çabej, M. Domi, A. Krajni, O. Myderrizi. Instituti i Shkencave të Sekcioni i gjuhës e i letërsisë. Tiranë, 1954, 648 f.*

edhe një nga profesorët e merituar të kësaj katedre, Vojislav S. Dančetović, duke bashkëpunuar me emra simbol të gjuhësisë shqiptare, si Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Eqrem Çabej. Le të shërbejë ky rast për të hedhur edhe ndonjë hap të ri, sado të vogël, në horizontet tashmë të hapura të bashkëpunimit shkencor ndërmjet nesh.

Dorđe BOŽOVIĆ¹

Fakulteti Filologjik i Beogradit

 <https://orcid.org/0000-0003-3028-5441>

MBI SHUMËSIN E SHQIPES NË KONTEKSTIN BALLKANIK²

Formimi i temës së shumësit të emrave në gjuhën shqipe paraqit një nga sistemet më të ndërlikuara morfologjike të kësaj gjuhe. Duke filluar me analizën formale, të përpunuar nga Bozhoviq (2021), në këtë kumtesë do të trajtojmë këtë dukuri edhe më tej, në kontekstin ballkanik – duke i krahasuar sistemet e formimit të shumësit në shqipen dhe në gjuhët e tjera ballkanike, që gjithashtu tregojnë shenja ristrukturimi morfosintaktik po në këtë fushë gramatikore.

Fjalët kyçe: numri shumës, gjuha shqipe, gjuhësi ballkanike.

§1. Në literaturë thuhet shpesh se gjuhët ballkanike – ku, në radhë të parë, nënkuptohen shqipja, gjuhët romane lindore dhe gjuhët sllave juglindore – kanë pësuar një prirje të fortë kah analitizmi në sistemet e tyre të lakimit. Tipare të përbashkëta strukturore të gjuhëve ballkanike – të ashtuquajturat *ballkanizma* – që i takojnë sistemit të lakimit, e që janë më shpesh të cituara në literaturë dhe të ekzaminuara më shumë nga studiuesit, e përfshijnë prapavendosjen e nyjes shquese dhe sinkretizimin e rasave, kryekrejet ai i rasave gjinore-dhanore (ku, përveç gjuhëve të lartpërmendura, përfshihet edhe greqishtja e re). Mirëpo tipare të përbashkëta strukturore brenda lakimit ekzistojnë poashtu edhe në kategoritë e tjera gramatikore të këtyre gjuhëve dhe ato nuk përfaqësojnë gjithmonë dhe jo domosdoshmërisht tendenca analitizimi. Në këtë punim pikërisht do të tregohet sesi njëra prej këtyre kategorive të ballkanizuara, por ama, jo në mënyrë analitike, është edhe kategoria gramatikore e numrit.

Kategoria gramatikore e numrit në të gjithë gjuhët ballkanike i përfshin dy anëtarë të kategorisë – numrin *njëjës* dhe numrin *shumës*. Shumësi zakonisht është

¹ djordje.bozovic@fil.bg.ac.rs

² Ky punim është prezantuar së pari në kuadër të *Seminarit XL Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare* në Prishtinë më 15–26 gusht 2022 dhe është botuar po aty.

anëtari më i markuar i kategorisë, si kuptimisht ashtu edhe morfologjikisht (shih Corbett 2000). Megjithatë, realizimi morfosintaktik i shumësit ka pësuar ndërrime të rëndësishme diakronike në krahasim me fazat më të vjetra të gjuhëve tona. Pra, kemi të bëjmë me një sërë inovacionesh formale, siç është rasti edhe me ballkanizmat e tjerë. Për ta vërtetuar këtë, sëpari do t'i shqyrtojmë më hollësisht gjendjen dhe të dhënat e gjuhës shqipe, pastaj ato të rumanishtes, dhe më në fund, ato të gjuhëve sllavoballkanike.

§2. **Shqipja.** Karakteristike për gjuhën e sotme shqipe janë strategji të shumëllojshme morfologjike për të formuar temën e shumësit të emrave. Nga një anë, këtu përfshihen shenja zero të pluralit (d.m.th. sinkretizmi formal midis temave të njëjësit dhe të shumësit, si p.sh. *një qen : disa qen*), kurse nga ana tjetër markimi i ndryshëm të pluralit, me anë të mbaresave të ndryshme (si p.sh. *një mal : disa mal-e*, me mbaresën e pluralit *-e*) ose me anë të alternimeve morfonologjike të fonemave brenda temës së fjalës (si p.sh. *një mashkull : disa meshkuj*, me metafoninë e zanoreve *a : e* dhe qiellzorizimin e bashkëtingëllores *ll : j*), ose me kombinimin e këto të dy dukuritë (si p.sh. *një breg : disa brigj-e*, me mbaresën e shumësit *-e* plus alternime morfonologjike *e : i* dhe *g : gj* në temën e fjalës).

Sipas *Gramatikës së gjuhës shqipe (Vëllimi I: Morfologjia)* të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, sinkretizmi në kategorinë e numrit del rregullisht tek emrat e gjinisë femërore me temën në zanore *-i, -e, -a, -o* (*lule, shami, rrufe, kala, pallto* etj.), si dhe tek emrat e gjinisë mashkullore me prapashtesën *-ës, -ues* (*blerës, mësues*) dhe *-as* (*prishtinas, maqedonas* etj.). Përveç atyre, këtu përfshihet edhe “një pjesë e emrave femërorë që mbarojnë me *-ë* të patheksuar, veç tyre që në shumës marrin prapashtesën *-a*”, si *kafshë, lopë, shtazë, ditë, gjuhë, këmbë, këngë, lugë, mollë, plagë, rrënjë, rrugë, shkallë, udhë* etj., si dhe “pak emra mashkullorë”, si *lot, qen, muaj, sy, thi, ballë, tru* etj. (Agalliu et al. 2002: 97).

Mbaresat që shërbejnë për formimin e temës së shumësit, me shkallë të ndryshme të prodhimtarisë, janë: *-e, -a, -ë, -nj, -ër, -enj, -inj, -ra* etj. Sipas *Gramatikës*:


“Për përdorimin e tyre, për karakterin e temave me të cilat bashkohen, sidomos për emrat mashkullorë, është vështirë të jepen rregulla plotësisht të përcaktuara. Luhajat që janë vënë re më parë në gjuhën e shkruar dhe që shfaqen tek-tuk edhe sot në ligjërimin e shkujdesur, shkaktohen si nga shumëllojshmëria e mjeteve dhe nga mungesa e një kufiri ndarës të qartë midis temave, ashtu edhe nga ndikimi i dialekteve.” (Po aty)

Kësaj vështirësie i kontribuon edhe fakti që një pjesë e konsiderueshme e emrave në fakt mund të formojnë dy ose më shumë tema të ndryshme në shumës,


me ose pa dallime në përdorim dhe në nuancat kuptimore. Për shembull, *grykë* – shumë *grykë* ose *gryk-a*, *copë* – shumë *copë* ose *cop-a*, *kohë* – me shumësin *kohë* por edhe *kohë-ra*, *flamur* – *flamuj* ose *flamur-ë* (me dallimin theksor), *vit* – *vjet* ose *vit-e*, *yll* – *yj* ose *yj-e* etj. Në disa raste na del edhe kombinimi i dy mbaresave tek i njëjti emër, si p.sh. tek emri *vëlla* – shumësi *vëlle-z-ër* (me alternim morfonologjik të temës plus dy mbaresa të shumësit *-ëz* dhe *-ër*), ose te *baba* : *baba-llar-ë*, *dervish* : *dervish-ler-ë* etj. (me mbaresën e huazuar nga turqishtja *-llar/ler* dhe mbaresën *-ë*), si dhe tek emri *gju* : *gju-nj-ë* (forma e dialektit tosk).

Formimi i shumësit në gjuhën shqipe e tërhoqi vëmendjen e shumë studiuesve, siç janë E. Çabej (2012 [1967]), B. Bokshi (2005 [1980]), Sh. Demiraj (1985), por edhe albanologët e huaj, si W. Fiedler (2007 [disertacioni më 1961]) e tjerët. Shqipja dihet se ka pësuar historikisht procesin e *singularizimit të pluralit* të trashëguar, pas apokopisë së rrokjeve fundore. Në këtë proces, temat e shumësit u rianalizuan si njëjës, kurse forma të trashëguara të njëjësit u mënjanuan. Shkaku i kësaj, u rishfaqën në gjuhë mbaresat dhe format e ndryshme të reja të shumësit për emra të ndryshëm, duke e krijuar kështu sistemin sinkronik më kompleks sesa ai i fazës më të vjetër, duke përfshirë edhe variacionin jo të papërfillshëm.

§3. Në kuadër të gjuhësisë formale, ky sistem morfologjik i numrit i gjuhës shqipe është përshkruar nga ne (Bozhoviq 2021), si sistemi i shpërndarë morfosintaktikisht midis kokave të ndryshme gramatikore në strukturën e frazës emërore, duke ndjekur analizën e kategorisë së numrit të zhvilluar nga Kramer (2016) brenda teorisë së morfologjisë së distribuar (DM). Këtu presupozohet se në strukturën e fjalës pasqyrohen marrëdhëniet hierarkike midis kokave të ndryshme gramatikore. Një emër, për shembull, do të përbëhet nga rrënja leksikore, që mbart kuptimin, e cila bashkohet me kokën kategorizuese emërore, të ashtuquajturën “*n-në* e vogël”, duke e krijuar kështu temën e fjalës, mbi të cilën atëherë do të renditen projeksionet e ndryshme të tjera funksionale, siç janë numri (Num), rasa (K) ose shquarsia (D) – sh. (1).



Mirëpo, ndërsa mbaresat e shumësit në shumicën e rasteve thjesht e realizojnë kokën gramatikore e numrit (Num) në strukturën e fjalës, në gjuhën shqipe, për shkak të singularizimit dhe të pasojave të tij, realizimi i kategorisë së numrit në fakt është shpërndarë formalisht midis kokës gramatikore të numrit (Num), ku realizohen shumica e mbaresave të rregullta (dhe më të reja) të shumësit, dhe kokës kategorizuese emërore, të ashtuquajtur “*n* e vogël”, ku faktikisht realizohet shumësi i parregullt, si dhe alternime të ndryshme morfonologjike brenda temës së fjalës, që janë pikërisht gjurmët e shumësit të vjetër të singularizuar, çka do të thotë të rianalizuar në gjuhën e sotme si pjesë e temës gramatikore të emrit – khs. (2).




Në vijim do të prezantoj shumë shkurtimisht vetëm sesi analiza e tillë funksionon edhe për gjuhët e tjera ballkanike, siç janë rumanishtja dhe sllavishtja e jugut.

§4. Rumanishtja. Në rumanishten është vërejtur një prirje për markimin e dyfishtë të shumësit, me anë të mbaresave si dhe alternimeve morfonologjike të temës së fjalës. Sipas autorëve të *The Oxford History of Romanian Morphology*, kjo është “një fakt që e veçon këtë gjuhë brenda familjes romane” (Maiden et al. 2021: 37). Kështu p.sh., *brad* ‘bredh’ – shumës *braz-i* me alternim të bashkëtingëllores *d* : *z* dhe mbaresën *-i* për shumësin e emrave mashkullorë, *poet* – shumës *poet-i* (poashtu), *urs* ‘ari’ – shumës *urş-i*, *artist* – shumës *artişt-i*. Emrat mashkullorë me bashkëtingëlloret fundore *-t* /*ts*/ dhe *-ş* /*j*/ dalin pa mbarese dhe ashtu e tregojnë sinkretizmin e temave të njëjësit dhe të shumësit, si p.sh. *moş* ‘plak’ – shumës *moş*, kurse emrat dhe mbiemrat që mbarojnë me prapaqielzorët *-c* /*k*/ dhe *-g* e formojnë shumësin vetëm me anë të alternimit të këtyre bashkëtingëlloreve me qielzorët *-ci* /*tʃ*/ dhe *-gi* /*dʒ*/, p.sh. *bunic* /*bunik*/ ‘gjysh’ – shumës *bunici* /*bunitʃ*/, *drag* ‘i dashur’ – shumës *dragi* /*dradʒ*/.

Në të gjithë këto raste, ashtu si në shqipen, alternimet morfonologjike shkaktohen nga formanti i pluralit të emrave mashkullorë *-i* (← **oi*), që e shkakton qielzorizimin (formanti ky i përbashkët i shqipes dhe i rumanishtes, dhe i vënë re si i tillë edhe nga Desnickaja 1976: 35). Dhe si në rastin e shumësve

të singularizuar të shqipes (shih më lartë), markimi i dyfishtë i shumësit të rumanishtes me anë të mbaresave dhe të alternimeve të temës gramatikore të fjalës, nënkupton përfshirjen e kokës kategorizuese “*n* e vogël” në realizimin e kategorisë gramatikore të numrit, si në (3) – fakti që vërtetohet formalisht, ndër të tjera, edhe nga sinkretizimi i temave me *-tj* dhe *-s* fundore.



Emrat femërorë, nga ana tjetër, e formojnë shumësin me më shumë mbaresa të ndryshme sesi mashkullorët, duke përfshirë këtu *-e*, *-i*, *-le* dhe *-uri* (kjo e fundit nga emrat e gjinisë asnjane), por ashtu si te mashkullorët, edhe tek emrat e gjinisë femërore shumësi mund të formohet me anë të mbaresës, ose me kombinim të mbaresës dhe të alternimit morfonologjik, që mund t’i përfshijë bashkëtingëlloret fundore ose zanoret brenda temës, ose edhe bashkëtingëlloret edhe zanoret njëherazi.


Si në shqipen, edhe në rumanishten është kryesisht e paparashikueshme cila mbaresë e shumësit do të bashkohet ndonjë emri të caktuar. Dhe si në shqipen, ka emra që mund t’i formojnë tema të ndryshme të shumësit (treguesi ky i ristrukturimit relativisht të vonë morfosintaktik në këto gjuhë), me anë të mbaresave *-uri*, *-e* ose *-i*, shpesh edhe me nuanca të ndryshme kuptimore, por jo gjithmonë, si p.sh. *trebi* ose *treburi* ‘punime’ (pa çfarëdo dallimi kuptimor), *vremi* ose *vremuri* ‘kohë’, etj.

§5. Sllavishtja e jugut. Situata e ngjashme vlen edhe për gjuhët sllave të jugut. Sipas P. Iviqit (khs. Ivić 1957; 1958), efektet e ballkanizimit shihen mirë në shpërndarjen gjeografike të kategorive gramatikore nëpër dialektet sllavojugore, nga Alpet sllovene në veriperëndim deri në brigjet e Detit të Zi dhe Egjeut në juglindje. Kështu, në sistemin e lakimit, dallimi mes rasave dhanore dhe vendore ruhet ende në gjuhën sllovene, por fshihet në serbokroatishten, dialektet lindore e së cilës, si dhe maqedonishtja dhe bullgarishtja, e kanë humbur lakimin e emrave gjithsesi. Ashtu edhe kategoria e numrit: vetëm sllovenishtja e ruan numrin dual nga parasllavishtja (p.sh. *žena* ‘grua’ : *žen-i* ‘dy gra’ – shumësi *žen-e* ‘gra’), kurse gjuhët e tjera sllave të jugut e kanë mënjeluar dualin.

Mirëpo, në gjuhët sllave juglindore (d.m.th., bullgarishten dhe maqedonishten), pra ato që janë më të ballkanizuara, vëzhgohen shenja ristrukturimi edhe të mëtejshëm të kategorisë së numrit. Përveç mbaresave *-i* për mashkullorët dhe femërorët dhe *-a* për emrat asnjans, në maqedonishten p.sh., kemi edhe mbaresat e reja të shumësit *-inja*, *-išta* dhe *-vci*, si në *tatko* ‘baba’ dhe *čičo* ‘xhaxha’ – shumë *tatko-vci*, *čičo-vci*. Dhe si në shqipen dhe në rumanishten, këto mbaresa mund të konkurrojnë për realizimin e pluralit edhe tek i njëjti emër, me ose pa dallime kuptimore, si p.sh. *kraj* ‘fund’ – shumë *kra-evi* dhe *kra-išta*, *pat* ‘udhë’ ose ‘herë’ – shumë *pat-i* (me kuptimin ‘herë’) dhe *pat-išta* (me kuptimin ‘udhë’).

Stankjević, madje, kështu i dallon katër kategori të shumësit në gjuhët maqedonase dhe bullgare: përveç shumësit të zakonshëm, kemi edhe “shumësin e numërimit” (forma me *-a* tek emrat mashkullorë, si gjurmë e dualit të vjetër, që përdoret me numërorët në gjuhën e sotme), si dhe shumësin kolektiv dhe atë “emocional”, që sipas Stankjevićit “është prodhimtar në bullgarishten, ku emrat mashkullorë mund t’i shtojnë prapashtesat *-išt(-a)*, *-ovc(-i)* ose *-ol’(-a)*” (Stankiewicz 1986: 118), p.sh. *dolove* (neutral) dhe *dolišta* (shumë emocional) ‘lugje’, *katove* dhe *kaštišta* ‘qoshe’, *trapove* dhe *trapišta* ‘gropa’, *gospoda* dhe *gospodinovci* ‘zotërinj’, *turci* dhe *turčol’a* ‘turq’, etj.

Duke pasur parasysh se në të gjithë këto raste dallohet qartë mbaresa e rregullt e pluralit *-i* ose *-a* nga prapashtesat fjalëformuese *-išt*, *-(o)vc*, *-inj* etj., edhe këtu na duket se në fakt kemi të bëjmë me realizimin e dyfishtë të shumësit, me anë të kokës funksionale të numrit (Num) edhe kokës kategorizuese “*n* e vogël”, ku formohet tema e fjalës (4).



§6. Të përfundojmë: markimi i dyfishtë i shumësit, ekzistenca e mjeteve të ndryshme gramatikore për formimin e temës së shumësit, shfaqja e mbaresave të reja dhe ristrukturimi i shumësit të trashëguar, janë indikative e një procesi të përbashkët morfosintaktik në gjuhët e lidhjes gjuhësore ballkanike. Formalisht, bëhet fjalë për shpërndarjen e mjeteve të realizimit të kategorisë së numrit nëpër kokat e ndryshme gramatikore në strukturën e frazës emërore, kështu që koka kategorizuese “*n*-ja e vogël”, që përndryshe kontribuon për formimin e temës së

fjalës, pas rianalizimit, merr edhe disa nga funksionet e realizimit të kategorisë gramatikore të numrit. Duke filluar me singularizimin e pluralit të shqipes, kjo dukuri është zgjeruar në masë të ndryshme edhe në gjuhët fqinje, romane dhe sllave ballkanike – fakti që na mundëson ta konsiderojmë edhe si një ballkanizëm, por të shqyrtuar me metoda të gramatikës formale. E rëndësishmja, nuk bëhet fjalë për analitizimin e një kategorie të lakimit, si në raste të tjera më të njohura të ballkanizmave në këto gjuhë, por përkundrazi, për ndërlikimin e mëtejshëm morfosintaktik të asaj kategorie. Dhe kjo, më në fund, na përmundëson që edhe lidhja gjuhësore ballkanike për t’u parë në një dritë të re.

Literatura

- Agalliu, F. et al. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe. Vëllimi I: Morfologjia* (Redaktor i vëllimit: prof. Sh. Demiraj). Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Bokshi, B. (2005). *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*. (Botim i dytë). Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- Bozhoviq, Gj. (2021). From Number Cycle to Split Plurality and Back in Albanian. *Balkanica et Slavia*, 1(2), 157–180.
- Corbett, G. (2000). *Number*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Çabej, E. (2012). *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*. Tiranë: Botime Çabej.
- Demiraj, Sh. (1985). Singularizimi i shumësit të emrave në gjuhën shqipe (vështrim historik). *Studime filologjike*, 39(4), 13–22.
- Desnickaja, A. (1976). Kategorija sobiratel’nosti i kategorija massy v istorii grammatičeskogo stroja albanskogo jazyka. In: A. Desnickaja (ed.), *Grammatičeskij stroj balkanskix jazykov* (5–105). Leningrad: Nauka.
- Fiedler, W. (2007). *Die Pluralbildung im Albanischen*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- Ivić, P. (1957). Značaj lingvističke geografije za uporedno i istorisko proučavanje južnoslovenskih jezika i njihovih odnosa prema ostalim slovenskim jezicima. *Južnoslovenski filolog*, 22, 179–206.
- Ivić, P. (1958). *Die serbokroatischen Dialekte: ihre Struktur und Entwicklung*. ‘s-Gravenhage: Mouton.
- Kramer, R. (2016). A split analysis of plurality: Number in Amharic. *Linguistic Inquiry*, 47(3), 527–559.
- Maiden, M. et al. (2021). *The Oxford History of Romanian Morphology*. Oxford: Oxford University Press.
- Stankiewicz, E. (1986). *The Slavic Languages*. Berlin: Mouton de Gruyter.

Dorđe Božović
Faculty of Philology, Belgrade

ON ALBANIAN PLURALS IN THE BALKAN CONTEXT

Summary

Formation of the plural stems in Albanian nouns represents one of the most complex morphological systems in this language. Following a formal analysis laid out by Bozhoviq (2021), in this paper we revisit this phenomenon in its Balkan context – by comparing the systems of plural formation in Albanian and in the other Balkan languages which, too, show signs of morphosyntactic restructuring in this particular grammatical domain.

Keywords: plural morphology, Albanian, Balkan linguistics.

Arben PRENDI¹

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

 <https://orcid.org/0009-0008-5795-4100>

TJETËRSIMI I IDENTITETIT, SHPRISHJA E TRADITËS DHE PËRPLASJET ME IDEOLOGJITË E REJA, NË ROMANET E MARTIN CAMAJT

Martin Camaj (1925-1992) është tashmë ndër shkrimtarët e rëndësishëm në letërsinë bashkëkohore shqiptare. Ai është autor edhe i tre romaneve, të cilët fatkeqësisht u botuan jashtë Shqipërisë dhe ashtu si krejt vepra e tij letrare, deri në vitet 1993 ishin pothuaj të panjohura gjatë regjimit komunist dhe të ndaluara. Është fjala për romanet “Diella” (1958), “Rrathë” (1978) dhe “Karpa” (1987).

Qëllimi i këtij punimi është të analizohen veçoritë artistike, tematike dhe përmbajtjesore të romaneve “Diella” (1958) dhe “Rrathë” (1978) në radhë të parë për larminë e cilësive që manifestojnë, por edhe për të vënë në fokus këtë lloj letrar, për shkak se në studimet letrare mbi veprën e autorit është theksuar më tepër profili i tij si poet. Për realizimin e punimit jemi mbështetur në analizën dhe interpretimin e tekstit në romanet e bëra objekt studimi. Artikulli ka arritur në përfundimin se Camaj si romancier mbetet origjinal në letërsinë shqipe, jo vetëm për nga veçantia stilistike e veprës, por edhe nga tematika dhe problematika e saj; nga ndërthurjet e imazheve mitike-legjendare me ato të jetës bashkëkohore, dhe të ardhme; mpleksjet e fateve të personazheve me fatin vendlindjes, eksplorimin e rrënjëve të qenies njerëzore, krizës së identitetit dhe vlerave të saj etiko-morale në bashkëkohësi. Dallohet në këto romane, ashtu sikurse në disa novela, parapëlqimi i autorit për “botët e shmangura”, larg vëmendjes së qytetërimit, në të cilat jehon përplasia mes traditave dhe ideologjive moderne. Objekt dhe subjekt i rrëfimit artistik është bota e malësive shqiptare të Veriut, me të cilat autori mbeti i lidhur përjetësisht edhe pse jetoi në zemër të Evropës Perëndimore. Veprat janë thurje e të njëjtës cohë, ndaj edhe fijet (motivet, shqetësimet) që i përshkojnë ato janë të ngjashme. Shkrimtari shqetësohet se shprishja e këtyre botëve, ku ai kaloi fëmijërinë dhe rininë e hershme, do të zhdukë edhe mbijetojat e vetme të një qytetërimi të lashtë me rrënjë deri ilire, indoevropiane.

Fjalët kyçe: Camaj romancier, traditë-ideologji në romanet e Camajt

¹ arben.prendi@unishk.edu.al

Në romanet “Djella” (1958) dhe “Rrathë” (1978) rrëfimi artistik nxjerr në pah dhe shpreh shqetësimin e autorit për shprishjen e botës së malësorit dhe malësive shqiptare përballë proceseve të reja shoqërore që ndodhin gjatë gjysmës së parë të shekullit të XX. Te “Djella” shprishja ndodh për shkak të lëvizjeve demografike, ndërsa tek “Rrathë” për shkak të ndërhyrjes së dhunshme të propagandës së regjimit komunist. Mund të thuhet se shqetësimi për këtë shprishje është një obsesion artistik që karakterizon të gjithë veprën letrare të Camajt në poezi, prozë dhe dramë. Ndoshta edhe për atë arsye që na thotë shkrimtari Ernest Koliqi: “Dukagjini, -ky vis ku u ruejten të paprekuna doket e burrnija stërgjyshore dhe ku banorët mund të njehen më tepër se ngjeti tepriçë katalilash ilirjanë kursye nga stuhia zvetnuese e kavaljetave, - Dukagjini, thom, tekembrâmja gjeti mjetin shprehës” (Camaj, Vep. I, 2010: 17). Camaj “...s’don qi burri i malsis të shikohet si specimen i një rrace të lashtë, objekt kureshtie për t’u vendue në një muzé. Nën leskrat xhixhilluese të një epiciteti anakronistik, syni vezhgues i tij kundron me zëmër të plasun rrudhat e shkaktueme nga úja, nga mudi keq i shpërblyem prej natyrës e njerzve e fatit, nga ndryshku i disa zakoneve dâmprûse, nga ngushtësia e vendit” (Camaj, Vep. I, 2010: 18).

Shprishja e traditës për shkak të migracionit apo emigracionit

Motivin e shkrimit të romanit “Djella” autori e përshkruan në komentin e veprës kur shprehet: “Për t’i treguar vetes se unë si emigrant nuk qenkësh shkëputë prej problemeve shqiptare zgjedha për romanin Djella dukuninë e dyndjeve të popullatës së Veriut drejt fushave e qyteteve të vendit tonë. [...] *Shpërngulja e njerëzisë që si motiv nuk do të më lëshonte tanë jetën*, në romanin Djella u fsheh mbas një perdje edhe për t’u ra ndesh trajtave të anshme apo pajambajtëse të realizmit socialist” (Camaj, Vep. I, 2010: 27). Romani në fjalë është shkruar rreth viteve 1956-1958 kur vetë Camaj ishte emigrant në Itali dhe me siguri është duke u përshtatur apo duke bërë përshtatjet e duhura me kulturën e vendit të ri, në një proces të ngjashëm me atë të personazheve në roman, të cilët të shkullur nga malësitë e tyre u duhet të lëshojnë rrënjë në tokën e re; çka përbën edhe një motiv të preferuar për “letërsinë e kufijve” (Hafizi, 2008: 25); për të shtuar më tej se: “kjo vepër edhe në këtë trajtë të përpunueme qëndron si nye e pazgjidhun në vargun e veprave në prozë që ndoqën, shegë e mbyllun së cilës i ka plasë vetëm lëvorja.” (Camaj, Vep. I, 2010: 28), çka nënkupton se temat, por edhe përmbajtjet e prekura në këtë roman, si: shpërnguljet e popullatave, emigracioni e migracionet, ndrrimet e zbehja e traditave, përplasjet mes traditave të provincave dhe jetës moderne të qendrave, ndërliqet mes trupit dhe shpirtit, ndjenjës e instinktit; do të dalin herë pas here edhe në prozat tjera.

Popullata e shpërngulur nga fshatrat malore pëson procesin e përvuajtur të ndryshimeve duke mbetur e cunguar, *në kufi gjeografik* (Hafizi, 2008: 29) dhe

kulturor, mes fshatit dhe qytetit, madje edhe e vendosur në një lagje në periferi të qytetit. Gjithashtu procesi i ndryshimeve të traditës, largimi prej saj për shkak të jetës moderne dhe arsimimit. Bardhi, personazhi kryesor, del si shenjë e këtyre ndryshimeve. Bardhi me familjen është shpërngulur në një lagje periferike të qytetit, pastaj në qendër të tij, por shkon e vjen herë pas here në një fshat fushor buzë kënetës, sepse është i punësuar si mësues atje: “Një herë tjetër tue kthye prej qytetit për katund, kalova me qëllim nëpër lagjen e vorfën të periferisë e cila i përngjet katundit sidomos në arkitekturë. Banorët e saj ishin shpërngulur nga malet e fushat dhe rueshin doke e mënyra jetese. As veten e s’e ndieshin qytetarë. Ishin të lidhun me fisin e tyne të përardhjes” (Camaj, Vepra I, 2010: 45).

Për malësorin shkolla e prish djalin, sepse ndërpret dhe shprish traditën. Fëmija dhe prindi e shohin botën ndryshe, dhe prindi fajëson veten pse djalin e ka dërguar në shkollë sepse lidhja mes breznive do të këputet dhe bashkë me të edhe tradita e përcjellë brez pas brezi. I ati i thotë të birit: “Dëshiroj me kuvendë me ty si me një shoq, por ndoshta nuk kemi me mujtë asnjani. Unë kam vjetët, ti ke shkollën, ti për mue je im birë, unë për ty malok” (Camaj, Vepra I, 2010: 28). Por megjithatë ai don për të birin shkollën dhe dijen që të jep ajo. Ndërkohë djali, Bardhi, i lë prindin në cakun e vet dhe largohet në kërkim të një bote më pak të ashpër dhe më të hapur: “Due ajër dhe një botë të hapët, pa skâje” (Camaj, Vepra I, 2010: 52). Bardhi bëhet mësues dhe shkrimtar (i padeklaruar) dhe e cilëson veten si: “... një kandil bishtuk ndezë në fushën e errët, natën, bân mâ dritë se një hyll i largët”. Ndërsa si shkrimtar ai thotë se “...dosha me shkruë për njerëz si ti e unë. S’dosha me u nda prej atyne që dosha mirë: ndiesitë e tyne ishin të mijat, fjala tyne, fjala ime” (Camaj, Vepra I, 2010: 33). Pra, Bardhi si mësues dhe si shkrimtar e sheh veten të lidhur me njerëzit e fshatit Ndërsanë ku punon si mësues, madje dëshiron të jetë mjeti shprehës i botës së tyre, por nuk ka asnjë lidhje të fortë me ta, në fakt ai është aty një kalimtar pa asgjë të vetën. Ndryshe nga Curri, personazhi tjetër, që synon të ndërtojë familjen dhe follenë e tij në Ndërsanë, pavarësisht se i paragjykuar prej fshatarëve që e shohin si kërcënim për ta, sepse ka një kulturë dhe traditë të ndryshme prej tyre. Por në fund as Curri, që vritet, as Bardhi që shkon e vjen pas pushimeve verore, nuk arrijnë të bëhen pjesë e fshatit Ndërsanë, ata shihen si të huaj dhe në një kuptim ata dështojnë të sjellin një ndryshim aty. I vetmi rezultat i të gjithë procesit është rrëfimi artistik i Bardhit për të, pra kronika, ditari artistik që përshkruan momente të procesit të shprishjes dhe ndërprerjes së traditës. Pra, Bardhi ka një rezultat si shkrimtar: rrëfimin artistik që e ka hedhur në ditarin e tij, në të tjerat duket se del i dështuar: “Krijimi im letrar, -shprehet tregimtari këtu, -ka diçka fragmentare në vetvete dhe për këtë fajn e ka koha jonë, edhe ajo fragmentare, aritmike në rrjedhën e vet. Koha na u sëmue mun në zemër nga ngjarjet që ndoqën. Pra, një kohë e tillë ishte kundër vetjes, njerëzve si unë e si ti. Andaj tregimi im deri në këtë pikë i ngjan një

shege të mbyllun: diçka ishte mbrendë që do të piquej dhe vetvetiu shpërthente përjashta, por koha që jetoshim ishte pothuajse e pa stinë, pa verë!” (Camaj, Vepra I, 2010: 136). Nuk është e qartë nëse ka rezultat misioni i tij si mësues, dhe është e qartë se është i dështuar si dashnor i mundshëm i Djellës, është i dështuar si ruajtës së traditës apo vijues i trashigimisë familjare: Shpresa e fejuara e tij në qytet, fejohej me dikënd tjetër, ndërsa aventura erotike me Sosen del më shumë si ëndërrim për të kompensuar mungesën e femrës në jetën e tij.

Në romanin “Djella” për malësin shprishja e traditës përjetohet në mënyrë dramatike si zhgënjim i përjetshëm dhe më e rëndë se vetë vdekja. Prindi vuan për shprishjen e traditës dhe zhdukjen e saj së shpejti: “Ti edhe pak e ke me ua dhanë dorën gjindjes ndëjun, si në Evropë. Kajherë e vë dorën në tamth e pyes: kur djali sot ndrro kështu, po nipi? Sugure, ka me i ardhë marre me thanë se i nipi i kuj është. Shkurt, djalo, më duket se si me qenë tue shkue me qiri fikët!” (Camaj, Vepra I, 2010: 53). Tradita nënkupton Kanunin ndërsa Kanuni njerëzit e dikurshëm që i përkasin një kohe tjetër, e cila në roman përshkruhet si e kaluar: “Kanunin e njihshin vetëm etnit tanë, ngulte kambë Curri, ata që jetojshin prej bukës së një are, të një dheu brez mbas brezit, e brez mbas brezit pishin ujin e një kroni e mbuloshin trupin e vet me zhgun të endun me leshin e dhenve të veta prej lindjes deri në vdekje. “Kaloi ajo kohë!” “Kaloi ajo kohë!” Pohoi edhe Curri”. (Camaj, Vepra I, 2010: 76).

Raporti mes njeriut të alfabetit, kulturës dhe analfabetit, malësit të ashpër, por praktik në veprimet thelbësore të jetës së tij, shfaqet përmes Bardhit, mësuesit dhe Currit, një malësor i zbritur në fshatin fushor, Djellës, të resë fshatare, të cilën e lakmojnë të dy burrat. Bardhi është poet, ëndërrimtar dhe pasiv duke ndjekur shtjellin e ndjenjave ndërsa Curri flet dhe vepron duke realizuar qëllimin: lidhjen me Diellën për të krijuar familjen e tij. Tek Curri instinkti për mbijetesë është i fortë dhe shtytës i veprimeve ndërsa tek Bardhi instinkti është erotik dhe për kënaqje të epshit (skenat me Sosen tek furrat e qymyrit, por edhe dëshira për të “përpjekur shtatin” me Djellën). Mund të jetë edhe ajo që vë re ndonjë studiues (Berisha, 1994: 54) se Curri përfaqëson vetjen e dytë të Bardhit, atë të lidhur me prejardhjen e tij, vetjen malësore dhe instinktuale, të cilën si njeri me kulturë që është, ai e ka shtypur në brendësi të vetvetes. Kjo përforcohet edhe më tepër me të dhënë se Curri vritet nga Cubi në kënetë, në grindje e sipër për Diellën. Udhëtimi i Bardhit shumë vite pas vdekjes së prindërve në malësitë e vendlindjes është një përpjekje e tij për të rindërtuar lidhjen me traditën, me të kaluarën, ku gjendet një pjesë e identitetit të tij.

Shprishja e traditës dhe përplasja me ideologjinë e dhunshme

Të jetuarit me problemet e shoqërisë shqiptare e ndjek Camajn edhe në romanin monumental “Rrathë” (1978) në të cilin shtjellon artistikisht rrëfimin

e madh për shpërndërrimet e kësaj shoqërie pas ardhjes në fuqi të regjimit komunist, ku kryetema është përplasja mes traditës identitare dhe ideologjisë së regjimit komunist, bashkë me mënyrën e jetesës që imponon ai. Ngjarjet vendosen në një malësi të veriut të Shqipërisë, në afërsi të detit. Episodi i parë i rrëfimit na paraqet thelbin e përplasjes mes përfaqësuesve të traditës malësore dhe aparatçikëve të regjimit komunist. Baci i quajtur edhe Folkloristi ka krijuar në fshatin e tij të lindjes një muze të traditës popullore, ku spikatë një maskë e vjetër e mbivlerësuar. Ka mbledhur gjithçka ka mundur në përpjekje për të ruajtur traditën materiale të krahinës, deri edhe këngë e rrëfime popullore. Por detyrohet që muzeun e tij t'ia dhurojë regjimit të ri, siç ishte rregull edhe me pasuri të tjera kulturore e shpirtërore të kohës, të cilat individët detyroheshin t'ia bënë dhuratë shtetit, megjithëse pa dëshirën e tyre. Nëse pasuritë nuk bëheshin dhuratë, atëherë regjimi i shtetëzonte vetë. Baci kupton se: “Kështu ka qenë e do të jetë: rrethanat krijojnë njerëzit dhe veprat e tyre!” (Camaj, Vepra 5, 2010: 30). Prej muzeut ai merr me leje vetëm një maskë me të cilën e ndien veten të lidhur dhe që mund t'i duhet në jetën e re me regjimin e ri. Baci/Folkloristi në moshë, është i papëlqyeshëm prej regjimit dhe funksionarëve të tij sepse bën një jetë të lirë, ndjek traditat e popullit që i përket, dhe s'do t'ia dijë për ideologjinë e re. Madje Bardhi/Përgjegjësi, funksionari i regjimit thotë qysh në fillim për të: “dam që nuk ia hoqëm kryet në fazën e parë të revolucionit!” (Camaj, Vepra 5, 2010: 53). Baci megjithëse në moshë është moskokëçarës për propagandën e regjimit madje e ironizon atë dhe njerëzit që i shërbejnë atij, siç është Bardhi. Ai është i përkushtuar ndaj folklorit, traditës popullore, ndaj thirret edhe Folkloristi. Agoni e gjen në malet e Rripës duke mbledhur nga goja e popullit këngë e përralla dhe duke kremtuar me ta festa të ndryshme të traditës popullore deri edhe fetare.

Bardhi, aparatçiku i regjimit komunist, “lkura e harushës” siç e thërrasin me përçmim bashkëvendësit, është i ashpër deri edhe me të vëllanë e tij, Drenashin, kryetar i një sekti fetar me tradita të hershme në krahinë, dhe kërkon zhdukjen e tij me çdo kusht. Ai është aparatçiku tipik i regjimit komunist që për ideale ideologjike është i gatshëm të bëhet vëllavrasës, nënkupto luftën klasore që u zhvillua në Shqipërinë komuniste, luftë e cila duhet të përfshinte të gjitha shtresat e shoqërisë, madje duhej zhvilluar edhe brenda familjes: “S'ishte e para herë që ai propozonte të zhibihej prej faqes së dheut bashkë me vëlla e farefis, si njollë e zezë e jetës së tij, e krahinës dhe e kombit, si sëmundje vdekjepruese, sëmundje që hapte varrë të reja në kurm...” (Camaj, Vepra 5, 2010: 57). Ideologjia e re ka ndërhyrë dhunshëm në traditën folklorike, zakonore, fetare deri edhe në atë familjare, në të cilën lidhja e vëllait me vëllanë është shumë e rëndësishme dhe jetike. Drenashi/Fetari është drejtues i një sekti fetar dhe vëllai i Bardhit/Përgjegjësit. Ai i është përkushtuar besimit fetar, me tradita të hershme në krahinë, por ka fituar urrejtjen e regjimit dhe të vëllait Bardhit, që është

funksionar i regjimit. Siç dihet gjatë regjimit socialist, pas luftës së ashpër ndaj fesë dhe besimit fetar në vitin 1967 Shqipëria u shpall vend ateist me kushtetutë. Bardhi, nëse regjimi do t'ia kërkojë edhe të vëllain do ta mohojë. Regjimi nuk njuh familje, por vetëm luftë klasash. Ideologjia marksiste-leniniste-staliniste e sulmoi ashpër strukturën e familjes tradicionale shqiptare në përgjithësi, duke shprishur atë me instrumentet dhe metodat e dhunës dhe persekutimit.

Në ligjërimin e Bardhit është terminologjia komuniste e dhunës: “zhdukje” “vendim drastik”, “njollë e zezë”, “smundje vdekjepruese”, “heqje koke” etj. Lufta klasore përfshin edhe brezin e ri me brezin e vjetër, ata ruajnë njëri-tjetrin kush gabon për ta eliminuar në momentin më të parë. Bardhi e parashikon se Ylli, (djali i shokut të tij të rënë në luftë dhe i sekretares së tij, të cilin për hir të kujtimit të shokut të tij e ka ndihmuar të bëjë karrierë), parashikon se do t'i bëjë gropën sapo të ketë mundësi bamirësit dhe mbështetësit të tij, gjë e cila në jetën tradicionale të malësorëve përbën një shkelje të normave etiko-morale, ndërsa për moralin e ri komunist përbën një sjellje normale. Në luftën e klasave dhe të brezave në shoqërinë socialiste nuk ka kompromis.

Agoni/Novelisti, gazetar dhe shkrimtar e gjen veten në shërbim të propagandës dhe kupton cektësinë, por edhe mashtrimet e sistemit duke nisur nga gjërat më të rëndomta, siç tregon riparimi nga punëtorët i një dyshemeje të kalbur, e cila mbulohet me një fletë shtroje linoleum për të fshehur këtë kalbëzim, i cili rrezikon në fakt, shembjen e dyshemesë. Ai kupton se kështu vepron regjimi dhe propaganda edhe në fusha të tjera të jetës. Madje edhe në letërsi ai kupton se vetë parimi i realizmit socialist se shkrimtari duhet të jetojë me hallet e popullit, në mënyrë që t'i pasqyrojë me realizëm në veprën letrare, është në fakt një mashtrim i madh për lexuesin, një propagandë ideologjike e letërsisë së re: “Shkrimtari asht një jush, masa vetë. Nëse shkrimtari përpiket të shlirohet prej lexuesvet, ata duhen t'i ngrehin grackën e ta kapin, pa pikën e dhimbës, si kurva kopilin” (Camaj, Vepra 5, 2010: 71). Agoni dërgohet nga gazeta lokale për të bërë kronikën e hyrjes së traktorëve në Rripë dhe për ta paraqitur atë si një ngjarje me rëndësi shoqërore për regjimin, si sukses të regjimit në malësitë shqiptare të Veriut.

Hyrja e traktorëve në Rripë në fakt nuk shënon thjesht një përparim teknologjik për ekonominë bujqësore, por synon të shndërrohet në një veprim me karakter ideologjik, për të prishur strukturën e jetës sociale dhe të traditave të krahinës, me qëllim nënshtrimin dhe indoktrinimin e saj më lehtë. Sepse sa kohë që populli mbahet fort pas traditave është e vështirë të ideologjizohet. Për ta shkatërruar lidhjen e njerëzve me identitetin e tyre, traditën regjimi fut në veprim traktorët me naftë dhe njëkohësisht traktorët që punojnë me karburant ideologjik. Bashkë me tokën që nënkupton traditën traktorët do të synojnë të thyejnë edhe identitetin shumëshekullor të malësorëve. Bardhi/Përgjegjësi e paraqet kështu

ngjarjen: “Zhurma e traktorëve të parë jo vetëm që duhet të zgjojë nga gjumi shekullor njerinë e Ripës, si thonë një palë, por lypset që ta trandë atë, ta shkundë që të bien prej tij të gjitha frytet e kalbëta të kalesës, doket dhe zakonet e vjetra e besimet tytëse të çdo rigate. Ato i randojnë ngrah aq sa njeriu ynë s’mund të bajë katër hapa përpara” (Camaj, Vepra 5, 2010: 87). Traktorët vetëm sa e simbolizojnë makinerinë e propagandës së regjimit të ri. Ata punojnë me karburant ideologjik dhe synimi i tyre nuk është shtimi i rendimentit të bujqësisë por “trandja” e jetës tradicionale të malësorëve për ta zëvendësuar me luftën e klasave në kolektivin socialist, me jetën e re socialiste.

Në pjesën e parë të romanit: “Rrathë uji”, ndryshimet sociale përshkruhen si rrathët e ujit, valët e të cilit hyjnë gradualisht në veprim. Këto ndryshime përshkruhen edhe simbolikisht përmes shtjellave të ujit nëntokësor që nuk dalin në sipërfaqe, por e përmytin krahinën dhe qytetin në lagështirë edhe vetë me frymën e tyre. Struktura e regjimit të ri përbëhet prej disa rrathëve që ndërpresin njëri-tjetrin, përmes tyre ai kontrollon të gjitha trajtat e jetës së individit dhe të vendit. Njerëzit ruhen të mos flasin hapur sepse kanë kuptuar se regjimi i përgjon, në mal thuhet se është shfaqur një ilegal, pritët ardhja e traktorëve në Ripë, është hapur gazeta lokale dhe propaganda ka një pallat në qendër të qytetit, pritët të ndërtohet një muze i ri. Ndërsa Drenashi/ Fetari është dënuar për shkak të përkushtimit ndaj besimit fetar dhe ka fituar urrejtjen e të vëllait Bardhit, funksionar i regjimit.

Agoni/Novelisti është personazhi që ngjan me një vetje të autorit, i bashkon edhe cilësia e shkrimtarit. Përmes përshkrimeve të Agonit është dhënë edhe jeta në fshatrat e thella malore ku regjimi është ende në hapat e parë për përmybsjen e jetës tradicionale, por këta hapa janë artificialë sepse përbëjnë një ndërhyrje të dhunshme në të. Botët e tilla të përshkruara me lirizëm dhe me detaje realiste, janë në qendër edhe tek novelat e Camajt. Përmes këtyre detajeve ndërtohen marrëdhëniet e njeriut me natyrën, nostalgjia e njeriut të qytetit për natyrën e fshatit malor, ku jeta rrjedh sipas ligjësisë parake të trashëguara brez pas brezit, dhe ku vetë ky njeriut i qytetit preket thellë në qenien e tij sepse rrëmon e gjen lidhjet e tij të këputura me këtë natyrë dhe me këtë mënyrë të jetuari brez pas brezi. Agoni/Novelisti me prejardhje nga fshati, ka mall për vendin ku shumë breza lindën, u rritën e vdiqën. Ai jeton në kufirin mes dy kohëve, kufi në të cilin bota e malësisë do të ndryshojë nga ndërhyrja e dhunshme e ideologjisë politike që sjell denatyrim të njeriut, por edhe të vetë natyrës së gjallë. Malësorët e Ripës, të rrahur e të vaditur me normat e ashpra, por të drejta e të barabarta të traditës së tyre zakonore, duhet të mësojnë të tjetërsohen e të dyzohen përballë njerëzve të regjimit të ri dhe përballë të tjerëve. Në thelb ata njerëz janë siç i përshkruan Baci/ Folkloristi: “Të shkolluem apo të pashkolluem, mendo çka të duash. Nëse mbetesh gjatë këtu, do të zbulosh se njerëzit mendojnë dhe andërojnë” (Camaj, Vepra 5, 2010: 203).

Në pjesën e dytë “Rrathë zjarmi” Agoni/Novelisti mbrrin në Rripën e Mesme dhe njih jetën e gjallë të malësive. Dërgohet me shërbim në malësi për të pasqyruar hyrjen e traktorëve atje. Sheh nga afër ndryshimet artificiale me të cilat ballafaqohet jeta e malësive ku ideologjia ka hyrë deri edhe në jetën dhe në fjalorin e barinjve të dhenve të cilët nën presionin e propagandës kanë përvetësuar disa terma propagandistikë dhe kërkojnë që mësimet e propagandës t’i vënë në jetë deri duke u bërë qesharakë, por edhe tragjikë në vetvete. Leshkuqi, përgjegjësi i barinjve është portretizuar si një surrogat ideologjik i sistemit të ri, gjysëm analfabet, por me ndërgjegje të lartë ideologjike. Siç e përshkruan një bari tjetër këtë kategori personazhesh, ai përbën “inteligencien e fshatit” në fakt katundarin e indoktrinuar që beson verbërisht tek propaganda e regjimit. Për këtë arsye ai edhe quhet Leshkuqi.

Shtirirja e elementit ideologjik në jetën e malësive e bën situatën karikatureske dhe artificiale. Citatet pseudoideologjike hyjnë në strukturën e ligjërit, por edhe në botën e malësorëve si “mish i huaj”. Për të qenë në rregull me sistemin, secilin veprim që bëjnë përpiqen ta argumentojnë së pari ideologjikisht, pastaj funksionalisht. Për shembull në episodin ku përshkruhet shembja e një kulle të vjetër të braktisur për të marrë gurët dhe lëndën drusore për të ndërtuar shkollën e re, muratori kryesor e argumenton para Novelistit/Agonit çështjen kështu: “Që, pra pjesa dërmuese e landës na duhet doemos për ndërtimin e godinës shkollore. Edhe ideologjikisht, thanë mësuesit e aktivistët tanë, arsyetohet të marrësh landën e vjetër, nëse hyn në punë, për të ndërtue diçka të re” (Camaj, Vepra 5, 2010: 142). Por sigurisht nuk mungon edhe shpotitja që malësori i rrahur me voj e me uthull me sundimtarë të rinj e të vjetër, i bën ideologjisë sa herë i jepet rasti, si në episodin kur Agoni/Novelisti që është edhe agronom me profesion, përpiqet ta këshillojë një malësor se çfarë duhet të bëjë me një copë tokë të ashpër, për ta kthyer në tokë të bereqetshme: “Domethanë, ti propozon me ba një revolucion të vogël në këtë grimcë dheu?” “S’marr vesh çka don me thanë ti me fjalën revolucion. Vërejtje Agoni. – Të thashë atë që edhe ti e di fare mirë se çka duhet me ba.” “E di se çka asht revolucion. – Tha kinse tue u mburrë katundari dhelpën. -Për shembull, unë baj atë që thue ti me këtë rrabe toke dhe mandej mbasi ta kemi vu për fije, vjen bashkësia apo ku ta di unë dhe e merr për vete. Kësaj i thonë revolucion.” (Camaj, Vepra 5, 2010: 153). Me shpoti katundari i malësisë ka përmbledhur përvetësimin e pronës private, tokës në këtë rast, nga shteti, nga bashkësia/kooperativa bujqësore. Ndërkohë është karikatureske edhe skena e kremtimit të barinjve, të cilët mezi presin të hanë mish, dhe kur ushqehen ngjasojnë me ujë e çakaj, me sa thuhet edhe pse ndërkohë në sofrat e malësorëve ka nisur të mungojë ushqimi tradicional për shkak të varfërisë dhe përvetësimit të mishit dhe bulmetit nga kooperativa, e cila ka plane për të realizuar për llogari të shtetit. Ekonomia socialiste rrezikon me

uri edhe vetë barinj të fshatarët, të cilët kishin mbijetuar në shekuj me maleve e luginave me prodhimet e tyre bujqësore e blegtorale si dhe me mjeshtritë e fituara në shekuj nga tradita. Regjimi i ri, veç të tjerash po i rrezikonte malësorët edhe me uri.

Leshkuqi, “intelektuali” i barinjve është për çrrënjosjen e të kaluarës, traditës dhe edukimin e masave sipas ideologjisë së re. Ndërsa Baci/Folkloristi me dhimbje e shpreh qartë atë që është duke ndodhur në këtë hapësirë: “Disa e mbajnë si mbrapambetje pajen shpirtnore të së kaluemes, disa donë të ndërrojnë gjithçka menjëherë pa ditë se me çka duhet zëvendësue gjaja e shlyeme prej faqes së dheut. Të gjithë - çoi zanin tue i tregue barijtë me gisht përreth vërviten në pellgun e shijes folklorike dhe nëse përpiqen të dalin andej, pa qenë të shtitëruem maparë në tjera shkolla arti, mbeten pa gja si peshku në zall” (Camaj, Vepra 5, 2010: 221). Ndryshon madje edhe kanga e këngëtarit të ri me rapsodin e vjetër, ndryshon vallja e barijve gjysëm të dehur me vallen tradicionale, shenja të ndërprerjes së traditës edhe në traditën muzikore e artistike. Ndërprerja e kësaj tradite është gjithashtu me rëndësi për regjimin e ri dhe propagandën, sepse synohet të krijohet një “art i ri” i shkëputur nga kjo traditë.

Në atmosferë është e pranishme frika dhe ngurrimi i malësorëve për të folur hapur për shkak të “luftës së klasave”. Ata që e kishin ruajtur si vlerë të traditës së tyre etiko-morale të folur in e drejtëpërdrejtë të vërtetë dhe të sigurtë tashmë do të jenë të detyruar ose të heshtin ose kur të flasin të flasin “kodra mbas bregut”. Agoni/Novelisti është ngarkuar nga regjimi edhe për të marrë informacion për illegalin, kush është dhe nga fshihet. Shkrimtari me shqetësim paraqet mënyrën e rekrutimit të njerëzve në shërbim të regjimit, sipas parimit se të gjithë duhet të ndihmojnë për të luftuar armikun e klasës aq sa edhe Agoni, agronom e shkrimtar duhet të hetojë për illegalin, kundërshtarin e regjimit për të cilin thuhet se shfaqet diku në bjeshkë. Baci e përçmon shkrimtarin që punon të bëhet një vegël qorre e regjimit: “Edhe ti po dashke me qenë një asish - vijoi Baci – që me çdo kusht don të ketë dikend për të luftue, një lodër fëmijësh me emën “anmik”? Nganjëherë kam përshtypjen se me pasë një anmik na qenka për shumë kend ndër ne e domosdoshme dhe kjo psikozë përhapet prej breznie në brezni si sëmundje familiare” (Camaj, Vepra 5, 2010: 243). Baci shpjegon mekanizmin e propagandës socialiste që krijon psikozën e armikut që gjendej kudo, në shoqëri, në familje, në punë etj. Përmes krijimit të kësaj psikoze regjimi e kishte më të lehtë të gjurmonte ata që mendonin ndryshe dhe t’i eliminonte ose t’i demaskonte. Pra nuk ekzistonte mirëbesimi midis malësorëve që gjithmonë kishin besuar tek fjala e dhënë dhe tek besa. Edhe kjo traditë do të vihej në rrezik për të sulmuar vetë identitetin e këtyre njerëzve të rritur me respektin për tjetrin, për të vërtetën, për nderin, dinjitetin, burrërinë etj.

Romani “Rrathë” synon të rrëfejë se si funksionon propaganda e regjimit për të kontrolluar jetën e individit dhe shoqërisë shqiptare nga ndërmarrjet e

punës nëpër qytete, tek jeta e barinjve e bashkësive të vogla fshatare në malësitë shqiptare; si dyzohen njerëzit nga dita në ditë; si propaganda ideologjike ndërhyjnë në të gjitha sferat e jetës sociale e familjare; dhe si përkundër zhvillimit të propaganduar, në fakt regjimi jo vetëm po e varfëronte fshatarin e malësive, por edhe po e zvetënonte duke e tjetërsuar dhe duke e zhveshur nga identiteti i tij i vërtetë. Bardhi, Agoni, Leshkuqi etj., bëhen gradualisht vegla të regjimit, madje disa, si Bardhi janë të gatshëm të vrasin vëllanë e tyre, vetëm e vetëm që të çojnë në vend direktivat e regjimit. Baci, Drenashi, Rapsodi, por edhe Sosja dhe Ilegali janë në anën tjetër të skenës, në krah të jetës së lirë, në harmoni me traditat e trashëguara, folklorike, fetare; dhe për ndryshime graduale të cilat e ruajnë identitetin e tyre e janë në pajtim me traditën e këtyre njerëzve, pa shtrëngime të dhunshme.

Siç mund të konstatohet lehtësisht, të gjitha skenat kanë në sfond rrënojat e të vjetrës, traditës dhe bëmat e propagandës së re, e cila trumbeton sukseset e regjimit të ri. Shtëpia muze e Bacit/Folkloristit bastiset nga komisioni për ngritjen e muzeut të ri sepse do të sekuestrohet muzeu i vjetër e do të ngrihet sipas kriterëve ideologjike muzeu i ri; në qytezë po ndërtohet një grup pallatesh të reja bri shtëpive të vjetra ose duke i shembur ato, ndërkohë hapësira ndërmjet tyre është e përmbytur në baltë dhe pluhur; në shtëpinë e vjetër ku qëndron për pak kohë Agoni me qira, ka mbetur një e moshuar e vetme, ndërsa e bija Zoja ka shkuar ku ka nevojë adheu; në Rripë po shembet një kullë e vjetër e lënda e saj po përdoret për të ndërtuar një shkollë të re; festa e barinjve dhe debatet mes mbrojtësve të traditës dhe atyre të ideologjisë së re zhvillohet mbi rrënojat e kështjellës së Qytecës. Hyrja e traktorëve në Rripën e Mesme shënon instalimin e regjimit të ri, në kuptimin real, pra të mjeteve dhe mekanizmave por edhe të propagandës ideologjike. Njëkohësisht ky moment shënon edhe cënimin e natyrës për të cilën thuhet se “ka ardhë dita e gjyqit për këtë vis e bimësi”. Tymrat dhe zhurmat që sjellin me vete makinat e traktorët shënojnë prishjen përfundimtare të bukurisë dhe qetësisë së natyrës, por edhe të jetës tradicionale dhe çiltërsisë së saj.

Në romanet e Camajt, sikurse edhe në poezi, vërehet adhurimi deri në mitizim i natyrës, bimësisë, pemëve, përrenjve, ujërave, kafshëve të egra e të buta, sidomos malit me të fshehtat e tij: “mali bar gjithçka me vete dhe bahet urë kah kalojnë egërsina e njeriu i prapët, shpirtën të mirë e të këqij. Derisa mali mbet mal, fsheh gjithçka në gji, përndryshe s’asht mal!” (Camaj, Vepra 5, 2010: 441). Edhe në përshkrimet e personazheve shpesh kemi krahasime të tipareve të tyre me ato të kafshëve tipike të këtyre zonave si: ujku, dhelpa, dhitë e egra, gjarpërinjtë, arusha etj. Camaj ka një adhurim për botën tradicionale dhe natyrën e egër, të pacënuar nga ndërhyrja e dhunshme e njeriut dhe kohës së re, dhe duket se këtë e shpreh përmes vërejtjeve dhe komenteve të Bacit/ Folkloristit, i cili thotë se traktorët ngjiten përpjetë malit: “për t’i kumtue alemit dhe polemit

një periudhë të re” (Camaj, Vepra 5, 2010: 296) dhe njëkohësisht i përqesh mjetet e regjimit të ri që e kanë të vështirë të ngjiten lart nëpër malësi. Me qesëndi populli i quan traktorët “nuse” dhe festën që bëhet për nder të ardhjes së tyre “dasmë”. Por siç vë re Baci/Folkloristi nëse traktorët vijnë, ata do të mbeten përjetë aty në malësi, sepse nuk mund të zbresin më poshtë, duke nënkuptuar bashkë me to edhe ngulitjen e infrastrukturës së regjimit të ri në malësi. Baci si njohës i thellë dhe me përvojë i traditës dhe jetës së malësive, nënkupto vetjen artistike të autorit, e përmbledh procesin në të cilin kishte hyrë kjo jetë me pak fjalë: “Jeta asht ma e kapërthyeme se sa kujton: atje thellë në terr, si mbas shpinës së dheut, vriten njerëz pa gjyq, pa kuvend; këtu presim modernizimin e jetës fletë-fletë, atje nalt- e shënoi ndërtesën ku ishte ngujue paria- i dalin rrajët në diell propagandës së rrejshme, ndërsa dikush ma i mendshëm dikund në katund i gjen zokthin andjes!” (Camaj, Vepra 5, 2010: 320).

Në pjesën e tretë: “Rrathë gjaku”, rrëfimi kalon nëpër një shtresë tjetër të tronditjes që ka pësuar bota e malësive nga ardhja e regjimit komunist, i cili është kundër besimeve fetare dhe njerëzve që e praktikojnë atë. Drenashi/Fetari dhe sekt i tij jetojnë në ilegalitet dhe të fshehur nga syri i sistemit. Baci/Folkloristi dhe Agoni/Novelisti marrin pjesë në një ceremoni fetare të këtij sekti të çuditshëm, për të cilin autori nuk bën me dije qartë, se cilit besim i përket. Vdekja e Bacit të moshuar është në një farë mënyre vdekje e traditës dhe e trashigimisë popullore. Ritual i me përgjakje para derës së mbyllur të përjetësisë në faltoren e fshehtë të sektit shënon edhe zhdukjen e sektit ose kalimin në ilegalitet të plotë. Agoni/Novelisti disa vite më vonë duke vizituar të njëjtin vend nuk gjen më asgjë nga sekt i, vetëm disa rrënoja të braktisura.

Agoni/Novelisti, duke qenë edhe agronom, gazetar dhe shkrimtar, është personazhi kompleks që lidh të tre pjesët e romanit dhe ndërkohë me përsiatjet dhe komentet e tij paraqet trajtat e ndryshme të jetës individuale dhe sociale. Në kërkim të identitetit të tij vetjak ai e ka të pamundur të përshtatet me sistemin, megjithëse është njëfarësoj pjesë parëndësishme e tij; të përshtatet me shoqërinë ku jeton, apo me botën femrave. Vetë ai është kontradiktor si njeri, si artist dhe si aktivist i sistemit. Si njeri kërkon të plotësojë qëllimin e jetës dhe ekzistencës, por dështon sepse Sosja/Blega nuk pranon të martohet me të dhe ai e përdhunon duke u njëjtësuar me Ilegalin, prej të cilit e shpëtoi nga përdhunimi. Pra nga përlavdërues i ndjenjave, ai bie pre e instinktit dhe dhunës. Ëndërron për një kasolle, mbas malit në Ripën e Poshtme, ku të realizojë lumturinë e tij me Blegën, por kjo nuk realizohet.

Si artist dështon sepse nuk arrin të afirmohet siç duhet përmes veprës së tij artistike, vetëm rastësisht djali i Soses/Blegës, (që mund të jetë edhe djali tij) ka arritur të vërë në skenë një pjesë teatrale për fëmijë në teatrin e kukullave të qytetit. Si artist, ai është në kundërshtim me veten si aktivist. Joshet nga bota e vjetër e traditave dhe misticizmit, nga folklori dhe kuvendimet e Bacit me

malësorë, joshet nga natyra e virgjër dhe jeta e botës së gjallë, duke u distancuar nga jeta e qytetit dhe zhvillimet sociale e teknologjike; por e ndien veten të lidhur me regjimin i cili i ka caktuar detyrë të hetojë për llegalin, të cilin dëshiron ta vrasë me duart e tij, si armik të supozuar të regjimit. Si aktivist dhe propagandist derdiku i sistemit e gjen veten të internuar për afro 20 vjet në fshatrat e Ripës, nga Bardhi/Përgjegjësi e pastaj edhe nga Ylli/ djali i Nushës. Këtë dështim e pranon edhe ai vetë mbas shumë vitesh ravgimesh nëpër Ripën e Mesme, Ripën e Epërme dhe Ripën e Poshtme duke pohuar në fund të romanit: “Na të dështuemit përfaqësojmë një epokë të tanë.” (Camaj, Vepra 5, 2010: 472).

Përfundime

Objekt dhe subjekt i rrëfimit artistik në romanet e Camajt është bota e malësorit dhe e malësive shqiptare të Veriut të Shqipërisë. Këto botë ai i sheh si mbijetoja të qytetërimit të vjetër shqiptar deri me rrënjë ilire e indoevropiane. Shprishja e traditës përbën shqetësim dhe temë në të dy romanet. Te “Djella” shpërnguljet e popullatës dhe ndikimi i arsimit e vënë atë në rrezik përballë mjedisit të ri dhe mënyrës tjetër të jetesës; te “Rathë” ndërhyrja e ideologjisë dhe propagandës së regjimit të ri ekërcënojnë traditën me zhdukje përfundimtare. Zhdukja e traditës është zhdukja e magjisë, bukurisë dhe vetë kuptimit të vetë jetës për malësorët. Zhdukja e traditës do të thotë për ta vdekje dhe zhdukje.

E reja përplaset me të vjetrën në formë ideologjike. Shoqëria tradicionale kapet mbas traditës së saj dhe e përjeton çdo ndryshim, aq më tepër të imponuar nga propaganda ideologjike si të huaj, si në romanin “Rathë”.

Në të dy romanet shpaloset kërkimi dhe synimi i identitetit në një mjedis në ndryshim, ku rreziku i tjetërsimit është real. Shprehet artistikisht shqetësimi se nëse traditat zhbëhen tërësisht dhe ndërkohë e reja nuk ka hedhur rrënjë, atëherë mbitheksohet humbja e identitetit dhe vështirësia për të pasur vijueshmërinë normale të procesit jetësor dhe shoqëror. Në të dy romanet kërkohet plotësimi i identitetit, por edhe i lumturisë, gjë që për Bardhin te “Djella” dhe Agonin te “Rathë” rezulton mision i pamundur, sepse vetë personazhet janë kontradiktore me veten, të keqkuptuar nga mjedisi ose të paafte për të komunikuar në të njëjtën kod me mjedisin edhe për shkak të disniveleve në formimin shpirtëror dhe intelektual.

Bardhi mësues dhe shkrimtar nuk ka sesi të gjejë gjuhën e përbashkët me Djellën, vashën fshatare të paarsimuar, madje ai joshet nga trupi i saj, jo nga mendja apo shpirti. Agoni, agronom dhe shkrimtar nuk ka sesi ta gjejë gjuhën e përbashkët me Sosen/ Blegën, malësoren e re e të bukur, kur i shpjegon ëndrrën e tij për jetën e lumtur “andej malit”, madje ai gabon edhe kur mendon se e ka gjetur kodin e komunikimit me të, duke e përdhunuar i nxitur instinkti më tepër se nga ndjenjat që ai mendonte se kishte për të.

Raporti mes të shkolluarit dhe analfabetit ose gjysëm analfabetit nxjerr në pah veçori të zhvillimit të shoqërisë, veçanërisht në malësitë shqiptare. Jo rastësisht personazhet kryesore janë të shkolluar: Bardhi mësuesi të “Djella”, Agoni/ Novelisti të “Rrathë” por edhe Baci/ Folkloristi, janë të shkolluar në një mjedis analfabet ose gjysëm analfabet por të “kulturuar” sipas modelit kulturor të traditës folklorike, ku kanuni, kënga, përralla dhe legjenda luajnë një rol të rëndësishëm.

Në të dy romanet përsiatjet dhe diskutimet për rolin e arsimit, artit dhe letërsisë në shoqëri janë afërmendësh të lidhura me qenien e personazheve shkrimtarë, që në një farë mënyre përfaqësojnë vetjet e Camajt. Bardhi synon të bëhet mjeti shprehës i popullit të tij, Agoni endet mes mjeteve artistike të traditës dhe letërsisë së re, dhe në fund akuzohet nga përfaqësuesi i propagandës për veprën armiqësore “Shtëpia andej malit” dhe e shpall veten si të dështuar.

Raporti mes ndjenjës dhe epshit përmes shpalimit të botës së personazheve. Bardhi të “Djella” priret fillimisht nga ndjenja të turbullta e poetike, por kupton se ato burojnë thjeshtë nga instinkti. Agoni/ Novelisti të “Rrathë” priret nga ndjenjat për Mësuesen/Zojën, por kupton se është viktimë e instinktit kur përdhunon Sosën/ Blegën në mal. Të dy personazhet, veç profesionit, Bardhi mësues e Agoni agronom, janë shkrimtarë edhe pse e njehin veten për shkrimtarë të dështuar.

Në të dy romanet Camaj shpalos adhurimin por edhe shqetësimin për shprishjen natyrës dhe traditës ku ruhen vlerat e identitetit njerëzor dhe kombëtar të një populli me origjinë të lashtë. Ardhja e traktorëve të zhurmshëm që vjellin tym të zi karburantesh në malësi, tek “Rrathë” përshkruhet si trandje e natyrës së gjallë, si katastrofë dhe cënim i virgjërisë së natyrës së gjithanshme. Këtë adhurim e mistifikim të natyrës dhe ishujve të izoluar ku ka mbijetuar tradita e kaluar dhe thelbi i identitetit të tyre e hasim edhe te romani “Karpa”.

Literatura

- Berisha, A. N. (1994). *Vepra letrare e Martin Camajt*. Kozencë: Radhonjtë e Zjarrit.
- Camaj, M. (2010). *Vepra 1, Diella*. Tiranë: Onufri.
- Camaj, M. (2010). *Vepra 5, Rrathë*. Tiranë: Onufri.
- Hafizi, A. (2008). *Letërsia e kufijve. (Përfaqja Magris-Camaj)*. Shkodër: Camaj-Pipa.
- Sinani, Sh. (2011). *Camaj i paskajuar*. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.

Arben Prendi
Luigj Gurakuqi University of Shkodra

**THE ALIENATION OF IDENTITY, THE BREAKING OF TRADITION AND THE COLLAPSE
WITH NEW IDEOLOGY, IN THE NOVELS OF MARTIN CAMAJ**

Summary

Martin Camaj (1925-1992) is already one of the important writers in contemporary Albanian literature. He is also the author of three novels, which unfortunately were published outside Albania and, like all his literary works, were almost unknown and banned during the communist regime until 1993. These are the novels "Diella" (1958), "Rrathë" (1978) and "Karpa" (1987). The purpose of this paper is to analyze the artistic, thematic and substantive features of the novels "Diella" (1958) and "Rrathë" (1978) primarily for the variety of qualities they manifest, but also to focus on this literary genre, because in literary studies on the author's work his profile as a poet has been emphasized more. For the realization of the paper we have relied on the analysis and interpretation of the text in the novels made the object of study. The article has reached the conclusion that Camaj as a novelist remains original in Albanian literature, not only for the stylistic uniqueness of the work, but also for its themes and problematics; for the combinations of mythical-legendary images with those of contemporary and future life, the entanglements of the characters' fates with the fate of their homeland, the exploration of the roots of the human being, the crisis of identity and its ethical-moral values in contemporary times. In these novels, as in some short stories, the author's preference for "avoided worlds", far from the attention of civilization, in which the clash between traditions and modern ideologies echoes. The object and subject of the artistic narrative is the world of the Albanian highlands of the North, with which the author remained eternally connected even though he lived in the heart of Western Europe. The works are woven from the same cloth, so the threads (motives, concerns) that run through them are similar. The writer worries that the dissolution of these worlds, where he spent his childhood and early youth, will also eliminate the only survivors of an ancient civilization with roots as far back as Illyrian, Indo-European.

Keywords: Camaj novelist, tradition-ideology in Camaj's novels

Naile R. MALA IMAMI¹

Universiteti i Beogradit, Fakulteti Filologjik

 <https://orcid.org/0009-0002-2059-7978>

GRUPE FJALËSH TË BASHKËLIDHURA ME FRAZELOGJIZMA SOMATIKË

Në këtë punim do të merremi me analizën kontrastive të frazeologjizmave somatikë *koka*, *dora* dhe *syri* në gjuhën shqipe dhe serbe, si dy gjuhë, gjenetikiisht jo të ngjashme. Gjithashtu do të japim një pasqyrë të shkurtër për fillimet e frazeologjisë në këto dy gjuhë. Studimi i somatizmave në kuadër të frazeologjisë është me rëndësi të veçantë, pasi në këtë mënyrë zbulohet dhe shihet bota e brendshme e njeriut, vendi i njeriut në të si edhe raporti i njeriut ndaj vetvetes. Përmes shembujve do t'i përcaktojmë ngjashmëritë dhe dallimet midis tyre. Për këtë punim kemi zgjedhur 120 frazeologjizma somatikë nga fjalorët përkatës dhe fjalori në dorëshkrim dhe më pas, përmes analizës kontrastive ndërgjuhësore, kemi përcaktuar llojin e ekuivalencës. Frazeologjizmat somatikë i kemi zgjedhur së pari nga gjuha shqipe në serbisht dhe anasjelltas. Përmes analizës kontrastive të fjalëve në gjuhën shqipe dhe serbe kemi arritur në përfundim se nga 120 frazeologjizma somatikë, leksema *kokë,-a* ka ekuivalencë absolute më të madhe midis gjuhës shqipe dhe serbe, kurse leksema *sy,-ri* ka ekuivalencë më të vogël. Nga rezultatet e fituara mund të konstatohet se gjuha shqipe dhe ajo serbe, nëse shikohen përmes këtyre leksemave të analizuara, në të shumtën e rasteve kanë ngjashmëri të madhe, gjë që edhe pritet, pasi që këto janë pjesë të përbërjes së hapësirës ballkanike, siç janë mënyra e të menduarit dhe të kuptuarit.

Fjalët kyçe: njësitë frazeologjike, frazeologjizmat somatikë, *koka*, *syri*, *dora*, somatizmi, analiza kontrastive, ekuivalenca, shqipja, serbishtja

1. Hyrje

Interesimi për frazeologjinë u shfaq në mesjetë, kurse përpjekjet për të shpjeguar teorikisht frazeologjizmat u bënë që nga shekulli XX. Themeluesi i frazeologjisë në gjuhësinë moderne është Charles Bally (Sharl Bally)².

¹ nailje.malja.imami@fil.bg.ac.rs

² Charles Bally (Sharl Baji) - gjuhëtar zviceran që nxiti zhvillimin e një disipline të re me studimin e vet për idiomatikën e shprehjeve të strukturës së fortë nga viti 1909, me titull *Traité de stylistique française*. Frazeologjia është një disiplinë relativisht e re gjuhësore dhe shumë nga aspektet e saj gjenden në veprën e përmendur në kapitullin *La phraséologie*, kështu që vetë termi *phraséologie* (frazeologji) përdoret edhe sot.

Sipas Fjalorit të gjuhës shqipe (1980) termin frazeologji e gjejmë të përkufizuar në këtë mënyrë: Tërësia e togjeve dhe e thënieve a e shprehjeve të qëndrueshme të një gjuhe, të cilat janë të pandashme nga ana leksikore, kanë kuptim tërësor, të njësisishëm, të mëvetësishëm e rëndom të figurshëm, riprodhohen në ligjërim si njësi të gatshme dhe kryejnë funksionin e një fjale a të një fjalie të vetme; Njësitë frazeologjike janë shprehje të ngurosurat ose gjysmë të ngurosurat, të cilat përbëhen në ligjërimin e përditshëm dhe kryejnë funksionin e një fjale duke mbartur edhe ngjyrimin emocional të veçantë.

Pra, frazeologjia është disiplinë gjuhësore, objekti i kërkimit të së cilës janë frazeologjizmat. Shkenca e frazeologjizmave ndahet në frazeologji me kuptim më të gjerë dhe frazeologji me kuptim më të ngushtë. Përveç kuptimeve të ndryshme të frazeologjisë, është krijuar një konsensus minimal, sipas të cilit frazeologjia në kuptimin më të gjerë u referohet të gjithë frazeologjizmave që përbëhen nga më shumë se një fjalë, d.m.th., janë leksema të shumëfishta dhe përfaqësojnë kombinime të vendosura fjalësh, më saktë, përdoren si të tilla në një bashkësi gjuhësore ashtu si leksema individuale. Frazeologjia në kuptimin e ngushtë përfaqëson shkencën e kombinimeve të forta, të vendosura të fjalëve (të paktën, dy leksema), të cilat ndërtojnë njësi që nuk mund të shpjegohen plotësisht me anë të ligjeve kuptimore dhe sintaksore të lidhshmërisë. Këto mund të marrin përsipër funksionin dhe kuptimin e fjalëve individuale (leksemave) në sisteme dhe fjali dhe mund të idiomatizohen pjesërisht ose plotësisht (Burger et al. 1982: 1–6; Стојановић-Веселиновић, 2018: 34).

E kundërta e kombinimit të fortë të fjalëve është kombinimi i lirë i fjalëve, kuptimi i të cilave mund të nxirret nga kuptimi i përbërësve të vet. Dallimi i vendosur midis kombinimeve të fjalëve të përmendura është një nga kriteret për dallimin e frazeologjizmave nga kombinimet e lira të fjalëve. Fjalët mund të lidhen me fjalë të tjera në gjuhë për të arritur marrëdhënien gramatikore sintagmatike. Në nivelin paradigmatic të gjuhës, mund të bëhet zëvendësimi i fjalëve në bazë të karakterit të tyre klasor³.

Ndryshe nga fjalët, frazeologjia nuk mund të kombinohet lirshëm në rrafshin sintagmatik, as të zëvendësohet në nivelin paradigmatic, që është një tjetër ndryshim në krahasim me fjalët individuale, d.m., leksemat⁴.

Procesi me të cilin kombinimi i lirë i fjalëve bëhet frazeologji quhet frazeologjizim, ndërsa procesi kur një kombinimi i caktuar i fjalëve bëhet idiomë quhet idiomatizim⁵.

³ Po aty.

⁴ Po aty.

⁵ Po aty.

2. Fillimi i zhvillimit të frazeologjisë

Në gjuhën shqipe studimet e para kushtuar frazeologjisë, gjegjësisht shprehjeve të ngurosur, filluan në pjesën e parë të shekullit XX. Ndër të parët janë A. Kostallari, A (1968), Xhuvani (1956), K. Cipo (1948), M. Domi (1985), Jani Thomaj (1964) e të tjerë.

Si në fushat e tjera të gjuhësisë shqiptare, ashtu edhe në fushën e frazeologjisë, siç dihet, janë bërë studime të rëndësishme, të cilat e kanë zgjeruar dijeninë në këtë fushë dhe kanë hapur perspektiva për studime të mëtejshme. Veçanërisht Jani Thomaj⁶ i ka trajtuar problemet më themelore në fushën e frazeologjisë së gjuhës shqipe. Në këto punime, ndër të tjera, ai e ka bërë klasifikimin e njësive frazeologjike të shqipes sipas vlerës leksiko-gramatikore (sipas përqasjes kuptimore me pjesët e ligjëratës) etj.

Në ditët e sotme, interesimi për frazeologjinë vazhdon të rritet. Siç nënvizon Bolly⁷ *Frazeologjia, fillesat e së cilës lidhen me nocionin e grupeve frazeologjike te Bally (1909), ka marrë një hov të konsiderueshëm që nga vitet 1980 dhe aktualisht gjen një jehonë të madhe në gjuhësinë e zbatuar:* “... në mënyrë të përgjithshme, studimet e bëra në frazeologji gjatë dekadave të fundit ndjekin dy prirje të mëdha..., qasjen funksionale, që përqendrohet në studimin e njësive të karakterizuara nga një shkallë minimale nguroseje semantike... dhe qasjen statistikore, që interesohet për njësitë polileksikore të karakterizuar nga një minimum atraksioni mes njësive” (Bolly, 2012: 13; Dedaj, 2015: 25–26).

Në gjuhën shqipe ekziston një mori fjalorësh frazeologjikë njëgjuhësh, dy gjuhësh dhe shumëgjuhësh. Përpjekje për të mbledhur këtë pasuri janë bërë prej kohësh.

Kur është fjala për frazeologjinë serbe, vëmendja e gjuhëtarëve serbë në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit të XX u përqendrua në inventarizimin dhe studimin e fjalëve të urta. Një kontribut të rëndësishëm në kërkimin e tyre e dhanë Vuk Stefanoviq Karaxhiqi (1987) në koleksionin e vet të fjalëve të urta popullore serbe dhe Ivan Kasumoviqi (1912) në veprën e vet *Proverbat popullore kroate dhe serbe krahasuar me fjalët e urta dhe frazat greke dhe romake*, i cili është studim kontrasti, që synoi përcaktimin e ngjashmërive dhe

⁶ Jani Thomaj, *Probleme të frazeologjisë së gjuhës shqipe, në Studime filologjike*, 1964, II,III; Mbi rendin e fjalëve në strukturën e frazeologjizmave të shqipes, në “Studime filologjike”, 1966, I; Një klasifikim i frazeologjizmave me vlerë ndajfoljore në gjuhën shqipe, në “Studime filologjike”, 1969, I; Grupe fjalësh të bashkëlidhura me frazeologjizma, në Studime filologjike”; 1975, II; Aspekti shoqëror-kulturor në formimin e frazeologjisë së shqipes, në “Studime filologjike”, 1975, III; Frazeologjizma emërorë e mbiemërorë në gjuhën shqipe, në Studime filologjike”; 1975, IV; Frazeologjizma foljorë në gjuhën shqipe, në “Studime filologjike”, 1976, I Jani Thomaj – Xhevat Lloshi, *Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit*, në “Studime filologjike”, 1967, I etj.

⁷ Catherine Bolly, *Flou phraséologique, quasi-grammaticalisation et pseudo marqueurs de discours: un no man’s land entre syntaxe et discours?*

dallimeve ndërmjet fjalëve të urta, nga njëra anë dhe greke dhe romake, nga ana tjetër (Mršević-Radović, 1987: 25; Станојевић-Веселиновић, 2018: 38).

Në frazeologjinë serbokroate patën ndikim të madh veprat e gjuhëtarëve rusë si V.V. Vinogradovit (В. Виноградов), V. P. Zhukovit (В. П. Жуков), V. M. Mokienkut (В. М. Мокиенко), M. M. Kopilenkut (М. М. Копыленко), I. I. Černishevit (И. И. Чернышева) (krh. Njësoj: 20, 28, 70).⁸

Frazeologjia si disiplinë gjuhësore u vendos në studimet e serbokroatishtes në dekadat e fundit të shekullit të njëzetë. Një nga veprat më të rëndësishme të frazeologjisë serbe është *Sintagma frazeologjike foljore-emërore* e Dragana Mërsheviq-Radoviçit në gjuhën bashkëkohore serbokroate (1987)⁹

Kohëve të fundit një numër i madh i studiuesve serbë janë duke u marrë me frazeologjizmat në gjuhët ballkanike, me theks të veçantë në gjuhën serbe. Ngjashmëritë në jetën materiale dhe shpirtërore, në vlerat morale dhe filozofinë popullore të popujve ballkanikë shfaqen në folklor dhe frazeologji. Korpusi i frazeologjisë së përbashkët të gjuhëve të Ballkanit është mjaft i pasur dhe u krijua si rezultat i simbiozës kulturore të grupeve etnike që banuan në Gadishullin Ballkanik (Марковић & Манић, 2022: 157).

Në frazeologjizma vetëm një komponent është bartës i kuptimit, p.sh. (*nuk e ka kokrrën e lekut /nema prebijene pare*), përbërësi i komponentës është bartës i kuptimit.

Pra, frazeologjizmat janë njësi të ngulitura gjuhësore të përbëra nga të paktën dy fjalë që kanë kuptim unik. Që një grup fjalësh të jetë frazeologjizëm duhet t'i plotësojë këto kushte: duhet të jetë i ngulitur, që do të thotë se duhet të përdoret në të njëjtën renditje të pjesëve që e përbëjnë atë grup; duhet të ketë strukturë të ndërlikuar (të përbërë nga jo më pak se dy fjalë; të ketë kuptim unik, të plotë dhe duhet të përsëritet.

Për shembull, shprehjet: *Thembra e Akilit* e përdorim për të shënuar dobësinë e dikujt, një pikë të dobët të dikujt; kur themi *Si sytë e ballit* kjo do të thotë që flasim për diçka të shtrenjtë; kur themi për dikë që është *Zemërpulë*, kjo do të thotë që ai njeri për të cilin flasim është i frikësuar; *u shtoftë dhe u pasuroftë sa fjet e flokut në kokë* - domethënë u bëftë i pasur (dikush); *sikur ia lan kokën gomarit* – mosmirënjohës; *sytë i lëshuan miza* – i zemëruar; *të flet pa dorashka* – i hapur, i singërtë; *i mirrte koka zjarr* etj.

Në njësitë frazeologjike të motivueshme hyjnë edhe shprehjet me origjinë dialektore, tërësia semantike e të cilave nëpërmjet mjeteve gjuhësore që përdoren, na komunikojnë një krahasim: *e ka kokën si të mushkës, është kokëfortë si mushkë* etj. Të gjitha këto shprehje janë mjaft të qarta; janë përdorime në kuptimin figurativ të jetës së përditshme.

⁸ Po aty.

⁹ Po aty.

Në gjuhën shqipe ndërtohen frazeologjizma edhe me anë të përsëritjes së njërit element ose të dyve të një *kategorie leksiko-gramatikore*, p.sh., *gëzuar kokë më kokë* (të gjithëve), *krah për krah*, *sy më sy* etj. (Thomaj, 1975: 42).

Thomaj thekson se: Në disa frazeologjizma të shqipes vendi i elementit me kuptim figurativ (kur vetëm njeri është i tillë) nuk luan rol në ndryshimin e kuptimit frazeologjik. Bile në një “çerdhe” togfjalëshash të qëndrueshëm somatikë që dalin nga një fjalë bosht, komponenti kryesor herë mund të jetë, herë jo, me kuptim figurativ, p.sh. në rastet: *s’më punojnë sytë*, *shoh me bisht të syrit*, *shkelë synë*, *ia bëj me sy*, *ngul sytë*, *më mbetën sytë*, *sa çel e mbyll sytë* etj., fjala *sy* është përdorur në kuptimin e drejtpërdrejtë; kurse tek *s’kam sy e faqe*, *sa për sy e faqe*, *e bën për sy e faqe*, *e bën për sy të botës*, *s’ma mbush synë*, *mora një sy gjumë*, *s’i trembet syri* etj., fjala *sy* është përdorur në kuptimin figurativ¹⁰ (Thomaj, 1964: 60).

3. Kuadri teorik i kërkimit

Siç e thamë në pjesën hyrëse të punimit, objekt i këtij punimi janë frazeologjizmat në gjuhën shqipe dhe serbe përmes analizës kontrastive. Që ta kuptojmë më mirë pozitën e frazeologjizmave krahasues dhe veçoritë e tyre në kuadër të frazeologjisë si shkencë në përgjithësi do të japim një përmbledhje të shkurtër, kryesisht për frazeologjinë në gjuhën shqipe dhe më pas edhe në gjuhën serbe.

Analiza kontrastive, së bashku me teorinë e përkthimit dhe analizën e gabimeve, u përket tri degëve më të ngushta të gjuhësisë kontrastive dhe përkufizohet si një disiplinë gjuhësore përmes së cilës gjuha amtare dhe gjuha e synuar e nxënësit krahasohen sistematikisht në të gjitha nivelet e strukturave të tyre për të përcaktuar dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet tyre, duke pasur si qëllim parashikimim e vështirësisë me të cilat përballet nxënësi gjatë mësimit të një gjuhe të re dhe shmangia e gabimeve të cilat krijohen. Degë e veçantë e analizës kontrastive është frazeologjia kontrastive – disiplinë e cila merret me studimin e ngjashmërive dhe dallimeve në sistemet frazeologjike të gjuhëve që analizohen (Byjović, 2023: 65–66).

Për të arritur këtë duhet ta përcaktojmë ekuivalencën e këtyre frazeologjizmave. Ekzistojnë tri lloje themelore të ekuivalencës ndërgjuhësore: ekuivalenca absolute, e pjesshme dhe zero. Ekuivalenca absolute nënkupton mungesën e dallimeve midis leksemave në gjuhën nisëse dhe gjuhës së synuar në të gjitha nivelet. Njësitë frazeologjike absolutisht ekuivalente ndajnë të njëjtën bazë metaforike, janë identike në kuptimin e tyre denotativ dhe konotativ (shprehës, emocional dhe stilistik), kanë një strukturë sintaksore dhe leksikore identike, kanë të njëjtat kufizime diasistemike, shpërndarjen dhe frekuencën e përdorimit (Trivić, 2013: 72).

¹⁰ Është fjala për frazeologjizma kuptimi tërësor i të cilëve del nga shuma e kuptimeve të të dy komponentëve, me kusht që njeri të ketë kuptim figurativ, tjetri të drejtpërdrejtë.

Ekuivalenca e pjesshme arrihet kur ka shmangie të parëndësishme midis njësive frazeologjike të gjuhëve të analizuara. Zakonisht e nënkupton ekzistencën e identitetit semantik midis frazeologjisë së kundërt, por ka një divergjencë formale leksikore, morfologjike ose sintaksore midis elementeve përbërës të frazës. Ekuivalenca zero krijohet kur nuk ka shprehje korresponduese frazeologjike në inventarin frazeologjik të gjuhëve të analizuara, pra kemi të bëjmë me raste të asimetrisë totale ndërgjuhësore. Bëhet fjalë për ekzistencën e përputhshmërisë strukturore dhe leksikore, d.m.th., për ngjashmëri formale midis njësive frazeologjike, por ndryshimi ndodh në nivelin semantik, domethënë në kuptim (Вујовић, 2023: 66–67).

4. Korpusi dhe metoda

Korpusi përbëhet nga 120 frazeologjizma me leksemat *koka*, *dora* dhe *syri*. Te 60 frazeologjizma gjuhë nisëse është shqipja dhe te 60 të tjerë serbishtja. Këta i kemi marrë kryesisht nga veprat e ndryshme të literaturës së shkruar, libra, fjalorë frazeologjikë, nga përkthimet e librave të ndryshëm ndër vite, si nga *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* (1980) por edhe nga fjalori në dorëshkrim, i cili përmban më shumë se 2000 fraza në të dyja gjuhët.

Kur është fjala për terminologjinë të cilën e kemi përdorur në punim, këtu gjenden të gjitha grupet e fjalëve, pa e marrë parasysh karakterin e tyre struktural. Meqenëse deri më tani nuk ka pasur ose ka pasur shumë pak punime lidhur me frazeologjizmat somatikë në gjuhën shqipe, konsiderojmë që ky punim do të jetë me interes jo vetëm për studentët, por edhe për përkthyesit dhe për frazeologjinë kontrastive të gjuhës shqipe dhe serbe në përgjithësi. Në shembujt e mëposhtëm në të dy gjuhët e vërejmë që frazeologjizmat somatikë përbëhen kryesisht nga folja, parafjala dhe emri ose folja emri dhe mbiemri.

<i>Nuk mendoj me kokën time</i>	<i>Ne mislim svojom glavom</i>	EA
<i>Ka dorë të mirë</i>	<i>Ide mu od ruke</i>	EA
<i>Vera i ra në kokë</i>	<i>Udarilo mu vino u glavu</i>	EA

Somatizmat përmbajnë potencial të madh semantik në krijimin e frazeologjizmave, si njësi jashtëzakonisht ekspresive gjuhësore, me anë të ndërtimit të leksemave të ndryshme, të cilat bashkë japin një kuptim të ri dhe të cilat nuk është lehtë gjithmonë të interpretohen. Nëpërmjet analizës kontrastive do të vihen në pah ngjashmëritë dhe dallimet kuptimore që ekzistojnë midis këtyre frazeologjizmave somatikë si edhe ekuivalencat e tyre që dalin nga veprimi i dy konteksteve kulturore (Милојевић, 2013: 257).

5. Përdorimi i termit somatizëm

Termin “somatik” e futi në teorinë gjuhësore ruse F. Vokk, i cili duke studiuar frazeologjizmat në gjuhën estoneze, të cilët i përmbanin pjesët e trupit, të njëjtit i quajti frazeologjizma somatikë.

Siç pohon Joviqi termi “somatik” vjen nga fjala greke soma/somatos që do të thotë trup. Përdoret në biologji dhe mjekësi në kuptimin “lidhur me trupin e njeriut, fizikun”, dhe është në kundërshtim me termin “psikik”. Në gjuhësi, ky term ka filluar të përdoret në mënyrë aktive në gjysmën e dytë të shekullit XX në studimin e njësive që me kuptimin e vet pasqyrojnë tërë atë që lidhet me fizikun (Јовић, 2020: 623).

Arsyetimin për interesimin e vazhdueshëm të shkencëtarëve për këtë lloj të leksikut¹¹ e gjejmë në vetë procesin e njohjes së vetvetes (njeriut) në mjedisin e të cilit na rrethon dhe në përcaktimin e vetes sonë si personalitet, nëpërmjet gjuhës dhe mendimit, që gjithmonë është zhvilluar nëpërmjet ndjenjave që paraqiten drejtpërsëdrejti përmes shqisave dhe pjesëve të trupit të njeriut¹².

Prandaj, leksiku somatik është një nga grupet më të vjetra universale të fjalëve në të gjitha gjuhët e botës, e cila ka një funksionim kompleks me një mori asociacionesh e konotacionesh dhe në gjuhë të ndryshme përcaktohet në mënyrë sistematike.

Për simbolikën e kokës:

1. Pjesa e sipërme e trupit të njeriut ose pjesa e përparme e trupit të kafshëve, ku ndodhen truri, goja, sytë, veshët, hunda etj. 2. Njësi për të numëruar bagëtinë (*njëqind kokë dhen. Taksë për kokë* (hist.) *Okë e kokë secilit aq sa i takon*. 3. fig. Pjesë e trupit të njeriut si qendra e të menduarit, truri dhe aftësia e tij për të arsyetuar; mendja. Njeriu si bartës i ideve e pikëpamjeve të ndryshme, i aftësive të veçanta mendore (+ një varg njësish frazeologjike): *la bëri koka /e ka fajin vetë/;*

Leksema¹³ *kokë* simbolizon mençurinë, inteligjencën, shkathtësinë, jetën, por edhe humbjen e kokës (*as që e qan kokën fare, nuk e di ku e ka kokën, dikujt do t'i pritët koka*) ndjenjën e krenarisë dhe mendjemadhësisë (*kokëfortë, kokëmadh, kokëkrisur, kokëgjuhë, kokëjashtë, kokëderr, kokëçarje, kokëbosh*) etj.

Një Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980) leksema *kokë* në trajtën e pashquar përmendet 983 herë, ndërsa në trajtën e shquar 118 herë. Siç shihet leksema *kokë-a* në mesin e somatizmave të analizuar zë vend parësor. Njëkohësisht kjo leksemë, bashkë me leksemën *syri*, marrin pjesë në formimin e frazeologjizmave në numrin më të madh në të dy gjuhët¹⁴.

¹¹ Po aty.

¹² Po aty.

¹³ Lidhur me fjalën leksemë shih më shumë në *Probleme dhe diskutime për kulturën leksikore*, Hajri Sheku, Studime filologjike nr. 1-2, Tiranë.

¹⁴ Kuptimet e leksemave, *koka*, *dora* dhe *syri* i morëm nga *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* (1980) dhe nga fjalori *Frazeologjizma të gjuhës shqipe*, Mehmet Gjevori, Rilindja, Prishtinë.

Pra leksema *kokë*, -a është burim themelor i marrjes së informacioneve nga jashtë, si edhe mjet i shprehjes së emocioneve të shumta;

Në *Fjalorin e frazeologjizmave të gjuhës shqipe* të Mehmet Gjevorit (1988) mund të gjejmë një numër të madh të frazeologjizmave me somatizmin “koka”. Përmes kokës mund të shprehet lumturia, gëzimi, kënaqësia, euforia e të tjera. *S’ka kokë* – s’ka mend, s’ka tru, s’është i mençur: *Të paska krisur koka!* – s’qenke në të, i paske mangët dy dërrasa! *Është njeri me kokë* - është i mençur e i matur, *I rri mbi kokë/krye/ natën të sëmurit*; i rri afër e kujdeset për të; *U mblodhën kokë më kokë* – rrinin pranë njëri tjetrit; e ka kokën në torbë – është në rrezik; *Më ra qielli mbi kokë, më ra shtëpia mbi kokë* – nuk dija ku të futesha nga turpi ose nga një e papritur; *Dikush ka shumë çoque në kokë* – ka shumë halle, derte, telashe; *Pse e prure /e solle/ kokën?* - (mospërf.) Pse erdhe? – i thuhet dikujt që nuk të pëlqen, që nuk e ka në qejf; *E vë kokën në satër për të* – betohem me kokën time për të, e vë veten në rrezik për të, i besoj.

Nga shembujt e mëposhtëm në tabela do të shohim se çfarë ekuivalence kanë somatizmat në këto dy gjuhë. Me EA do ta shënojmë ekuivalencën absolute, me EP ekuivalencën e pjesshme dhe me Z ekuivalencën Zero.

<i>E pres kokën/qafën</i>	<i>Dajem glavu</i>	EA
<i>Ka krimba në kokë</i>	<i>Ima bube (crve) u glavi</i>	EA
<i>Nuk ka strehë/kulm mbi kokë</i>	<i>Nema krov nad glavom</i>	EA
<i>E mori në qafë</i>	<i>Došao mu je glave</i>	Z
<i>E ka mizën nën kësulë/kapuç</i>	<i>Ima putera na glavi</i>	Z
<i>Gjaku i vajti në kokë</i>	<i>Udarila mu krv u glavu</i>	EA
<i>Vera i ra në kokë</i>	<i>Udarilo mu vino u glavu</i>	EA
<i>E paguajmë me kokë</i>	<i>Nama se lomi o glavu</i>	EA
<i>As që çan kokën fare</i>	<i>Ne boli glava uopšte</i>	EA
<i>Nuk më hiqet nga mendja</i>	<i>Ne izlazi mi iz glave</i>	EA
<i>S’ia pret kaploqja/rradakja</i>	<i>Ne ulazi mu u glavu</i>	EA
<i>Nuk më mbushet mendja</i>	<i>Ne ide mi u glavu</i>	EA
<i>Nuk di ku e ka kokën</i>	<i>Ne zna gde mu je glava</i>	EA
<i>Dikujt do t’i pritët koka</i>	<i>Nekome će da ode/odleti glava</i>	EA
<i>Peshku qelbet nga koka</i>	<i>Riba smrdi od glave</i>	EA
<i>Mos e vra mendjen /kokën/ shumë</i>	<i>Nemoj da te boli glava</i>	EA
<i>Iki si pa krye, iki me të katra, iki turravrap!</i>	<i>Pobeći glavom bez obzira</i>	Z
<i>Po më pëlçet koka; po më ndahet koka dysh</i>	<i>Puca mi glava</i>	EA
<i>I bie murit me kokë</i>	<i>Lupati glavom kroz zid</i>	EA
<i>Ka një dërrasë mangut në kokë</i>	<i>Fali mu jedna daska u glavi</i>	EA

Në bazë të krahasimit të 20 frazeologjizmave nga shqipja në serbisht me leksemën *kokë,-a*, 17 prej tyre kanë ekuivalencë absolute, 0 ekuivalencë të pjesshme dhe 3 kanë ekuivalencë zero

<i>Ne znam gde mi je glava</i>	<i>S'di ku e kam kokën, më ziejnë, më vlojnë trutë</i>	EA
<i>Ima da lete glave</i>	<i>Të fluturon koka</i>	EA
<i>Zabio je glavu u pesak</i>	<i>Fus kokën në rërë si (struci)</i>	EA
<i>Dunulo mi je nešto u glavi</i>	<i>Më mbiu në kokë (diçka befas)</i>	EP
<i>Dobiti po labrnji</i>	<i>Ha dru, më japin një dajak të mirë</i>	Z
<i>Dubiti na glavi</i>	<i>Sikur kaq (sa të kalit) ta bësh dhëmbin, hidhu përpetë po të duash</i>	Z
<i>Oprali mu glavu, strogo su ga okorili</i>	<i>I ranë kokës</i>	Z
<i>Ne mislim svojom glavom</i>	<i>Nuk mendoj me kokën time</i>	EA
<i>Odmerio ga je od glave do pete</i>	<i>E vështroi nga koka te këmbët, nga maja e flokut te thonjtë e këmbëve</i>	EP
<i>Razbiće se nekome o glavu</i>	<i>I bie në (më) qafë dikujt, iu rëndua, e mori më qafë</i>	Z
<i>Od glave do pete</i>	<i>Kokë e këmbë, që nga koka deri te thonjtë (thembrat)</i>	EA
<i>Ne ide mi iz glave</i>	<i>Më mbiu në kokë (në mendje), nuk më hiqet nga mendja</i>	EA
<i>Obijati se (obiti se) lupati se nekome o glavu</i>	<i>I bie në (më) qafë dikujt, e mori më qafë</i>	Z
<i>Odmerio ga je od glave do pete</i>	<i>E vështroi nga koka te këmbët, nga maja e flokut te thonjtë e këmbëve</i>	Z
<i>Izgubiti glavu</i>	<i>E kanë lëshuar (i janë liruar) rrathët, i kanë luajtur dërrasat</i>	Z
<i>Pamet u glavu</i>	<i>Mblidhe mendjen</i>	EP
<i>Ne može se glavom kroz zid</i>	<i>S'i bihet murit me kokë</i>	EA
<i>Hvatati se za glavu</i>	<i>I bie kokës me grushte, zë kokën me duar</i>	EA
<i>Doći će mu glave</i>	<i>Do t'i mbushet mendja</i>	EA
<i>Stavljači, metnuti glavu u torbu</i>	<i>Vë kokën në rrezik, e vuri kokën në torbë</i>	EA

Në bazë të krahasimit të 20 frazeologjizmave nga serbishtja në shqip me leksemën *kokë,-a*, 11 prej tyre kanë ekuivalencë absolute, 2 ekuivalencë të pjesshme dhe 7 kanë ekuivalencë zero.

Në bazë të analizave semantike të bëra deri më tani leksema kokë,-a bën pjesë në afro njëzet fusha të ndryshme. Trembëdhjetë prej tyre lidhen drejtpërdrejt me njeriun dhe me aktivitetet e tij themelore jetësore, gjendjet dhe vetitë, si: lëvizja, perceptimi auditiv dhe vizual, gjendjet fiziologjike, pamja fizike, tiparet e karakterit, emocionet, intelekti dhe gjendjet e ndërgjegjes, komunikimi, pozicioni i kushtëzuar nga rrethanat e ndryshme jetësore, veprimi i tipave të ndryshëm të njerëzve, marrëdhënia me mjedisin dhe ekzistencën në përgjithësi. Lëvizja si formë e veprimtarisë mekanike e njeriut e nënkupton ndryshimin e pozicionit të trupit në hapësirë, përkatësisht lëvizjen e tij në krahasim me pikat e caktuara hapësinore. Kjo realizohet si vendndodhje e caktuar në ndonjë vend ose si largim dhe përafrim, psh. *të shkosh atje ku të çojnë sytë (dhe të mbajnë këmbët) /içi kud /a (koga) oči vode (i noge nose)* (Штрбац-Штасни, 2015: 20).

Emocionet janë procese mendore të njeriut të realizuara si dashuri, trishtimi, gëzimi etj., ndërsa komunikimi përfshin veprimtarinë e të folurit në funksionin e realizimit të ndërveprimit midis njerëzve: *i hipi mbi majën e kokës (dikujt) /popeti se kome navrh glave/, i hip dikujt mbi kokë /sesti nekome na glavu/ etj.*

Pozicioni nënkupton, para së gjithash, situatat në të cilat ndodhet një person duke pasur parasysh gjendjen materiale, por edhe rrethanat e ndryshme jetësore nëpërmjet të cilave kalon, p.sh. *I ka ardhur (dikujt) shpirti te hunda /došla kome voda do nosa (do usiju)*

Si genie shoqërore, njeriu vepron në fusha të ndryshme duke u përpjekur që të arrijë qëllime të caktuara, që t'i kthejë gjërat në favor të vet, të ndërmarrë veprime etj.,: *I bie murit me kokë/ içi glavom kroz zid/* (Штрбац-Штасни, 2017: 20-21).

Për simbolikën e dorës:

Secila nga dy gjymtyrët e sipërme të njeriut, që nga supi e deri te gishta. 2. fig. Krah pune: *Janë pesë duar që punojnë në ferma*. 3. Kjo gjymtyrë si përfaqësuese e njeriut që kryen një veprim, që nxit, shkakton ose zotëron diçka, që ka fuqinë a pushtetin mbi dikë a mbi diçka ose si treguese e mënyrës a e mjeshtërisë me të cilën është bërë diçka; njeriu vetë si zotërues a pronar ose e drejta e tij për të zotëruar, për të urdhëruar etj.; përfundimi i punës a pasoja e veprimeve të njeriut (+ në një varg njësisht frazeologjike). Secila nga dy gjymtyrët e sipërme të njeriut, që nga supi e deri te gishtat.

2. fig. Krah pune: *Janë pesë duar që punojnë në ferma*. 3. Kjo gjymtyrë si përfaqësuese e njeriut që kryen një veprim, që nxit, shkakton ose zotëron diçka, që ka fuqinë a pushtetin mbi dikë a mbi diçka ose si treguese e mënyrës a e.

Në Fjalorin e gjuhës shqipe (1980) leksema *dorë* në trajtën e pashquar përdoret 838 herë, ndërsa në trajtën e shquar *dora* 132 herë.

<i>Heq dorë nga...</i>	<i>Dići ruke od...</i>	EA
<i>Çoj/ngre dorë në...</i>	<i>Dići ruku na...</i>	EA
<i>Me duar të veta</i>	<i>Golim rukama</i>	Z
<i>Ka dorë të mirë</i>	<i>Ide mu od ruke</i>	EP
<i>I ka duart e lira (të veprojnë)</i>	<i>Imati odrešene ruke</i>	EA
<i>E futi në xhep</i>	<i>Ima ga u džepu</i>	EA
<i>Duart t'u lumshin</i>	<i>Pozlatile ti se ruke</i>	EA
<i>Nuk ka qëndruar duarlidhur</i>	<i>Nije sedeo skrštenih ruku</i>	EA
<i>Mbeti duarthatë</i>	<i>Ostao je praznih ruku</i>	EA
<i>I vjen (shkon) për dore</i>	<i>Polazi mu za rukom</i>	EA
<i>Dora e parë (e dytë)</i>	<i>Prva (druga) ruka</i>	EA
<i>Me thonj e me dhëmbë</i>	<i>Rukama i nogama</i>	Z
<i>Çdo gjë i shkon/bën për dore</i>	<i>Sve mu ide od ruke</i>	EA
<i>Pa kokë e pa bisht</i>	<i>Bez glave i repa</i>	EA
<i>I bie me gisht të madh</i>	<i>Uraditi što levom rukom</i>	Z
<i>M'i lidhi këmbët</i>	<i>Vezao mi je ruke</i>	Z
<i>Njëra dorë lan tjetrën, të dyja lajnë fytyrën/faqet</i>	<i>Ruka ruku mije, obraz oba dvije</i>	EA
<i>Asnjë s'të kruan si dora jote</i>	<i>Tuđa ruka svrab ne češe</i>	EP
<i>I mbeti shala në dorë</i>	<i>Ostao je kratkih rukava</i>	Z

Në bazë të krahasimit të 20 frazeologjizmave nga shqipja në serbisht me leksemën *dorë*,-a 12 prej tyre kanë ekuivalencë absolute, 2 ekuivalencë të pjesshme dhe 5 kanë ekuivalencë zero.

<i>U vašim rukama je moja sudbina</i>	<i>Fati im është në duart e tua</i>	EA
<i>Biti vezanoh ruku</i>	<i>I ka duart e lidhura</i>	EA
<i>Biti nëçija desna ruka</i>	<i>Është dorë e djathtë e dikujt</i>	EA
<i>Ispustio je iz ruke (ruku)</i>	<i>I iku nga dora</i>	EA
<i>Ruku na srce</i>	<i>Dorën në zemër</i>	EA
<i>Iz (maći) se iz ruku</i>	<i>I iku (i shpëtoi) nga dora, s'e ka më në dorë</i>	EA
<i>Stavio je ruku u vatru</i>	<i>Vë dorën në zjarr</i>	EA

<i>Kao rukom odnešeno</i>	<i>Sikur m'u largua me dorë</i>	EA
<i>Ruka ruku mije, obraz oba dvije</i>	<i>Njëra dorë lan tjetrën, të dyja lajnë fytyrën/faqet</i>	EP
<i>Držati na rukama (nekog)</i>	<i>E ka me (në) pekule dikë</i>	Z
<i>Vrti (mota) mi se u mislima</i>	<i>E kam në kokë</i>	EA
<i>Bolje je vrabac u ruci nego golub na grani (na krovu)</i>	<i>Më mirë një vezë sot se një pulë mot</i>	EA
<i>Biti pri (na ruci)</i>	<i>Më jep dorë, më ndihmon</i>	EA
<i>Dati se u ruke (nekome)</i>	<i>I vë i lë zemrën në dorë diku, i jap besim të plotë</i>	EA
<i>Iz druge, treće ruke</i>	<i>Më anë të ndërmjetësit, jo drejtpërdrejt</i>	Z
<i>Iz prve ruke (saznati, kupiti)</i>	<i>Drejtpërdrejt, pa ndërmjetësim</i>	Z
<i>Imati pune ruke posla</i>	<i>Jam shumë i zënë, kam shumë punë</i>	Z
<i>Sedeti skrštenih ruku</i>	<i>Rri me duar në xhepa</i>	Z
<i>Imati prljave ruke</i>	<i>I kam duart e ndyra</i>	EP
<i>Svrbi (me dlan)</i>	<i>Më kruhet dora, lakmoj paranë</i>	EP
<i>Srećne je ruke</i>	<i>Ka dorë të mbarë</i>	EA

Në bazë të krahasimit të 20 frazeologjizmave nga serbishtja në gjuhën shqipe me leksemën *dorë*, -a 12 prej tyre kanë ekuivalencë absolute, 3 ekuivalencë të pjesshme dhe 5 ekuivalencë zero.

Somatizmi "*dora*" mund të shprehë simbolikisht ndihmën, emocionet, tiparet (pozitive dhe negative), gjendjet e ndryshme psikologjike. Është simbol i të gjitha veprimeve me të cilat njeriu i siguron vetes kushtet për jetë, por shpesh edhe simbol i gjendjeve të ndryshme, pasqyrimi për njeriun dhe pozitën e tij, statusin; është gjithashtu simbol i kontaktit fizik (shpesh dhunës).

Kështu në *Fjalorin e frazeologjizmave të gjuhës shqipe* të Mehmet Gjevorit (1988) mund të gjejmë një numër të madh shembujsh: *la mori dorën* – ia mori zanatin mjeshtrit, ia mësoi zanatin; *S'e ka veten në dorë* – nuk e zotëron veten, bën veprime të pandërgjegjshme pa e ditur as vetë se çka bën; *I jep dorën e të kërkon krahun* - i jep një gjë të vogël e të kërkon një gjë të madhe; *Fshij duart nga ai* (nga i sëmuri) – ai mbroi, e pat puna e tij, të lashtë zoti shëndosh për të!; *la ngjiti dorën* – i ndihmoi; *I jep gishtin, të kërkon dorën*; *S'ia arrin dora* – s'ka fuqi, nuk mundet; *I holloi duart së fërkuari* (ir.) fërkon duart nga kënaqësia, është shumë i kënaqur për diçka etj.

Për simbolikën e syrit:

1. Organ i të parit te njeriu dhe te kafshët, që ndodhet në pjesën e përparme të kokës ose anash saj. *Me sy të zinj. Me sy të skuqur (të përlotur, të përgjumur).*
 2. Aftësia për të parë, shikimi, të parit. *Ka sy të fortë (të dobët). Humbi sytë.* 3. Vështrimi a mënyra si shikon dikush, si shprehje e jashtme e gjendjes së tij të brendshme; të drejtuarit e këtij organi mbi dikë a mbi diçka për ta parë; shikim, vështrim (dhe në një varg njësisish frazeologjike). 4. fig. Mënyra si e vështrojmë a e vlerësojmë dikë ose diçka, pikëpamja a pozita nga nisemi për të gjykuar për dikë a për diçka; këndi i vështimit. *Me syrin e mjeshtrit (e mjekut).* 5. | fig. Vëmendje e mprehtë dhe e përqendruar për të mos na shpëtuar gjë pa e vënë re, vigjilencë; mbikëqyrje. *Syri i masës (i popullit).* 6. bised. Fytyra, faqet. *Lau sytë. Ia hoqi (ia përveshi) syve.* 7. Pamje, paraqitje e jashtme (rëndom e mirë) e diçkaje, dukë. *Nuk ka sy. Duket i mirë në sy.* 8. fig. Vend prej nga duket mirë hapësira përreth; pika më e përshtatshme, më në qendër, mesi. 9. Laku i një filli a i një litari. *Syri i litarit.* 10. tek. Vrimë e rrumbullakët ku futet një vegël a një pjesë tjetër. *Syri i pistonit (i boshtit).* 11. anat. Nyjë ku lidhen dy kocka, kyç. Syri i këmbës secila nga pjesët e ngritura të kockës te qafa e këmbës. *Syri i gjurit kupa e gjurit.* 12. vet. nj. shtypshkr. Pjesa e ngritur e shkronjës prej plumbi, që merr bojë dhe që del në letër. *Sy i vrrarë (i zbehtë).* I priset (i vritet) syri¹⁵.

Përmes shqisave të të parit përceptohet sasia më e madhe e informacionit që marrim nga mjedisi ynë, prandaj duhet të hapen sytë (më mirë ose më gjerë) për të shmangur situata të parashikuara ose surpriza të pakëndshme.

Kuptimet e leksemës *sy* i kemi marrë nga *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* (1980). Në trajtën e pashquar leksema *sy* është përdorur 207 herë, ndërsa në njëjës *syri* 151 herë dhe në trajtën e shquar në shumës *sytë* 326 herë.

<i>Me sy të lirë/të zhveshur</i>	<i>Golim okom</i>	EP
<i>Nuk vura gjumë në sy</i>	<i>Nisam oka sklopio</i>	EP
<i>Sy për sy, dhëmb për dhëmb</i>	<i>Oko za oko, zub za bub</i>	EA
<i>Me syçeltësi</i>	<i>Pod budnim okom</i>	Z
<i>Sheh në një dritë tjetër</i>	<i>Posmatra drugim okom</i>	Z
<i>S'i trembet syri</i>	<i>Ni ne trepane</i>	Z
<i>E ka halë /ferrë/ gjemb në sy</i>	<i>Trn mu je u oku</i>	EP
<i>Kokë më kokë; krye më krye</i>	<i>U četiri oka</i>	Z
<i>Sheh në një dritë tjetër</i>	<i>Posmatra drugim okom</i>	EP

¹⁵ *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 1980.

<i>I hap/bën sytë katër</i>	<i>Pretvoriti se u oko</i>	Z
<i>Mbyll një sy</i>	<i>Progledati kroz prste</i>	Z
<i>E ka vënë kësulën mbi sy/</i>	<i>Na konju je</i>	Z
<i>E shikoi me bisht të syrit</i>	<i>Pogledao ga je popreko</i>	Z
<i>Humbi në sytë e njerëzve</i>	<i>Pao je u očima ljudi</i>	EP
<i>Vetëm për t'u hedhur hi syve</i>	<i>Samo je to bacanje prašine u oči</i>	EP
<i>S'ma mbyll syrin</i>	<i>Ne uliva mi poverenje</i>	Z
<i>Shkojnë mykë e pykë</i>	<i>Vade jedan drugom oči</i>	Z
<i>Për sytë e ballit; për këta sy që kam në ballë</i>	<i>Tako mi očiju mojih</i>	EA
<i>Larg sysh, larg zemrës; sytë e larguar, zemërharruar</i>	<i>Daleko od očiju, daleko od srca</i>	EA
<i>Bëju fshesë shtëpisë sate!</i>	<i>Svako treba da očisti ispred svoje kuće!</i>	EP

Në bazë të krahasimit të 20 frazeologjizmave nga shqipja në serbisht me leksemën *sy, -ri*, 3 prej tyre kanë ekuivalencë absolute, 7 ekuivalencë të pjesshme dhe 10 ekuivalencë zero.

<i>U tuđem oku vidi trn, a u svome brvna ne vidi</i>	<i>Sheh qimen në syrin e tjetrit, nuk shesh trarin në syrin e vet.</i>	EP
<i>Pogledati istinu u oči</i>	<i>Shoh të vërtetën në sy</i>	EA
<i>Zapeti kome za oči</i>	<i>I mbeti syri te dikush</i>	EA
<i>U strahu su velike oči</i>	<i>I bëhet ferra Brahim, trembet për çdo gjë.</i>	Z
<i>Čuvati kao zenicu oka</i>	<i>E ruaj si beben e syrit</i>	EA
<i>Zažmuriti na jedno oko</i>	<i>Mbyll një sy e një vesh (bën një vesh të shurdhër e një sy qorr</i>	EA
<i>Ima oko sokolovo</i>	<i>E ka syrin pishë (kokërr), s'i shpëton gjë syrit të tij, sypetrit, syshqiponjë</i>	EP
<i>Gledati smrt u oči</i>	<i>E shoh vdekjen drejt në sy</i>	EA
<i>Baciti pesak/pepeo (nekome) u oči</i>	<i>U hedh hi (pluhur) syve</i>	EA
<i>Baciti oko na nekoga</i>	<i>I hedh syrin diku</i>	EA
<i>Za tren oka</i>	<i>Sa hap e mbyll sytë</i>	EA
<i>Skloni mi se sa očiju</i>	<i>Hiqmu sysh, Mu hiq sysh se po më hanë duart.</i>	EA
<i>(na)pariti oči</i>	<i>Laj sytë diku, kullot sytë, m'u kënaq syri</i>	Z

<i>Idi kud te oči vode (i noge nose)</i>	<i>Thyej (këput) arrëzën (qafën), shporru, largou që këtej</i>	EP
<i>Pretvoriti se u oko i uho</i>	<i>Bëhem gjithnjë (tërë) sy e e veshë</i>	EP
<i>Očiju mi (tako mi očiju)</i>	<i>për sytë e ballit, pasha sytë e ballit, më plaçin sytë</i>	EP
<i>Čuvati kao zenicu oka</i>	<i>E ruaj si sytë e ballit</i>	EP
<i>Za lepe oči</i>	<i>Për sytë e bukur, për hatër të dikujt, për shpirt të babait</i>	EA
<i>Zapasti za oko (nekome)</i>	<i>Bie në sy</i>	EA
<i>Kazati, skresati (reči) u oči</i>	<i>la plasi ndër sy, i tha në sy (troç)</i>	EA

Në bazë të krahasimit të 20 frazeologjizmave nga serbishtja në shqip me leksemën *sy*, -*ri*, 12 prej tyre kanë ekuivalencë absolute, 6 ekuivalencë të pjesshme dhe 2 ekuivalencë zero.

Syri (sytë) si përbërës somatik simbolizon dritaren drejt botës, gjerësinë e mënyrës se si e shikojmë realitetin, qasjen emocionale ndaj të përditshmes së njeriut, por edhe qenien e brendshme e njeriut (termi *syri* i tretë).

Në fjalorin *Frazeologjizma të gjuhës shqipe*, Mehmet Gjevori gjejmë shembuj të numërt: *Mate me sy* - çmoje/ *Shëtiti sytë* - hedh sytë andej e këndeje, *Të ha me sy* - do të të përpijë, të nënçmojë (ai); *Syrin sy s'e ka* - ai që mashtron, që është i zgjuar për sherr; *Doli sa çel e mbyll sytë* - doli shumë shpejt; *E kanë sy në ballë* (atë djalë) e duan shumë, e kanë me kimet; *Një sy e ka nëna* /një djalë të vetëm e ka nëna, një djalë që e do shumë; *I ka sytë shkëndijë*: i ndriçojnë sytë, i shkëlqejnë; *S'na trembet syri* – nuk kam frikë fare; *E ka syrin boçë* – s'i trembet syri për shpenzime që mund të bëjë, s'do të dijë se sa shumë do të shpenzojë; *Ia shkel syrin* - për t'ia bërë të kuptojë diçka; *Të dalshin sytë!* (mallkim – u qorrofsh!, u verbofsh! *M'i zyre sytë* – më verbove, *Mos t'i pafsha sytë!* – s'ua të të shoh me sy!, s'dua të kem punë me ty; *S'ka sy për Qabe* – thuhet për një njeri që i hyn një pune, p.sh. studimeve, por nuk nxjerr gjë në krye; *I ka sytë me jakëz* (mospërf.) – njeri që mashtrohet lehtë.

Siç shihet në shembujt e mësipërm mund të vërejmë që përbërësi somatik “*syri*” ka kuptime të ndryshme.

Përfundime

Në këtë punim bëmë analizën e frazeologjizmave somatikë me përbërësin “*kokë*”, “*dorë* dhe “*sy*” në gjuhën shqipe dhe serbe. Gjuhë fillestare është shqipja, kurse gjuhë e synuar serbishtja, dhe anasjelltas.

Lloji i ekuivalencës u përcaktua për 120 somatizma, nga 40 për secilën njësi frazeologjike.

Në bazë të krahasimit të këtyre frazeologjizmave shohim se me leksemën ***kokë,-a*** nga shqipja në serbisht 17 prej tyre kanë ekuivalencë absolute, 0 ekuivalencë të pjesshme dhe 3 kanë ekuivalencë zero; kurse nga serbishtja në shqip me leksemën ***kokë,-a*** 14 prej tyre kanë ekuivalencë absolute, 3 ekuivalencë të pjesshme dhe 7 kanë ekuivalencë zero. Pra, gjithsej 28 frazeologjizma me leksemën “*kokë*” kanë ekuivalencë absolute, 2 kanë ekuivalencë të pjesshme dhe 10 nuk kanë fare ekuivalencë.

27 EA

3 EP

10 Z

Te leksema ***dorë,-a*** nga shqipja në serbisht 12 prej tyre kanë ekuivalencë absolute, 3 ekuivalencë të pjesshme dhe 5 kanë ekuivalencë zero; kurse nga serbishtja në shqip po ashtu 12 prej tyre kanë ekuivalencë absolute, 3 ekuivalencë të pjesshme dhe 5 ekuivalencë zero.

24 EA

6 EP

10 Z

Në bazë të krahasimit të 20 frazeologjizmave nga shqipja në serbisht me leksemën ***sy,-ri*** 3 prej tyre kanë ekuivalencë absolute, 7 ekuivalencë të pjesshme dhe 10 ekuivalencë zero, kurse nga serbishtja në shqip me leksemën ***sy,-ri*** 11 prej tyre kanë ekuivalencë absolute, 7 ekuivalencë të pjesshme dhe 2 ekuivalencë zero.

14 EA

14 EP

12 Z

Përmes analizës kontrastive të fjalëve në gjuhën shqipe dhe serbe kemi arritur në përfundimin se nga 120 frazeologjizma somatikë, leksema – ***kokë,-a*** ka ekuivalencë absolute më të madhe midis gjuhës shqipe dhe serbe, kurse leksema ***syri*** ka ekuivalencë më të vogël. Për dallim nga gjuhët e tjera ku leksema ***sy*** ka ekuivalencë më të madhe absolute, si p.sh. te italishtja, spanishtja dhe serbishtja, në gjuhën shqipe dhe serbe mbizotëron leksema ***kokë-a***.

Leksema ***kokë,-a*** përfaqëson hapësirë mendore dhe në shembujt e dhënë kemi hasur në mendime, ide, dyshime, defekte të konceptuara si përmbajtje që e mbushin kokën. Disa shembuj jo ekuivalentë në këtë grup mund të shpjegohen me faktin se disa fraza me të njëjtën semantikë formalizohen ndryshe nga ana leksikore në këto dy gjuhë.

Literatura

- Bally, Ch. (1909). *Traité de stylistique française*. Paris: Klincksieck Bolly. Ch (1909> Traite de stzlistique Fran[aise, Paaris, Klincksieck.)
- Burger, H., Buhofer, A., Sialm, A. (1982). *Handbuch der Phraseologie*. Berlin: W. De Gryter.
- Dedaj, M. (2015). *Shprehjet frazeologjike me vlerë mbiemërore në gjuhën shqipe dhe përvetësimi i tyre nga nxënësit*. Tiranë.
- Lama, I. (2008). Frazologjia – një pasuri e rëndësishme e trashëgimisë kulturore. *Aktet e takimit vjetor, II (2,)*, 115–119.
- Mršević-Radović, D. (1987) Frazuološke glagolsko-imeničke sintagme u savremenom srpskohrvatskom jeziku, Filološki fakultet, Beograd.
- Trivić, A. (2013) *Leksičko-semantička analiza somatizama u frazologiji savremenog španskog i srpskog jezika: kontrastivni pristup*, (doktorska disertacija). Filološko-umetnički fakultet, Kragujevac.
- Thomaj, J. (1964). Probleme të strukturës formale dhe të klasifikimit të frazeologjizmave të gjuhës shqipe. *Studime filologjike*, 18(3), 55–74.
- Thomaj, J. (1975). *Grupe fjalësh të bashkëlidhura me frazeologjizma*, *Studime filologjike*, 29(2), 37–50.
- Thomai, J. (1975). Grupe fjalësh të bashkëlidhura me frazeologjizma. *Studime Filologjike*, 2, f. 37-50.
- Вујовић, Х. М. (2023) *Контрастивна анализа соматских фразеологизама са компонентом „око“ у италијанском, шпанском и српском језику (семантичко поље пажња/опрез)* 2. Београд: Logos.
- Јовић, Е. (2020). *Симболички карактер соматских фразеологизама*. Ниш: Филозофски факултет. Департман за руски језик и књижевност.
- Марковић, А., Манић, К. (2023). Фразеологизми са зоонимом као компонентом у албанском и бугарском језику. *Анали Филолошког факултета*, XXX(2), 135–151.
- Милојевић, И. (2015). Frazuološke jedinice sa komponentom ruka u srpskom i grčkom jeziku. *Анали Филолошког Факултета*, 27(2), 257–283. doi:10.18485/analiff.2015.27.2.13.
- Станојевић-Веселиновић, Д. (2018). *Компаративни фразеологизми за језички пар српски-немачки* (докторска дисертација). Филолошко-уметнички факултет, Крагујевац.
- Штрбац, Г., Штасни, Г. (2017). *Соматизми и концептуализација стварности у српском језику (глава и њени делови)*. Нови Сад.

Nailje R. Malja Imami
Univerzitet u Beogradu, Filološki fakultet

GRUPE REČI POVEZANE SOMATSKIM FRAZEOLGIZMIMA

Rezime

U ovom radu bavićemo se kontrastivnom analizom somatske frazeologije glava, ruka i oko u albanskom i srpskom jeziku, kao dva genetski različita jezika. Daćemo i kratak pregled početaka frazeologije u oba jezika. Kroz primere ćemo utvrditi sličnosti i razlike među njima. Za ovaj rad smo odabrali 120 somatskih frazeologizama iz relevantnih rečnika i rečnika u rukopisu, a zatim smo kroz međujezičku kontrastivnu analizu odredili vrstu ekvivalentnosti za neke od njih. Izabrali smo somatsku frazeologiju prvo sa albanskog jezika na srpski i obrnuto. Kontrastivnom analizom reči u albanskom i srpskom jeziku došli smo do zaključka da od 120 somatskih frazeologizama, leksema glava ima najveću apsolutnu ekvivalentnost između albanskog i srpskog jezika, dok leksema oko ima najmanju ekvivalentnost. Iz dobijenih rezultata može se zaključiti da albanski i srpski jezik, ako se posmatraju kroz ove analizirane lekseme, u većini slučajeva imaju veliku sličnost, što je sasvim očekivano, budući da su deo kompozicije balkanskog prostora, kao što su način razmišljanja i razumevanja.

Ključne reči: frazeološke jedinice, somatski frazeologizmi, glava, oko, ruka, somatizam, kontrastivna analiza, ekvivalencija, albanski, srpski

Merima H. KRIJEZI¹

Universiteti i Beogradit, Fakulteti Filologjik

 <https://orcid.org/0000-0002-2230-5329>

SEMANTIKA E PARAFJALËS NGA DHE REALIZIMET E SAJ NË KONSTRUKTET SINTAGMATIKE E FRAZELOGJIKE NË GJUHËN SHQIPE²

Me cilësinë e saj specifike të parafjalës së rasës emërore, gjë që nuk është veçori e asnjë gjuhe indoevropiane, gjuha shqipe dallohet nga grupi i gjuhëve indoevropiane (Demiraj 1989; Çeliku 2019), pasi posedon madje dy parafjalët që përdoren me emëroren (përveç parafjalës *nga* edhe parafjalën *te/tek*). Punimi trajton analizën e kuptimeve të parafjalës *nga* në konstrukte, semantikën e saj, perimetrin e saj semantik dhe mundësinë e kombinimit të kësaj parafjale me gjymtyrë të tjera të fjalisë (në radhë të parë me emrat, përemrat dhe numërorët, por edhe me foljet brenda konstrukteve më të gjera), nga këndvështrimi i morfosintaksës, semiologjisë dhe gjuhësisë kognitive. Analiza është drejtuar te dallimi i kuptimeve bazë, parësore, që kjo parafjalë mund të ketë në gjuhën shqipe, si edhe te rruga e përfutimit të kuptimeve të saj sekondare, në masë të madhe me karakter metonimik.

Fjalët kyçe: semantika, gjuha shqipe, parafjala *nga*, konstruktet (sintagma/fraza) me parafjalën *nga*, gjuhësia kognitive, teoria lokalistike

1. Hyrje

Me gjithë interpretimet dhe konceptimet e shumta gjuhësore të parafjalëve, çështja e kuptimit të parafjalëve është një nga çështjet më specifike të gjuhësisë së përgjithshme. Gjuhëtarja serbe D. Klikovac (2006) thekson se në përcaktimin e parafjalëve, hasen të paktën dy vështirësi, që janë tregues të natyrës së kuptimit gjuhësor në përgjithësi. E para i referohet pamundësisë së përfshirjes të gjithë kuptimeve të një parafjale në një përkufizim të përgjithshëm, “pavarësisht nga sa përkufizimi të ‘shtrihet’ që të përfshinte sa më shumë përdorime që të jetë e mundur” [...] mbetjet gjithmonë janë të shumta – dhe shumë të ndryshme, ndërsa tjetra tregon se “një parafjalë duhet të përcaktohet me vetveten (Klikovac

¹ merima.krijezi@fil.bg.ac.rs

² Punimi bazohet në rezultatet e hulumtimit të kryer si pjesë e monografisë me titull “Semantika e parafjalëve në gjuhën e sotme shqipe”, të cilën autorja e ka botuar në vitin 2023.

2006: 7), domethënë se çdo përkufizim i një parafjale përfshin në mënyrë të pashmangshme përdorimin e një parafjale tjetër në përcaktimin e kuptimit të saj.”

Ndonëse në shumë gjuhë, përfshirë edhe shqipen, ato caktohen si fjalë jo të pavarura dhe të pandryshueshme (Agalliu et al. 2005; Demiraj 1971; Topalli 2011; Vesi 2005; Стевановић 1991; Пипер, Клајн 2014; Станојчић, Поповић 2012), si fjalë ndihmëse pra, fakti është se bëhet fjalë për një njësi gjuhësore (leksemë), që e merr kuptimin brenda një ndërtimi më të gjerë – sintagmë /klauzë / fjali - dhe që, nga njëra anë nuk është plotësisht e zhveshur nga kuptimi leksikor, ndërsa nga ana tjetër ka edhe frekuencë (shih Samara 1999). R. Dragiqeviq (P. Драгићевић) tërheq vëmendjen se “në përkufizime theksohet jopavarësia e parafjalëve” e që me këtë gjithmonë mendohet në jopavarësinë sintaksore e jo semantike (Драгићевић 2012: 92), e që në shumë përkufizime nënvizohet aftësia e tyre për të shprehur marrëdhënien ndërmjet dy nocioneve (po aty 92). Parafjala është caktuar si kategori leksiko-gramatikore e paepetueshme, që nënkupton neutralitetin ndaj kategorive të gjinisë, numrit dhe rasës (nuk ka gjini, numër e rasë), por në rastin e gjuhës shqipe nuk është krejt neutrale ndaj këtyre kategorive (Topalli 2011). Drejton rasën e fjalës që vjen pas saj duke kërkuar që të jetë në një rasë të caktuar (si, për shembull, parafjala *nga* kërkon përdorimin e emrit në rasën emërore; *nga libri / nga një libër*), për ndonjë parafjalë ka edhe drejtim numri duke kërkuar që fjala pas saj të jetë në një numër të caktuar (vetëm në njëjës ose vetëm në shumës; p.sh. *midis jush* kurrsesi *midis teje*) dhe “disa prej tyre ndërtohen me të dyja trajtat, por disa të tjera ndërtohen vetëm me trajtën e pashquar, duke pranuar trajtën e shquar kur emri pas tyre ndiqet nga një përcaktor” (Topalli 2011: 1111).

Sipas Korpusit Kombëtar Britanik (BNS; Burnard 2000), një nga dhjetë fjalët më të shpeshta në anglisht janë parafjalët *of*, *to*, *in* dhe *for* (cf. Baldwin, Kordoni & Villavicencio), ndërkohë në gjuhën shqipe parafjala *në* renditet e treta për nga shpeshësia, e parafjala *nga* zë vendin e njëmbëdhjetë në listën e njëqind fjalëve më të shpeshta brenda korpusit që përmban mbi 35 milionë fjalë (Spahiu 2010). M. Samara i veçon parafjalët si më të shpeshtat brenda grupit të llojeve të fjalëve jo të pavarura të gjuhës shqipe (Samara 1999: 7). Veç këtyre, parafjalët shënohen gjithashtu edhe si fjalë multipolisemike (polisemantike). Sipas G. Lakoff, polisemia buron prej faktit se ekzistojnë marrëdhënie sistematike midis modeleve të ndryshme kognitive dhe elementeve të të njëjtit model (Lakoff 1987: 13), ndërsa Croft dhe Cruse pohojnë se “njësitë polisemike burojnë prej të njëjtit burim leksikor, si rezultat i procesit të zgjerimit metaforik dhe metonimik” (Croft & Cruse 2004: 111) dhe se, polisemia e tyre është, në radhë të parë, çështje që ekziston apo jo kuptimi i lidhjes semantike midis dy interpretimeve të fjalës, thënë ndryshe, nëse njëri interpretim është shtrirje semantike e besueshme e tjetrit.

2. Semantika dhe kuptimi i parafjalëve

Arsyetimi dhe përvetësimi i duhur i kuptimit të parafjalës, i nuancave semantike të saj, nuk është i njëjtë për të gjitha rastet. Duke folur për parafjalët në anglisht, Seth Lindstromberg (2010) vë në dukje se më pak problematike paraqiten parafjalët që nuk kanë lidhje me hapësirën dhe kohën, si dhe disa parafjalë me origjinë foljore. Do të thonim se edhe në gjuhën shqipe gjendja paraqitet e ngjashme, duke shtuar se në këtë grup sigurisht që mund të përfshihen edhe shprehjet parafjalore.

Ndryshe nga parafjalët e parme, lokucionet (shprehjet) parafjalore, si parafjalë të përbëra, në një numër të gjerë rastesh të gjuhës shqipe nuk tregojnë vendin dhe kohën, megjithëse mes tyre ka edhe shprehje të tilla, duke paraqitur një konstrukt në të cilin gjymtyra e fundit të tij përcakton reksionin e gjymtyrës pasardhëse në fjali (Samara 1999; Agalliu et al. 2005), si për shembull: *me anë të figurave, për shkak të rrethanave, me ndihmën e qytetarëve, falë një projekti...* (në të cilin gjymtyra e fundit të konstruktit ndikon në reksionin e gjymtyrës pasardhëse në gjinore dhe, në shembullin e fundit, në dhanore).

Në gjuhën shqipe si dhe në një numër i madh i gjuhëve indoevropiane, parafjalët e parme janë shumëkuptimshme, ndërsa ato të prejardhura janë zakonisht dykuptimshme e shprehjet parafjalore të njëkuptimshme. Shkallën më të ulët të qartësisë së kuptimit leksikor e tregojnë parafjalët e parme, “si *në, me, për, nga* etj., ndërsa parafjalët e prejardhura si *buzë, majë, mes, afër, kundër, përfshirë...*, së bashku me shprehjet parafjalore kanë shkallën më të lartë të qartësisë së kuptimit leksikor, ku përkimi semantik i tyre me temat prodhuese fjalëformuese është i dukshëm” (Çeliku 2019: 16).

3. Qëllimi dhe qasja

Analiza jonë është fokusuar në semantikën e parafjalës *nga* të gjuhës shqipe dhe është motivuar me këto arsye:

a) bëhet fjalë për atë parafjalë që, krahasuar me të gjitha parafjalët e tjera, ka numrin më të madh të kuptimeve, duke u paraqitur në 28 forma (sipas FGSSH 2008);

b) është parafjalë që përputhet nga ana semantike dhe sintaksore me emëroren (veçori e gjuhës shqipe që e bën atë unike brenda familjes së gjuhëve indoevropiane (Demiraj 1989; Përnaska 1996; Çeliku 2019);

c) e vetmja parafjalë e gjuhës shqipe, që brenda perimetrit të saj semantik ka një kuptim ambivalent, antonim - mund të tregojë afrim dhe largim (U kthye *nga unë* dhe më tha: “Në rregull, jam dakord.”; Pa asnjë fjalë ajo u kthye *nga unë* dhe u largua përgjithmonë.; U largua *nga vendi i ngjarjes.*);

ç) në konstruktet tregon lokacionin (vendin), marrëdhëniet hapësinore dhe shënon aspektin e dinamizmit (lëvizjes).

Qëllimi i hulumtimit tonë paraqitet si në vijim:

a) perimetri semantik i parafralës *nga*, që përshkruan strukturën kuptimore dhe përdorimin e kësaj parafralë;

b) përcaktimi i rrjetit kuptimor të parafralës *nga*;

c) analiza e konstrukteve me parafralën *nga* me ndihmën e metodave të gjuhësisë kognitive me fokus të veçantë në konstruktet në të cilat parafralja *nga* ka kuptimin e përmbajtësit (enës) (cointaner-it).

4. Semantika e parafralës *nga* në gjuhën shqipe

Kur shtjellohet çështja për kuptimin e një parafralë, së pari duhet parë nga këndvështrimi më i gjerë, i cili përfshin të gjitha kuptimet e mundshme të një parafralë, të përcaktuara në gramatikat dhe fjalorët e një gjuhe të caktuar, kuptimet e kushtëzuara nga kontekstet socio-kulturore, etimologjia, kuptimet e reja etj., por edhe shfaqjen e saj në konstrukte (sintagma/klauzë/fjali) si modele gjuhësore. Një nga karakteristikat e të gjitha gjuhëve naturale është kombinimi i dy ose më shumë fjalëve në njësi që janë gramatiksht dhe semantiksht të sakta dhe të kuptueshme për të gjithë folësit e gjuhës së caktuar. Numri i këtyre grupeve të fjalëve, konstrukteve, është i madh në çdo gjuhë, Sipas S. Lindstromberg (2010), disa konstrukte kanë kuptimin e tyre specifik deri në atë masë sa, nëse njëra prej fjalëve zëvendësohet me një fjalë tjetër, qoftë edhe sinonime, kuptimi zhduket dhe/ose konstrukti i ri duket i çuditshëm (Lindstromberg 2010: 5), p.sh.: në anglisht parafralët *in*, *inside*:

Mund të themi: *in trouble*, por jo *inside trouble** (e parregullt*).

Në shqip mund të themi: *jam në gjumë*, por kurrësi *jam mbi gjumë**

*Një nga një / një prej një** (kanë semantikë të ndryshme).

Dasma po afronte, kështu që ata filluan *nga përgatitjet / prej përgatitjeje** (e parregullt).

Gramatika dhe fjalorët e gjuhës shqipe i dallojnë këto kuptime të parafralës *nga* (kur ajo përdoret me emër në emërore):

a) kuptim vendi (ku entiteti fillon të lëvizë ose nga vjen; drejt të cilit lëviz; nëpër të cilin kalon; ku ndodhet; vendi ose drejtimi nga i cili diçka vepron mbi folësin ose sendin; vendi ose objekti në bazën e të cilit caktohet distanca; me parafralën *në* cakton vendin, brenda kufijve të të cilit lëviz entiteti; një vend a entitet nga sipërfaqja ose brendësia e të cilit diçka hiqet, lëviz); b) pika drejt së cilës drejtohet veprimi; c) tërësia nga e cila ndahet pjesa; ç) ndarja e dy ose më shumë entiteteve; d) origjina, prejardhja e entitetit; dh) koha (koha e përafërt, kornizë kohore) e) veprimi që fillon; ë) shkaku; f) agjenti; g) ndarja e një mase të caktuar; gj) mënyra; h) marrëdhëniet farefisnore etj.

Më tej të gjitha kuptimet mund t'i ndajmë në ato që kanë shënues hapësinorë (spacialë) dhe ato që nuk i kanë.

Shënues hapësinorë e parafjalës nga:

<i>Pika prej së cilës fillon lëvizja</i>	<i>U nisën nga Vlora.</i> <i>Erdhën nga Shkodra.</i>
<i>Drejt së cilës drejtohet lëvizja</i>	<i>U drejtuan nga fshati.</i> <i>U kthye nga unë.</i>
<i>Prej së cilës largohet entiteti</i>	<i>Largohem nga qyteti.</i>
<i>Pika ku ndodhet entiteti</i>	<i>Po e shikoj nga ballkoni.</i>
<i>Pika që shënon kalimin e entitetit nëpër/përmes një hapësire/ perlativiteti</i>	<i>Kaluam nga fusha.</i> <i>Nga dhoma në dhomë. (https://fjale.al/nga)</i>
<i>Largësia / propozicionaliteti</i>	<i>Njëqind metra nga rruga.</i> <i>Dy hapa nga shtëpia ime.</i>

Shënues jo hapësinorë:

<i>Agjenti</i>	<i>“Fabula rasa”, romani i shkruar nga Agron Tufa.</i>
<i>Pacienti</i>	<i>Mbledh fletoret nga nxënësit.</i> <i>(http://www.fjalori.shkenca.org/)</i> <i>Hodhi sytë nga Edit Bergleri dhe nga ne.</i>
<i>Shkaku</i>	<i>Vepra është bërë nga pakujdesia.</i> <i>Vdiq nga dashuria.</i> <i>U lodh nga puna.</i>
<i>Pjesë e së tërës</i>	<i>Një nga zyrtarët.</i> <i>Një nga shtatë mrekullitë e botës.</i>
<i>Marrëdhëniet farefisnore</i>	<i>Kushëri nga nëna. (https://fjalorthi.com/kushëri)</i>
<i>Koha (kufi kohor përafërsisht i përcaktuar/ segment kohor i përcaktuar saktësisht)</i>	<i>Shihemi nga e hëna.</i> <i>Nga e marta ndryshon moti.</i>
<i>Mënyra</i>	<i>Të ftuarit mbërritën në ditëlindje një e nga një.</i>
<i>Sasia</i>	<i>Na dhanë nga një kilogram sheqer.</i>
<i>Cilësi, karakteristikë</i>	<i>I pjekur nga mendja. (https://fjale.al/nga)</i> <i>I vogël nga trupi. (https://fjale.al/nga)</i>

5. Semantika e parafjalës nga nga këndvështrimi i gjuhësisë kognitive

Gjuhësia kognitive niset nga qëndrimi se gjuha është pjesë përbërëse e të gjithë sistemit tonë kognitiv dhe se ajo nuk përfaqëson një sistem të veçantë modular, të izoluar dhe të pavarur nga ai kognitiv, pavarësisht se ky nuk është rasti me gramatikën.

Në një kuptim edhe më konkret, ajo thekson se ne organizojmë njohuritë tona me ndihmën e procesit kognitiv më të rëndësishëm, procesit të *kategorizimit*, në të cilin “larmia e pafundme e stimuljeve të jashtëm reduktohet në një masë të arsyeshme kognitive, duke klasifikuar objektet, që ne i konsiderojmë të barabartë, së bashku në të njëjtën kategori” (Rosch 1977 te Klikovac 2006: 13), si dhe nga ana tjetër me struktura të quajtura modele kognitive ideale (Jackendoff 1983).

Përvoja jonë fizike përfaqëson nivelin bazë të konceptualizimit tonë. Për gjuhësinë kognitive, kuptimi është një konceptualizim, ndërsa kuptimet nuk ekzistojnë vetvetiu, por përfshijnë të gjithë njohuritë e folësit, si gjuhësore ashtu edhe enciklopedike, të cilat bazohen në aftësitë njohëse të njeriut që më tej çojnë në një strukturë kategorish që organizohen rreth prototipave. Një nga konceptet më të rëndësishme të gjuhësisë kognitive është koncepti i “prototipit”, si një shembull bazë, themelor brenda një klase që mund të konsiderohet përfaqësuesi i saj.

Kështu, leksema është një kategori, gjymtyrët e së cilës janë kuptime individuale të leksemës, që janë të ndërlidhura në një “rrjet” në të cilin secili prej kuptimeve është një “nyjë” e atij rrjeti (Klikovac 2006: 15). Disa kuptime janë prototipike, më përfaqësuese e një lekseme të caktuar, së cilës i shtohen kuptime të tjera të lidhura, ndërsa Lakoff (1982) vë në dukje se struktura prototipike e një lekseme vazhdon deri në nivelin e përdorimeve të saj individuale (po aty 15).

Në rastin e parafjalëve, termi i drejtohet kuptimit qendror bazë, nga i cili rrjedhin kuptimet dytësore, të prejardhura. Të dhënat mbi kuptimin bazë ose prototip mund të sigurohen nga etimologjia dhe kuptimet më të hershme të konfirmuara të një parafjale, të cilat dokumentohen në dokumentet më të vjetra të shkruara gjatë historisë (Tyler & Evans 2003).

Ndërkaq, në rastin e parafjalës *nga*, G. Mayer në *Fjalorin Etimologjik të Gjuhës Shqipe* (1891) jep një shpjegim të kuptimit të kësaj parafjale, duke vënë në dukje se ajo është një parafjalë që përdoret me një emër në trajtën e shquar dhe të pashquar, me kuptim “përpara; afër tek” dhe që mund të ketë edhe kuptim shpërndarës dhe të përdoret me krahasoren “sesa” (me shenjuesit “cal., siq., arv. në Specia e Hidra”; Mayer [1891] 2007: 351), Pedersen i më tej ishte i pari që pohonte se kjo parafjalë e kishte burimin të lidhëza gjegjëse me origjinë përemërore e që ishte përfutur përmes lënies jashtë të foljes kallëzues në fjali të varura të tipit “(dola) nga shtëpia është” (Demiraj 1989: 643).

Interpretimet e mëtejshme janë vetëm një konfirmim i këtij qëndrimi, të cilin e gjejmë te W. Cimochofski, i cili shprehet se “bëhet fjalë për një ndajfolje nga prejardhja, që filloi të përdorej me trajtën e emërores (emër; shënim M.K.) në fjali të thjeshta “në të cilat nuk është përdorur kallëzuesi” (Cimochofski 2004: 223), si për shembull:

“tu špija (e) eme”, që në fillim e kishte kuptimin “atje ku është shtëpia ime”, *ka* (gegishtja jugore *nga*) *kâ dâl ka katuni*; *ka ní, ka dû dhe kah* (drejt): *kah špija* (po aty 223).

Çeliku et al., në *Gramatikën Praktike të Gjuhës Shqipe* në një fusnotë theksojnë se bëhet fjalë për lidhëzën e dikurshme *nga* (me *te/k*), e cila u bë parafjalë me ndërtimin e elipsës (2004: 211), ndërsa autorët e *Gramatikës së Gjuhës Shqipe I* theksojnë se përdorimi i parafjalës *nga* (së bashku me parafjalën *te/k*) në gjuhën shqipe është përjashtim, për të cilin konsiderohet se ka dalë nga përdorimi i saj si fjalë lidhëse (Agalliu et al. 2005: 383).

Duke u nisur nga kuptimi më i vjetër i njohur i kësaj parafjale, mund të dalim në përfundimin se kuptimi i saj parësor është kuptim vendor. Kuptimet themelore ndryshojnë me kalimin e kohës, d.m.th. në një numër të madh rastesh, ato bëhen më pak të njohura si të tilla, plotësohen me kuptimet e reja ose, nga ana tjetër, fitojnë disa kuptime krejtësisht të reja, që bëhen dominuese nëpërmjet përdorimit të gjuhës dhe pranimit të përgjithshëm nga folësit amtarë të një gjuhe.

Si udhërrëfyes i dytë në kërkimin e kuptimit bazë të një parafjale, mund të na ndihmojë edhe kuptimi i parë që shfaqet si më tipik ndër folësit amtarë, kur u jepet detyra për të dhënë një shembull, d.m.th. të shkruajnë ose të shqiptojnë një fjali, në të cilën do të përdorin një parafjalë të caktuar (Rice 1996: 156 në: Lindstromberg 2010: 20).

Këto dy qasje paraqesin kryqëzimin e leximeve diakronike dhe sinkronike të kuptimit të parafjalës, në rastin tonë konkret, parafjalës *nga*. Anketuam 40 persona (folës amtarë nga Tirana të moshave të ndryshme, 23 gra dhe 17 burra) të cilëve iu dha detyra të thonin ose shkruanin një fjali, pa u menduar shumë, në të cilën do të përdorej parafjala *nga*. Pas analizës së materialit të vjelë, arritëm në këto rezultate: përdorimi i parafjalës *nga* me kuptim vendor u shfaq si e para me 17 shembuj, prej të cilëve 5 ishin me kuptim metaforik, pasuar nga përdorimi me kuptim kohor, qoftë si pikë kornizore kohore ose si segment kohor i përcaktuar, madje edhe në 12 shembuj.

Një element tjetër i rëndësishëm është shkalla në të cilën një kandidat për një kuptim protopik shpjegon një përdorim të veçantë abstrakt të një parafjale. Deri në çfarë mase është më i shpeshtë dhe më intensiv përdorimi i saj kur bëhet fjalë për ndërtime që kanë kuptim metaforik dhe metonimik. Në rastin e parafjalës *nga* është jashtëzakonisht i zhvilluar rrjeti i saj i kuptimit abstrakt, si dhe përdorimi i saj me kuptim metaforik.

Çdo model ideal kognitiv është një strukturë e përbërë nga simbole. Sipas Lakoff (1987), ekzistojnë dy lloje të strukturave komplekse simbolike: strukturat e blloqeve të ndërtimit dhe strukturat gestalt. Një strukturë bllok karakterizohet nga ekzistenca e pavarur e të gjithë elementëve strukturorë të saj, të cilët nga ana tjetër janë të ndërlidhur në mënyrë që kuptimi të jetë rezultat i të gjithë kuptimit

të pjesëve të saj (Lakoff 1987: 28). Përndryshe, është një strukturë gestalt, d.m.th. bëhet fjalë për një strukturë, elementët e së cilës nuk ekzistojnë në mënyrë të pavarur nga e tëra ose kuptimi i përgjithshëm i së cilës nuk është i parashikueshëm mbështetur në kuptimin e pjesëve të saj dhe në mënyrën se si ato pjesë janë të lidhura.

Realizimi i gjuhës në formë gojore dhe të shkruar janë fjali që kanë strukturë blloku, kurse vetë kategoritë sintaksore dhe marrëdhëniet gramatikore kanë strukturë radiale me qendër prototipike të parashikueshme në themel të bazës semantike. Gjymtyrët joqendrore formojnë zgjerime që nuk janë të parashikueshme në bazë të semantikës, por që janë tipikisht të motivuara semantikisht ose pragmatikisht (po aty 465), ndërsa e gjithë struktura është e renditur dhe e përcaktuar nga parime qendrore që kanë një rol të dyfishtë. Ato përcaktojnë rregullsi të formës dhe kuptimit për mbikategori qendrore, d.m.th. fjalitë prototipike, emrat, foljet, mbiemrat, temat etj. Dhe më pas ato karakterizojnë edhe mënyrën se si shkrihen rastet joqendrore me ato qendrore, ndërsa bashkimi i këtyre dy grupeve të kategorive është i motivuar nga pikëpamjet e gjuhësisë kognitive.

Sipas Lakoff (1987), pikënisja bazë është leksema, kategoritë gramatikore dhe ndërtimet gramatikore. Kuptimi i njësive leksikore - fjalëve dhe morfemave - përcaktohen nga karakteristikat e modelit kognitiv. Brenda një modeli të tillë, kategoritë qendrore janë emrat, foljet, mbiemrat, subjektet etj. Për shembull, gramatikisht, emrat janë një lloj i pavarur fjalësh që emërton kategori themelore si njerëzit, kafshët, objektet, qytetet, etj. dhe përfaqësojnë kategorinë radiale.

Folja është gjithashtu një kategori radiale me një nivel bazë të veprimit/veprimtarisë fizike si gjymtyrë qendrore (*flas, vrapoj, eci, jap* etj.). Edhe pse kategorive gramatikore në tërësi nuk mund t'u jepet një përkufizim strikt klasik në kuptimin semantik, nënkategoritë e tyre qendrore mund të përkufizohen pikërisht në këtë mënyrë. Gjymtyrët e mbetura të çdo kategorie të caktuar mund të motivohen nga marrëdhëniet e tyre me gjymtyrët qendrore. Një lidhje që "lokalizon" një kategori konstruktive në lidhje me një gjymtyrë tjetër, si një nënkategori e saj, quhet relacion "bazuar në" (Lakoff 1987: 465).

Pavarësisht nga kuptimet e renditura në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, në kuptimin e saktë të semantikës dhe përdorimin e parafjalës ndikon në radhë të parë konstrukti, përkatësisht konstrukti gramatikor (sintagma, klauzë, fjalia) në të cilën shfaqet, si edhe konteksti i tij semantik. Mbështetur në analizën e materialit që kemi nxjerrë nga fjalorët e disponueshëm të shtypur dhe online të gjuhës së sotme shqipe dhe mbi 500 fjali të filtruara nga motori i kërkimit Google, kur bëhet fjalë për konstruktin më të gjerë, si më i shpeshti dhe më i zakonshmi në përdorimin gjuhësor në gjuhën shqipe, doli kjo strukturë:

folja + sintagma (parafjalë + emër (më shpesh), por edhe + përemër), ndërsa në rastin e konstruktit më të ngushtë, bëhet fjalë për sintagmën (parafjalë + emër, përemër, numëror); si shumë frekvente u paraqit edhe konstrukt i ngushtë numëror + sintagmë (*një + nga një*).

Foljet që janë më të shpeshta e paraqiten brenda konstrukteve më të gjera, të cilat përfshijnë parafjalën *nga*, janë: *nisem, kthehem, jam, dal, largohem, drejtohem, kaloj, vij, zbres, hyj, shkoj, shihemi, shoh ...*

Gjithashtu, në konstruktet paraqitet modeli i foljeve mediale: *frikësohem, trembem, turpërohem, gërditem, neveritem* + parafjala *nga* + emër në rasën emërore (Vmed + NGA + Nnom), “që presupozojnë kuptimin ‘të kesh ndjenjë X’, pra në interpretimin semantik të fjalive me folje të tilla nënkupton kuptimin ‘Y shkakton ndjenjën X’ dhe emri në emërore ka kuptimin e shaktuesit (*causator-it*)” (Пипер et al. 2005: 127). Për shembull: *Frikësohem nga viruset*.

Foljet: *mësoj, dëgjoj, marr, blej, kërkoj*, që nënkuptojnë ekzistencën e një agjenti/pseudoagjenti.

Mësoj nga media.

Marr nga nëna.

Blej nga shitësi.

Ndeshet edhe një model i shpeshtë, që del si modeli i tipit: folja semikopulative *përbërë, bëhet*, ose një folje e tipit *varet* + parafjala *nga* + emër në rasën emërore (VsemiCop + NGA + Nnom): *Përbëhet nga mielli dhe uji*.

Parafjalët më tej, janë të përcaktuara si fjalë që tregojnë relacion. Ato tregojnë marrëdhënien midis dy ose më shumë objekteve dhe gjuhësia kognitive shpesh thekson se kjo marrëdhënie është asimetrike dhe se nënkupton dy elemente bazë - një objekt që është në plan të parë, “ndërsa tjetri shërben si sfond ose pikë referimi” (Taylor 1993 në: Klikovac 2006: 19). Baza për të kuptuar këtë marrëdhënie jepet nga psikologjia Gestalt, e cila studion marrëdhëniet midis figurës (*figure*) dhe bazës (*ground*). Figura është zakonisht më e vogël, më e lëvizshme, gjeometrisht më e thjeshtë (shpesh si pikë), më ekspresive, me një paraqitje të mëvonshme në skenën hapësinore dhe në vetëdije, ndërsa baza është zakonisht më e madhe, më e fiksuar, e imagjinuar me kompleksitet më të madh gjeometrik, e vendosur në sfond, ekzistues më parë në skenë ose në kujtesë (Klikovac 2006: 19). Një tipar tjetër i rëndësishëm i kësaj marrëdhënieje asimetrike është markimi gjithmonë i spikatur i pozicionit të figurës në raport me bazën, dhe kështu në gjithmonë themi dhe i perceptojmë gjërat në realitet:

“Makina është pranë ndërtesës” dhe jo “Ndërtesa është pranë makinës”.

Në gjuhësinë kognitive këto dy objekte në relacion emërtohen si *trajectory* dhe *landmark*, ndërsa në gjuhësinë serbe përgjithësisht pranohen termat: objekt lokalizimi dhe lokalizues. Për shembull në fjalinë: *Shkronja është në tabelë*, shkronja është objekt lokalizimi (OL), tabela është lokalizuesi (L).

Një parim tjetër i organizimit të brendshëm të kategorive është skematizmi, i cili paraqet një kategorizim abstrakt përmes skemave në të cilat skema nuk funksionon si “gjenerator” për nxjerrjen e kuptimeve specifike (Klikovac 2006: 17), por paraqet një rrjet kuptimesh. Sipas Johnson (Johnson 1987) dhe Lakoff (Lakoff 1987), sistemi ynë konceptual funksionon dhe organizohet në bazë të një numri të caktuar skemash imazhi që përfaqësojnë modele të përsëritura të përvojës sonë konkrete, fizike, lëvizjes nëpër hapësirë, ndërveprimit me entitetet rreth nesh dhe perceptimit tonë.

Një nga skemat bazë është skema e kontejnerit në të cilën ekziston një marrëdhënie midis SO (objektit të përmbajtur) dhe S (kontejnerit), me një kufi të qartë të asaj që është brenda dhe jashtë S (kontejner). Kjo marrëdhënie transferohet në mënyrë metaforike në sferë e jo më fizike, por abstrakte, ku objekti i përmbajtur mund të jenë entitete abstrakte ose logjike, dhe vetë përmbajtësi (kontejneri) entitete edhe më abstrakte (siç janë kontratat, statutet, marrëveshjet, etj.). Një skemë e tillë transferohet në shumë nga përvojat tona, përmes metaforës dhe metonimisë. Para së gjithash, ekziston përvoja trupore: ne mund ta përjetojmë trupin tonë në dy mënyra - si një kontejner (përmbajtës, enë) dhe si një objekt i përmbajtur. Në rastin e parë, trupi ynë është kontejneri (përmbajtësi, ena) dhe frymëmarrja jonë (thithja e nxjerrja e frymës), organet tona, emocionet, mendimet, etj. përjetohej si një objekt i përmbajtur, ndërsa në rastin tjetër trupi ynë mund të përjetohej si një objekt i përmbajtur, si p.sh.:

Unë jam në ashensor.

Në atë rast, ne jemi objekti i përmbajtur dhe ashensori është kontejneri. Analiza e konstrukteve me parafjalën *nga* me ndihmën e metodave të gjuhësisë kognitive në të cilat kjo parafjalë tregon kuptimin e kontejnerit (përmbajtësit/enës) dallohen dy lloje semantike - a) konstruktet me kuptim parësor dhe b) ato me kuptim abstrakt, të cilat janë rezultat i metaforës dhe në një numër shumë të vogël i metonimisë. Do të rendisim edhe disa shembuj të konstrukteve me kuptim bazë:

E nxori *nga xhepi*.

Flet në telefon *nga makina e tij*.

Të telefonoj *nga posta*.

Në shembujt e dhënë, entitetet (në fjalinë e parë një objekt, në të dytën dhe të tretën një qenie të gjallë) janë objekti i përmbajtur, ndërsa *xhepi*, *makina*, *posta* janë kontejneri. Grupi i dytë përfshin konstrukte me kuptim abstrakt që janë kryesisht rezultat i një metafore. Hartëzimi metaforik përfshin si domenin-burim ashtu edhe dhe domenin e synuar, ku supozohet se domeni burimor është i strukturuar si një model propozicional ose piktor-skematik, ku hartëzimi është tipik i pjesshëm d.m.th., struktura e domenit burimor është hartuar me strukturën përkatëse të domenit të synuar, si, për shembull:

Pëlçet nga intati (xhelozia / smira/ zilia / urrejtja).

Trupi paraqitet si përmbajtës kurse ndjenja si objekt i përmbajtur. Ndjenja është një metaforë për “zemërim, xheloz, zili, zili në kuptimin pozitiv, urrejtje”.

Vuante nga stomaku (zemra/ veshkat / ethet).

Po vdiste nga kureshtja.

Trupi është përmbajtës, ndërsa stomaku, zemra, veshkat, ethet janë objekt i përmbajtur. Dhembja është metaforë. Në shembullin “po vdiste nga kureshtja”, trupi është përmbajtës, kureshtja është objekt i përmbajtur, vdekja është metaforë.

Falënderoj nga zemra.

Më doli nga mendja.

Zemra është përmbajtës, objekti i përmbajtur është falënderimi. Zemra është një metaforë për organin qendror të trupit tonë, si fizikisht ashtu edhe shpirtërisht. Në shembullin e dytë, mendja është përmbajtës, objekti i përmbajtur është mendimi, ndërsa metafora është largësia, largimi.

Një metaforë mund të motivohet nga një imazh real ose një imazh-përvojë. I tillë është rasti në shembujt:

Shtangu (mbeti / dridhej) nga frika.

Trupi është përmbajtësi, frika është objekti i përmbajtur. Është një imazh-përvojë që motivohet nga efektet e gjendjes psikologjike të frikës. Për shkak të rrezikut, një person mund të bëhet i paralizuar, i ngurtësuar dhe plotësisht i paaftë për të lëvizur, si dhe mund të dridhet me gjithë trupin. Ky grup përfshin gjithashtu shembuj:

U lodh nga puna.; E ka nga paniku.; Ra nga pozita.

Në shembullin e parë, trupi është përmbajtësi, lodhja është objekti i përmbajtur. Dikush mund të lodhet nga puna (fizike ose mendore). Në shembullin e dytë, trupi është P, OP është paniku. Për shkak të panikut, një person ka lëvizje dhe sjellje shumë të dukshme dhe shprehja e tij e fytyrës tregon qartë se personi është i mërzhitur, ndërsa në shembullin e tretë një rënie nga pozita, pozicioni është motivuar nga një imazh real i rënies nga kali, shkëmbi ose ndonjë objekt i ngritur.

6. Përfundim

Analiza jonë tregoi se kuptimi parësor, prototip i parafjalës *nga* në konstrukcion është vendor, se të gjitha kuptimet e saj mund të grupohen në dy grupe - me dhe pa shënues hapësinorë (agjenti, pacienti, shkaku, pjesë e së tërës, farefisnia, koha (një afat kohor për afërsisht i përcaktuar / segment kohor i përcaktuar saktë), mënyra, shuma, pasuria, cilësia). Kur bëhet fjalë për konstruktin më të gjerë, si më i shpeshti dhe më i zakonshmi në përdorimin gjuhësor në gjuhën shqipe, doli struktura: folje + sintagmë (parafjalë dhe shumë shpesh një emër, por edhe përemër), ndërsa kur bëhet fjalë për konstruktin më të ngushtë bëhet fjalë

për sintagmë (parafjalë + emër, përemër, numëror), si shumë frekuent paraqitet edhe konstrukti më të ngushtë të tipit numëror + sintagmë (një + nga një).

Analiza e ndërtimeve me parafjalën *nga* me ndihmën e metodave të gjuhësisë kognitive me fokus të veçantë të konstruktet në të cilat parafjala *nga* ka kuptimin e përmbajtësit veçoi dy lloje semantike - a) konstruktet me kuptim parësor dhe b) ato me kuptim abstrakt, që janë rezultat i metaforës dhe, në një numër shumë të vogël, i metonimisë.

Supozojmë gjithashtu se parafjala *nga* do të ruajë sigurisht statusin e saj si parafjala me numrin më të madh të kuptimeve brenda sistemit parafjalor të gjuhës shqipe. Ky pozicion është, nga njëra anë, pasojë e origjinës së saj si pjesë e konstruksionit në të cilin kallëzuesi mungon dhe që mundëson kombinimin me njësi të tjera gjuhësore, ndërsa nga ana tjetër kuptimi themelor i saj është një kuptim vendor me një numër të madh të shënuesve hapësinorë.

Literatura

- Agalliu, F., Angoni, E., Demiraj, Sh., Dhrimo, A., Hysa, E., Lafe, E., Likaj, E. (2005). *Gramatika e gjuhës shqipe 1, Morfologjia*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë / Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Baldwin, T., Kordini, V., Villaiencio, A. (2009). Preposition in applications: A survey and introduction to the special issue. *Computational Linguistics*, 35(2), 119–149.
- Beci, B. (2005). *Gramatika e gjuhës shqipe*. Tiranë/Shkup/Prishtinë: Logos - A.
- Burnard, L. (2000). *Reference Guide for the British National Corpus*. Oxford University Computing Services, Oxford. UK.
- Cimochowski, W. (2004). *Për gjuhën shqipe*. Botime të veçanta LI, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 23. (redaksia Idriz Ajeti, Besim Bokshi, Rexhep Ismajli). Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- Croft, W., Cruse A. D. (2004). *Cognitive Linguistics*. Cambridge University Press. UK.
- Çeliku, M., Karapinjalli, M., Stringa, R. (2004). *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*. (botimi i tretë). Tiranë: Botimet Toena.
- Çeliku, M. (2019). *Parafjalët e shqipes standarde*. Tiranë: Shtëpia botuese/shtypshkronja ILAR.
- Demiraj, Sh. (1971). *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*. Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.
- Demiraj, Sh. (1989). *Gramatika historike e gjuhës shqipe*. Tiranë: Universiteti i Tiranës “Enver Hoxha”, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Shtëpia botuese “8 Nëntori”.

- Jackendoff, R. (1983). *Semantics and Cognition*. Cambridge, Massachusetts / London, England: The MIT Press.
- Johnson, M. (1987). *The Body in the Mind: The Bodily Basis of Meaning, Imagination and Reason*. Chicago: University of Chicago Press.
- Klikovac, D. (2006). *Semantika predloga – Studija iz kognitivne lingvistike* (drugo izdanje). Beograd: Filološki fakultet.
- Lakoff, G. (1982). Categories: An essay in cognitive linguistics. In: *Linguistics in the Morning Calm* (The linguistic Society of Korea, ed.), Seoul: Hanshin Publishing Co., 139–193.
- Lakoff, G. (1987). *Women, Fire and Dangerous Things*. (What Categories Reveal about the Mind). The University of Chicago Press: Chicago and London.
- Lindstromberg, S. (2010). *English Preposition Explained*. Amsterdam / Philadelphia: John Benjamins Publishing Company.
- Mayer, G. [1891] 2007. *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe – 1891*. Tiranë: Botime Çabej.
- Përnaska, R. (1996). *Kundranori me parafjalë në gjuhën e sotme shqipe*. Pejë: Botues Dukagjini.
- Samara, M. (1999). *Parafjalët në shqipen e sotme (Vështrim leksiko-semantik)*. Tiranë: Panteon.
- Spahiu A. (2010). 100 fjalët më të shpeshta në gjuhën shqipe. [http://www.shkenca.org/pdf/gjuhe/100_fjale.pdf], aksesuar më 20 janar 2022.
- Taylor, A., Evans, V. (2003). *The Semantics of English Prepositions: Spatial Scenes, Embodied Meaning and Cognition*. United Kingdom: Cambridge University Press.
- Topalli, K. (2011). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Драгићевић, Р. (2012). О именицама у служби предлога. *Јужнословенски филолог*, LXVIII, Београд, стр. 91–111.
- Пипер, П., Антонић, И. Ружић, В., Танасић, С., Поповић, Љ., Тошовић, Б. (2005). *Синтакса савременог српског језика. Проста реченица*. (у редакцији академика Милке Ивић), Београд: Институт за српски језик САНУ / Београдска књига / Матица Српска.
- Пипер, П., Клајн, И. (2014). *Нормативна граматика српског језика*. (друго допуњено издање). Нови Сад: Матица Српска.
- Станојичић, Ж., Поповић, Љ. (2012). *Граматика српског језика за гимназије и средње школе*. (четрнаесто издање). Београд: Завод за уџбенике.
- Стевановић, М. (1991). *Савремени српскохрватски језик I*. (пето издање). Београд: Научна књига.

Burime (Fjalorë njëgjuhësh/frazeologjikë)

- FGJSH (2006). *Fjalor i gjuhës shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë / Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Dhrimo, A., Tupja, E., Eshref, Y. (2007). *Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe*. Tiranë: Botime EDFa.
- Gjevari, M. (1988). *Frazeologjizma të gjuhës shqipe*. Prishtinë: Rilindja.
- Jashari, A. (2020). *Fjalor homonimeve në gjuhën shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Qesku, P. (2008). *Fjalor themelor i gjuhës shqipe*. Tiranë: EDFa.
- Thomai, J. (1999). *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë / Instituti i gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Fjalorë elektronikë (online)

- <http://www.fjalori.shkenca.org/>
- <https://fjalorthi.com/>
- <https://fjale.al/>
- <https://sq.wiktionary.org/wiki/fjalor>
- <https://albasoftgroup.com/sq/Our-Work/Fjalori-elektronik-shpjegues---FESh>
- <https://fjalor-recnik.com/>

Merima H. Krijezi
Faculty of Philology, University of Belgrade

THE SEMANTICS OF THE PREPOSITION *nga* AND ITS RELATIONS IN THE SYNTAGMATIC AND PHRASEOLOGICAL CONSTRUCTS IN THE ALBANIAN LANGUAGE

Summary

With its specific quality of having nominative prepositions, which is not a feature of any Indo-European language, the Albanian language differs from the group of Indo-European languages (Demiraj, 1989; Çeliku, 2019), it even possesses the two prepositions that are used with the nominative, in addition to the preposition *nga* the preposition *te/tek*. The paper deals with the analysis of the meanings of the preposition *nga* in constructs, its semantics, semantic perimeter and the possibility of combining this preposition with other parts of the sentence (primarily with nouns, pronouns and numbers, but also with verbs within wider constructions), from the perspective of morphosyntax, semiology and cognitive linguistics. The analysis is directed to the difference of the basic, primary meanings that this preposition can have in the Albanian language, as well as to the way of making its secondary meanings, largely of a metonymic character.

Our analysis showed that the primary, prototypical meaning of the preposition *nga* in the construction is locational, that all its meanings can be grouped into two groups - with and without spatial markers (agent, patient, cause, part of the whole, kinship, time (an approximately determined time limit /precisely determined time segment), manner, amount, property, characteristic)). When it comes to the broader construction, as the most frequent and common in language use in the Albanian language, the structure stood out: *Verb + syntagm* (preposition and most often a noun, but also a pronoun), while when it comes to the narrower construction it is a syntagm (preposition + noun, pronoun, number).

Key words: semantics, Albanian language, the preposition *nga*, constructs (syntagma/phrase) with the preposition *nga*, Cognitive Linguistics, localistic theory

Anđela M. MARKOVIĆ¹

Univerzitet u Beogradu, Filološki fakultet

 <https://orcid.org/0009-0000-6531-1107>

IMENICE SA PREPOZITIVNIM ČLANOM U ALBANSKOM JEZIKU

Iako su danas za mnoge imenice sa prepozitivnim članom pronađeni ekvivalenti bez člana, određeni broj ovih imenica je zadržao ovu gramatičku osobinu. Gramatičari i proučavaoci albanskog jezika u većoj meri su se bavili izučavanjem članova u kontekstu prideva i genitiva, što dodatno otežava proučavanje ovog tipa imenica. Kao takve, najčešće se pominju imenice koje označavaju dane u nedelji, rodbinske odnose ili etničku pripadnost. Pomoću analize roda, broja i padeža ovih imenica, kao i funkcije članova koji se vezuju uz njih sa posebnim akcentom na kategoriju srednjeg roda u albanskom jeziku, nastojali smo da objasnimo ulogu ovih imenica u gramatičkom sistemu albanskog jezika. Pregledom relevantne literature i kritičkom evaluacijom zaključaka različitih autora, došli smo do zaključka da, uprkos tendenciji redukcije i smanjenja upotrebe imenica sa prepozitivnim članom, značajan broj ovih imenica i dalje nalazi svoje mesto u svakodnevnoj komunikaciji. Ovo istraživanje ukazuje dodatno na potrebu za detaljnijim i sistematičnijim proučavanjem ovih imenica, sa ciljem boljeg razumevanja njihove ulogu u savremenom albanskom jeziku.

Ključne reči: albanski jezik, imenički sistem, srednji rod, particip, poimeničavanje prideva, prepozitivni član.

Uvod

Imenički sistem albanskog jezika predstavlja jedan od ključnih aspekata gramatičke strukture ovog jezika, a kao takav ima značajnu ulogu u formiranju i upotrebi članova. Upravo, posebno zanimljiva kategorija su imenice sa prepozitivnim članom, koje, iako se ne koriste tako često, zadržavaju poseban status u savremenom albanskom jeziku.

U svojoj knjizi *Gramatikë historike e gjuhës shqipe* Kolec Topalli (2011: 165–174) posvećuje posebnu pažnju razvoju imeničkog sistema albanskog jezika. Albanski jezik, kao deo indoevropske porodice jezika, deli zajedničke karakteristike sa drugim jezicima ove grupe, koja se prostire od zapadne Evrope do južne Azije. U

¹ andjela.markovic@fil.bg.ac.rs ; markovic.m.andjela@gmail.com

indoevropskom jeziku postojala su tri roda – muški, ženski i srednji, koja su kasnije preneti i na albanski jezik. Međutim, iako je indoevropski jezik imao tri broja – jedninu, množinu i dual, albanski jezik je zadržao samo jedninu i množinu, dok je dual iščezao, što predstavlja karakteristiku koju albanski jezik deli sa mnogim drugim jezicima ove porodice. Ono što albanski jezik čini posebnim je i postepeni nestanak srednjeg roda, iz kojeg je najveći broj imenica prešao u muški rod.

Iako deklinacioni sistem albanskog jezika ima svoje korene u indoevropskom jeziku, tokom njegovog razvoja došlo je do značajnih promena, od kojih je najvažnija uvođenje članova. U pogledu broja padeža, albanski jezik je, u odnosu na osam padeža u indoevropskom jeziku, zadržao pet padežnih formi. Međutim, usled pojave sinkretizma, u albanskom jeziku se razlikuju samo četiri formalne varijante – za nominativ, genitiv-dativ, akuzativ i ablativ. Članovi su iz temelja promenili deklinaciju imenica i povećali broj padežnih formi (Topalli 2011: 168–169)².

Takođe, značajna promena u odnosu na indoevropski jezik dogodila se u sistemu prideva albanskog jezika. Naime, dok drugi jezici poseduju posebne oblike prideva za svaki rod – sa različitim nastavcima za muški, ženski i srednji rod, u albanskom jeziku rod je regulisan drugačije – prepozitivni članovi predstavljaju glavni pokazatelj roda kod prideva.

Članovi su jedna od glavnih i najvažnijih kategorija u gramatici albanskog jezika, ali istovremeno su i predmet brojnih naučnih rasprava i diskusija (Spiro 2021: 39). Sistem članova u albanskom jeziku predstavlja ključni element koji je uticao na razvoj i transformaciju imeničkog i pridevskog sistema. Uvođenje postpozitivnih i prepozitivnih članova ne samo da je promenilo strukturu deklinacije imenica, već je dovelo i do jasne distinkcije u obeležavanju roda, broja i padeža, čime je albanski jezik izgradio specifičan model unutar indoevropske porodice jezika. Ove promene ukazuju na kompleksnu evoluciju jezičkih mehanizama koji su omogućili razvoj jedinstvenog morfološkog sistema.

Metodološki okvir istraživanja

Rad se fokusira na proučavanje imeničkog sistema albanskog jezika, pri čemu se pomoću deskriptivne i dijahronijske analize izučava kategorija imenica sa prepozitivnim članom sa posebnim akcentom na imenice srednjeg roda. Namera je da se detaljno objasni gramatička struktura imeničkog sistema u albanskom jeziku, uz istovremeno razmatranje njegovih istorijskih promena. Imajući u vidu normativni karakter istraživanja, cilj rada je da pruži sveobuhvatni opis imeničkog

² Topalli naglašava da iako u albanskom jeziku možemo izdvojiti četiri različita padežna oblika, ovaj broj se može smanjiti, i to na dva oblika za neodređeni vid jednine za nominativ-akuzativ i genitiv-dativ-ablativ, tri za određeni vid u jednini za nominativ, genitiv-dativ-ablativ, akuzativ, dva za neodređeni vid u množini za nominativ-akuzativ, genitiv-dativ-ablativ i dva za određeni vid u množini za nominativ-akuzativ, genitiv-dativ-ablativ.

sistema albanskog jezika, kao i da razmotri teorijski relevantna gramatička načela i postojeće probleme koji se odnose na upotrebu prepozitivnog člana kod imenica. Predmet interesovanja rada se posebno usredsređuje na pitanja koja se tiču porekla, funkcije i upotrebe prepozitivnog člana u govoru i pisanju.

Da bi se adekvatno definisao istraživački problem ovog rada, neophodno je razmotriti postojeću literaturu koja se odnosi na ovu gramatičku kategoriju u albanskom jeziku. Različiti autori, kao što su Demiraj (1972) i Topalli (2011), u svojim studijama obrađuju imenički sistem albanskog jezika, fokusirajući se na neodređeni i određeni vid, kao i na deklinaciju, sa posebnim osvrtom na problematiku množine imenica. Pored toga, autori kao što su Durmishi (2013) i Spiro (2021) istražuju upotrebu članova u albanskom jeziku, sa akcentom na genitivni i pridevski član, što dovodi do zaključka da kategoriji imenica sa prepozitivnim članom treba posvetiti dodatnu pažnju u lingvističkim istraživanjima.

Sistem članova u albanskom jeziku

Imenički sistem albanskog jezika je doživeo značajnu reorganizaciju, što je doprinelo razvoju originalne gramatičke strukture. Ova transformacija započeta je uvođenjem članova koji su reorganizovali imenički sistem albanskog jezika, a kasnije se proširila i na druge sisteme.

Termin *nyjë* pojavljuje se prvi put 1886. godine u delu *Shkronjëtores e gjuhës shqip* čiji je autor Sami Frashëri, koji je pod tim terminom podrazumevao samo prepozitivne članove (Spiro 2021: 57). Pored ovog termina Frashëri je osmislio više od 100 osnovnih termina, a samo 50 je pronašlo mesto u gramatici savremenog albanskog jezika – *nyjë e lidhurë*, *nyje*, *i (e) nyjshëm* itd. (Agalliu 1979: 15). Prema S. Rizi albanski jezik se odlikuje izuzetno složenim i jedinstvenim sistemom članova u poređenju s ostalim indoevropskim jezicima (Riza prema: Čeliku 2010: 125). Nastanak članova može se smestiti u period ranih i intenzivnih kontakata sa latinskim jezikom, ne pre 4. i ne posle 6. veka, ali pre početka kontakata sa slovenskim jezicima (Topalli 2011: 513). Albanski jezik je stvorio sistem članova, koji nema ekvivalent ni u jednom drugom jeziku osim u rumunskom (Demiraj 1978: 65). Iako nije lako utvrditi precizno vreme nastanka članova u ovim jezicima, njihova pojava se vezuje za period kada su ovi narodi živeli blizu, a razlike, naročito u pogledu drugačijeg funkcionisanja prepozitivnog člana, razvile su se kasnije, tokom faze kada su se ova dva jezika razvijala nezavisno (Марковић & Маља Имами, 2024: 475).

Sami Frashëri definiše članove kao male reči koje se pojavljuju uz imenice, prideve i zamenice kako bi ih povezale ili odredile. Njegova definicija ne obuhvata postpozitivne članove, budući da ih tretira kao zasebne reči. Značajan doprinos njegove analize predstavlja podela na vezane i slobodne članove. Da bi član bio vezan, on mora da stoji uz imenicu koja je određena, i on je zavisn od promena

koje trpi imenica tokom deklinacije. Nasuprot tome, da bi član bio slobodan, imenica ispred njega mora da bude u neodređenom vidu i on ostaje nepromenljiv, nezavisno od gramatičkih promena imenice. Ipak, on smatra da genitivni član može biti i slobodan i vezani član, dok član imenica srednjeg roda posmatra isključivo kao vezan i kao nedeljivu celinu sa imenicom (Frashëri prema Agalliu 1979: 19–20; Omeri 2021: 31).

Članovi su morfeme koje se nalaze na početku određenih reči ili flektivnih oblika, koje su grafički odvojene od reči ili oblika kojima pripadaju, ali funkcionalno ostaju njihov integralni deo i potiču od pokaznih zamenica. Svi članovi, osim postpozitivnog člana *-në* u akuzativu određenog vida, koji je nastao fuzijom starog nastavka sa pokaznom zamenicom, nastali su direktnom redukcijom pokaznih zamenica. Ovaj proces nas vodi i do kraćih oblika zamenica – član *-i* potiče od pokazne zamenice (*a/i*), član *-e* od nenaglašenog oblika *e* za akuzativ, član za formiranje određenog vida srednjeg roda *-të* od zamenica *ata, këta*, dok član *të* za muški rod i član *së* za ženski rod nemaju odgovarajuće kraće oblike. Ove morfeme imaju značajnu ulogu u formiranju određenog i neodređenog vida imenica. Istorijski gledano, deklinacija određenog vida imenica je nastala nakon deklinacije neodređenog vida i razvila je sopstvena sredstva izražavanja, koja su nazvana određeni članovi. Za razliku od mnogih drugih jezika, albanski jezik pored članova za formiranje određenog vida – postpozitivnih članova, ima i članove koji se koriste ispred reči – prepozitivne članove, što dodatno usložnjava gramatički sistem ovog jezika. Prepozitivni član može se posmatrati kao zasebna gramatička jedinica, ali raznolikost njegovih značenja i funkcija otežava opštu definiciju koja bi obuhvatila sve njegove primene. Poreklo prepozitivnih članova predstavlja jedno od najsloženijih pitanja u proučavanju albanskog jezika. Kada se uporede sa postpozitivnim članovima, prepozitivni članovi su dobili naziv „članovi“ samo zbog formalne sličnosti (Agalliu 1970: 87; Topalli 2011: 416–418; Durmishi 2013: 431–432).

Postpozitivni član, iako „mala reč“ ima funkciju sužavanja opšteg značenja reči, izdvajajući jedan specifičan predmet ili osobu iz šire grupe. Nasuprot njemu, prepozitivni član, koji može biti vezan ili slobodan, ima drugačiju funkciju – vezani član povezuje imenicu ispred s rečju koja sledi, usklađujući se u rodu, broju i padežu, a slobodni član ima vezu s rečju koja sledi, dok se reč ispred njega ne pojavljuje (Cipo 1949: 68–69; Vokshi 1957: 37).

Topalli (2011: 453–454) proučavajući poreklo prepozitivnog člana, identifikuje grupe reči koje u svojoj strukturi imaju ovaj gramatički element – prvu grupu karakteriše član koji je nastao od postpozitivnog, druga grupa ima član koji je izveden od prepozitivnog člana prideva, treća grupa sa članom koji ima poreklo od genitivnog člana i četvrta grupa sa članom koji je nastao od pokazne zamenice. Različita etimologija prepozitivnog člana, ukazuje na njegove varijabilne funkcije

u reči, u zavisnosti od gramatičkog konteksta. Zbog činjenice da prepozitivni član nije direktno povezan sa kategorijom određenog vida i da se uz veliki broj prideva i zamenica, ipak, ne javlja, autor Hendriks (1982: 101) ga naziva pridevskom rečcom.

Istorijska gramatika bavi se proučavanjem postpozitivnih članova, dok se savremena gramatika, naročito sintaksa, fokusira na prepozitivne članove. Članovi predstavljaju gramatičko sredstvo koje, kada se doda imenicama, ne samo da ih gramatički određuje, već utiče i na njihovu određenost po značenju. Topalli (2011: 419) ovu tvrdnju ilustruje na primeru upotrebe genitiva i ablativa – u genitivnim konstrukcijama obe imenice su u određenom vidu i time su određene po značenju (*mishi* i *dashit*). Ukoliko je prva imenica u neodređenom vidu, druga ne može imati postpozitivni član (*mish dashi*), tj. ako je prva imenica određena i druga mora biti određena, a ako je prva u neodređenom vidu, i druga će biti u tom obliku. Ova teorija delimično potvrđuje da je prepozitivni član nastao dupliranjem postpozitivnog člana, s obzirom na to da je imenica koja prethodi genitivu i sama u određenom vidu, kao i genitiv, osim u slučajevima kada neka druga odrednica zahteva drugačije. Jedna od funkcija genitiva je da iskazuje pripadnost, što znači da imenica ispred nije proizvoljna, već da je genitiv određuje. Nasuprot tome, ablativ ima funkciju određivanja vrste nečega i, u skladu s gramatičkim pravilima, zahteva upotrebu imenice u neodređenom vidu. Prepozitivni član je, takođe, sredstvo za razlikovanje genitivnih i dativnih oblika. Usled sinkretizma, motivisanog sintaksom, kojim su obuhvaćeni genitiv i dativ, a kasnije i ablativ i neodređeni akuzativ sa nominativom, albanski jezik je redukovao broj padeža, tj. pojednostavio je nasleđeni padežni sistem. Međutim, paralelno s ovim procesom, broj padeža je povećan stvaranjem sistema članova, koji su udvostručili paradigmu deklinacije – stvorili određeni i neodređeni vid. Pojava kategorije određenog vida omogućila je morfosintaksi balkanskih jezika sprovođenje sinkretizma nasleđenih padežnih oblika, čime je inicirana funkcionalna reorganizacija oblika i stvoreni su uslovi za uspostavljanje stabilnosti u sistemu deklinacije (Mala-Imami 2023: 529; Ajdini-Murtezi & Azizi 2021: 170; Božović 2021: 66, Božović 2023: 30–33).

Prepozitivni član se može podeliti u tri glavne grupe:

1. Prepozitivni član koji ima funkcije gramatičke morfeme – razlikuje genitiv i dativ, deo je prideva sa članom, deo je imenica sa članom (kao što su *e hënë*, *të korrat*, *të folurit*) i zamenica;
2. Prepozitivni član koji se upotrebljava ispred osnovnih brojeva i neodređenih zamenica da bi se označila neodređena celina;
3. Prepozitivni član ispred imenica iz oblasti rodbinske terminologije, kao i ispred *zot* i *zonjë*, koji je blizak prisvojnim zamenicama (Demiraj 1978: 65–66).

Pored genitivnog člana, još jedna vrsta prepozitivnog člana je i član prideva, koji je stariji od genitivnog člana, budući da određuje gramatičke kategorije prideva

kao što su rod, broj i padež. Suprotno, član genitiva nema ovu funkciju, pošto se imenica u genitivu ne podudara sa imenicom ispred po rodu, broju i padežu. Prepozitivni član prideva se deklinira na isti način kao prepozitivni genitivni član, što ukazuje na njihovo isto poreklo i odsustvo suštinskih funkcionalnih razlika između ova dva tipa članova. Činjenicu da su ovi članovi predstavljeni kao ista leksička sredstva potvrđujemo i oblikom prideva bez člana koji se ne menja po padežima – dakle, samo se član deklinira, a ne i sam pridev. Osim toga, između člana i prideva nije moguće umetnuti druge reči, dok je član genitiva gramatički povezan sa imenicom koja mu prethodi, a ne sa imenicom koja sledi (Topalli 2011: 424; Spiro 2021: 263).

Primeri *i miri, i ligu, e bukura* itd. ukazuju na blisku vezu između prepozitivnog i postpozitivnog člana. Ovi primeri se mogu tretirati kao imenice, a oduzimanjem postpozitivnog člana mogu preći u neodređeni vid. U percepciji govornika, njihov imenički sastav je uslovljen uvek određenim vidom što ukazuje da prepozitivni član nije mogao da ima funkciju određivanja imenice. Svaki pridev sa članom se može poimeničiti dodavanjem postpozitivnog člana, a postpozitivni član nije onaj koji menja pridev u imenicu, već njegova sposobnost da preuzme postpozitivni član (Spiro 2021: 232).

Dakle, postpozitivni članovi, odnosno nastavci za određeni vid, imaju funkciju u određivanju imenica, dok prepozitivni članovi, u svojim karakterističnim upotrebama, služe za povezivanje određenih reči, kao što su imenice, pridevi, zamenice, brojevi. Ključna razlika između ovih tipova članova je njihova veza sa određenim vidom (Spiro 2021: 60).

Srednji rod u albanskom jeziku

Iako je značajan broj imenica srednjeg roda iščezao, a neke su se u jeziku pojavile relativno kasno, albanski jezik je srednji rod nasledio iz indoevropskog jezika. Razlikuju se formalno i semantički od imenica i prideva sa prepozitivnim članom (Veselaj 2013: 9). Srednji rod predstavlja imeničku kategoriju u albanskom jeziku koja je svedena na ograničen broj reči. Usled gotovo potpunog nestanka srednjeg roda kod određenih vrsta reči, kao što su pridevi, pokazne i prisvojne zamenice, on se javlja samo morfološki u deklinaciji određenog vida (samo u nominativu i akuzativu jednine) kroz upotrebu člana *të* (*krye-t*, *të ecur-it*, *të ri-të*) (Agalliu et al. 2002: 93).

Srednjem rodu pripadale su sve imenice koje su se odnosile na predmete bez prirodnog roda, te nisu mogle biti svrstane u muški ili ženski rod na osnovu pola. Međutim, kasnijim razvojem jezika ova kategorija je ograničena samo na imenice koje označavaju nedeljive, tj. nebrojive imenice. Ovaj rod je obuhvatao: gradivne imenice (*ujë, gjak, drithë*), imenice koje označavaju delove tela (*ballë, sy, tru*), predmete (*shtrat*), mesta (*krua, kopësht*), apstraktne imenice (*emër, faj*,

muaj), imenice formirane od prideva (*të madhtë, të bardhëtë, të keqtë*), imenice formirane od prideva nastalih od participa (*të dalëtë, të ngrënë, të shpërblenëtë*) (Topalli 2011: 210–211). Srednji rod ima indoevropsko poreklo, i iako je u velikoj meri redukovan, treba uzeti u obzir da se i danas od svakog glagola može tvoriti glagolska imenica srednjeg roda (Demiraj 1966: 84). Danas gradivne imenice, kao što su *ujë, gjak, drithë, mish, grurë, gjalpë, mjaltë, vaj* i slične, koje se završavaju na nenaglašeni vokal *ë*, a istorijski su pripadale srednjem rodu, pretežno se koriste u muškom rodu, kako u govornom tako i u pisanom jeziku. Izuzetak predstavljaju određeni govori i frazeološki izrazi u kojima su ove imenice i dalje sačuvale kategoriju srednjeg roda (Agalliu et al. 2002: 93–94). Ono što suštinski razlikuje imenice srednjeg roda od muškog i ženskog roda jeste specifičnost njihovih oblika u nominativu i akuzativu, kako u jednini tako i u množini. Kada govorimo o imenicama sa prepozitivnim članom, jasno se izdvajaju poslednje dve grupe imenica srednjeg roda, u kojima je ovaj rod opstao (Topalli 2011: 211).

Imenice srednjeg roda menjaju se po četvrtoj deklinaciji, a od imenica prve deklinacije razlikuju se samo u nominativu i akuzativu određenog vida (Agalliu et al. 2002: 117–118).

Padež	Neodređeni vid	Određeni vid
Nominativ	të ftohtë	të ftohtë-t
Genitiv	(i,e) të ftoht-i	(i,e) të ftoht-it
Dativ	të ftoht-i	të ftoht-it
Akuzativ	të ftohtë	të ftohtë-t
Ablativ	(prej) të ftoht-i	(prej) të ftoht-it

Topalli (2011: 222) ističe da je srednji rod u albanskom jeziku ostao u pet specifičnih kategorija: imenice koje su formirane od prideva nastalih od participa (*të lodhurit, të punuarit, të mësuarit*), sintagme sa glagolom u kojima se koriste ove imenice u ablativu (*mbarova së foluri, plasa së qari, u lodha së punuari*), imenice formirane poimeničavanjem prideva (*të zi, të verdhë, me të mirë*), prilozi i priloški izrazi formirani poimeničavanjem drugih leksičko-gramatičkih kategorija u ablativu (*së largu, së shpejti, së bashku*) i analitički bezlični glagolski oblici formirani od predložkih grupa sa imenicom srednjeg roda nastalom od participa (*me të marrë, një të dalë, për të hyrë*). Demiraj (1972: 124) konstrukcije iz četvrte kategorije definiše kao priloške ablative imenica nastalih od prideva srednjeg roda.

Particip u albanskom jeziku se ne može tretirati kao samostalni deo govora, jer nema formalne odredbe i gramatičku kategoriju lica, a integrisan je u glagolski sistem jezika (Agalliu 1970: 88). Kada se obliku za particip dodaju prepozitivni članovi, od njih se formira pridev koji dobija kategoriju roda, broja i padeža.

Slično, kada se postpozitivni članovi dodaju takvom pridevu, on zadržava sve ove gramatičke kategorije, što nam omogućava da od njega napravimo imenicu.

Kao što smo već napomenuli, veliki broj imenica srednjeg roda zamenjen je imenicama koje imaju isto značenje, ali su bez člana. Na primer, imenice formirane od prideva koje proizilaze iz participa ustupaju mesto glagolskim imenicama sa sufiksima *-im* i *-je*, kao što su *lodhje* umesto *të lodhurit*, *mësim* umesto *të mësuarit*, *larje* umesto *të larit* itd. Ponekad dolazi i do zamene neglagolskim imenicama kao što su *me punë* umesto *me të punuar*, *përgjigje* umesto *të përgjigjur*. U drugim slučajevima, imenice srednjeg roda zamenjuju poimeničeni pridevi kao što su *e ftohta* ili *i ftohti* umesto *të ftohtët*, *e nxehta* ili *i nxehti* umesto *të nxehtët* (Topalli 2011: 222–223).

Važno je napomenuti da u savremenom albanskom jeziku i dalje postoji značajan broj glagolskih imenica srednjeg roda, koje obuhvataju glagolske imenice srednjeg roda koje nemaju odgovarajuće zamenske forme sa sufiksima *-im* i *-je* (*të gjarë*, *të pangrënë*, *të përgjarë*) i glagolske imenice srednjeg roda čije zamenske forme nastale pomoću sufiksa *-im* i *-je* imaju drugačije značenje (*të folur* i *folje*, *të qëlluar* i *qëllim*). U nekim slučajevima i glagolska imenica srednjeg roda i njen ekvivalent sa sufiksima *-im* i *-je* se koriste podjednako, pri čemu imenica sa članom označava apstraktni pojam, a imenica formirana pomoću sufiksa označava konkretni pojam (*të parë* i *pamje*, *të shkruar* i *shkrim*). I pored pokušaja da se njihova upotreba redukuje, određeni broj imenica srednjeg roda se koristi u istoj meri kao i njihovi ekvivalenti formirani pomoću sufiksa *-im* i *-je* (*të zbuluar* i *zbulim*, *të aguar* i *agim*), u zavisnosti od preference govornika (Demiraj 1972: 235–237).

Ako uporedimo status ovih imenica danas sa starim albanskim tekstovima iz 16. veka, jasno je da je kategorija srednjeg roda bila veoma frekventna pre pet vekova, ali se vremenom značajno redukovala. Danas je ovaj rod sačuvan uglavnom u frazeološkim izrazima koji su po svojoj prirodi konzervativni. Osim toga, neke imenice srednjeg roda zadržale su ovu kategoriju samo u određenim oblastima ili dijalektima, dok u drugim govorima pripadaju muškom, ređe ženskom rodu, a najbolje su očuvane u govorima na jugu (Topalli 2011: 222–223).

Zbog uočene redukcije imenica srednjeg roda, određeni broj istraživača, kao što su Demiraj (1972) i Spiro (2021), usmerio je svoje studije na analizu starijih tekstova kako bi utvrdili stepen zastupljenosti ovih imenica u njima. U zavisnosti od tematike, ove imenice su dominirale u određenim tekstovima. Razumevanje uzroka njihove manje upotrebe ili potpunog nestajanja i razloga zbog kojih su zamenjene drugim imenicama predstavlja ključno pitanje. Ova pojava može biti posledica tendencije uprošćavanja svakodnevnog govora radi lakše upotrebe jezika, prelaskom na dva roda – muški i ženski, ili ekonomičnosti govora, budući da je upotreba imenica sa deklinacijom pomoću različitih nastavaka mogla biti praktičnija od imenica srednjeg roda koje funkcionišu drugačije – sa razlikom u nominativu i akuzativu.

Na primer, u *Jevanđelju po Mateju*, koji je preveo Konstandin Kristoforidhi, zabeleženo je 67 oblika srednjeg roda sa prepozitivnim članom (Spiro 2021: 351). Gjon Buzuku u svom delu od 188 strana upotrebljava samo 13 glagolskih imenica sa sufiksom *-im*, dok glagolske imenice srednjeg roda dostižu broj od čak 188. Pjetër Budi u svojim delima koja obuhvataju 1068 strana, koristi 25 glagolskih imenica sa sufiksom *-im* i 232 glagolske imenice srednjeg roda. Frang Bardhi u svom rečniku, koji sadrži oko 4500 latinskih i 2544 albanskih reči, upotrebljava 27 glagolskih imenica sa sufiksom *-im* i 148 glagolskih imenica srednjeg roda. U delu *Çeta e profetave*, čiji je autor Pjetër Bogdani i koje ima 362 strane, zabeleženo je 59 glagolskih imenica sa sufiksom *-im* i 182 imenice srednjeg roda (Demiraj 1972: 205–209).

Pored ekonomičnih razloga u jeziku i redukcije padežnih nastavaka za imenice muškog i srednjeg roda, razlozi za nestanak imenica srednjeg roda i njihovu sve manju upotrebu uključuju i funkciju prepozitivnog člana. U jezičkoj svesti govornika albanskog jezika, prepozitivni član je uvek povezan sa imenicom koja prethodi imenici sa članom, međutim, u slučaju imenica srednjeg roda ta imenica izostaje. Kao rezultat, govornicima je logično da se ispred ovog oblika nalazi imenica na koju se član odnosi (Spiro 2021: 352).

Ostali primeri imenica sa prepozitivnim članom

Jedna od specifičnosti albanskog jezika, pored prisustva prepozitivnog i postpozitivnog člana u njegovoj strukturi, jeste pojava imenica sa prepozitivnim članom koje se po funkciji ne razlikuju od imenica bez ovog elementa, a nisu srednjeg roda (Марковић & Маља Имами, 2023: 91–92).

Prepozitivni član funkcioniše kao slobodna morfema, koja se upotrebljava kako bi povezala zavisnu reč sa imenicom ispred. U slučajevima kada nam imenica ispred nije potrebna, npr. kada poimeničimo pridev sa članom, član postaje nosilac sintagme i čini pridev nezavisnom rečju. On se javlja u sledećim kontekstima (Spiro 2021: 230):

1. Ispred poimeničenih prideva, kao što *su i ftohtë, e bukur, të punuar, e ardhmja, e shkuara* itd.;
2. Ispred imena dana u nedelji – *e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte, e premte, e shtunë, e diel*;
3. Ispred imenica koje označavaju etničku pripadnost – *i borsh* (stanovnik Borša), *i golëm* (stanovnik Golema), *i kastrat* (stanovnik Kastrata) itd. Ovaj oblik se koristi samo u dijalektu;
4. Ispred imena svetaca i slava – *i Shën Pjetër, i Shën Todhër* itd. Ovi oblici su arhaični i sada su očuvani samo u narodnoj književnosti;
5. Ispred osnovnih brojeva koji označavaju celinu – *të dy, të tre, të katër, të pestë, të gjatë* itd.;

6. Ispred poimeničenih rednih brojeva – *i par/ë, i dyt/ë, i tret/ë* itd.;

7. Ispred razlomaka – *të tretat, të shtatat, të dyzetat* itd.

Pod poimeničavanjem prideva podrazumeva se njegov prelazak u klasu imeničke vrste reči, bez spoljašnje tvorbenne promene, tj. bez nastavka. Dok pridev imenuje karakteristiku koja može da pripada različitim predmetima, kada se on poimeniči dobija leksičko-gramatičko značenje imenice i imenuje i karakteriše istovremeno određeni predmet prema datoj osobini – *E mira dhe e liga nuk harrohen*. Poimeničeni pridevi se koriste u određenom vidu ili sa nekom odredbom, a retko sa neodređenom zamenicom *një* (Agalliu et al. 2002: 181–182).

Pedersen (prema Topalli 2011: 463) je utvrdio da prepozitivni član kod imenica koje označavaju dane u nedelji ima poreklo od genitiva, kao rezultat elipse prve reči, odnosno imenice *ditë*. Ova teorija se potvrđuje činjenicom da se prepozitivni član genitiva uvek vezuje za imenicu koja mu prethodi, pri čemu se poklapa s njom u rodu i broju, a to je slučaj sa članom *e*, koji se odnosi na podrazumevanu imenicu *ditë*. Dodavanjem postpozitivnih članova, ove imenice su dobile oblik za određeni i neodređeni vid. Durmishi (2013: 433) istražuje i evoluciju nastavka *ë* kod imenica koje označavaju dane u nedelji – ona objašnjava da je završetak u padežu *-e* i *-i* izgubio svoju morfološku funkciju i pretvorio se u *ë*, kod *e hënë, e martë, e mërkurë, e shtunë, e diel(ë)*, dok je kod *e enjte* i *e premte* ostao nepromenjen zbog poklapanja sa genitivom neodređenog vida u jednini (*e enjte-e > e enjtee > e enjte*).

Analogno sistemu članova za dane u nedelji, član koji stoji uz imena svetaca takođe ima genitivno poreklo, pri čemu se imenica *Shenjt*i podrazumeva i ne ponavlja u sintagmi (Topalli 2011: 463). Ovakav model upotrebe člana proširio se i na obična imena u arbreshkim govorima. Spiro (2021: 235–236) objašnjava da kategorija imenica sa prepozitivnim članom funkcioniše tako što reči koje označavaju svece ili termine koji iz njih proističu, kao što su slave, obično prethode glavnoj leksemi *e kremt/e, ja*. Ipak, on ističe da se te imenice danas uglavnom koriste bez prepozitivnog člana.

Imenice koje označavaju etničku pripadnost formirane su u istom istorijskom periodu, imajući u vidu da se mogu pronaći u oba dijalekta albanskog jezika i da su prisutne kod starih autora. Međutim, put njihovog nastanka je teško pratiti, budući da se javljaju sa neujednačenim sufiksima ili čak i bez njih – *i pukës, i mirditas, i hot, i shkodran*. Ove imenice možemo posmatrati kroz prizmu imenica koje označavaju rodbinske veze, kao što su *jam* i *Palit* ili *asht e Gjergjit*. Analogno tome, ovaj tip elipse može se preneti i na sintagme koje označavaju etničku pripadnost, poput *jam* i *Pukës* ili *jam* i *Mirditës* (Topalli 2011: 464). Spiro (2021: 242) ukazuje na nekoliko dijalekatskih sintagmi koje označavaju andronime – *e Gjonit, e Gjergjit, e Thomait, e Shabanit*. Pojava da se prepozitivnim članom izražava pripadnost značajno je proširena, naročito u dijalektima, što dodatno potvrđuje važnost ove gramatičke strukture.

Kada govorimo o imenicama iz oblasti rodbinske terminologije, uočava se da prepozitivni član kod ovih imenica nema poreklo od genitiva, budući da se ispred njih ne može staviti imenica, kao u prethodnim grupama. Poreklo ovog člana vezuje se za pokazne zamenice koje su vršile funkciju prisvojnih, a i u starom i u novom albanskom stajale su isključivo ispred imenice na koju se odnose. Prepozitivni član kod imenica koje označavaju rodbinske veze u albanskom jeziku ima ulogu prisvojne zamenice – *i biri* (njegov/njen sin), *e bija* (njegova/njena ćerka), *të bijtë* (njegovi/njeni sinovi). Ove imenice se upotrebljavaju sa prisvojnim članom u nominativu i po pravilu se pojavljuju uvek u određenom vidu, jer u suprotnom nema pripadnosti³. Razlikujemo dva tipa ovih imenica:

1. Nasledene i imenice latinskog porekla, kao što su *i vëllai*, *e motra*, *i ati*, *e ëma*, *i biri*, *e bija*, *i zoti*, *e zonja*, *i nipi*, *e mbesa*, *i gjyshi*, *e gjyshja*, *e njerka*, *e reja*, *i thjeshtri*, *e thjeshtra*, *i kunati*, *e kunata*, *i vjehërri*, *e vjehrra*, *i shoqi*, *e shoqja*, *i ungji*, *e emta*, *i kushëri*, *e kushërira*;
2. Imenice koje su ušle u albanski jezik nakon perioda aktivnog kontakta sa latinskim jezikom, kao što su *baba/babë*, *xhaxha/axhë*, *dai/dajë*, *teze*, *hallë*, *teto* (Beci 2004: 62; Shkurtaj 2006: 148; Topalli 2011: 465–467; Spiro 2021: 104, 297).

Zaključak

Članovi su oduvek predstavljali gramatičku kategoriju koja je privlačila pažnju mnogih istraživača, a njihovo poreklo je tumačeno na različite načine. Njihov značaj ogleda se u činjenici da se članovi aktivno održavaju u jezičkoj svesti govornika većine albanskih dijalekata, uprkos tendenciji ka pojednostavljenju jezika.

Na osnovu prethodno izloženih činjenica, mogu se izvući sledeći glavni zaključci:

1. Albanski jezik je nasledio određene karakteristike imeničkog sistema iz indoevropskog jezika, kao što je srednji rod imenica;
2. Albanski jezik ima razvijen sistem prepozitivnih i postpozitivnih članova;
3. U albanskom jeziku dolazi do redukcije imenica srednjeg roda, koje se menjaju ekvivalentima sa sufiksima *-im* i *-je*;
4. U albanskom jeziku je prisutna pojava poimeničavanja prideva;
5. Imenice sa prepozitivnim članom predstavljaju posebnu kategoriju imenica u albanskom jeziku.

Kategorija imenica sa prepozitivnim članom nije dovoljno istražena, a u mnogim gramatikama nije posebno istaknuta. Iako su nepravедно zanemarene, one predstavljaju specifičnost albanskog jezika, a njihov značaj potvrđuje njihova

³ Kod konstrukcija u prvom i drugom licu u slučajevima kada prisvojna zamenica stoji ispred imenice, imenica je u neodređenom vidu – *im atë*, *ime ëmë*, *jot ëmë*, *im bir*, *ime bijë* itd.

upotreba u svakodnevnom govoru, gde se koriste za označavanje pojmova kao što su dani u nedelji i rodbinska terminologija, koji su frekventni u svakodnevnoj komunikaciji.

Analiza prepozitivnih i postpozitivnih članova u albanskom jeziku pokazuje da ovi članovi čine ključnu gramatičku kategoriju i da su u savremenom albanskom jeziku razvili specifične karakteristike. Iako postoji tendencija ka redukciji imenica srednjeg roda, što može biti posledica jezičke evolucije ka jednostavnijim strukturama, javlja se potreba za daljim istaživanjima kako bi se bolje razumeli ovi gramatički fenomeni i njihova funkcija u savremenom albanskom jeziku. Ova istraživanja bi mogla osvetliti promene u upotrebi prepozitivnih članova u svakodnevnom govoru i pokazati da li će tendencija njihove redukcije biti nastavljena ili će određeni oblici opstati kao specifične gramatičke strukture.

Literatura

- Agalliu, F. (1970). Mbi pjesët e ligjëratës në gjuhën shqipe. *Studime filologjike*, 24(4), 83–91.
- Agalliu, F. (1979). “Shkronjëto e gjuhës shqip” e S. Frashërit – vepër e rëndësishme e gramatologjisë shqiptare. *Studime filologjike*, 33(3), 13–29.
- Agalliu, A., Angoni E., Demiraj, Sh., Dhrimo, A., Hysa E., Lafe, E., Likaj, E. (2002). *Gramatika e Gjuhës Shqipe I*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Ajdini-Murtezi, Sh., Azizi, H. (2021). Syncretization of Cases in Albanian and Latin. *Albanologjia*, 15–16, 168–175.
- Beci, B. (2004). *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*. Tiranë: Botime EDFA.
- Božović, Đ. (2021). Roli i sinkretizmit në sistemin rasor të shqipes. *Mapping Balkan Routes 2: Literary, Cultural and Linguistic Landscapes – European Perspectives*, 2, 59–68.
- Božović, Đ. (2023). Motivating a Morpheme: Albanian case syncretism as a case study. U: J. Audring et al. (ured.). *Comparing typologies: Proceedings of the 13th Mediterranean Morphology Meeting* (27–36). University of Patras.
- Çeliku, M. (2010). Kontributi i Selman Rizës për nyjat e rasat e emrit në rrafshin sinkronik. *Studime filologjike*, 64(1/2), 123–128.
- Cipo, K. (1949). *Gramatika shqipe*. Tiranë: Instituti i shkencavet.
- Demiraj, Sh. (1966). Rreth ndërtimit të gjinisë së emrave në shumës në shqipe vështuar edhe në përqasje me rumanishten. *Studime filologjike*, 20(4), 83–97.
- Demiraj, Sh. (1972). *Çështje të sistemit emëror të Gjuhës Shqipe*. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Katedra e Gjuhës Shqipe.

- Demiraj, Sh. (1978). Rreth “nyjave të përparme” të shqipes, vështruar edhe në përqasje me rumanishten. *Gjurmime albanologjike – Seria e shkencave filologjike*, VII, 65–72.
- Durmishi (Elezi), G. (2013). Vështrim e interpretim gjuhësor mbi mënyrën e konceptimit të nyjës si pjesë ligjërata. *Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca*, VI(4), 430–437.
- Hendriks, P. (1982). On distinguishing articles in Albanian. *Studies in Slavic and General Linguistics, South Slavic and Balkan Linguistics*, 2, 95–108.
- Mala-Imami, N. (2023). Bashkëpërkimi i rasave në gjuhët ballkanike. *Albanologjia*, 19–20, 524–531.
- Omeri, A. (2021). Albanian Grammatical Terminology of Sami Frashëri on his book “Shkronjëtorë e gjuhësë shqip”. Bucharest, 1886. *Albanologjia*, 15–16, 24–43.
- Spiro, A. (2021). *Nyjat në gjuhën shqipe – Diakronia dhe sinkronia e një evolucioni tipologjik: prokliza binare dhe enkliza shqese*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Shkurtaç, Gj. (2006). *Kultura e gjuhës*. Tiranë: Shtëpia botuese e librit universitar
- Topalli, K. (2011). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Qendra e Studimeve Albanologjike, Inst. i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Veselaj, N. (2013). *Rreth identitetit të gjinisë asnjane në shqipen e sotme*. Prishtinë.
- Vokshi, H. (1957). *Gramatikë e gjuhës shqipe për klasën e VII dhe VIII të shkollës tetëvjeçare*. Prishtinë: Milladin Popoviq.
- Марковић, А., Маља Имами, Н. (2023). Именице са препозитивним чланом у албанском језику које се издвајају у области родбинске терминологије. *Узданица*, XX(2), 91–101.
- Марковић, А., Маља Имами, Н. (2024). Препозитивни и постпозитивни члан у албанском и румунском језику из балканолошке перспективе. *Philologia Mediana*, 16(16), 469–480.

Anđela M. Marković
University of Belgrade, Faculty of Philology

NOUNS WITH PREPOSITIVE ARTICLES IN THE ALBANIAN LANGUAGE

Summary

Although many nouns with prepositive articles have today found equivalents without articles, a significant number of these nouns have retained this grammatical feature. Linguists and scholars of the Albanian language have primarily focused on the study of articles in the context of adjectives and genitive constructions, which complicates the analysis of this type of noun. Such nouns are most commonly associated with the names of days of the week, familial relations, or ethnic affiliations. Through the analysis of gender, number, and case of these nouns, as well as the function of the articles associated with them, with particular emphasis on participles and the category of the neuter gender in Albanian, we have sought to explain the role of these nouns within the grammatical system of the Albanian language. A review of relevant linguistic literature and a critical evaluation of various authors' conclusions have led us to the finding that, despite the tendency towards reduction and decreased usage of nouns with prepositive articles, a significant number of these nouns continue to be employed in everyday communication.

This research highlights the need for more detailed and systematic studies of these nouns to better understand their role in contemporary Albanian. The analysis of prepositive and postpositive articles in Albanian reveals that these articles constitute a key grammatical category and have developed specific characteristics in the modern Albanian language. Despite the tendency towards reduction of neuter gender nouns, which may be attributed to the language's evolution towards simpler structures, there is a need for further research to better understand these grammatical phenomena and their function in contemporary Albanian.

Key words: Albanian language, noun system, neuter gender, participle, nominalization, prepositive article

Berton SULEJMANI¹

Fakulteti Filologjik - Universiteti i Tetovës

 <https://orcid.org/0009-0008-7286-279X>

NDIKIMET NDËRGJUHËSORE TË SHQIPES E TË MAQEDONISHTES NË FUSHËN E LEKSİKUT (NË RRAFSHIN DIALEKTOR)

Vetëm një vështrim i vogël mbi pasurinë leksikore të gjuhës shqipe dhe asaj maqedonase, tregon se këto dy gjuhë ballkanike, edhe pse në dukje krejtësisht të ndryshme, në të vërtetë, në fjalët e tyre fshehin një të kaluar të përbashkët (në peridha tanimë të caktuara e të njohura historike), një të kaluar në semantikën e fjalëve, në përdorimin e tyre të njëjtë, në kuptimet themelore dhe bartëse. Lëndë e analizës së këtij punimi do të jenë leksemat e të dy gjuhëve, që i konsiderojmë se janë specifike dhe që me gjithë mend pasqyrojnë vështrimin ballkanik për botën, si një filozofi për ta kuptuar tjetrin dhe si parakusht themelor për bashkjetesë të vërtetë. Por, pjesë e studimit do të jenë edhe ndikimet e gjuhës shqipe në maqedonishte dhe anasjelltas (në fushën e leksikut, në rrafshin dialektor).

Fjalët kyçe: ballkanologji, ndikime gjuhësore, gjuha shqipe, gjuha maqedonase, vështrimi i botës, leksiku.

Në Gadishullin Ballkanik shqiptarët dhe maqedonasit, si dhe popujt e tjerë të këtij rajoni, prej shumë kohësh jetojnë në kushte dhe rrethana të njëjta ekonomike, sociale e kulturore. Kjo bashkëjetesë ka bërë që te popujt ballkanikë të krijohet një kulturë e përbashkët materiale e kulturore, të krijohen doke dhe zakone të njëjta e të ngjashme e në shumë raste të krijohet edhe një mënyrë e njëjtë e të menduarit dhe e të shprehurit. Shikuar nga ky aspekt, vlen të përmenden edhe një numër i konsiderueshëm fjalësh të urta, shprehjesh urimi e mallkimi e të tjera që kanë brendi e strukturë të njëjtë. Krahazo shembujt: : *Koka e bën, koka e pëson*, “*Gllavata pravi, glavata trga*” (мкд. Главата прави, главата трга); *Dy duar për një kokë* “*Dve race za edna gllava*” (мкд. Две раце за една глава); *Nuk i bihet murit me kokë* “*Xid so gllava ne se turka*” (мкд. Суд со глава не се турка); *Paç shëndet* “*Zdravje da imash*” (мкд. Здравје да имаш); *Mos paftë ditë të bardhë* “*Bell den da ne videl*” (мкд. Бел ден да не видел); *lu shkrettë emri* “*Da mu opusti imeto*” (мкд. Да му опусти името) etj.

¹ berton.sulejmani@unite.edu.mk

Shqipja dhe maqedonishtja si gjuhë ballkanike fliten në një hapësirë në të cilën interferenca gjuhësore ka qenë e pashmangshme, e cila, gjatë zhvillimit konvergjent dhe divergjent, ka bërë që të paraqiten shumë dukuri gjuhësore të përbashkëta. Ndikimet që janë bërë në një gjuhë të veçantë nga gjuhët që e rrethojnë, njëkohësisht janë edhe faktorë të rëndësishëm në zhvillimin e kësaj gjuhe. Por, për sa i përket kontaktit të drejtpërdrejtë të gjuhës shqipe me gjuhën maqedonase si gjuhë e mjedisit, gjuhë e administratës shtetërore, gjuha shqipe është “e pushtuar” nga ndikimet e maqedonishtes dhe nga kjo paraqiten përdorime të fjalëve nga kjo gjuhë, sidomos në rrafshin dialektor.

Nga regjistrimi i fundit i popullsisë i realizuar në vitin 2021 në Maqedoninë e Veriut nga 2.097.319, përkatësisht 1.836.713 (popullsi rezidente) 54.21 % janë deklaruar maqedonas, 29.52 % shqiptarë, 3.98 % turq, 2.34 % romë, 1.18 % serbë, 0.87 % boshnjakë dhe 0.44 % vllah². Shqiptarët, krahas qytetit të Shkupit e Kumanovës, kryesisht banojnë në pjesët veriperëndimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, veçanërisht në Tetovë dhe në rrethinën e saj, por jo vetëm, nuk duhet harruar këtu Shkupin e Kumanovën. Në këtë territor kontakti në mes popullsisë shqiptare dhe asaj maqedonase vazhdimisht është i pranishëm e nga kjo vijnë edhe kontaktet e drejtpërdrejta të dy gjuhëve. Andaj, ndikimi i njërës gjuhë mbi tjetrën është i pashmangshëm, dhe anasjelltas, që rezulton ose vjen deri në nevojën e huazimeve leksikore, por ka edhe ndikime në fushën e fonologjisë, morfologjisë e sintaksës në relacionin gjuhë-dhënës – gjuhë-marrës³. Duke u mbështetur në këtë që e thamë më lart, në vazhdim të tekstit do t’i përdorim termat dialekti-dhënës (kupto: ai që jep) dhe dialekt-marrës (kupto: ai që merr). Në këtë territor, interferenca gjuhësore zhvillohet në mes dy gjuhëve indoevropiane, nga të cilat, shqipja përbën grup më vete në kuadrin e gjuhëve indoevropiane, ndërsa maqedonishtja bën pjesë në grupin e gjuhëve sllave. Edhe pse në shikim të parë, të dyja gjuhët, janë të ndryshme, prapëseprapë midis tyre mund të gjejmë shumë pika të përbashkëta, për shkak se janë pjesë e gjuhëve ballkanike, siç thotë edhe B. Koneski: “nga gjuhët paraindoevropiane kanë trashëguar shumë dukuri gjuhësore, por me kalimin e kohës, të dyja gjuhët kanë pasur edhe zhvillimin e vet” (Конески 1986: 213 – 221). Dukuri të përbashkëta gjuhësore kanë zhvilluar edhe gjatë kontakteve shekullore (në periudha të caktuara me maqedonishten, ndërsa me gjuhët sllave në përgjithësi ndër shekuj) në hapësirën ballkanike, duke krijuar një aleancë gjuhësore, e kjo si rezultat i ndikimeve të gjuhëve tjera, si: latinishtja, greqishtja, turqishtja; në shekujt e fundit edhe ndikimet e gjuhëve neolatine, ndërsa në periudhën më të re ato të anglishtes (Хамити 2006: 311).

² <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSooopstenie.aspx?rbtxt=146>

³ Gjuha e burimit ose gjuha e parë dhe gjuhë-pranuese (e elementeve të interferencës gjuhësore) ose gjuha e dytë, sipas terminologjisë së Uriel Vajnrakh në *Gjuhët në kontakt (gjendje dhe probleme)*, 1953.

Ndikimet që janë bërë në një gjuhë të veçantë nga gjuhët që e rrethojnë, njëkohësisht janë edhe faktorë të rëndësishëm në zhvillimin e kësaj gjuhe. Por, për sa i përket kontaktit të drejtpërdrejtë të gjuhës shqipe me gjuhën maqedonase si gjuhë e mjedisit, gjuha shqipe është “e pushtuar” nga ndikimet e maqedonishtes dhe nga kjo paraqiten edhe shmangie nga normat e shqipes standarde (Tocka, 1997: 79).

1. Leksiku dhe veçoritë leksikore

Ndarja e leksikut bëhet sipas dy kriterëve kryesore:

- ndarje sipas fushës semantike;
- ndarje sipas shpërndarjes më të shpeshtë.

Përveç kësaj, huazimet nga një gjuhë në tjetrën, mund të sjellin edhe ndryshimin e përbërjes fonematike të fjalës, e cila vjen prej ndikimit të gjuhës e cila në këtë rast jep, por pa e ndryshuar kuptimin, ndërsa marrja e fjalëve ose vetëm morfema trajtëformuese, më së shpeshti sipas rregullave që vlejnë në gjuhën-marrëse, edhe atë në shumë fusha (fonetike, morfologjike e sintaksore); pastaj disa krijime “hibride”, kryesisht kur një element gjuhësor kalon nga njëra gjuhë në tjetrën. Në shembujt të cilët i kemi vjelë gjatë hulumtimit në terren, në të shumtën e rasteve kemi vërejtur vetëm ndryshime fonetike (me fjalë tjera adaptime fonetike) të cilat do t’i paraqesim në vazhdim të tekstit.

1.1. Ndarja e leksikut sipas fushës semantike

Bilinguizmi dhe interferenca gjuhësore sjellin që në mes maqedonishtes dhe shqipes (në rrafshin dialektor) të ketë ndikime të cilat më së shumti vërehen në fushën e leksikut (khs. Poloska 1998: 7). Pikërisht këtë e kemi vërejtur edhe nga hulumtimet tona nëpërmjet të cilave kemi ardhur në përfundimin se interferenca leksikore është më e theksuar. Kjo gjë është edhe e pritur, pasi siç thotë Poloska (khs. 1998: 31–32), kjo dukuri gjuhësore nuk paraqitet vetëm si rezultat i kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet dy grupeve etnogjuhësore, por kjo më tepër paraqet një domosdoshmëri dhe nevojë në gjuhën e folur, si nevojë për komunikim të përditshëm ndërmjet popullsisë shqiptare dhe maqedonase. Gjatë analizës së materialit leksikor kemi përdorur arealin semantik/gjuhësor të marrë nga “Pyetësi i atlasit dialektologjik të maqedonishtes”⁴, punimet e dialektologëve maqedonas të cilët kanë monografi për fusha të caktuara leksikore⁵, si dhe disa artikujve shkencorë të gjuhëtarëve të cilët e kanë trajtuar interferencën gjuhësore ndërmjet maqedonishtes dhe shqipes (shih literaturën). Në të njëjtën rrugë kemi

⁴ Божидар Видоески 2000: *Прашалник за собирање материјал за Македонскиот дијалектен атлас*, ИМЈ, „Крсте Мисирков“ Шкуп.

⁵ Ѓоргиева Светлана-Давкова 2009: *Дијалектните именувања на посатките во македонскиот јазик од јужнословенски и балканистички аспект*, ИМЈ, „Крсте Мисирков“ Шкуп.

shkuar edhe për të bërë analizat e materialit leksikor të shqipes, kemi përdorur Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe⁶, si dhe monografitë: “E folmja e Dervenit”⁷ dhe “E folmja e Malësisë së Sharrit”⁸.

Dukuritë fonetike-fonologjike dhe ato gramatikore, së bashku me veçoritë leksikore e frymëzojnë individualitetin gjuhësor të së folmes. Karakteristikat fonetike-fonologjike dhe gramatikore së bashku me veçoritë leksikore “e frymëzojnë, inspirojnë” individualitetin gjuhësor të së folmes. Leksiku i gjuhës maqedonase ka qenë i ndikuar nga disa gjuhë ballkanike të cilat s’janë pjesë e grupit të gjuhëve sllave. Andaj, përdorimi i numrit të madh të turqizmeve dhe më pak i greqizmeve dhe fjalëve rumune vërehet shumë. P.sh.: *изум* (*izim*), *џузеп* (*xhiger*), *ала* (*hallvë*), *ахамџа* (*axhami*), *зарзават* (*zarzavate*), *таксират* (*taksirat*), *инам* (*inam*), *џердан* (*gjerdan*) etj. (turqizma); *борзилек* (*borzilok*), *калџа* (*kaldisa*), *пцовџа* (*pcovica*), *сомун* (*somune*)(greqizma), *кмет* (*kmet* – *kupto*: *çifçi*, *bujkrob B.S.*), *клусура* (*klisura* – *grykë mali B.S.*), *комка* (*komka*), *манџа* (*manxha*) etj. (fjalë rumune) (Конески 1986: 213 – 221).

Në Maqedoni, një dukuri e veçantë që është e lidhur me ndërtimet prapashtesore paraqet mundësinë e emërtimit të bashkëshortes duke ia shtuar prapashtesën emrit ose profesionit të burrit. Edhe pse kjo dukuri është e përhapur në disa të folme dialektore që fliten sot në Maqedoni, veçanërisht karakteristikë e të folmeve perëndimore të maqedonishtes (*Стојан* > *Стојаниџа*; ***Stojan*** > *Stojanica*) edhe në disa tituj më të vjetër (*ага* > *аџиџа* – *aga* > *agica*; *бег* > *беговиџа* – *beg* > *begovica*) janë interesante ndikimet e drejtpërdrejta mbi të folmet shqipe në Maqedoni. Kjo gjedhe është e marrë nga maqedonishtja e që përdoret në të folmet shqipe në Maqedoni, si p.sh.: *Hasan* > *Hasanica*; *Kamber* > *Kamberovica*, përkatësisht *haxhi* > *haxhica*; *hoxhë* > *hoxhovica* etj. (Toska 2009). Kjo dukuri është paraqitet edhe në të folmen e Tetovës me rrethinë. Ky është një shembull tipik i formimeve “hibride”.

Futja e një elementi gjuhësor nga fusha e leksikut, në të folmet e Pollogut të Poshtëm, të huazuara nga të folmet e maqedonishtes të këtij territori, ndonjëherë nga bashkëbiseduesit, të cilat vijnë nga një anë tjetër është parë si devijim, përdorimi i këtyre elementeve të huaja në këto vende në rastet kur s’ka nevojë të përdoren shihet si gabim. Në bazë të devijimit, në këtë rast nënkuptojmë shmangie nga norma⁹, paraqiten forma shumë të pazakonta dhe të panevojshme.

⁶ Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe, V II, Universita degli di Napoli, L’Orientale, 2007. Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe, V I, Universita degli di Napoli, L’Orientale, 2007.

⁷ Remzi Nesimi, E folmja e Dervenit, USHT, Tetovë, 2008.

⁸ Fadil Sulejmani, E folmja e Malësisë së Sharrit, USHT, Tetovë, 2006.

⁹ Duhet ta kemi parasysh se këto fjalë i hasim vetëm në të folmet dialektore, në të shkruar në asnjë mënyrë nuk hasen. Edhe pse e dinë që janë fjalë të huaja, folësit i përdorin, këto ndikime vijnë nga gjuha e administratës, e cila deri para disa vjetëve ishte vetëm në gjuhën maqedonase. Kjo dukuri s’është shumë shqetësuese për cilëndo gjuhë, në këtë rast për gjuhën shqipe, sepse akëcili që i

Maqedonishtja në këtë mënyrë ndikon në atë mënyrë që shqiptarët, kur flasin në gjuhën amtare, përkatësisht gjatë hulumtimit në terrenin në fjalë, ata përdorin leksik sllav (kryesisht nga maqedonishtja, por edhe nga gjuhë tjera sllave të marra kryesisht nga maqedonishtja), por edhe një numër i madh i ndërkombëtarizmave të huazuara nëpërmjet të folmeve të maqedonishtes të cilat i përdorin çdo ditë, madje edhe në administratë. Rreth asaj që thamë më lart, shihni shembujt e mëposhtëm:

- Mos u bëj i dosadët. (Не биди досаден.) (në vend të: i mërzitshëm, i bezdisshëm)
- Do t'shkojm n' bollic. (Ќе одиме во болница.) (në vend të: spital)
- A be uzhivaj. (Абе уживај!) (në vend të: kënaqu, gëzohu, jeto)
- Mos bon shumë greshka. (Не прави многу грешки.) (për: gabim/e)
- Cisto shqip, pa greshka. (Чисто албански, без грешки) (për: pastër, pa gabime)
- Istojam. (Исто сум.) (në vend të: njëjtë)
- S'ka struj. (Нема струја.), (për: rrymë elektrike, korrent)
- Vozitënveturën. (Вози кола.), (ngas një automjet/drejton veturën)
- Kruzhnitok. (për: unaza/rrethore)
- Pegllatën. (për: hekuros)
- Vikat. (për: bërtet, thërret)
- M'prijaviti. (Ме пријави.) (për: më paraqiti)
- Liçna kart. (për: letërnjoftim)
- A kije ni penkall? (për: stilograf/stilolaps)
- Domi i kultures. (për: формата pallati, shtëpia)
- Praznik. (për: festë)
- Slladoled. (për: akullore)
- Stanica. (për: stacion, vendndalim, vendqëndrim)
- Dë e boj ni slik. (për: fotografi)
- A e more pasoshin. (për: pasaportë)
- Razoçarët. (për: zhgënjyer)
- Xhi je zalubçaç shaum. (për: dashuruar)
- Brza pomosh. (për: ndihma e shpejtë)
- A ke marr pllaten. (për: rrogën/pagën)
- sok (për: lëng)
- Ma jep ni priroden sok (për: lëng frutash)
- bik (për: dem)

përdorë edhe sikur të mos jetë i arsimuar, e kupton që është fjalë e huaj, andaj po të dojë mund të përdor fjalën shqipe në vend të tyre si: p.sh.: *gëzohu*, *kënaqu* në vend të: *uzhivaj* (*уживај*). Sipas meje, shumë të rrezikshme janë ndikimet në fushën e gramatikës nga një gjuhë në tjetrën, sepse këto ndikime s'mundet akëcili t'i hetojë siç ndodh me fjalët e huaja, d.m.th. me leksikon.

- viljushka (për: pirun)
- A mund të ma jepni një “Jogobella” pi jagode (për: dredhëz/luleshtrydhe)
- unë kam një maicë me bojë kuqe (për: këmishë; ngjyrë/bojë)
- ai punon si çistaç (për: pastrues)
- gollubar (për: pllumbaruajtës)
- metla (për: fshesë)
- mexhe (për: mezhde, ledh)
- korpa (për: shportë)
- zaglavi çelezi (për: ngeci/mbeti)
- brava (për: bravë – a)
- Mi jep slushallkat (për: kufjet)
- Ndani zvuçnika (për: altoparant)
- Prikolica (për: rimorkio)
- Ka pas tepačka në qender (për: përleshje/zënkë)
- Shvajcarija (në vend të: Zvicra)
- Ma jep (bemi) nja/di piv/a (për: birrë/a)
- Izvor (për: burim)
- Vuna potpis (për: nënshkrova, firmosa)
- Drzhavjanstvo (për: shtetësi)
- Izvod (për: certifikatë lindjeje)
- Trud (për: punë)
- Socijalno (për: asistencë sociale)
- A ka zimaska gu:m (për: gomë dimri)
- Në putarin (për: pagesa për rrugë)

Nga analiza e materialit të mbledhur erdhëm në përfundim se ndërmjet maqedonishtes dhe shqipes s’ka përputhje të emrave të pjesëve të trupit të njeriut, përemrave vetorë, marrëdhënieve farefisnore (përveç për emrin e motrës së burrit золва – zolva, që në shqipe përdoret emri kunatë, në këtë rast për motrën e burrit për gruan), kafshëve shtëpiake, bagëtisë, insekteve (me përjashtim të emrit të insektit të mushkonjës - комапец – komarc), trupave qiellorë, emrave të ditëve të javës. Në lidhje me emrat profesioneve vërehen afri rreth terminologjisë, të cilën e kanë huazuar (edhe maqedonishtja, edhe shqipja) nga turqishtja (ose nga ndonjë gjuhë tjetër të Evropës). Kjo vërehet kryesisht te prapashtesa maq.: -џија; shq.: -xhi, si në shembujt e mëposhtëm: фурнаџија – furnaxhi/furrxhi (furrtar), кондураџија – kundraxhi (këpucar), саатџија – sahatxhi (orëndreqës), самарџија – samarxhi (samarpunues), por afri kemi vërejtur edhe tek emrat e profesioneve, si p.sh.: механичар – mehaniçar (për: mekanik automjetesh), сидар – zidar (për: murator), бравар – bravar (për: bravapunues), чувар – çuvar (për: rojë/rojtar), дрвар – drvar (për: druvar, druprerës), зубар – zubar (për: dentist, mjek

dhëmbësh), фризерка – frize:rk (për: floktar/e), edhe rreth emrit лекар – doktor¹⁰ (në shqipe përdoret edhe emri mjek).

Fushat në të cilat kemi vërejtur afri, madje edhe paralelizma leksikore:

1. Bimë dhe çaj mjekues: камилица – kamilic (për: kamomil), липа – lipa (për: bli, çaj bliri), коприва – kopriv (për: hithër), брусница – brusnica (për: boronicë ekuqe), мајчина душица (për: trumzë), жалфија (për: sherbelë) etj.

2. Veshjet: фармерки – farmerka (përdoret edhe xhinse), маица – maic (për: veshje të brendshme), палто – pallto (për: xhaketë), патики – patika (për: atlete), каиш – kaish (për: rrip, FGJSH e ka edhe fjalën kaish), фустан – fustan (për: fustan), блуза – bluz (për: bluzë), сандали – sandallet (për: sandale), кондури – kundra (për: këpusë), чизми – çizme, панталони – pantulle (për: pantallona), џемпер – xhemper (për: triko), елек – jelek, чорапи – çarap/çorap (për: çorape), хеланки – hellanka, капут – kaput (për: pallto).

3. Orenditë e shtëpisë dhe pjesa e jashtme rreth saj : бавча – bafçe (për: kopsht), бања – ba:j, купатилл (për: banjë), соба, одаја – hynn’odë, hynn’sobë (për: dhomë). Përdorimi i leksemës *sobë* ka kuptimin e një dhome solemne. Ndërsa, leksema odë – odaја është një ballkanizëm i huazuar nga hungarishtja. Në gjuhën shqipe, fjala *sobë* ka kuptimin e një pajisjeje që shërben për të ngrohur një dhomë ose për të gatuar, zakonisht në trajtën e një kutie prej metali, prej balte etj (në këtë kuptim përdoret në të folmet maqedonase të Kërçovës, Manastirit etj. që paraqet një huazim nga shqipja). Por, në të folmet shqipe të cilat po i studiojmë, përdoret në kuptimin e një dhome, pra të secilës nga pjesët e një banese, përveç kuzhinës.

4. Pjesë të mobilierisë: кревет – krevet (për: krevet), пергал – rregal (për: dollap), астал – astall (për: tavolinë/tryezë), креденец – kredenec (për: bufe, dollap enësh), чешма – çeshmë/a (për: çezmë), спална – spallna (për: dhomë fjetjeje), шпорет – shporet (e ka edhe FGJSH), греалка – grealic (për: ngrohës), парно – parno (për: nxehje qendrore), кауч – kauç (për: kanape), кумбе – qimbet, qimet (për: koftor, por, stufë e sobë – këto katër emra i kemi edhe në FGJSH).

5. Enët e kuzhinës: тањир – tanjir, tanir (për: pjatë), шише – shishe (për: shishe e ka edhe FGJSH), тава¹¹ – tavë/tepsi (peshkunë tavë, groshë në tavë), црепна, черепна – çerep, bukë në çerep, сач – saç.

6. Emrat e bimëve dhe pemëve: këtu ka një ndeshje ose afri të mëdha të këtyre emrave, veçanërisht rreth produkteve që shiten në treg, si p.sh.: патлиџан – patlixhan (për: domate), компир – kompir (për: patate), марула – marull (për: marule), kajсија – kajsiја (për: kajsi), карфиол – karfiol (për: lulëlakër), краставица – krastavec (për: kastavec, trangull), багрем – bagrem (për: akacie), пиперка – piperka (për: spec, piperkë), пченка¹² – mçenka = misër.

¹⁰ Fjala доктор – doktor është huazim nga latinishtja, ndërsa emri лекар – lekar nga gjuhët sllave.

¹¹ Leksemat шише, тава и сач/ shishe, tavë dhe saç janë ballkanizma të huazuara nga turqishtja, ndërsa leksema црепна/çerep është huazim sllave (khs. Давкова-Ѓоргиева 2009).

¹² Leksema пченкае ka prejardhjen nga gjuhët sllave.

7. Mjetet e transportit: авион – avion (për: aeroplan/avion), автобус – avtobus (për: autobus), хеликоптер – helikopter (për: helikopter), комбе – kombe (për: kombibus).

8. Mjetet e bujqësisë: лопата – llopat (për: lopatë), гребало – grebule (për: grabujë), плуг – pllug (për: plug), копач – koraç; трактор со приколица – traktormeprikolic (për: traktor me rimorkio), тесла¹³ – teslic, teshlic (për: sqepar).

Nga të gjitha fjalët e sipërshënuara mund të vërehet se edhe maqedonishtja një numër të madh të tyre i ka huazuar nga gjuhët e fqinjëve (kuptohet edhe nga shqipja), por edhe nga ndonjë gjuhë evropiane e nga turqishtja (siç i paraqitëm disa më lart). Megjithatë, në të folmet shqipe të Tetovës me rrethinë, këto fjalë kanë hyrë nëpërmjet gjuhëve sllave (viteve të fundit edhe nëpërmjet maqedonishtes), e kjo shihet edhe nga forma fonetike e tyre (p.sh.: приколка – prikolic etj.).

2. Shprehjet frazeologjike

Folësit e të dy gjuhëve gjatë komunikimit të tyre të përditshëm përdorin kombinime gjuhësore të ndryshme, kështu që një situatë të caktuar ose një ide, mund ta tregojmë në mënyra të ndryshme, e kjo varet edhe nga aftësia kreative e folësit. Ndonjëherë një fjalë të njëjtë nëse e përdorim në situata të ndryshme s'ka kuptim të njëjtë. Krahaso *каменјаглен* (në shqipe ka kuptimin e thëngjillit) dhe *камено срце* (në gjuhën maqedonase) zemërgur (në gjuhën shqipe), *црна волна* dhe *црна судбина* (во македонскиот јазик) përkatësisht (lesh i zi) fat i zi, fatzi (në gjuhën shqipe). Përdorimi i disa fjalëve të caktuara të cilat paraqesinhuazim të një numri të fjalëve të huaja, po përdoren në vend të fjalëve të tyre amtare (maqedonishtes, përkatësisht shqipes). Krahaso: апел (место *помош*), прогрес (место *напредок*), база (место *основа*), таргет (место *цел*) etj. Ose në shqipe abonim – i, abonoj, abonohem; за: pajtim, pajtoj, pajtohem; abrogim, abrogoj за: shfuqizim, shfuqizoj (зборови кои ги советува А. Џувани); adaptoj за: përshtat, adoptoj за: birësoj, bijësoj; aktivitet за: veprimtari; ambient за: mjedis; apel за: thirrje; dedikoj за: kushtoj etj. Edhe në të folmen maqedonase të Tetovës me rrethinë dhe në të folmet shqipe të gegërishtes qendrore (veçanërisht të Tetovës me rrethinë) kemi vërejtur përdorimin e panevojshëm të fjalëve të huaja, si: *чао* - *чао*, *бејбу* - *bejbi*, *хеллоу* - *hello*, *бај* - *baj* etj. Leksiku i “slangut” i lidh të rinjtë e të dy kombësive (shqiptarët dhe maqedonasit) dhe i hetojmë shembujt si, p.sh.: *бомба* - *bombë*, *авион* - *avion*, *руба* - *peshk*, *бомбона* - *bonbone* si mbiemra cilësorë (atribute) që përdoren për t'i thënë një femre (shumë rrallë përdoren për t'ia atribuar një mashkulli) etj.

Interes të veçantë të hulumtimit janë **frazeologjizmat**. Një numër i madh i tyre që përdoren në maqedonishte korrespondojnë sipas strukturës me frazeologjizmat përkatës të gjuhës shqipe. Krahaso:

¹³ Leksema *теслае* ka prejardhjen nga gjuhët sllave (e formuar nga folja*tesati).

- Го зеде на заб. (со значење *го замрази*) – E mori inat.
- Има долг јазик. (со значење *многу зборува*) – E ka një gjuhë të gjatë.
- Око не му трепнува. (со значење *не се плаши*) – S'i trembet syri.
- Како гром од ведро небо (со значење *се случи неочекувано*) – si me i ra prej qielli; pa e pritur e pa e kujtuar;
- Ќе најдеш и од пиле млеко. (со значење *има сè*). Veç tamël zogu s'ka; thitë naksan i ka.
- Го собра кајмакот. E mori kajmakun.
- Има мува на капата. E ka mizën nën kapuç.
- Круша под круша паѓа. Dardha nën dardhë bie.
- Село гори, баба се чешла. Fshati digjet, e kurva krihet.
- Ако не врне, ќе капне. Nëse nuk rrjedh, do të pikojë.
- Ќе дојде колце на тркалце. Vjen cjapi te kasapi.

Në këtë rast duhet t'i përmendim edhe disa kalke “ndërkombëtare” (të marra nga gjuhët e ndryshme evropiane) të cilat kanë hyrë nëpërmjet literaturës së ndryshme ose nëpërmjet mediave (si, p.sh.: студена војна, затишје пред бура, железна завеса/lufta e ftohtë, perdja e hekurt).

3. Anglicizmat dhe ndërkombëtarizmat

Dekadën e fundit po na shqetëson mjaft edhe ekspansioni i gjuhës angleze në fushat që lidhen me komunikimin botëror: ekonominë, diplomacinë, politikën, shkencën, informatikën, që sjell depërtim “të pandalshëm” të fjalëve edhe në të folur, madje edhe në të shkruar në maqedonishte. Fjalët që më tepër po përdoren janë: *брифинг, консалтинг, прес, бос, офис, агенда, мониторинг, иновација (briifing, konsalting, press, bos, ofis, agjendë, monitorin, rinovim)* etj.¹⁴ Edhe në shqipe vërehen fjalë të tilla, kuptohet që në vend të tyre ka edhe fjalë shqipe që disa plotësisht mund t'i zëvendësojnë. Мë së shpeshti, në të dy gjuhët, po përdoren edhe disa shkurtesa nga anglishtja, si: brb (be right back, со значење ќе се вратам брзо, kthehem shpejt), LOL (laughting out loud или смеј се гласно, qesh me zë), nvm (never mind или не е важно, s'është me rëndësi), np (no problem или нема проблем, s'ka problem), ly (love you или те сакам, të dua), ttyl (tolk to you later или ќе зборуваме подоцна, bisedojmë/flasim më vonë), u (you или ти, ti), y (why или зошто, pse), pls (please или те молам, të lutem), tnx (thanks или благодарам, faleminderit), hru (how are you или како си/si je), për fat të keq, një numër i vogël janë maqedonase, si: nz (не знам, s'e di), pozz/prsh. (поздрав), zdr/tng (tung) (здраво), mn (многу), cek (чекај), zsh (зошто), bd4 (бор да чува) edhe atë të shkruara me shkronja latine.

¹⁴ <https://hcnm-ndc.org/%D1%80%D0%B5%D1%87%D0%BD%D0%B8%D0%BA/>

Kuptohet, këto shkurtesa përdoren për shkak të komunikimit të shpejtë, por në këtë mënyrë e “shfityrësojnë” gjuhën, ose i bëjnë dëm gjuhës. Në komunikimin e përditshëm vërejmë edhe shprehje të tipit: *пушти ми мејл (ma dërgo një email)*, *тач екран (çet monitor/ekran)*, *јави се на чет (paraqitu në çet; hyn në çet)*, *ке одуме на фаст фуд (do të hamë fast-fud)*, *кул девојка, фенси*.

Duke e analizuar gjuhën e të rinjve shqiptarë, vërejtëm një situatë të njëjtë. Ata, gjatë komunikimit nëpërmjet rrjeteve sociale, përkrah atyre të anglishtes, përdorin edhe shkurtesa të shqipes, si p.sh.: sps (s’ka përse), flm (faleminderit), prsh (përshëndetje), klm (kalofsh mirë), ntm (natën e mirë), tdsh (të dua shumë), sh (shumë), klb (kalo bukur), mgjth (megjithatë) msg (mesazh), mm (mirëmëngjesi), sh.m. (shkolla e mesme), ugh (i mërzhitur), tdf (të dua fort), tdi (turbo disel ineksion), psp (prapëseprapë), ups (më fal, gabova).

E folmja maqedonase e Tetovës bën pjesë në të folmet e maqedonishtes perëndimore, edhe pse sipas karakteristikave gjuhësore është pjesë e të folmeve të maqedonishtes veriore. Rezultatet e hulumtimit tonë, tregojnë se e folmja maqedonase e Tetovës ka ndikuar më shumë mbi shqipen në këtë fushë, pra atë të leksikut. Sa i përket interferencës së kundërt, përkatësisht nga shqipja në maqedonishte, kuptohet që ajo është më e vogël. Një grup i veçantë i leksikut dialektor paraqesin huazimet nga shqipja në maqedonishte (Видовски 1993: 33–54). Në të folmet e veçanta të studimeve dialektologjike janë vërejtur leksemat e mëposhtme: *ала* – тетка (alla – hallë), *барџа* – бела овца (barxhë – dhi e përhimë, me qime të përziera, gjysmë e bardhë e gjysmë e zezë), *бир*, дем. *буре* – син (bir – djali kundërt prindërve të vet), *брѣнда* – затвор (brenda – внатре), *буза* – усна (buzë), *бук* – леб (bukë), *бабо* – татко (babë), *буаре* – оџак (buhare – buhari), *бишч* – опашка (bisht), *вајза* – ќерка (vajzë), *гропа* – дупка (gropë), *дамалуг* – плуг со две рачки (damalug – lloj parmende prej hekuri, me plor të madh e zakonisht me dy doreza, plug), *дајо* – вујко (dajë), *даш* – овен (dash), *џал’* – дечко (gja:l, djalë), *жур* – глужд (zhur – rërë e trashë dhe e ashpër), *јакуцка* – гуна (jakouce, jakuce – veshje e sipërme burrash), *кока* – глава (*удри ја малку коката*) (kokë), *кушерија* – сосед (kushëri), *кундри* – чевли (kundër, këpusë), *л’але* – постар брат (при обраќање) (lalë), *л’опа* – крава (lorë), *л’уле* – цвеќе (lule), *мургаш*, *мурго* – пес со темни влакна (murgash, rum. murg), *мотра* – сестра (motrë, motër), *миџо* – вујко, стрико (mixhë), *нуса*, *нусе* – невеста (nuse), *огич / угич* – овен (ogiç – dash i madh me këmborë, që i prin tufës së dhenve), *пус* – бунар (pus) (Видоески 1993), *вендоса* – реши, одлучи (vendos), *дашурија* – љубов (dashuri), *догана* – царина (doganë), *кушерија* – роднина, братучед (kusherië), *талва* – исмева, потсмева (tall), *шартоса* – калеми овошка (shartoj) (khs. Цветановски 2008). Gjatë hulumtimit tonë kemi vërejtur edhe këto huazime nga gjuha shqipe, si: *дембел* – mrza (dembel), *буза* – усна (buzë), *бир* – сине (bir), *кумбара* кум (kumbarë), *аџо* – чичко (axh/ë), *беса* – чесен збор (besë), *преш* – праз (presh), *шитне*, *шитка* – продава (shitet).

Mbiemri *barzav* është mbiemër që i përket terminologjisë blegtorale, dhe rrjedh nga rrënja e mbiemrit *bardhë* në gjuhën shqipe dhe prapashtesës së serbishtes – *av*, përmes ndryshimit fonetik /dh/ > /z/. Hoxha pohon se ky mbiemër gjendet edhe në gjuhën maqedonase (Rečnik na makedonskiot jazik I, Shkup, 1961, 22) dhe i ka dy kuptime: 1. (*dhi me pulla të bardha në kokë ose në trup* /koza so beli pegi po glavata ili teloto/ dhe 2. *Plak i thinjur*. U shënua në të folmet maqedonase dhe bullgare (Çabej, St. Gj. (IV) 312). Ky mbiemër gjendet edhe në trajtën *barz*, *barzast* dhe *barziv* (Hoxha 2001: 53; Malja-Imami & Hrkalović 2021: 87).

Në studimet gjuhësore, në pjesën më të madhe të rasteve është shkruar për huazimet, përkatësisht për elementet sllave në gjuhën shqipe. Kjo është e natyrshme, pasi siç është e ditur, që nga kontaktet e para, në leksikun e gjuhës shqipe hynë dhe u shtresuan mjaft fjalë sllave, thuajse në të gjitha sferat e veprimtarisë njerëzore, veçanërisht në terminologjinë e kulturës materiale, bujqësore etj. (Nesimi 2019: 291).

Nga historia e gjuhëve të Ballkanit, veçanërisht nga ajo e maqedonishtes janë të njohura si huazime të shqipes fjalët ***besë, bir, buzë, cucë, çupë, farë, katund*** etj. Shumica e këtyre fjalëve janë përfshirë edhe në Fjalorin e gjuhës maqedonase “Rečnik na makedonskiot jazik” (Речник на македонскиот јазик) si dialektizma e arkaizma.

Qeno është term që lidhet me blegtorinë dhe që ka hyrë në gjuhën bullgare dhe maqedonase nga shqipja, por edhe në gjuhën serbe në Mal të Zi dhe Bosnjë e Hercegovinë me të njëjtin kuptim si në gjuhën shqipe ‘pas’ (Čabej 1976: 168; Popović 1957: 1- 2; Malja-Imami & Hrkalović 2021: 88).

Në të folmet maqedonase të Maqedonisë Perëndimore, përkatësisht në krijimtarinë gojore të këtyre anëve, veçanërisht në rrethin e Strugës e të Dibrës, hasen edhe mjaft fjalë e shprehje të tjera, shumica e të cilave janë me burim të padiskutueshëm nga shqipja e ndonjë me burim nga gjuhët e tjera, por të infiltruara nëpërmjet shqipes (Nesimi 2019: 291). Më poshtë po i përmendim disa fjalë e shprehje të këtyra.

Në prozën popullore të mbledhur nga Kuzman Shapkarevi, i lindur në Ohër (1834 – 1909), hasim edhe termin ***ande***. “*Preçopori ande*” me kuptimin *kërce andej* që do të thotë se është fjalë e shqipes. Me përjashtim të fjalës *druzhina*, i tërë vargu “*bini, ore bini, druzhina*” është shqip. Tek i njëjti autor hasim edhe shprehjen *do edna dushka* “afër një dushku” e fjala *dushk* që është e mbarë shqipes siç ka vërtetuar prof. Çabej, vjen nga *dru*. Kjo fjalë, përveç kuptimit të parë leksikor, do të thotë degë të vogla me gjethe të prera, që grumbullohen e vihen në mullar dhe gjatë dimrit përdoren si ushqim për kafshët.

Me burim të padiskutueshëm nga shqipja është edhe fjala *shok*, të cilën e hasim në funksion të thirrorit bashkë me pasthirmën shqipe *ore* në vargun: *Stani, ore shok, leb da jedime* “Çohu more shok të hamë bukë”.

Në të folmet popullore, në stilin e bisedimit e madje edhe në FGJM-në folja **shes** haset në dy forma: *shitne* dhe *shitka* (шитне и шитка). Edhe kjo folje, siç dihet, është me burim të padiskutueshëm nga shqipja.

Në shqip, në greqishten e re, bullgarisht e rumanisht, në një formë përdoret fjala **tuf/ë,-a**, ndërsa në maqedonisht po kështu në formë deminutive, *tufka* edhe atë si dialektizëm: *tufka cveçinja* “tufë lulesh”. Petar Skoku nuk e përmend origjinën e kësaj fjale, por, kur të merret parasysh përdorimi i kufizuar në gjuhët e tjera në një anë dhe përdorimi i gjerë me disa kuptime kontekstuale si dhe derivatet e shumta të formuara nga kjo fjalë: *tufël*, *tufëz*, *tufëzim*, *tufëzoi*, *tufoj*, *tufshak*, bën të përfundojmë që në gjuhët e tjera do të jetë e përhapur nga shqipja (Nesimi 2019: 293).

Kështu ndodh edhe me disa huazime shqipe në maqedonisht, si p.sh.: *Toj si nemashe fara i rodnina* (Тој си немаше фара и роднина) “Ai s’kishte farefis”. Ose: *Dojde vreme, dojde kova* “Erdhi koha, edhe zemani”. Fjala *farë* haset edhe në disa fjalë të urta, si p.sh.: *Zet (kum) fara (rodnina) ne e “Dhëndri (kumbara) nuk është farefis”; Aren komshija i od brat pogolema fara*, “Fqinji i mirë më i afërt se vëllai”.

Në pjesën më të madhe të të folmeve maqedonase *h*-ja është e paqëndrueshme siç ndodh edhe me disa të folme shqipe. Prandaj emri *kohë* del herë në formën *koa*, herë *kova*, ndërsa në të folmen shqipe të Dibrës përdoren në formën *koja*. Kjo fjalë ka depërtuar edhe në të folmen serbe në Mal të Zi (Plavë), ku përdoret në kuptimin optimal: *Sad je koa da se kopa kukuruz*. “Tani është koha që punohet misri”. Në të gjitha gjuhët e Ballkanit paraqiten folje të formuar ame baresën –s; psh. Serb. Araksati, arnisati, ðakoisati, metanisati e tj.

Nëpërmjet shqipes në maqedonisht do të ketë hyrë edhe fjala *pljaga*<*plagë* si dhe derivati *plagosan*<*i plagosur* dhe *nepljagosen*< *i pa plagosur*. Krahaso p.sh.: *Zborot dupka ne otvara ama pljaga otvara* “Fjala nuk hap birë, por hap plagë”. Loshata *pljaga* zazdravjat, ama loshit zbor ne se zaboravit “Plaga e rëndë shërohet, por fjala e keqe s’harrohet”. Ose: *Junak nepljagosen nema* “S’ka trim të paplagosur”. Siç dihet, fjala *plagë* është me burim nga latinishtja “plaga”. Po në këtë formë haset edhe në dialektin dorik të greqishtes e në atë të atikës, ndërsa në greqishten e re me formën *pligi*. Në italisht kemi palatalizimin e *l-së* – *plaga* ashtu siç ka ndodhur edhe në disa të folme geqe *pjagë* e madje edhe *qagë* dhe *qagoj*. Kur të merret parasysh fakti se forma origjinale si në latinisht përdoret vetëm në shqip, atëherë s’ka dyshim se edhe këtë fjalë maqedonishtja do ta ketë huazuar nga shqipja (Nesimi 2019: 296).

Përveç fjalës shqipe *besë*, strukturë sintaksore të shqipes kanë edhe shprehjet: *Vije da besa vrzite* (Shapkarev 1976: 144) “Ju të lidhni besë”; *Tije na besa ne stojat* “Ata nuk rrinë në besë”; *kako si besa vrzafme* “Si e lidhën besën”; *Prvo da besa vrzime* “Më parë të lidhim besën”. Kështu ndodh edhe kur në vend të fjalës *besë* përdoret termi adekuat i maqedonishtes *vera*. P.sh.: *Toga nea vera*

ja fatila “Atëherë asaj i zunë besë”; ose *Vera do begot ne fašcat* Begut s’i zënë besë.

Në vitin 2016 së bashku me profesorët Haki Imeri-Bina, Petar Atanasov, Veselinka Labroska dhe unë, Berton Sulejmani kemi hartuar një fjalor të vogël dykahësh shqip-maqedonisht dhe maqedonisht-shqip me dy gramatika të shkurtra. Fjalori u hartua kryesisht për nevojat e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme në RMV. Krahas versionit të shtypur, fjalori ka edhe versionin elektronik i cili falas mund të shkarkohet¹⁵. Në këtë fjalor kemi përfshirë leksema (fjalë) që kanë kuptim të ngjashëm ose të njëjtë (të njëjtën formë). Të tilla janë: ara / aga, олтар / altar, ама / ама (сврзник, разг.), аманет / amanet, анегдота / anekdota, аргат / argat, артист / artist, ас / ас(= првак), асфалт / asfalt, атакува / atakoj, авлија / avlli, аџо / axhë, бавча / bahçe, бања / banjë, барабар / barabar, бардак / bardak, бастун / bastun, баш / bash, баца / baxhë, базира / bazohem (текстот се базира на легенда: *teksti bazohet në legjenda*), богат / begatë, боја / bojë, беља / bela, беса / besë, брлог / bërllok, биба / bibë (= мала шатка), бигор / bigorr, бир(о) / bir (=син), беседа / bisedë, бише / bishë, подрум / bodrum, боја / bojë, боровница / boronicë, борч / borxh, босилок / borzilok (*një tufë borzilok = една туфа босилок*), бош / bosh (бош муабет), божур / bozhur, брава / bravë, брег / breg, бубрег / bubrek, буф / буф, бунар / bunar, букет / buketë, бусола / busull, буза / buza, бурек / byrek, цар / car, ципа / cipë, циронка / cironkë, цуца / cuscë, чадор / çadër, чаир / çair, чај / çaj, чакал / çakall, чакмак / çakmak, чам / çам, чанта / çanta, чаршаф / çarçaf, чардак / çardak, чаре / çare, чаршија / çarshi, час / çast, чатија / çati, чекан / çekan, челик / çelik, чета / çeta, чешма / çezma, чибук / çibuk, чифлиг / çiflig, чифт / çift, чифте / çiftë, чифтелија / çifteli, чекрек / çikrik, чирак / çirak, чобан / çoban, чорба / çorba, чудо / çуди, чуди / çудит, чука / çукë, чупе / çурë, дада / dadë, далдиса / daldisem, далга / dalga, дамла / damlla, тантела / dantellë, дебитира / debutoj, дева (=камила) / deve, денк / deng, долап / dollap, дүлбија / dylbi, душек / dyshек, душеме / dysheme, даскал / dhaskal, дома / dhomë, илач / ilaç, инает / inat, интегрирање / integrim, јатаган / jatagan, југ / jug, кадифе / kadife, качак / kaçak, кенгур / kangur, колан / kollan, краставица / kastravec, ливада / livadh, лаф / llaf, ластик / llastik, лопата / lopatë, лост / lloz, магија / magji, мај / maj, мандало / mandall, манекен / manekin, мантил / mantel, марама / maramë, мачка / mace, мелодија / melodi etj.

Një pjesë të fjalëve që nga gjuha shqipe kanë depërtuar në gjuhët sllave, pra edhe maqedonase, janë dhënë në këtë fjalor. Të tilla janë: *аџо-axhë* (чичко), *беса-besa* (чесен збор), *биба-bibë* (пајка), *бир-bir* (сине), *буза-buz-ë/a* (усна), *далга-dallgë* (бран), *дембел-dembel* (мрза), *лала-lalë* (стрико), *лејлек-lejlek* (штрк), *преш-presh* (праз), *’рзак* (пастув), *скама-shkumë* (пена), *туфа-tufë*

¹⁵ <https://hcnm-ndc.org/%D1%80%D0%B5%D1%87%D0%BD%D0%B8%D0%BA/>

(*кутка*), *циронка-cironkë* (*мрена*), *цуца-сисë* (*девојка*), *чупе-çорë* (*девојка*), *шутка-shes-shesim* (*продава*) etj.

Në fjalor kemi dhënë edhe disa frazeologji me kuptime të njëjta a të përafërta në të dy gjuhët, pra në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedonase, si:

ai ka gisht në këtë punë *има замешано прсти во оваа работа*;
 çdo gjë që ndrit nuk është ar (*flori*) *сè што сјае не е злато*;
 dardha nën dardhë bie *крушата под круша паѓа*;
 dora e huaj nuk të kruan si e jotja *туѓата рака не чеша како што чеша својата*;
 eja baba të të dëftej arat *ајде тате да ти ги покажам меѓите*;
 fjala e burrit, pesha e gurit *зборот на маж, тежок како камен*;
 gënjeshtria i ka këmbët të shkurtra *лагата има куси нозе*;
 guri është i rëndë në vend të vet *каменот на местото си тежи*.
 gjarpri nuk i dëften këmbët *змија нозе не покажува*;
 gjuha kocka s'ka e kocka thyen *јазикот коски нема, ама коски крши*;
 kau lidhet për brirë, e burri për fjale *волот се врзува за рогови, а мажот за збор*.
 me një dallëndyshe s'vjen pranvera *со една ластовица пролет не бидува*.
 t'u bëftë gjak e dhjamë! *крв да ти се стори!*

Literatura

- Bahri, B. (1987). *Të folmet qendrore të gegërishtes*. Dialektologjia shqiptare V. Tiranë.
- Çabej, E. (1976). *Studime gjuhësore. V.2, Studime etimologjike në gjuhë të shqipes: P - ZH* (p. 508 f.). Rilindja.
- Malja-Imami, N., Hrkalović, M. (2021). Albanizmi u srpskim i makedonskim govorima. *Naučne publikacije državnog univerziteta, Novi Pazar. Serija B: Društvene & humanističke nauke*, 4(2), 85–102.
- Nesimi, R. (2008). *E folmja e Dervenit*. Tetovë: USHT.
- Nesimi, R. (2019). *Për gjuhën shqipe*. Shkup: ITSHKSH.
- Sulejmani, F. (2006). *E folmja e Malësisë së Sharrit*. Tetovë: USHT.
- Shapkarev, K. (1975). *Izbrani dela V, Misl*.
- Аргировски, М. (1998). *Грцизмите во македонскиот јазик* (Vol. 29, p. 313 стр.). Институт за македонски јазик “Крсте Мисирков.”
- Видоевски, В. (1993). *Меѓујазичниот контакт (на дијалектно рамниште) како фактор на дијалектната диференцијација на македонскиот јазик, Реферати на македонските слависти на XI меѓународен славистички конгрес во Братислава, МАНУ, Shkup, 33–54.*

- Видоески, В. (1998). *Дијалектите на македонскиот јазик 1*. Скопје: Македонска академија на науките и уметностите.
- Видоески, В. (2000). *Прашалник за собирање материјал за Македонскиот дијалектен атлас*. Скопје: ИМЈ, „Крсте Мисирков“.
- Давкова-Ѓоргиева, С. (2009). *Дијалектните именувања на посатките во македонскиот јазик од јужнословенски и балканистички аспект*. Скопје: ИМЈ, „Крсте Мисирков“.
- Демирај, Ш. (1994). *Балканска лингвистика*. Скопје: Логос-А.
- Конески, Б. (1986). *Историја на македонскиот јазик*. Скопје: Култура.
- Лаброска, В., Гајдова, У., Давкова-Ѓоргиева, С., Цветановски, Г., Томовски, Д. (2012). *Вратничко-полошките говори–духовна ризница*. Скопје: ИМЈ, „Крсте Мисирков“.
- Полоска, А. (1990). *Лексичка интерференција на македонскиот и албанскиот дијалектен јазик*, (докторска дисертација). Скопје: Филолошки факултет „Блаже Конески“.
- Савицка, И., Спасов, Љ. (1997). *Фонологија на современиот македонски стандарден јазик*. Скопје: Детска радост.
- Стоевска-Денчова, Е. (2009). *Именување на роднинските односи во македонските дијалекти од словенски и балканистички аспект*. Скопје: ИМЈ „Крсте Мисирков“.
- Сулејмани, Б., Даниловска, М., Спасовска, М., Лаброска, В. (2013). Меѓујазичното влијание на македонскиот говор и албанскиот гегиски говор во Тетово на лексичко рамниште. *Македонски Јазик*, 64, 105–115. <http://www.imj.ukim.edu.mk>
- Тоска, В. (2009). *Влијанието на македонскиот јазик врз албанскиот во рамките на посесивните именски синтагми*, докторска дисертација, ракопис.
- Хамити, А. (2006). Заеднички гласовни промени во албанскиот и македонскиот современ јазик. В: *Годишен зборник, книга 32*. Скопје: Универзитет „Св. Кирил и Методиј“, Филолошки факултет „Блаже Конески“.
- Цветановски, Г. (2008). Албанскиот јазичен елемент во западнопреспанскиот говор, *Јазичите во контакт, Денови на Благоја Корубин*, Скопје.
- Цветановски, Г. (2010). *Говорот на Македонците во Мала Преспа (западнопреспански говор) (во Р Албанија)*. Скопје: ИМЈ, „Крсте Мисирков“.

Burime të tjera

Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe, (2007). V II, Universita degli di Napoli, L'Orientale.

Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe, (2007). V I, Universita degli di Napoli, L'Orientale.

Бертон В. Суљејмани
Филолошки факултет, Универзитет у Тетову

**МЕЃУЈЕЗИЧКИ УТИЦАЈИ АЛБАНСКОГ И МАКЕДОНСКОГ ЈЕЗИКА
У ОБЛАСТИ ЛЕКСИКЕ (НА ДИЈАЛЕКТСКОМ НИВОУ)**

Резиме

Из онога што смо претходно рекли о стању језичке интерференције албанског говора у Тетову и околини посебно, између македонског и албанског језика, можемо са сигурношћу закључити да је оно специфично, као што смо изнели на наведеним примерима, чак и за друге градове, у којима се користе оба језика паралелно. Узајамни утицај логично иде у оба смера, јер је донедавно само македонски језик био службени језик, а то је утицало да има више позајмљеница из македонског у албански, посебно у административној терминологији. Позајмљенице са албанског на македонски углавном су из лексичке терминологије везане за родбинску терминологију, свакодневни живот и делатности везане за становништво, а то су пољопривреда и сточарство. Наравно, део заједничке лексике речи, су позајмљенице из турског или балканизми различитог порекла. На крају, морамо нагласити да су оба језика под великим утицајем енглеског језика, посебно у комуникацији нових генерација.

Кључне речи: балканологија, лингвистички утицаји, албански језик, македонски језик, поглед на свет, лексика.

Evalda PACI¹

Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë

ELEMENTE TË NJË LASHTËSIE KOMPLEKSE NË STUDIME MBI BOTËN INDOEVIROPIANE E ATË BALLKANIKE

Studimet e krahasuara paraqiten si një shtysë e rëndësishme për nxitjen ndaj njohjes së elementeve konstitutive të gjuhëve dhe qytetërimeve, ndërkohë që vetë prurjet nga fusha të veçanta të gjurmimeve shkencore janë një vlerë më vete dhe dëshmi e një formimi kompleks dhe të një periudhe me rëndësi për interesat rreth gjuhësisë i.e., asaj ballkanike dhe të krahasuar. Vetë gjuha shqipe dhe lashtësia e saj, tiparet që dëshmojnë karakterin i.e. të saj, por dhe veçori që janë tipike të evolucionit të brendshëm, janë bërë me të drejtë objekt vëzhgimesh të disa disiplinave. I përpiluar nën një strukturë gjithëpërfshirëse, por dhe të prirë për të reflektuar çështje konkrete të hulumtimit të historisë së një gjuhe si shqipja, vetë manuali studimor që ka për autor H. Barić (botuar në shqip në Prishtinë, 1955) përbën një objekt që nxit kureshtje shkencore, por dhe reflektime mbi vështirime të natyrës përfaqëse apo më të thelluar mbi elemente që dëshmojnë dhe në studime të mëvona, që mund të ndajnë të njëjtën perspektivë. Një traditë e mirëfilltë arritjesh reflektohet në sprovat e këtij gjuhëtari, profili i të cilit që shtysë dhe për këtë trajtesë tonën në këtë konferencë shkencore.

Fjalët kyçe: histori e gjuhës, studime të krahasuara, elemente latine, studime romane.

Në rasë të një përkujtimi solemn siç mund të jetë përvjetori domethënës i përrimit të një katedre studimesh albanologjike, paraqitet më se me vend që vëmendja të orientohet ndaj kontribuesve që me kërkimet dhe përpjekjet jetësore ndërtuan gurë miliarë në një rrugëtim që natyrshëm dhe gradualisht vijohet në hapa të mëtejme nga gjeneratat e studiuesve pasardhës

Shekulli i kaluar dhe në pikëpamje të vëmendjes dhe kujdesit që kanë gëzuar studimet albanologjike është për t'u veçuar e parë në një optikë kategorizuese që sheh dhe në bashkërendim përvijimin e ndihmesave në fusha si gjuhësia historike dhe ajo e krahasuar, gjuhësia ballkanike, por dhe bashkëlidhjet me atë romane dhe

¹ evaldapaci@gmail.com

studimin e gjuhëve neolatine, gjurmimet filologjike, interpretimet mbi burimet epigrafike etj.

Vetë historiku i bërthamave kërkimore, i instituteve që lidhen me ballkanologjinë, albanologjinë, studimet e krahasuara dhe orientimet ndërdisiplinore që kanë ndihmuar së tepërmi të njihen më nga afër gjuhë e kultura të rëndësishme për vetë Ballkanin është i lidhur me emrat e studiuesve që me kontributin përkatës përforcuan ndjeshëm dhe studimet mbi këto argumente.

Përzgjedhja e këtij argumenti që parashtrojmë në këtë veprimtari të rëndësishme për shumë arsye është bërë në rrethana të konsiderimit të një sërë ndihmesash që kohë më parë patën shërbyer në zgjedhjen e një rrugëtimi të veçantë profesional për mua, fakt që kam vazhduar ta respektoj në vijimësi, në veçanti në kushtet e angazhimit në role mësimdhënëse në nivel universitar dhe pasuniversitar.

Në rolin e një docenteje të gjuhës e të kulturës latine, emërtuar shpesh si kulturë klasike por që në këtë vështrim duhet asociuar dhe me lidhjet e natyrshme me botën greke, shpesh konsultimi i manualeve të përpiluara në dekada të hershme, (kur tradita e studimit të klasicitetit ishte në një fazë të ndryshme lëvrimi dhe receptimi) bëhet një domosdoshmëri, ashtu siç paraqitet po aq e nevojshme dhe marrja në konsideratë e mjaft burimeve, në veçanti të atyre literaturave që lidhen dhe me studime e gjurmime që një bazë të konsiderueshme dokumentare e gjejnë si mbështetje në autorë të caktuar dhe në interpretime e trajtesa që u referohen veprave të këtyre të fundit. Një tërësi çështjesh që lidhen drejtpërdrejt me vetë gjuhësinë i.e. dhe shfaqjen e tipareve që supozohen të kenë një origjinë më të hershme se vetë dokumentimi shkrimor i gjuhëve të sipërcituara mund të trajtohen duke pasur parasysh të dhëna që ofrojnë nënsisteme qenësore që kanë të bëjnë me klasa fjalësh e me kategoritë përkatëse leksiko-gramatikore. Në traditën e studimeve albanologjike nuk kanë munguar trajtesa e as punime të plota, me gjasë dhe tematike mbi vendin e shqipes në familjen gjuhësore i.e., vështruar shpesh dhe në vijimësi me të tjera çështje që ngërthejnë tiparet e karakterit i.e. të saj, të dhëna që kanë qenë shtysë të përpiloheshin reflektime mbi prejardhjen e saj dhe marrëdhëniet e hershme me gjuhë e kultura të tjera, me një status të veçantë që në kohët më të lashta, me shumë mundësi dhe për arsye të një dokumentimi më të hershëm shkrimor. Dëshmi e përpjekjeve për ta projektuar shqipen në një perspektivë që duke u nisur nga të dhëna që përbënin një bazë të rëndësishme krahasimore mes gjuhësh që ishin referenciale në prospektet mbi veçoritë morfologjike e fonologjike të një idiome të hershme i.e. mbeten dhe kontributet e linguitit H. Barić (1888-1957), i cili është bërë i njohur me artikuj, prova, punime e studime mbi një sërë çështjesh të dijes së gjuhësisë për kohën kur jetoi, por dhe për vëmendjen ndaj historisë së gjuhës shqipe dhe aspekteve qenësore të kësaj të fundit.

Në veprën me titull *HËmje në historinë e gjuhës shqipe*, konceptuar me një destinacion tipik universitar, referimi ndaj gjuhëve që kanë shërbyer si shtysa dhe për të rindërtuar teori mbi lidhje afrie mes gjuhësh e popullsish më të lashta, është një fakt i pranishëm që në krye të herës, aq më tepër që vetë ndikimeve nga këto të fundit u kushtohen krerë më vete në përbërje të tij.

HËmje në historinë e gjuhës shqipe, si një doracak që paraqitet i paracaktuar për studime të nivelit universitar, nuk mbetet pas punimeve që duhet të kenë objekt të vetin parashtrime çështjesh që qëndrojnë në themel të hulumtimit të bazave shkencore të trajtimit të historisë së një gjuhe të caktuar.

Dhe pse e dokumentuar me shkrim në shekuj relativisht të vonë për zhvillimet gjenetike gjuhësore, shqipja ka qenë objekt vëmendjeje dhe në pikëpamje të prejardhjes së saj, të lidhjeve birnore me gjuhë-amë për të cilat është folur, shtruar dhe supozuar gjerësisht.

H. Barić mëton të paraprijë interpretime që më tej i konkretizon në krerë të veçantë të këtij punimi, duke mbetur kryesisht koherent ndaj mendimeve të veta dhe në sythe të veçanta të tij. Sa i përket metodës dhe burimeve të shumta të literaturës shkencore, duhet pohuar që dhe pse në paracaktimin e një manuali universitar, në këtë të fundit do të mund të gjurmohet një pasuri e tërë indicesh bibliografike, por që reflektojnë dhe shkallën e receptimit të autorëve që kanë qenë themelore për disiplina si gjuhësia historike, gjuhësia e krahasuar, gjuhësia ballkanike dhe ajo romane, por dhe filologjia latine dhe e gjuhëve romane.

Me vetë konstatimin mbi përkatësinë i.e. të gjuhës shqipe dhe bashkërendimin e saj ndër grupe gjuhësore që ofrojnë mundësi për të qasur, evidentuar mbi afrinë gjenetike jo pak gjuhë të tjera, vetë studimet mbi gjuhët e arealit evropian dhe më gjerë shihen në një perspektivë që pikërisht dhe gjuhën tonë e bën të projektueshme në disa pikëpamje, mbi të gjitha, në ato të krahasimeve që rrokin disa nënsisteme. Gjuha shqipe është një burim qenësor të dhënash në lidhje me dijen gjuhësore i.e., por ndërkohë, ubikimi i saj mes gjuhësh tipike të kësaj familjeje të madhe duke pasur parasysh këto të dhëna, mundësohet pikërisht nga një njohje e mirë burimore që pikënisjen e ka në elemente të nënsistemeve emërore, mbiemërore, foljore, në të cilat vihet re fare qartë që morfe e tipare fonomorfologjike e përafrojnë gjuhën tonë me të tjera idioma të rëndësishme të familjes gjuhësore i.e. Trajtimi i eptimit emëror në një syth të veçantë të kapitullit që i kushtohet indoevropishtes zanafillëse përbën një minitrajtesë me interes për mënyrën si konceptohet sistemi rasor i kësaj të fundit, aq më tepër duke patur parasysh faktin që në jo pak manuale rezulton një vështrim mbi një paradigme prej pak më shumë se shtatë rasa, që rezultojnë të sinkretizuara në gjuhë të caktuara i.e. si p.sh., latinishtja.²

² A mund të konsiderojmë që Barić u kushton faqe të çmuara çështjeve themelore të gjuhësisë i.e., duke pasur parasysh që leksiku, në veçanti ai i lidhjeve familjare, por dhe nënsisteme të përveçme shihen në një perspektivë hershmerie për të cilën dokumentimi është realizuar pikërisht mbi

Paraqitet më se me vend pikënisja nga çështje të njohjes së drejtimeve studimore që lidhen me gjuhësinë i.e. dhe konsiderimin e një protoindoevropianishteje, që te Barić gjindet me një emërtim krejt origjinal, e që janë marrë në konsideratë në vijimësi dhe në studimet tona universitare, në veçanti kur ishin në proces kurrikula që kishin një hapësirë të posaçme për gjurmime mbi gjuhësinë ballkanike dhe atë të krahasuar, por dhe mbi gramatikën historike të shqipes.

Si një kapitull domethënës, shënues për vetë metodën e autorit dhe paraprijës trajtesash pasardhëse mbi elemente që shfaqen si huazime nga gjuhë të tjera, të shpjegueshme me marrëdhënie afërsie gjeokulturore, mbetet dhe ai me titull *Epoka latino-romane. Hipoteza gotike*, që pason në të vërtetë kreun me titull *Ndikimet e substratit paraindoevropian*.³

Evidentimi i elementit latin dhe latino-roman në shqipe nuk shihet i shkëputur nga çështje të shtrirjes së një ndikimi të tillë në pikëpamje nënsistemesh të veçanta, fakt që bën që autori të shtjellojë disa interpretime, arritje dhe mendime jo domosdoshmërisht të njëjta, si dhe të nënvizojë njëfarë gjykimi më të përfunduar mbi shkallën e depërtimit të një faktori të tillë. Në pikëpamje të kontekstit historik, shtresëzimet që kanë qenë dalluar tradicionalisht nga studiues të gjuhësisë historike dhe asaj romane, si dhe asaj ballkanike janë mëtuar të lidhen me ndarje të natyrës kronologjike që në rastin e përveçimeve që lidhen me shqipen janë shpjeguar dhe me procese të dallueshme fonetike.

Shqipja në këtë pikëpamje e dëshmon praninë e elementit latin, si dhe të atij latino-roman, aq më tepër që në lidhje me këtë të fundit ka studime të përqendruara në shfaqje të tij në tekste të dokumentuara me shkrim, ndaj elementesh që mund të gjurmohen dhe në trajta të ngjashme në glosarët më të rëndësishëm të botës italike, me përmbajtje leksikore që shpie natyrshëm në shpjegime të domosdoshme etimologjike. Çka mbetet me rëndësi në reflektimet e autorit në lidhje me praninë e latinitetit dhe romanitetit në vise të caktuara në atdheun tonë dhe në Ballkan, janë dallimet mes varieteteve që kanë të bëjnë me nëndarje që kushtëzojnë më tej dhe dallime specifike të natyrës sa gjuhësore, aq dhe territoriale dhe historike.

Terminologjia e autorit dhe në këtë kapitull reflekton një njohje të mirë të arritjeve të studiuesve që mbeten iniciues apo saktësues çështjesh qenësore në lidhje me elementin latin në gjuhën shqipe. Konsiderimi i traditës preekzistuese në lidhje me të tilla elemente në shqipen është shoqëruar me të tjera parashtresa, që janë mbështetur dhe nga shembuj konkretë, që shpjen sërish në çështje të

bazë analogjish të formës e të përbërjes fonemore të ngjashme? Sigurisht, një mëtim të tillë na e mbështesin mjaft shembuj, por dhe trajtesa që duke pasur të njëjtin objekt vëzhgimi, orientohen ndaj argumenteve të ngjashme.

³ Barić H., *Hymje në historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë, f.53-58.

shtresëzimit leksikor apo në pozicionimin e shqipes në një kryqëzim arealesh ku mund të flitet për dy shfaqje të romanitetit.⁴

Ndër argumentet kryesore që ndeshen të rimarra në këtë vepër e që cekin në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e studiuesve të historisë së gjuhës shqipe mbetet dhe ajo e marrëdhënieve të hershme me gjuhë e kultura të tjera, marrëdhënie që nuk janë parë asnjëherë në një këndvështrim thjesht kulturor, apo të evidentimit të një sërë përkimesh në zëra leksikorë apo dukuri të natyrës gramatikore. Gjuhësisë historike në veçanti i njihet dobia në rasë të parashtrimit të argumenteve që qëndrojnë në thelb të interpretimit të origjinës së një popullsie e më tej, të shkëmbimeve që koha, rrethanat i kanë mundësuar, duke u rimarrë dhe kohë më vonë, kur elemente të kulturave të mëparshme diktohen falë të dhënash që bashkojnë tipare zhvillimi në gjuhë që vijnë t'i ruajnë këto të fundit. Në lidhje me një çështje të tillë, të nënvizuar që në hyrje të punimit të sipërcituar, duhet vënë në dukje që Barić shprehet në veçanti me konsiderata për disiplina të tjera të dijes, që bashkërendojnë rezultatet me kërkimet gjuhësore, të cilat natyrshëm mund të paraqiten prioritare në rasë të hulumtimit mbi gjuhë të caktuara dhe të arealit ballkanik.

Nuk vihen më në diskutim mundësitë e ndërkëmbimeve mes popullsive tona e atyre rumune, për të cilat flitet gjerësisht në studime tematike që i kushtohen jo vetëm gjuhësisë ballkanike e asaj të krahasuar, por dhe në vëzhgimet mbi dukuri që me gjasë ose një tipologji e hershme apo predispozita që lidhen me vetë konstituimin gjenetik të gjuhëve i bëjnë të shfaqen. Por, për t'iu kthyer reflektimit në të tjera interpretime që kanë të bëjnë me atdheun e hershëm të këtyre popullsive, migrameve përherë për t'u diskutuar në varësi pikëpamjesh e hipotezash sa herë të rimarra dhe në kuadër të rindërtimit të parahistorisë së popujve të Ballkanit, duhet vlerësuar dhe vendi që zënë disiplina të tjera studimore, që ushqehen jo rrallë dhe nga të dhëna gjuhësore, nga përkime në rang zërash, trajtëformash, apo sintagmash tipike për të hulumtuar mbi kalkime apo ndërtime të ngjashme.⁵ Autori u kthehet disa herë çështjeve të ndërkëmbimeve apo ndikimeve të ndërsjella, që mbështeten nga jo pak shembuj e përfundime, që ia mundëson njohja e mirë e argumentit dhe vetë interesi specifik ndaj ndriçimit

⁴ Barić H., *po aty, botim i cituar*, f.61: Në Gadishullin Ballkanik janë zhvilluar dy gjuhë romane: romanishtja në mbrendësin e tij dhe dalmatishtja", dmth, gjuha indigjene (paraveneciane) në bregdetin lindur t'Adriatikut në qytetin Kërk, që asht rrujtë deri në fund të shekullit XIX-të, madje edhe në qytetet e Dalmacisë deri nga fundi i kohës së mesme. Romanisht kanë folë edhe në qytetet e Shqipnis së Veriut, ku Romanët e fundit përmenden në Drishtë gjithashtu kah fundi i kohës së mesme. Prandaj, vetëveti, na parashtrohet pyetja: cila është pozita e gjuhës shqiptaro-romane ndaj rumanishtes, në një anë, dhe ndaj gjuhës romane bregdetare (dalmatine) n'anën tjetër.

⁵ Këndvështrimet e gjuhëtarëve në lidhje me të tilla çështje, ndër të tjera dhe ndaj origjinës së gjuhës shqipe e prejardhjes së saj nuk kanë qenë të njëjta e një fakt i tillë lidhet si me formimin përkatës, ashtu dhe me perspektivën e shtrirjes së gjurmëve të tyre. Po kaq të ndryshme paraqiten dhe trajtesat përkatëse, në veçanti në pikëpamje metodologjike.

(për sa e ndihmojnë të dhënat gjuhësore) të fazave më të hershme, që pavarësisht terminologjisë së ndryshme në trajtesa të ndryshme, është e rëndësishme përherë në studimet mbi historinë e gjuhëve përkatëse.

Henrik Barić është paraqitur me një përpilim të ndarë në kapituj, ndër të cilët dhe ata kushtuar nënsistemeve që duhet të kenë pasur indoevropianishtja në kohë mjaft të largëta janë relativisht të shtrirë në fakte dhe të dhëna të krahasueshme. Në interesat studimore të gjurmuesve të fakteve të tilla, në veçanti të atyre që orientohen ndaj rindërtimit të institucioneve themelore në gjuhët që konsiderohen i.e., zënë vend të konsiderueshëm zërat leksikorë që kanë bërë të mundur të rindërtohen fusha të veçanta semantike, në të cilat do të gjejmë emërtime të lidhjeve farefisnore, të afërive familjare, që jo rastësisht gjinden në përbërje të përqasshme fonetike në disa prej këtyre gjuhëve.

Pyetje me vend në lidhje me shqipen, gjenezën përkatëse, karakterin i.e., tiparet që bëjnë të mundur të lindin diskutime mbi kategorizimin në gjuhët satem apo kentum, si dhe refleksë më të veçanta që janë marrë në shqyrtim nga gjuhëtarë të njohur, njohës të mirë dhe të proceseve historike në nënsistemet e shqipes janë shtruar e janë marrë në vlerësim në çdo kapitull të punimit.⁶

Pohimi mbi lashtësinë e depërtimit të elementeve nga greqishtja e vjetër në shqipe dhe duke nënvizuar si më të mundshmen rrugë të këtij procesi afërsinë gjeografike që lidhet drejtpërdrejt me hershmërinë e vendosjes së paraardhësve tanë në kufi me popullsitë antike greke përbën një prej pikave më me interes për studiuesin e historisë së gjuhës shqipe, i cili po në këtë kapitull do të rigjejë të rimarrë nga pikëpamja e autorit dhe çështjen e prejardhjes së shqipes, si një argument që për të mbetet ndër më të diskutueshmit në lidhje me karakterizimin gjenealogjik të saj.

Dhe pse trajtuar në mënyrë sintetike, kreu në të cilin trajtohen çështje të gjurmimit të një leksiku paraindoevropian në shqipe (*Ndikimet e substratit paraindoevropjan, po aty, v.i cituar, f.53 v.*), gjithnjë në lidhje me argumente që cekin vetë parahistorinë e shqiptarëve dhe të ngulimeve në atdheun e mëvonë të tyre, ofron mundësi për të analizuar dhe të tjera interpretime mbi të njëjtat probleme, të mprehta nëse kemi parasysh që në trajtesa mbi historinë e gjuhës shqipe, fonologjinë historike dhe morfologjinë historike të saj janë marrë parasysh zëra që janë supozuar dhe të kishin një prejardhje paraindoevropiane. Referimet leksikore bëjnë të mundur orientimin e studiuesve ndaj një sërë burimesh shkencore, por dhe trajtesash që evidentojnë përpjekjet për të gjetur përkime të mundshme mes gjuhësh për të cilat paqartësitë e kushtëzuara dhe nga

⁶ Një vëmendje e spikatur ndaj çështjes së vendbanimeve më të hershme, të vështira për t'u përcaktuar si për çdo popullsi të përkatësisë i.e., si dhe të ngulimeve në të cilat kanë ndodhur procese të tjera që e përfshijnë shqipen dhe karakteristikat konstitutive të saj shfaqet në kreun me titull *Atdheu i hershëm shqiptar në mbrendësin e Gadishullit Ballkanik...Kontaktet thrako-ilirjane. Ndikimet e greqishtes së vjetër. Kritika hipotezës skitjane...*, (po aty, f.46 v.)

mungesa e theksuar dokumentare kanë ngadalësuar saktësimet mbi përkatësinë gjenealogjike apo afritë e supozuara gjenetike me të tjera gjuhë, në raste të caktuara më të njohura në pikëpamje të dhënash.

Në kreun kushtuar ndikimeve latine apo latino-romane në gjuhën e kulturën e shqiptarëve do të mund të vihet re menjëherë prirja për një qëndrim objektiv ndaj vlerësimit të kësaj pranie, aq herë të përmendur dhe në studimet mbi leksikun e shqipes dhe shtresëzimin e elementeve në pikëpamje kronologjike, të interpretuar dhe në vështrim procesesh fonetike lehtësisht të gjurmueshme në raste të veçanta. Në traditën ekzistuese të gjurmimeve në fushë të gjuhësisë historike, në veçanti në ato trajtesa që në sprovë për të argumentuar lashtësinë e elementeve të caktuara të prejardhura nga greqishtja e vjetër apo nga latinishtja, janë orientuar dhe në interpretime mbi çështje të tjera pekulare të historisë së gjuhës shqipe janë dalluar veçmas ndihmesa, kontribute shkencore që me kalimin e kohës duhen parë dhe në një optikë më objektive e të shpjgueshme dhe me kontekstin në të cilin ishin formuar gjuhëtarët prej të cilëve dhe mund të jetë iniciuar vëmendja ndaj kësaj të fundit. Siç dihet, këto kontribute konsiderohen përherë në proces të trajtimit diakronik të gjurmimit të elementit latin dhe atij latino-roman në shqipen, duke u pasur parasysh dhe arritjet më të fundit, që mëtojnë të ndajnë në mënyrë objektive dhe shkallën e depërtimit të një ndikimi të tillë, të argumentuar me sundimin e gjatë romak në viset e Ballkanit dhe në kolonitë e hershme me një histori të caktuar që tashmë janë territore shqiptare. Si njohës i mirë i këtyre arritjeve, Barić jo vetëm evidenton në një vijimësi të arsyetuar pikëpamje dhe arsyeime mbi ndikimin latin në gjuhën shqipe, por kryen dhe analiza të shfaqjes së këtij të fundit në përveçime apo zëra të caktuar, që janë në të vërtetë pjesë e kuadrit leksikor të një sërë elementesh që reflektojnë kuptime të ngjashme apo të njëjta me ato gjegjëse në gjuhën latine, por dhe një sërë procesesh fonetike që janë të veçanta pikërisht në gjuhën shqipe.

Duke dashur të gjurmojmë njëfarë vijimësie në pikëpamje të argumenteve që kanë një ecuri logjike në vështrimet e autorit, do të mund të veçonim qartësisht trajtesa që duke pasur objekt vëzhgimi çështje të gjuhësisë i.e., mjaft natyrshëm mëtojnë të arrijnë në argumente që shqipen si gjuhë e një familjeje mjaft të gjerë për nga përkatësia gjenetike e përfshijnë në një mënyrë krejt të drejtpërdrejtë. Në pikëpamje metodologjike, kjo qasje, që gjen natyrshëm vijimësi në sythet pasuese të punimit, përbën një orientim mjaft origjinal, që dhe dallon ndër të tjera natyrën e vëzhgimeve me të cilat Barić pasuron introduktimin në historinë e gjuhës shqipe. Duke mos u shpëputur nga çështje themelore të teorisë mbi gjuhët i.e. dhe fazat më të hershme përherë në diskutim nga indoevropianistët e antropologët, përherë në objekt diskutimi dhe nga studiues të disiplinave të tjera, autori i përafrohet shqipes në çështje nënsistemesh, por dhe ndikimesh që përveç se paraqiten në ecuri dhe të karakterit kronologjik, bëhen të gjurmueshme dhe në

kuadër të reflektimit në to të proceseve që shqipen e kanë përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke ruajtur dhe gjurmë refleksesh në emra të përveçëm, toponime, hidronime, emërtime lokalitetesh etj.

Dhe në pikëpamje të emërtimit të disiplinave që në kohën kur jetoi, u formua dhe zhvilloi veprimtarinë e tij akademike H.Barić, ishin pjesë e një kuadri të gjerë literaturash shkencore, në këtë punim që vjen i shqipëruar arrijmë të vjelim emërtesa specifike, bashkë me sprovat më përfaqësuese që mbeten referenciale për rëndësinë e tyre dhe në ditët e sotme, qoftë dhe për të shënuar me qenësinë e tyre një shkallë arritjeje që do të paraprinte të tjera përpjekje për të hulumtuar më thellë dhe me të tjera qasje ndaj antropologjisë së studimit të botës së popullsisë i.e., për migrimet e të cilave dhe pse jo përherë me pikëpamje të njëjta, është shkruar e diskutuar gjatë, duke bërë më të pasur panoramën e klasifikimeve kryesisht në qasje gjenetike të gjuhëve në botë.

Autori ka një prirje që ndiqet dhe në krerët pasues në kuptimin e zgjerimit të qasjeve mes gjuhëve të kësaj familjeje, si kur bëhet fjalë për krahasime mes zërash që konsiderohen klasikë në dijen indoevropiane, ashtu dhe në ndjekjen e proceseve fonetike që kërkojnë para së gjithash njohjen e mjaft prej gjuhëve të kësaj familjeje.

Vëllimi i H.Barić, i thukët në dukje të parë, në të vërtetë përmban jo pak modele në pikëpamje të qasjes ndaj çështjeve që janë sa të vetë dijes mbi gjuhë e kultura të popujve i.e., aq dhe të didaktikës së disiplinave të caktuara, që dhe në nivele universitare e pasuniversitare kërkojnë një koncizitet në shtjellim dhe parashtrësë.

Tekstet që ndërmenden në pikëpamje burimesh, por dhe literaturat që në masën më të madhe u përkasin studimeve mbi gjuhësinë e krahasuar dhe atë historike janë dhe në ditët e sotme po aq referenciale në një masë të madhe studimesh, në veçanti në ato që priren t'u japin dhe dimensione antropokulturore çështjeve të gjurmimit të lëvizjeve migratore të popullsisë i.e., kontakteve mes tyre në rrethana të caktuara, por jo përherë të dokumentuara në pikëpamje historike e që shpesh supozohen në bazë të afrive gjuhësore, apo të elementeve të trashëguara të kulturës së jetesës. Në këtë vështrim, trajtesat e H.Barić janë paraprijëse të arritjeve të mëvona, qoftë dhe të studimeve më gjithëpërfshirëse që kanë bërë që të studiohen në vëllime sintetike e në pikëpamje shumëdimensionale gjuhët e vjetra i.e., ashtu dhe gjuhët për të cilat është filluar të flitet më vonë, por që kanë ndikuar në modifikimin e panoramës njohëse e studimore në lidhje me indoevropianishten dhe vijimësinë e saj, gjuhët bija që përbëjnë shfaqje të reja në një kuadër që është zgjeruar në vijimësi me faktet e reja dhe me terminologjinë që ka ardhur duke u përshtatur me të tilla risi.

Vetë shqipërimi i punimit të tij mbi historinë e gjuhës shqipe, i paraqitur si një introduktim rreth çështjesh që mëtojnë të inkuadrojnë këtë të fundit në një

suazë gjenetike që lidhet me botën i.e. e më tej me areale gjeokulturore që kanë qenë objekt ndikimesh të ndryshme e jo të papërfillshme, përbën një argument të gjerë diskutimesh, ndër të cilat terminologjia që reflekton dhe formimin specifik të studiuesve të asaj kohe mbi këto disiplina paraqitet bindëse, por dhe mjaft interesante.⁷

I përmendur dhe i vlerësuar në një sërë literaturash shkencore që kanë të bëjnë me disiplina që janë themelore dhe në programet tona universitare dhe pasuniversitare, H.Barić ka gëzuar një receptim të konsiderueshëm nëse kemi parasysh evidentimin e titujve të rëndësishëm të veprimtarisë së tij shkencore në punimet e Eqrem Çabejt, Shaban Demirajt, Idriz Ajetit, Seit Mansakut, Rexhep Ismajlit, Kolec Topallit etj. Tezat e tij mbi atdheun e hershëm dhe më tej atë historik të shqiptarëve, marrëdhëniet me popullsi ballkanike, pjesë e spektrit më të lashtë i.e., rimerren në krrerët përkatës në studimet që Shaban Demiraj u kushtoi çështjeve të historisë së gjuhës shqipe, duke renditur dhe atë të gjenezës ndër më themeloret në panoramën studimore përkatëse. Në pikëpamjet e veta mbi çështje të prejardhjes së shqipes, Barić ka vlerësuar rolin e rëndësishëm që mund të kenë dije e disiplina si arkeologjia, antropologjia, por dhe orientime të reja në fusha të gjuhësisë, emërtimi i të cilave ka përfshirë dhe këtë të fundit në studimet apo compte-rendus që janë përpiluar në dekada të përafërta me kohën kur ky i fundit ushtronte veprimtarinë e tij shkencore. Si një emër autoritar në studime që gëzonin një vëmendje të konsiderueshme në vitet '50-60, por dhe më parë, si dhe më vonë, me themelimin e bërthamave të reja kërkimore që përfshinin dhe ballkanologjinë me studimin e gjuhëve të veçanta, Barić do të rezultojë i cituar në mjaft manuale, artikuj, sprovë që u kthehen sërish çështjeve të reflektimit të tipareve i.e. në këto gjuhë, evoluimit të tyre në nënsisteme të caktuara, risive a inovacioneve që janë shfaqur në proces të profilizimit të tyre në faza të mëvona historike etj. Dëshmi e qartë e prirjes për të kontekstualizuar në të njëjtin kuadër studimor njëfarë parahistorie të indeovropianishtes, parë në vështrim të nënsistemeve, theksit, si një prej çështjeve më të diskutueshme ndër gjuhëtarët e fushës, një manual i tillë përmban të dhëna të rëndësishme që çdo traktat mbi gjuhësinë i.e. duhet të përmbajë.⁸

I krahasuar me punime që duke pasur si tematikë çështje të gjuhësisë historike dhe asaj të krahasuar e që janë përpiluar në pararojë të studimeve mbi gjuhësinë i.e., ky kontribut i H.Barić paraqet avantazhet e njohjes në pozitat e indeovropianistit dhe të ballkanologut dhe çështje themelore të hulumtimit të thelluar të gjuhës shqipe, e bërë objekt në vijimësi jo vetëm për karakteristikat

⁷ I jemi referuar në proces të përpilimit të kësaj kumtese botimit të punimit përkatës në gjuhën shqipe të H.Barić, shqipëruar nga H.Thaçi e H.Kaleshi, botuar në vitin 1955 në Prishtinë, nga shtëpia botuese Mustafa Bakija.

⁸ Shih në veçanti kreun me titull *Indoeuropeishtja zanafillëse. Atdheu i saj i lashtë. Karakteristikat e saj dialektore*, në Barić H., *Hymje në historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1955, f. 9-29.

e saj konstitutive, por dhe për ndikime të vazhdueshme në rrethana ngjarjesh historike nga gjuhë si greqishtja e vjetër, latinishtja dhe varietete të saj.

Në çdo vështrim të natyrës refleksive mbi këto studime të tij mbi historinë e gjuhës shqipes e në veçanti mbi punimin e shqipëruar të vitit 1955, do të mund të vërehet lehtësisht se dhe të dhënat mbi gjuhësinë i.e. kanë zënë një hapësirë të natyrshme dhe të konsiderueshme, po ashtu dhe rezultate që përfshijnë natyrshëm gjuhësinë ballkanike dhe gjuhët që janë objekt vëzhgimesh për dukuri apo tipare që gjejnë përkime dhe vijimësi në arealin ballkanik.

Le të theksojmë, dhe në përmbyllje të kësaj trajtëse të iniciuar nën një shtysë celebrative, që në vitet kur merrte zhvillim të mëtejshëm dija e hulumtimit mbi gjuhët i.e., por dhe mbi indoevropianistikën si konvergim disiplinash, vetëdija mbi mundësitë e qasjeve nga disa nënsisteme kanë ardhur duke u rritur, aq më tepër që dhe mbi kulturën përkatëse u përvijuan studime të thelluara që kishin qëllim jo vetëm të vinin në dukje përkime apo divergime në trajta, tipare apo veçori fonologjike e morfologjike, por dhe të hidheshin themelet e një shkence që kishte të bënte me institucionet e një bote mjaft të hershme, në shumë aspekte e pandriqur mjaftueshëm nga studiuesit e historisë, prehistorisë, antropologjisë kulturore, por dhe të gjuhësisë të krahësuar. Vitet kur Barić, por dhe studiues të tjerë të gjeneratës së tij ndërmorën studime mbi këto argumente, qoftë dhe duke i bashkërenduar në qëllimet e tyre kërkimore e didaktike, jo pak kontribute kishin parë dritën e shtypit, duke u bërë pararendëse të pikëpamjeve të reja, që assesi nuk mund të merrnin trajtë e profil pa u paraprirë nga sprova të domosdoshme në lidhje me të njëjtat fusha.

Literatura

- Barić, H. (1955). *Hymje në historinë e gjuhës shqipe*. Prishtinë: Shtëpia Botuese "Mustafa Bakija".
- Çabej, E. (1974). Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe, *Studime filologjike*, 28(2), 14–51.
- Çabej, E. (2008). *Hyrje në indoevropianistikë*, Tiranë: Botime Çabej.
- Çabej, E. (2012). *Fonetikë historike e gjuhës shqipe II*. Tiranë: Botime Çabej.
- Demiraj, Sh. (2004). *Gjuhësi ballkanike*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Demiraj, Sh. (2013). *Gjuha shqipe dhe historia e saj*. Tiranë: Onufri.
- Fanciullo, F. (2022). *Introduzione alla linguistica storica*. Bologna: Il Mulino.
- Landi, A. (1993). A proposito di alcuni latinismi in albanese. *Indogermanische Forschungen*, 98, 200–218.
- Meillet, A. (1921). *Linguistique historique et linguistique générale*. La Société de Linguistique de Paris.

- Meyer, G. (2007). *Fjalor etimologjike i gjuhës shqipe*. Tiranë: Botime Çabej.
- Milizia, P. (2022). *Le lingue indoeuropee*. Roma: Carocci editore.
- Paci, E. (2020). *Gjurmime filologjike mbi latinitetin dhe shkrimet e vjetra shqipe*. Shkodër: Botime Françeskane.
- Ramat, P., Giacaolone, R.A. (1993). *Le lingue indoeuropee*. Bologna: Il Mulino.

Evalda Paci
Academy of Albanological Studies, Tirana

ELEMENTS OF A COMPLEX ANTIQUITY IN STUDIES ON INDOEUROPEAN WORLD AND THE BALKAN ONE

Summary

Elements of a complex antiquity in studies on the indo european world and the Balkan one Comparative studies are presented as an important catalyst for encouraging the recognition of the constitutive elements of languages and civilizations, while the inflows from specific fields of scientific research constitute a distinct value and evidence of a complex formation and a period of importance for the interests regarding indo european, Balkan and comparative linguistics . The Albanian language itself and its antiquity, the features that prove its indo european character, but also features that are typical of internal evolution, have rightly become the object of observations of several disciplines. Compiled under a comprehensive structure, but also inclined to reflect concrete issues of the research of the history of a language like Albanian, the study manual itself, authored by H. Barić (Pristina, 1955), constitutes an object that arouses scientific curiosity, but also reflections on views of an approachable or more in-depth nature on elements that are evidenced in later studies, which may share the same perspective. A genuine tradition of achievements is reflected in the trials of this linguist, whose profile prompted our treatment in this scientific conference.

Keywords: history of language, comparative studies, Roman studies, Latin influence.

Genc LAPE¹

Universit  del Salento – Lecce (Itali)

PASQYR  E P RGJITHSHME E NDIKIMIT T  ITALISHTES N  GJUH N SHQIPE

Marr dh niet gjuh sore midis shqipes dhe italishtes z n  nj  vend t  r nd sish m n  historin  e zhvillimit t  gjuh s shqipe. Ato vijn  si nj  vazhdim i natyrsh m dhe organik i marr dh nies s  shqipes me latinishten dhe m  von  me varietetet romake t  folura n  Ballkan. Italishtja  sht  gjuha neolatine m  e af rt gjeografikisht me shqipen dhe fal  k tij fakti dhe rrethanave historiko-kulturore t  marr dh nieve shqiptaro-italiane nd r shekuj, ajo ka ushtruar nj  ndikim t  qen sish m n  gjuh n shqipe, e cila fillon praktikisht n  fillim t  mij vje arit t  dyt , pas afirmimit n  Gadishullin Apenin t  italishtes si nj  gjuh  e re, e dallueshme nga latinishtja.

Huazimet m  t  hershme nga italishtja n  gjuh n shqipe z n  fill rreth shekullit t  13-t , n  periudh n e sundimit t  Anzhuin ve; m  pas n  shqip hyn  nj  num r i madh huazimesh leksikore nga venecianishtja, si pasoj  e marr dh nieve intensive me Republik n e Sh n Markut. Italishtja ka ndikuar, p r arsye t  kuptueshme dhe n  m nyr  t  ndjeshme, edhe n  gjuh n e autor ve t  vjet r t  gjuh s shqipe.

Ndikimi i italishtes rritet ndjesh m n  fund t  shekullit t  19-t  dhe p rgjat  shekullit t  20-t , si rezultat i zhvillimeve t  reja dhe marr dh nieve intensive dhe peripecive t  shumta historike q  i kan  shoq ruar ato. Ky punim synon t  p rvijoj  nj  kuad r t  p rgjithsh m t  k tyre marr dh nieve duke nxjerr  n  pah  shtjet m  t  r nd sishme q  i karakterizojn  ato.

Fjal t ky e: shqipja, italishtja, gjuh t n  kontakt, gjuh sia historike, huazime leksike, nd rveprimet gjuh sore

¹ gentius@hotmail.com

1.0. Fillimet e ndikimit të italishtes mbi gjuhën shqipe

Marrëdhëniet gjuhësore të shqipes me italishten zënë një vend të rëndësishëm në historinë e zhvillimit të gjuhës shqipe. Ato vijnë si një vijim i natyrshëm dhe organik i marrëdhënieve të shqipes me latinishten dhe më pas me romanishten e folur në Ballkan. Ky ndikim është kundruar përgjithësisht si vijim i ndikimit të latinishtes, duke nënkuptuar këtu një vazhdimësi thuajse të pandërprerë, siç shfaqet edhe në thënien e Çabejt se “dallimi i italianizmave nga latinizmat është një nga çështjet themelore të historisë së gjuhës shqipe”, e cila ka fituar pothuajse vlerën e një aksiome në gjuhësinë historike shqiptare.

Italishtja është gjuha neolatine më e afërt gjeografikisht me gjuhën shqipe dhe falë këtij fakti dhe rrethanave specifike historike-kulturore përgjatë shekujve, ajo ka ushtruar një ndikim të qenësishëm mbi gjuhën shqipe, i cili zë fill praktikisht që në fillim të mijëvjeçarit të dytë, pas afirmimit në Gadishullin Apenin të të folmeve të italishtes si një gjuhë e re, e dalluar nga latinishtja. Fundi i mijëvjeçarit të 1-rë konsiderohet si “datëlindje” e italishtes, pasi në këtë kohë dëshmohej për herë të parë përdorimi i gjuhës së folur, të ashtuquajtur *volgare*, si gjuhë e mëvetësishme, e ndryshme nga latinishtja, e përdorur si gjuhë e administratës dhe e kishës.

Ndikimi i italishtes në gjuhën shqipe është kryesisht leksikor, por shfaqet edhe në fjalëformim, pikërisht në formimin e etnonimeve, të cilat janë formësuar sipas etnonimeve përkatëse të italishtes. Një aspekt i pavënë re deri më sot i këtij ndikimi përfshin edhe toponomastikën dhe toponiminë e shqipes.

Huazimi më i hershëm nga italishtja, i cili mund të identifikohet në mënyrë të padyshimtë si i tillë, është folja *ngadhënej* nga it. *guadagnare* ‘fitoj, përfitoj, kam përfitim’, e cila ka hyrë në gjuhën shqipe ndërmjet shek. XIII-XIV, në kohën e *Regnum Albaniae* (Mbretërisë së Arbërit) anzhvine. Kjo folje, e cila shfaqet tek autorët e vjetër të shqipes dhe gjithashtu tek arbëreshët e Italisë, shfaq karakteristikat fonetike të huazimeve më të lashta (latinizmave) të shqipes, si renditjen e saj në klasën e foljeve më -ej të zgjedhimit të parë, siç ndodh me një numër të konsiderueshëm foljesh të huazuara nga latinishtja (*këmbej, shërbej, fëjeje* etj.), por jo me huazime dhe formime foljore të periudhave të mëvonshme, dhe shfaqjen e një preverbi *n-*, si në foljet e fondit të trashëguar të shqipes (khs. *mbars, ndrashënj, ndreq, ngjat, ngjall, mbledh, ngarkonj, mbërthej, nxij, ngrij, nxë* etj.). Në italishte folja *guadagnare* është një huazim mesjetar që ka hyrë nga frankonishtja, gjuhë gjermanike, në kohën e ekspansionit të Frankëve rreth shekullit VIII, i cili është pak a shumë caku kohor i shfaqjes së saj në varietetet romane të folura (*volgare*) të Gadishullit Apenin². Në foljet e huazuara më vonë nga italishtja, përfshi edhe ato të shtresës së venecianizmave (p.sh. *lexoj*) nuk shfaqen këto tipare. Pra kjo analizë ka rëndësi parimore edhe për historinë e

² B. Migliorini, *Storia della lingua italiana*, Sansoni, Firenze 1978, f. 81.

gjuhës shqipe, sepse na lejon të përcaktojmë me saktësi më të madhe një kufi ndërmjet fazës së lashtë të shqipes dhe fazës së re.

Vlen të theksohet se, me aq sa jemi në gjendje të hetojmë përmes fakteve gjuhësore që njohim, kjo folje shfaqet si huazim i vetmuar nga të folmet e italishtes në periudhën paraveneciane të shqipes.

1.1. Ndikimi leksikor i venecianishtes

Ndikimi i dialektit venecian mbi gjuhën shqipe fillon pas vitit 1300 dhe vijon deri në fund të 1400-s. Ky ndikim ka qenë shumë intensiv dhe si rrjedhojë e tij kanë hyrë në gjuhën shqipe jo pak fjalë që sot janë të përdorimit të përditshëm, si *gotë*, *pirun* (me ndërmjetësimin e greqishtes), *karrige*, *lexoj*, *marangoz* (me ndërmjetësimin e turqishtes) *monedhë*, *picetë*, *rrugë* (etimologji e diskutueshme, ndoshta latinizëm i vonë), *vidë*, *xunkth*. Gjithashtu duhet përmendur edhe historizmi *bajloz* (nga *bailo* ‘ambasador’ me ndërmjetësimin e turqishtes).

Venecianizmat e toskërishtes shpesh janë ndërmjetësuar përmes greqishtes dhe turqishtes. Përmes greqishtes kanë hyrë: *ballkon* (*balcon*; khs. *balkue*, huazim i drejtpërdrejtë), *fustan* (ven. *fustagno*), *kuvertë* (*coverta*) *pirun* (venez. *piron*), *monedhë* (*moneda*)³ etj.

Përmes turqishtes ndër të tjera kanë hyrë *marangoz* (venec. *marangon*) dhe *bajloz* (*bailo*, venec. ‘i dërguar; ambasador’), figurë mitologjike në këngën e Gjergj Elez Alisë, fakt i cili tregon se marrëdhëniet ndërmjet popullsisë shqiptare dhe autoriteteve venedikase nuk kanë qenë idilike⁴.

Një venecianizëm/italianizëm i ndërmjetësuar në shqipe nga serbokroatishtja është sipas mendimit tonë *parangall*, përmes formës *parangal*, një mjet peshkimi me shumë grepa i cili pas gjasash ka hyrë në të folmet kroate të bregdetit të Dalmacisë dhe Istrias nga venec./it. *palangaro*⁵.

1.2. Ndikimi i italishtes në shqipen e vjetër

Në shqipen e vjetër, të cilën e njohim kryesisht përmes veprave të autorëve të shekujve XVI-XVII (Buzuku, Budi, Bardhi e Bogdani), italishtja ushtron një ndikim të konsiderueshëm *leksikor*. Në përdorimin e të autorëve të vjetër të shqipes regjistrohen rreth 1.500 italianizma⁶.

³ Për një përmbledhje të venecianizmave të shqipes shih Vicario, F. (1992–1993), *L'influsso lessicale veneto nell'albanese*, në *Balkan-Archiv* 17/18 (1993), f. 185-232.

⁴ Në mbështetje të këtij hamendësimi mund të sjellim një kumtim me gojë të Prof. P. Xhufit, sipas të cilit në dokumentet e arkivave venedikase dëshmohet se banorët e fshatit Ndroq, në jugperëndim të Tiranës, të lodhur nga angaritë e qeveritarit (*bailo*) venecian të Durrësit, rreth vitit 1403 (pra përpara pushtimit osman të Shqipërisë së Mesme), braktisën fshatin e tyre dhe u vendosën në Pulje, përballë Shqipërisë, ku gjurmët e tyre humbën me kalimin e kohës.

⁵ Shih: <https://hrvatski.en-academic.com/42630/parangal>

⁶ Këto italianizma gjenden të përmbledhura te K. Jorgaqi, *Ndikimi i italishtes në letërsinë e vjetër*

Ndikimi i italishtes në këtë periudhë shtrihet madje edhe në *strukturën morfologjike foljore*, siç është rasti i pësorës me *vjen*, e cila haset tek Buzuku (*ungjillë qi ën mejet vjen predikuom*) dhe Bogdani (*këjo punë vjen forcuem prej izajet*)⁷. Një perifrazë e tillë është pas gjasash një kalk i strukturës së pësorës së italishtes, të formuar nga *venire* + *paskajore*, me përdorim mjaft të dendur në italishte.

Në gjuhën e Buzukut, i cili pas të gjitha gjasave ka jetuar në territorin e Republikës së Venedikut (*Meshari* pas të gjitha gjasave është shtypur atje) dhe ka qenë dygjuhësh, hasen edhe venecianizma, të cilat nuk i gjejmë ndër venecianizmat e shqipes, por as tek autorët e vjetër të shqipes, si p.sh. *skonxuruom* ‘përgjërohem, largoj një rrezik’ nga venec. *sconzurar*, it. *scongiurare*. Ky është një tregues për faktin se Buzuku ka jetuar në një mjedis ku flitej venecianishtja, ndryshe nga autorët e vjetër të shqipes, të cilët ishin shkolluar në Itali, por nuk kishin jetuar gjatë atje. Po ashtu *porteg* ‘portik’, me ruajtjen e *g*-së së zëshme, nga venec. *portego*, it. *portico*. Por ka edhe fjalë që shfaqen në transliterim me bashkëtingëlloren qiellzore ç: *celebronj*, *çimbalë*, *çipres*, ku nuk është e mundur të përcaktohet qartë shqiptimi i tyre tek Buzuku, duke qenë se në venecianishte këto fjalë shkruhen me *c* si në italishte, por shqiptohen me afrikatën *ç* (në alfabetin e shqipes *c*)⁸.

Tek Buzuku ka mjaft italianizma e venecianizma që shfaqen si *hapax*-e, përdorime vetëm të këtij autori. Po sjellim disa shembuj:

Emra: *akuilon*, *aliment*, *austrë*, *avaricie*, *çimbalë*, *çipres*, *delicje*, *desgracje*, *ered*, *ereditat*, *ezempio*, *fior*, *fragjilitat*, *furie*, *golë*, *idol*, *irë*, *kamel*, *kamërë*, *kantuo*, *kapitulo*, *karitat*, *kastitat*, *kolpë*, *komemoracionë*, *konkë*, *maganjë*, *majshtri*, *maravejë*, *navë*, *ofic*, *ost*, *ostari*, *oste*, *pacience*, *part* ‘lindje’, *patrie*, *patroçinie*, *perikullë*, *pont* ‘pikë’ (it. *punto*), *porteg* ‘portik’, *prestë* ‘nxitim’, *respostë*, *salute*, *sasin* ‘vrasës’, *skorpion*, *superbi*, *terremot*, *torrent*, *trat*, *turibullë*, *vendetë*, *vjagj*.

Mbiemra: *bandizuom* ‘i shkretuar’, *feliçe*, *fermo*, *goloz*, *klemente*, *konfesuor*, *kuart*, *matutin*, *i sakrë*, *sinçero*, *skarlat*, *superbuom* ‘kryelartë’, *tentatuor* ‘ngasës’.

Folje: *amaistrionj*, *bandizonj*, *deliberonj*, *disputonj*, *dulonj*, *enbulonj*, *enkulponj*, *enpaçonj*, *fondonj*, *kompanjonj*, *konfidonj*, *konfortonj*, *konservonj*, *korononj*, *liberonj*, *manjifikonj*, *minaçonj*, *ornonj*, *oronj*, *prezentonj*, *prometonj*, *purgonj*, *purifikonj*, *refreskonj*, *respondonj*, *resushitonj*, *salutom*, *santifikonj*, *sepelonj*, *skonxuronj*, *skuzonj*, *spiritonj* ‘marr zemër’, *sufrenj*, *superbonj*, *temperonj*, *torkullonj* ‘trys’, *vendikonj*⁹ (Lafe, 1999: 143).

shqipe (XVI-XVII), Tiranë 2001, i cili bazohet mbi përmbledhjet leksikore të K. Ashtës mbi leksikun e autorëve të vjetër të shqipes.

⁷ Schumacher S. – Matzinger J. (2013), *Die Verben des Altalbanischen – Belegwörterbuch, Vorgeschichte und Etymologie*, Harassowitz Wiesbaden, f. 47.

⁸ Lafe, G. (1998–1999), *Der italienische Einfluß auf das Albanische. Erster Teil – Allgemeine Erörterungen*, në Ponto-Baltica 8–9, 1998–1999, f. 154-146.

⁹ Lafe, G. (1998–1999), *Vep. cit.* f. 143.

Xh. Lloshi ka njehsuar përafërsisht rreth 310 italianizma në leksikun e Buzukut. Prej tyre vetëm 90 kanë zënë vend në mënyrë të qëndrueshme në leksikun e shqipes, ndërsa 220 italianizma nuk kanë hyrë në përdorimin e shqipes, duke u konsideruar rrjedhimisht si fjalë të huaja të Buzukut (Lloshi, 2019: 19; 26).¹⁰

Shumë nga italianizmat e autorëve të vjetër të shqipes i përkasin ligjërimin letrar, por ka edhe fjalë të ligjërimin të përditshëm. Disa syresh kanë rihyrë në gjuhën shqipe në shekullin e 20-të. E tillë është p.sh. fjala diturake *oçeano* e Bogdanit ("*detit, maa të shumëtë, i thonë oceano*"), e cila tek ky autor shfaqet vetëm një herë si shpjegim koncepti, e papërshtatur morfologjikisht dhe e paintegruar në sistemin emëror të shqipes. Kjo fjalë nuk rishfaqet më në asnjë burim leksikor të mëvonshëm. Në *Dittionario italiano-albanese* të Da Lecce-s it. *oçeano* shpjegohet së pari në italishtë si *mar grande* dhe shqipërohet *deti i maadh*¹¹. Mitko¹² (e përkthen gr. *δεῦλόν* me *kërnallë*). Të njëjtën fjalë e hasim edhe tek G. Meyer¹³, të shpjeguar si 'oqean', pa të dhëna të tjera burimore dhe etimologjike (me siguri në këtë rast bëhet fjalë për një kumtim të Mitkos). Fjala e sotme *oqean*, e përshtatur nga gjuhët klasike dhe jo me prejardhje nga italishtja (siç pohohet në mënyrë të pasaktë në disa burime, përfshirë edhe Fjalorin Etimologjik të K. Topallit¹⁴), sipas të dhënave tona shfaqet në shqipen e shkruar në fillim të shekullit XX¹⁵.

2.0. Shekulli XIX

Ndikimi i italishtes rritet ndjeshëm pas gjysmës së shekullit të 19-të e përgjatë gjithë shekullit të 20-të, si rrjedhojë e zhvillimeve të reja dhe marrëdhënieve të shumanshme dhe peripecive të shumta historike që i kanë shoqëruar ato. Një zhvillim vendimtar në këtë fushë përfaqëson vendosja e *Kultusprotektorat-it* austrohungarez mbi popullsinë katolike të Shqipërisë së Veriut. Në kuadrin e tij u dërguan si klerikë nënshtetas italianë nga trevat italiane nën Perandorinë Austrohungareze. Po ashtu Shkodra, që në këtë periudhë ishte kthyer në një nga qytetet tregtare kryesore të pjesës europiane të Perandorisë Osmane, zhvillon një tregti të dendur me shumë porte dhe tregje në Austro-Hungari dhe Itali. Në rrafshin kulturor në Shkodër, kryeqendrën e Shqipërisë së Veriut vlen të shënohet ngritja e një gjimnazi jezuit më 1860 dhe e një gjimnazi françeskan më 1871.

¹⁰ Lloshi, Xh. (2019), *Ndërlikime në leksikun e Gjon Buzukut*, në "Studime filologjike 1-2, 2019, f. 19-26.

¹¹ Francesco Maria da Lecce, *Dittionario italiano-albanese* (1702), botim kritik me hyrje dhe fjalësin shqip përgatitur nga Gëzim Gurga, Shkodër 2009, f. 442.

¹² Mitko, Th.(2014) *Fjalëtore gërqisht-shqip e shqip-gërqisht* (përgatitur nga Dh. Qirjazi), Korçë.

¹³ G. Meyer, (1891) *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, Strassburg, f. 190.

¹⁴ Topalli, K. Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe, Tiranë 2017, f. 1084.

¹⁵ Mann, St. E. *A Historical Albanian-English Dictionary* 1948: 334. Si referencë e parë atje jepet Gj. Pekmezi, *Lehr- und Lesebuch des Albanesischen*, Wien und Leipzig 1912(?) dhe *Lese- und Übungsbuch der alb. Sprache*, Wien 1914 e më pas Leotti, *Dizionario Albanese-Italiano* 1937 s.v.

Si rezultat në këtë periudhë hyjnë shumë italianizma, kryesisht në të folmen e Shkodrës dhe të Shqipërisë veriperëndimore.

Në burimet leksikologjike për këtë periudhë dëshmohen ndër të tjera:

Emra: *alabastër, arkiv, banjë, baule, bilard, damë, damixhanë, datë facolet, façel, fashë, frazë, funeral, kalendar, kambial, kapar, kapedan, kapele, kapitull, kapotë, kordele, legat, metër, pagë, pandispanjë, panikotë, parukë, penë, pilot, pinjoll, pjanofort, policë, portofol, postë, propagandë, rebel, rimë, sonet, spiun, takë, teatër, tombë, tomboll, trombë, trumbetë, vapor, vasal, vermut, xhentil.*

Folje: *akaparoj, konsideroj, koston/kushton, pezulloj, shpjegoj.*

Fjalë të vjetruara dhe që nuk përdoren më: *botile, çelsomin, flashkë, fustë, garafë, gredellë, grincë, kalamitë, kandër, kanet, kason, kufet, medaje, metrajë, musull, navilj, obric, spron, stagua, stangë, tabakjerë, tabako, tabarr, tajer, telar, tërviel, tinar, trekë.*

Nga terminologjia liturgjike katolike dëshmohen mjaft terma, disa prej të cilave sot nuk përdoren më: *amit, brevial, bulë, çeremonie, diakon/xhakon, kalvar, kapelan, kapuçin, kardinal, konsakroj, koronë, mesal, pastoral, patriark, pegani, potent, predikoj, predk, prelat, purgator, ritual, sakrestan, sakresti, tonaçel, tonsurë, vikar, vjatic, xhezuit*¹⁶

Po ashtu në Fjalorin e Francesco Rossi da Montalo-s dëshmohen si italianizma fjalë të vjetruara ose që sot nuk përdoren: *alun, barabrez, brunc, çerte, çerr, çicerk, daturë, dottor, fritat, gan, gaxet, grespin, kanar, kanderie, karanten, karater, karnoval, kastigoj, kokodril, korcull, korte, latugë, leon, lënoj, liskë, mandër, marjol, mol, molan, mulinar, musaik, ndivnoj, ndisk, partikull, pënik, përmëtoj, pitur, ponent, ras, riz, ritrat, sensall, soldat, sotanë, sotolash, sparag, spendoj, sticë, shirup, shpik, shregull, tinjë, tombë, vesprë, xer, xhaniçer, xhinest*¹⁷.

Për të pasur një ide më të qartë të ndikimit të italishtes në të folmen e Shkodrës na vjen në ndihmë "Letërkëmbimi i firmës tregtare Bianku-Çoba 1877-1878", (firma tregtare, të cilat ndër të tjera zhvillonin tregti me Venecian dhe Triesten), ku krahas italianizmave të cilat kanë zënë vend në gjuhën shqipe, gjejmë edhe të tilla, të cilat nuk hasen në asnjë të folme të shqipes, nganjëherë të përdorura si sinonime të fjalëve të shqipes, p.sh. *avizoj* 'lajmoj, njoftoj'; më pas *arenohet* 'ngec në rërë', *antecipoj*, *aprofitoj*, *arrivoj* 'dal me sukses, ia dal një pune', *ballë* 'deng' (nga *bala*), *contumacia* 'karantinë, përdoret si sinonim me *karantina*), *dikjaracion*, *dimostracion* 'demonstratë', *divertohem*, *divertiment* 'zbavitje', *gjudikoj* 'gjykoj' (nga *giudicare*) etj.

Terma të sferës ekonomike tregtare (nga të cilat disa kanë hyrë në shqipen e sotme): *adebitoj*, *debitoj* 'i ngarkoj një borxh', *antecipoj* 'parapaguaj', *asikurohem*, *bankënotë*, *dikjaracion* 'nota di debito', *ezeguj* 'ekzekutoj (një vendim)' etj.

¹⁶ Lafe, G. *Vep. cit.* f. 150.

¹⁷ Po atje.

Hasen edhe fjalë-terma të italishtes, ndonjëherë të përdorura së bashku me barasvlerësit e tyre turqisht, p.sh. *doganë-gjymryk* etj.

Terma të përgjithshëm: *foj* 'gazetë' (nga *foglio*), *fuçiloi*, *impikoi*, *impjegoi* 'përdor', *indovinoj* (përdoret edhe *gjej*), *imprezar* 'sipërmarrës', *inkarikoj* 'ngarkoj një detyrë', *invencion*, *kambioj* 'këmbej'.

Shpesh këtu italianizmat hasen si fjalë të huaja të autorëve, p.sh. përdoren në të njëjtin kuptim fjala e shqipes *var* dhe italianizmi *impikoi* (*i kanë impikue*) në të njëjtin kuptim. Po ashtu haset edhe folja *fuçiloi* (nga it. *fucilare* 'pushkatoj'), në një kohë kur neologjizmi *pushkatoj* (krijuar në shek. XX sipas it. *fucilare*, fr. *fusiler*) ende nuk ishte shfaqur në gjuhën shqipe¹⁸. Në variantet e ndryshme të *Kanuneve* të Shqipërisë së Veriut hasen në këtë kuptim shprehjet *me grim*, *me ba batore* 'pushkatoj' dhe *grimje* 'pushkatim'.

Përndryshe është e vështirë të vlerësohet në tërësi ndikimi leksikor i italishtes në këtë periudhë, për shkak të mungesës së burimeve leksikore të besueshme.

Vlen të theksohet se italianizmat e kësaj periudhe mbeten të kufizuara kryesisht në gegërishten veriperëndimore dhe qendra e përhapjes së tyre është padyshim qyteti i Shkodrës.

2.1. Gjysma e parë e shekullit XX

Me fillimin e shekullit të 20-të ndryshon kryekëput tipologjia e ndikimit gjuhësor të italishtes dhe regjistrohët hyrja e një numri të madh të italianizmave në gjuhën shqipe. Më 1914-1918 shpërtheu Lufta e Parë Botërore, dhe për herë të parë pas shumë shekujsh trupa ushtarake nga bregu perëndimor i Adriatikut zbarkuan në Shqipëri. Trupat italiane qëndruan në Shqipëri deri më 1920, në zonën e Vlorës. Pas rimëkëmbjes së shtetit shqiptar, duke filluar nga viti 1925, në Shqipëri mbërritën të thirrur nga qeveria shqiptare këshilltarë, inxhinierë, punëtorë dhe personel italian për të punuar për zhvillimin dhe modernizimin e vendit. Një vend të veçantë zë këtu inxhinieria, mekanika dhe ndërtimi. Automjetet e para (për përdorim civil) dhe biçikletat në Shqipëri shfaqen praktikisht në këtë periudhë. Italishtja ndikon fuqishëm në këto fusha terminologjike, po ashtu në fushat më të përgjithshme të politikës, kulturës, ekonomisë, financave, administratës dhe ushtrisë. Shembujt nga këto fusha janë të panumërt dhe mund të arrijnë shifrën e mijëra fjalëve, të cilat janë në përdorim edhe sot. Ja disa shembuj nga fusha të ndryshme semantike¹⁹:

- Leksik administrativ: *akuzë*, *alibi*, *arrestoj*, *atentat*, *avokat*, *bllokoj*, *buletin*, *celebroj*, *çertifikatë* (te Leotti s.v. shfaqet forma *certifikatë*), *degradoj*, *dekret*,

¹⁸ Shih *passim* Luka, K. "Letërkëmbimi i firmës tregtare Bianku-Çoba 1877-1878" (përgatitur nga), Tiranë, 2000.

¹⁹ Shih Lafe, G. *Vep. cit.* f. 154-159.

delegacion, delegat, delegoj, deportoj, doganë, duplikatë, ent, falsifikoj, familje, flagrancë, flagrant, garanci, gradë, internoj, kadastër, karrierë, katast, komision, kompetencë, kompetent, konçesion, konfiskoj, kontrabandë, komunë, kooptoj, legal, legalizoj, modul, pasaportë, pension, rekuizoj, sekuestroj, statut, testament, votë.

- Ekonomi dhe financë: *bankënotë, bankier, biletë, bono, debitor, deficit, depozitë, ekonom, ekonomat, faturë, financë, importoj, inflacion, kapital, kasë, kont-korrent (Leotti s.v.), kontratë, kosto, kuitancë, liritë, magazinë, ofertë, ofroj, preventiv, saldo, skonto, spenxë, tarifë.*

- Teknikë, ndërtimtari, ndërtim rrugësh: *aerodrom, amortizoj, armaturë, asfalt, automobil, banjëmari, barakë, bateri, benzinë, binar, bitum, bronz, bronxinë, bust, çimento, dekovil, elikë, fildispanjë, filetë, filtër, flanaxhë, furçelë, graso, galeri, gomallak, gomë, granil, inxhinier, kantier, karburant, katramat, kavo, kiavetë, kompensatë, korrent, kremalierë, lubrifikoj, manivelë, maqinist, mekanik, metal, motor, motorist, ofiçinë, pedal, piketë, pilë, pompë, rafineri, rafinoj, riparoj, sifon, sirenë, sobalkë, soletë, spinë, stuko, shkallinë, tork, torno, torrë, turbinë, verandë.*

- Detari, aviacion: *kalatë, kapitaneri, mol, motoska, pikiatë, sandall, zbarkoj.*

- Automobil: *autobus, biçikletë, fren, kambio, kamerdare, kamionçinë, karburator, karroceri, manjete, piston, radiator, serbator, triçikël.*

- Sende dhe vegla: *argano, barelë, barominë, bidon, bot, brilant, brilantinë, çiklostil, çisternë, damixhanë, kabinë, kaçavidë, kaldajë, kallamar, kandër, karton, kasafortë, kaskë, koll, kordon, korniçë, kortinë, laps, listelë, listin, mastiç, mastikë, medalje, medaljon, mobilje, paketë, pastilë, pedanë, perlë, poltronë, portofol, skrivani, smeril/zmeril, sparmacetë, stekë, stufë, tabelë, tavolinë, tendë, tork, tub, valixhe, vaqetë, vazo, vangë, vaskë, ventilator.*

- Pesha: *kuintal, tonelatë.*

- Shëndetësi: *infirmier, tampon, tifo.*

- Muzikë: *fizarmonikë, kitarë, klarinetë, operë, pianist, solist, sonatë, sordinë, tastierë, violinë, violinist, violonçel.*

- Profesione: *disenjator, fokist, karpentier, minator, modist, murator, portier (formim i shqipes me -ier, sipas modelit të italishtes.*

- Ushtri: *alpinist (tek Leotti 'ushtar alpin'), artileri, bajonetë, batalion, beretë, bombë, dezertoj, dezertor, dislokoj, divizion, dragaminë, gavetë, granatë, guerril, inkursion, intendencë, intendent, invadoj, invazion, kaçator, kanonierë, kapitan, kaporal, karikator, kazermë, kolonel, komandant, komandë, kompani, koracatë, korparmatë, korrier, mareshal, milici, minë, minoj, mortajë, ofensivë, ordinancë, postblllok, postëkomandë, trupë, uniformë, xhandar, xhenio.*

- Veshje: *bluzë, borsalino, dopiopet, kapotë, kapuç, kasketë, kostum, kravatë, mantel, pantofël, peliçe, sandale, spaletë, stof, tirandë, xhakëtë.*

- Gatime: *antipastë, birrë, biskotë, çokollatë, gazozë, kaçkavall* (përmes turqishtes), *karamele, komposto, konservë, kotoletë, limonatë, majonezë, marmelatë, pastë, pastičeri, pastiço, semolin, tortë,*

- Sport: *allë, gardalinë, palestër.*

- Emra bimësh dhe kafshësh: *mimozë, pelikan, ton.*

- përdorim i përgjithshëm: *agjent, agjenci* (auch *axhent, axhenci*), *ballo, bandë, bandit, bordell, bordurë, dinamit, firmë, firmos, kanarinë, kantinë, kapriço, kartëpostale, karro, kaviļje, kininë, kinkaleri, kompresë, kontrolloj, listë, livandë, markë, merkato, minierë, muskul, orkidë, padron, pako, palaço, parullë, patentë, pirat, pishinë, pjacë, postë, preferoj, preokupoj, pretendoj, privat, rrufian, sabotoj, sallë, spikat, sportiv, stacion, stemë, studio, tavernë, torturë, turist, xhiro.*

- Thjeshtligjërim: *adio, basetë, belvedere, birbo, bravo, furbo, kaki, kapo, karambol, kartabiankë, maestro, mizerje, skopio, surrogato, vagabond, vilan.*

Gjatë periudhës së pushtimit ushtarak italian (1939-1943) kanë hyrë pas gjasave terma si *kuesturë, kuestor, karabinier*, etj., të cilat në FGJSSH 1980 janë shpjeguar si historizma, ndërsa sot janë kthyer në fjalë të përdorimit aktual. Me siguri gjatë kësaj kohe kanë hyrë edhe fjalë të tjera të leksikut ushtarak, si *autoblindë, autokolonë, brigatë, mitraljer, mitraloj, municion, pistoletë, raprezalje*, të cilat shfaqen në fjalorët e pasluftës²⁰

2.2. Huazime konvergjente nga italishtja dhe frëngjishtja në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore

Në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit të 20-të gjuhën shqipe kanë hyrë një numër i konsiderueshëm huazimesh neolatine, për të cilat nuk mund të përcaktohet saktësisht nëse janë huazime nga italishtja apo frëngjishtja (të cilat janë dy gjuhët e vetme neolatine që kanë ushtruar një ndikim të konsiderueshëm mbi gjuhën shqipe). Në këtë rast flitet edhe për huazime grafike (natyrisht të përshtatura sipas drejtshkrimit të shqipes)²¹:

- Emra: *apel, arrogancë, asistencë, aspirant, atentat, dekadencë, dekret, dimension, divergjencë, elegancë, emigracion, emigrant, episod, erudicion, esencë, farsë, fenomen, ideal, idealist, idil, ilaritet, iluminist, imunitet, individualitet, influencë, integritet, interval, klasë, kolaboracionist, koleg, kolonializëm, komisariat, komision, komplot, konferencë, konfidencë, kontrast, konvergjencë, kriter, kuriozitet, limit, mandat, manifest, mentalitet, motiv, opinion, paragraf, personalitet, prestigj, profan, profesion, profil, progres, proletariat, propagandë, raport, regres, rezistencë, senat, simpati, shovinist, timbër, tolerancë, tonalitet, vanitet, variant, version.*

²⁰ Shih Lafe, G. Vep. cit. f.151-154.

²¹ Shih: Lafe, G. Vep. cit. f. 83-88.

- Mbiemra: *agresiv, akrobatik, anormal, banal, dekorativ, delikat, elegant, emotiv, fatal, fenomenal, flagrant, frontal, global, imediat, intensiv, intim, komod, konkret, linear, lokal, makabër, mediokër, meskin, ornamental, pedant, penal, racial, radikal, rival, sentimental, servil, solid, teatral, tolerant, total, vakant, vasal, vertikal, vital, vokal*.

- Folje: *aderoj, akreditoj, alarmoj, alternoj, aplikoj, aspiroj, banalizoj, deformoj, degradoj, degjeneroj, deklamoj, dekoroj, denigroj, deportoj, destinoj, devioj, dezertoj, diskreditoj, diskriminoj, dislokoj, dominoj, dozoj, eliminoj, emancipoj, emigroj, etiketoj, evokoj, imagjinoj, implikoj, importoj, impresioj, improvizoj, informoj, insistoj, internoj, irritoj, kombinoj, kompiloj, komplikoj, komunikoj, kondicionoj, konfiskoj, konsideroj, konsolidoj, kooperoj, kooptoj, koordinoj, motivoj, predominoj, preferoj, privoj, provokoj, restauroj, revokoj, rivendikoj, sabotoj, sekuestroj*.

Deri në vitet 1930 tek huazimet neolatine shpesh ishte e dallueshme rruga e hyrjes së tyre nëpërmjet frëngjishtes, për shkak të ruajtjes së karakteristikave në shqiptim të saj, p.sh. *ambisjon, aksepto, anarshi, demisjon, desidoj, furnityrë, imparsjalitet, internasjonale, reparasjone* etj. Më pas këto forma dalin nga përdorimi, për arsye të njëtrajtësimit të terminologjisë, duke ndjekur për neolatinizmat parimet e shqiptimit të latinishtes mesjetare (sekuenca -tio-shqiptohet [-tʃjo-]), po ashtu edhe për shqiptimin e zanoreve, duke mënjanuar tiparet fonetike të frëngjishtes.

2.3. Periudha 1945-1990

Tek italianizmat që shfaqen pas vitit 1945 në burimet e ndryshme leksikore mbizotërojnë termat e leksikut dituror si edhe ato nga fusha e shkencës dhe e teknikës, ndërsa bie së tepërmi numri i fjalëve nga fushat e politikës, ekonomisë dhe administratës. Një arsye për këtë është se këto fusha leksikore të huazimeve u shteruan në periudhën e mëparshme, ndërsa arsyeja e dytë duhet kërkuar te ndryshimi i orientimit ekonomik, social dhe politik të shoqërisë shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore.

Këto italianizma shfaqen në burimet leksikore (fjalorë etj.) të botuara pas vitit 1945. Pra është krejtësisht e mundur që të kenë hyrë më parë në gjuhën shqipe; për këtë arsye kufiri kohor i vitit 1944 nuk ka vlerë absolute²².

Nga fusha e ekonomisë përmendim: *afarist, bankar, bankarotë, defiçitar, divizë, emetoj, filial, financiar, financier, financoj, fond, inventar, investoj, klient, klientelë, komercial, koncesionar, kreditor, monetar, obligacion, valutë*.

Numri i huazimeve nga italishtja bie ndjeshëm në fushat e politikës, leksikut juridik dhe administrativ. Këtu mund të përmenden: *abdikoj, abrogoj, aderoj, agresion, akreditoj, autentikoj, autorizoj, dekoroj, demarkacion, destabilizoj,*

²² Shih: Lafe, G. *Vep. cit.* f. 154-158.

deviator, disidencë, disident, divorc, emigracion, emigrant, emigroj, garant, imigracion, imigrant, irrendentist, irredentizëm, klauzolë, kompensoj, konservator, konvencion, kredencial, liberal, liçencë, mocion, organikë, peticion, plebishit, proçedoj, prokurë, protokoll, ratifikoj, regjent, regjencë, regjim, revokoj, rivendikoj, sentencë, totalitar, verbal, verifikoj.

Përkundrazi, rritet ndjeshëm numri i huazimeve nga terminologjia teknike, dhe e ndërtimit: *akumulator, altoparlant, amplifikator, antenë, batipal, betonierë, bobinë, bokull, bombol, bonifikoj, bulon, buton, çernierë, dado, disketë, frezë, galexhant, gominë, ingrananzh, gjenerator, kalibër, karbonçinë, kioskë, kompresor, kontator, kontenitor, konvertitor, kushinetë, laminë, limatriçe, lingotë, mandrino, matravidë, monitor, morsetë/morsë, motokompresor, motopompë, nastro, panel, patinoj, perforatriçe, pjalë, presë, pulexhë, pulsant, radrizator, ribatinë, rimeso, ripetitor, rondelë, saldatriçe, saraçineskë, silenciator, skorie, skrematriçe, sondë, spinë, sprucator, stabilizator, stampë, termosta, testinë, tranxhë, trapano, traversë, tubacion, valvolë, xokol.*

Po ashtu: *autoofiçinë, autopark, axhustoj, centrifugë, centroj, degustoj, dekantoni, fonderi, filaturë, gizë, ingranoj, instaloj, interferencë, izolant, izolator, izoloj, karikoj, kartoleri, katalizatoj, kolaudoj, kopisteri, lavanderi, montoj, peliçeri, piceri, pompoj, rikupero, rostiçeri, saldoj, skremoj, spruco, sprucoj, stabiliment, stakoj, stampoj, staxhionoj, tapiceri, taroj, temperoj, tension, turn, zmusoj.*

Shfaqen edhe terma të veçantë, si *premisto* dhe *presostat*, nga *premistoppa* dhe *pressostato*, vegla të makinës larëse (lavatriçes), të papërfaqësuar në fjalorët e shqipes (shkruesi i këtyre radhëve i mban mend këto terma në përdorimin gjuhësor të teknikëve, kur emërtonin pjesë të veçanta me defekte të makinës larëse gjatë riparimit të saj).

Në këtë periudhë shfaqen edhe emërtime profesionale dhe ushtruesish të tyre: *akrobat, ambulant, axhustator, degustator, dentist, doganier, edukator, fatorino, figurant, fonditor, frezator, furnitor, gomist, modelist, montator, navigator, operator, pagator, polumbar, parukier, pastiçer, revizor, saldator, spedicioner, sportelist, teknik, titullar, tornitor, xhenerik.*

Në fushën semantike të automobilit dhe lëvizjes rrugore ndikimi i italishtes është mjaft i ndjeshëm, para së gjithash në emërtimin e pjesëve të automobilit: *bjellë, friksion, indietro* (marshi për të ecur prapa), *kambio, kande, (bosht) kardani, karter, koperton, krik, mishelë, motorino, sedilje, skapamento, spond, targë, volant*. Po ashtu edhe emërtime për lloje të ndryshme automojetesh e terminologji rrugore: *autoambulancë, autobot, furgon, fuoristradë, motoçikletë, veturë, autostradë, distributor, rimorkjo, rul, semafor.*

Nga fusha e detarisë, hekurudhës dhe aviacionit: *aeropot, aviacion, aviator, batiskaf, bigë, bord, far, flotë, flotilje, fregatë, imbarkohem, lokomotivë, motobarkë, motovelier, peshkarexhë, pikiatë, radë, rimorkjator, skaf, skuadrilje, traget, tren, vagon.*

Ndërtimtari dhe punime: *argjinaturë, arkitra, armoj, bazament, digë, grataçelë, kubaturë, majolikë, navatë, parapet, paret, pasarelë, piketë, piketoj, pontil, skarpatë, sopraluçe, vetratë, vilë, vitrinë. apartament, impiant, kapanon, pusëtë, rubinet.*

Elektroshtëpiake dhe të ngjashme: *aspirator, ashensor, kalorifer, lavatriçe, skaldabanjë, telefon, televizor. Edhe frutierë, guardarobë, kondrabufe, lavaman, lavapjat, sallon, tapet.*

Kulinari: *amaretë, arançatë, bombone, kaneloni, kasatë, krem, martadell, panine, pastashutë, picë, pure, rosto, salçiçe, sallam, spageti, taljатели, tortelini, toron, vanilje. Po ashtu banket, gramaturë, konservoj, kontorno, mensë, piceri, porcion.*

Veshje: *geta, kamosh, kanotiere, kapardinë, paliçeta, papuçe, rexhipet, xhakavento.*

Muzikë: *baketë, balerinë, diskotekë, duet, fagot, flaut, flautist, kantatë, kompozitor, kontrabas, korist, libret, libretist, operetë, organo, okestral, orkestrinë, orkestroj, stonaj, trombon, vokal.*

Terminologji ushtarake: *autorepart, blindë, blindoj, detonator, fortifikoj, kadet, komisariat, koracoj, milizim, motovedetë, regiment, rifuxho, silur, skalion, torpedinierë, xhenier.*

Sport: *dribloj finte, kros, markoj, palexho, roveshatë, skedinë, stopoj. çiklist, eliminator, eliminoj, finale, finalist, garë, kampion, kampionat, korsi, pasoj, patinë, pedalaj, saltomortale, skermë, skualifikoj, stafetë, strap, tenis, tifoz, trampolinë.*

Mjekësi: *abort, abortoj, ambulancë, ambulator, arterie, dentar, dietë, drogë, ezauriment, flakon, gangrenë, garzë, impotent, infermier, kadavër, kardiak, kavernë, kavilje, konsultore, kurë, kuroj, malarik, medikament, nerv, operoj, pacient, paralizë, pincetë, por, retinë, sanitar, traumë, varicë, vazelinë, vertebër.*

Thjeshtligjërim: *barcaletë, biond, çiklamin, dopio, famoz, favorite, forca! foriserio, kapobandë, kapriçoz, komplet, konfidencë, konvaleshencë, kurioz, lisho, mafioz, menefregist, menefrego, prezantaj, prezent, puro, resto, salutoj, sforco, sforcohem, spostoj, spunto, vakancë.*

Leksik dituror: *adoleshencë, agrar, akustik, algë, artificial, asimiloj, dekadë, deklamoj, dekoracion, depresion, depresiv, derivat, determinant, devioj, difensiv, dozë, ebanit, emetoj, erozion, erudicion, erudit, fenomen, fosforeshent, gravitacional, inerci, inert, kapilar, karbon, kompas, laborator, lagunë, larvë, lavë, lente, letargji, limit, narkotik, nocion, okular, olivikulturë, opak, orbitë, poroz, rivierë, solucion, tropikal, uragan, vullkanik, xhungël.*

Të tjera: *diçiturë, intermexo, interurban, korsiv, nudo, skalpel, spacio, telekomandë.*

Kancelari, *format, formular, fotokopje, fotokopjoj, kartolinë, kartonçinë, kopertinë, kopjoj, kopjativ, portaminë, rigë.*

Seria e etnonimeve në -ez etj. Këto etnonime që përdoren për përcaktimin e etnive të huaja në shqip shfaqen në shek. e 20-të si rrjedhim i trysnisë së italishtes: *danez, eskimez, finlandez, irlandez, islandez, holandez, kanadez, libanez, nepalez, neozelandez, norvegjez, palestinez, panamez, portugez, sudanez, suedez, tajlandez, tirolez*. Sipas këtij modeli janë formuar edhe *anglez, francez, hungarez*. Po ashtu edhe *spanjoll, polak, indian, egjiptian* janë formuar sipas italishtes (dy të parat janë huazime).

2.4. Një italianizëm i shpërfillur nga leksiku i automobililit

Si italianizma duhen konsideruar edhe fjalë që sipas formës së tyre tingullore në shqipe nuk do të konsideroheshin të tilla, por shfaqen të trajtësuar shpesh sipas një gjuhe tjetër (latinishtes ose frëngjishtes). Rasti më domethënës është ai i emrit *frikcion*. Kjo fjalë, me përdorim mjaft të gjerë në veçanti pas viteve 1990, ka hyrë në gjuhën shqipe pas gjasave në gjysmën e parë të shekullit XX dhe ende nuk gjendet në fjalorët e shqipes, me përjashtim të fjalorëve dygjuhësh italisht-shqip dhe shqip-italisht të autorëve F. Leka dhe Z. Simoni²³. Gjykuar thjesht nga forma fonetike, vetëm frëngjishtja *friction* do të vinte në vështrim si burim i mundshëm i shqipes *frikcion*. Por vlerësimi i kuadrit historik na çon në një përfundim tjetër. Frëngjishtja nuk ka ushtruar ndonjë ndikim të ndjeshëm në terminologjinë e automobililit dhe të motorëve në shqipe, ndërsa dihet qartë se kjo terminologji në gjuhën shqipe ka hyrë në pjesën më të madhe nga italishtja, përmes një procesi intensiv të ndikimit leksikor, i cili ka zënë fill që nga vitet e Luftës së Parë Botërore dhe ka vijuar deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Italianët ishin ndër të parët që sollën automobilat në Shqipëri dhe që filluan ndërtimin e rrugëve automobilistike. Së bashku me automobilin hyri edhe terminologjia përkatëse e këtij sektori teknologjik deri atëherë thajse të panjohur në gjuhën shqipe. Ky proces shfaq ngjashmëri me vërshimin e termave nga anglishtja në të gjitha gjuhët e botës në sektorin terminologjik të kompjuterit dhe të financës, terma të cilat nuk përkthehen, por integrohen (ose përdoren të paintegruara) në gjuhët përkatëse. Fjala *frikcion* si emërtim i një vegje të automobilit pa dyshim ka hyrë në shqipe nga italishtja *frizione*, nëpërmjet gjuhës së folur, dhe me sa duket është rimodeluar sipas trajtës së frëngjishtes, duke qenë se një formë fonetike **fricion* sipas italishtes do të jetë perceptuar si e papërshtatshme ose e pamjaftueshme për t'u kuptuar. Mbështetja tek forma fonetike e frëngjishtes shpjegohet edhe me faktin se sekuenca fonetike *-kc-* (sipas shqiptimit të lat. mesjetare *frictio*, *-onis* 'fërkim') është e panatyrshme në gjuhën shqipe.

I njëjti arsyetim mund të bëhet edhe për fjalën *defekt*, e cila nuk kundrohet si italianizëm për shkak të pranisë së grupit bashkëtingëllor *-kt-* (i cili në italisht është shndërruar në *-tt-*). Këtu mendojmë se fjala *defekt* në shqipe ka hyrë nga italishtja, duke u formësuar sipas latinishtes *defectus*.

²³ Leka, F. – Simoni, Z. (1986), *Fjalor italisht-shqip*, Tiranë 1986, f. 479; Leka, F. – Simoni, Z. (2003), f. 185; Leka, F. – Simoni, Z. (2010), *Fjalor italisht-shqip i ndrequr e i përmirësuar*, Tiranë 2010, f. 489.

2.5. Ndikimi i italishtes në toponiminë dhe toponomastikën e shqipes

Një fakt interesant dhe i pavënë re deri më sot është edhe ndikimi që ka ushtruar italishtja në toponiminë dhe toponomastikën e shqipes. Ky ndikim është ushtruar relativisht vonë, në shekullin XX dhe për këtë arsye ka mbetur jashtë vëmendjes së studiuesve të historisë së gjuhës. Në lidhje me toponiminë mund të përmendet emri i fshatit *Kotë*, i cili bën pjesë në komunën e Selenicës, në rrethin e Vlorës, që pas të gjitha gjasave vjen nga it. *quota* 'kuotë lartësie', sipas emërimit ushtarak në italisht të vendit ku ndodhet ky fshat gjatë Luftës së Parë Botërore dhe Luftës së Vlorës, i cili shënonte kuotën e lartësisë mbi nivelin e detit. Kjo qendër banimi është themeluar relativisht vonë, pas Luftës së Parë Botërore dhe emri i saj nuk dëshmohej në dokumente më të hershme²⁴. Ndërsa në toponomastikë vlen të theksohet emri i fshatit *Bizë* në Malësinë e Shëngjergjit, në rrethin e Tiranës, emri i të cilit del në këtë formë në përdorimin e përgjithshëm, në harta, libra, media dhe në sinjalistikën rrugore²⁵, ndërsa vendësit përdorin me konsekuencë *Bixë* (nga e njëjta rrënjë vjen emri i fshatit tjetër të afërt *Bixëllë* - *Bixëllëja*)²⁶. Forma *Bizë* ka lindur pas gjasash në vitet '20-30 të shek. XX, kur u hartuan hartat e para të Shqipërisë, nga specialistë italianë, në italisht. Në italisht toponimi *Bixë*, tr. e shq. *Bixa*, tejshkruhet *Bizza*, e së këtijmi është përshtatur në shkrimin e shqipes, ku nuk njihen bashkëtingëlloret dyfishe tipike për italishten, në formën *Biza*, e interpretuar si trajtë e shquar, duke hyrë në këtë formë në të folur (vlen të theksohet që fshati ka pasur rëndësi ushtarake).

2.6.1. Aspekte fonetike të interferencës gjuhësore. Theksi

Në përgjithësi mbi italianizmat vepron rregullimi mekanik i theksit. Por ka edhe huazime të vona si: *gëndol*, *kërmerë*, *ñperë*, *ñrgano*, *téserë*, *trërpano*, ku theksi mbetet i pandryshuar²⁷ (ndërsa përshtatet në shqipen e Kosovës dhe ish-Jugosllavisë, ku hasim p.sh. shqiptimin *opërë* dhe *kamërë*). Ky është një tregues i integritetit të pjesshëm të tyre në gjuhën shqipe.

2.6.2. Riprodhimi i fonemave të italishtes në italianizmat e shqipes

Për sa i këtij aspekti nuk shënohen vështirësi dhe ndërlikime, sepse fonemat e italishtes gjejnë praktikisht gjegjëset e tyre në inventarin fonematik të shqipes. Hasen disa luhajtje në fonema të ndryshme zanore dhe bashkëtingëllore,

²⁴ Një histori e historit e emrit dhe e vendbanimit *Kotë* jepet në: <https://telegraf.al/aktualitet/si-u-internua-ne-kote-anetari-i-byrose-politike-abdyl-kellezi/>. Nuk jemi në gjendje të verifikojmë me saktësi vërtetësinë e pohimeve të këtij shkrimi.

²⁵ Nga një kërkim i shpejtë në Internet kemi konstatuar se mbizotëron forma *Bizë*, ndërsa *Bixë* shfaqet vetëm dy herë, në faqe turizmi të administruara nga vendësit.

²⁶ Shih për këta dy emërvende: Lafe, E. *Fjalor i emrave gjeografikë të Republikës së Shqipërisë*, Tiranë 2002, f. 28.

²⁷ Khs. Lafe, G. *Vep. cit.* f. 111.

që mund të konsiderohen më tepër si zhvillime organike të fonologjisë së shqipes. Bën përjashtim riprodhimi i qiellzores së lëngët [ʎ] (në të shkruar <gli>), e cila në huazimet më të vjetra (në gegërishten veriperëndimore) shfaqet si *j*: *maravejë* 'mrekulli' < *meraviglia*, *medaje* 'medalje' < *medaglia*, *metrajë* 'mitraloz' < *mitraglia*, *skoj* 'shkëmb' < *scoglio*, *tërfoj* 'tërfil' < *trifoglio*.

Në huazimet më të reja shfaqet *l* ose *lj*, pa qenë e mundur të përcaktohet një rregull e posaçme:

artileri < *artiglieria*, *biletë* < *biglietto*, *granil* < *graniglia*, *palaço* < *pagliaccio*, *palaçeta/paliçeta* < *pagliaccetto*.

artiljer < *artigliere*, *bataljon* < *battaglione*, *kavilje* 'kyç i këmbës' < *caviglia*, *medalje* < *medaglia*, *mitraljer* < *mitragliere*, *raprezalje* < *rappresaglia*, *skuadrilje* < *squadriglia*, *vanilje* < *vaniglia*²⁸.

3. Gjendja e sotme

Pas vitit 1990 ndikimi i italishtes forcohet dhe ushtrohet edhe përmes gjuhës së folur. Deri në mesin e viteve '90 italishtja ishte gjuha e parë e huaj e përdorur në Shqipëri; më pas u zëvendësua nga anglishtja, duke ndjekur prirjen globale të komunikimit. Brezi i ri i sotëm nuk e zotëron italishten në atë shkallë si brezi i 20-30-vjeçarëve në vitet 1990.

Fjalët që kanë hyrë nga italishtja pas vitit 1990, përveç disa përjashtimeve të pakta, ende nuk kanë gjetur pasqyrim në fjalorët e shqipes. Në përdorimin e përditshëm hasen shpesh emra konceptesh, të cilat kanë hyrë së voni në jetën e shqiptarëve. P.sh. fjalën *ferramenta* 'dyqan ku shiten materiale, objekte dhe vegla kryesisht metalike' e hasim sot shpesh në tabelat e këtij lloji dyqanesh në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Kjo fjalë është sjellë nga emigrantët shqiptarë në Itali, duke zëvendësuar emërtimin më të përgjithshëm *Artikuj ndërtimi*, të para viteve 1990. Fjala *lavastovilje* 'makinë enëlarëse' me sa duket po ndjek rrugën e huazimeve të tjera nga italishtja të emrave të eletroshtëpiakëve të rëndësishëm *lavatriçe* dhe *frigorifer*, të cilët shfaqen rreth viteve 1960 në përdorimin gjuhësor të shqipes, me mbërritjen nga importi të këtyre pajisjeve elektroshtëpiake, pa të cilat sot nuk mund të kuptohet jeta e përditshme shtëpiake. Në veçanti *lavatriçe* u afirmua në përdorim pavarësisht këmbënguljes së shkollës dhe institucioneve, të cilët këshillonin (dhe këshillojnë) përdorimin e neologjizmit të shqipes *makinë larëse*²⁹. Një shqyrtim më vete meriton fjala *sikuracion* 'sigurimi i makinës', nga *assicurazione*, e cila ka zënë vend në terminologji me gjithë kundërshtimet e ashpra jo vetëm të gjuhëtarëve. Arsyet për afirmimin në përdorim të kësaj fjale të huaj mund të kërkojnë në mungesën e konceptit të sigurimit të detyrueshëm

²⁸ Po atje.

²⁹ Fjala *lavatriçe* nuk gjendet në fjalorët shpjgues të shqipes (haset vetëm në F. Leka – Z. Simoni 2003), ndërsa *frigorifer* pasqyrohet rregullisht në ta.

të automjeteve përpara vitit 1991 (kur në legjislacionin shqiptar nuk parashikohej pronësia private mbi automjetet) dhe në konotacionin negativ që kishte marrë emri *sigurim* në periudhën në periudhën 1945-1990. Po ashtu fjala *karotrec* 'automjet i specializuar që përdoret për t'u ardhur në ndihmë automjeteve që kanë pësuar avari, ose për të marrë automjetet e vogla kur kanë pësuar defekt ose kur kanë parkuar gabim', ka hyrë në përdorim të qëndrueshëm në dhjetëvjeçarët e fundit, pas shfaqjes së këtij mjeti të specializuar në rrugët e Shqipërisë. Përpara kësaj kohe përdorej termi *autooficinë*, përsëri me burim nga italishtja, e pasqyruar në FGJSSH 1980, i cili i referohet një konteksti dhe fushe përdorimi të ndryshme nga ajo e sotmja.

Në fjalorët shpjegues të shqipes, të botuar pas vitit 1990, këto italianizma dhe shumë të tjera të ngjashme me to nuk janë pasqyruar. Ato mbeten ende në rrafshin e huazimeve të rastësishme (*prestiti d'occasione* ose *casuals*), në kuadrin e ndikimit të italishtes mbi shqipen pas vitit 1990 që paraqitet i shpërhapur dhe i përndarë në mijëra rryma të komunikimit global të ditëve të sotme.

Literatura

- Da Lecce, F. M. (2009). *Dittionario italiano-albanese (1702)*, botim kritik me hyrje dhe fjalësin shqip përgatitur nga Gëzim Gurga, Shkodër.
- Jorgaqi, K. (2001). *Ndikimi i italishtes në letërsinë e vjetër shqipe (XVI-XVII)*, Tiranë: TOENA.
- Lafe, E. (2002). *Fjalor i emrave gjeografikë të Republikës së Shqipërisë*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Lafe, G. (1998–1999). Der italienische Einfluß auf das Albanische. Erster Teil – Allgemeine Erörterungen. *Ponto-Baltica* 8–9, 47–172.
- Leka, F., Simoni, Z. (1986). *Fjalor italisht-shqip*. Tiranë.
- Leka, F., Simoni, Z. (2003). *Fjalor shqip-italisht*. Tiranë.
- Leka, F., Simoni, Z. (2010). *Fjalor italisht-shqip i ndrequr e i përmirësuar*. Tiranë.
- Leotti, A. (1937). *Dizionario Albanese-Italiano*. Romë.
- Luka, K. (2000). *Letërkëmbimi i firmës tregtare Bianku-Çoba 1877-1878*. Tiranë.
- Lloshi, Xh. (2019). Ndërlikime në leksikonin e Gjon Buzukut, *Studime filologjike*, LXXIII(LVII)(1-2), 19–26.
- Mann, St. E. (1948). *An historical Albanian-English Dictionary*. London - New York - Toronto.
- Meyer, G. (1891). *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*. Straßburg.
- Migliorini, B. (1978). *Storia della lingua italiana*. Firenze.
- Mitko, Th. (2014). *Fjalëtore gërqisht-shqip e shqip-gërqisht* (përgatitur nga Dh. Qirjazi). Korçë.

- Schumacher S., Matzinger J. (2013). *Die Verben des Altalbanischen – Belegwörterbuch, Vorgeschichte und Etymologie*. Harassowitz Wiesbaden.
- Topalli, K. (2017). *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Vicario, F. (1993). L'influsso lessicale veneto nell'albanese, *Balkan-Archiv*, 17/18, 185–232.

Internet

- <https://hrvatski.en-academic.com/42630/parangal>
- <https://telegraf.al/aktualitet/si-u-internua-ne-kote-anetari-i-byrose-politike-abdyl-kellezi/>

Genc Lafe
University of Salento – Lecce

THE INFLUENCE OF ITALIAN ON THE ALBANIAN LANGUAGE IN A HISTORICAL PERSPECTIVE. MAIN ISSUES

Summary

The linguistic relations between Albanian and Italian take an important place in the history of the development of the Albanian language. They come as a natural and organic continuation of the linguistic relations between Albanian and Latin and later the Roman varieties spoken in the Balkans. The Italian language is the geographically closest Neo-Latin language to the Albanian and thanks to this fact and the historical-cultural circumstances of the Albanian-Italian relationships throughout the centuries, it has exerted an inherent influence on the Albanian language, which begins practically at the beginning of the second millennium, after the affirmation in The Apennine Peninsula of the Italian language as a new one, distinct from Latin.

The earliest borrowings from spoken Italian entered the Albanian language around the 13th century, in the period of Angevin rule and the creation of Regnum Albaniae; after that a large number of lexical borrowings from Venetian entered Albanian, as a result of intense relations with the Republic of Saint Mark. Italian has influenced, for understandable reasons and in a sensitive way, even the language of the old authors of the Albanian language.

The influence of Italian increases significantly at the end of the 19th and throughout the 20th century, as a result of new developments and multiple relationships and the many historical vicissitudes that have accompanied them. This paper aims to outline a general framework of these relations by highlighting the most important issues that characterize them.

Keywords: Albanian, Italian, language contact, historical linguistics, lexical borrowing, linguistic interference

Marija HRKALović¹

Universiteti i Beogradit, Fakulteti Filologjik

 <https://orcid.org/0000-0002-7238-5099>

REKSIONI I DYFISHTË I FOLJES *NDIHMOJ* NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE

Në këtë punim duam të shqyrtojmë përdorimin e një foljeje me reksion të dyfishtë në gjuhën shqipe dhe serbe dhe dallimet kuptimore kur kjo folje përdoret me plotësinë në dhanore dhe në kallëzore. Folja e zgjedhur që do ta përdorim për ta shqyrtuar këtë fenomen është *ndihmoj* dhe ekuivalenti i saj në serbisht *pomagati*. Edhe pse te sintagmat me dhanore dhe kallëzore ekziston dallimi kuptimor, ka raste kur ai dallim është më i dukshëm, ndërsa te disa folje të tjera dallimi nuk është aq i qartë. Duam t'i zbulojmë faktorët që ndikojnë në përdorimin e plotësit në dhanore, përkatësisht në kallëzore, dhe nëse përdorimi i këtyre rasave në këto ndërtime është shkaktuar nga arsyet e njëjta në shqip dhe serbisht. Po ashtu, mendojmë se saktësimi i përdorimit të plotësve të ndryshme dhe të rasave të cilat përdoren me këtë folje, varësisht nga kuptimi, mund ta zbutë moskuptimin e reksionit të saj në praktikën pedagogjike dhe përkthimore.

Fjalët kyçe: reksioni, ndihmoj, pomagati, dhanore, kallëzore, plotësi foljor, shqip, serbisht

1. Hyrje - reksioni foljor në gramatikat e gjuhës shqipe dhe serbe

Reksioni është një kategori gramatikore për të cilën është folur mjaft në gjuhën serbe, por në gjuhën shqipe nuk gjetëm dëshmi as në gramatika as në libra shkollorë që konsultuam duke u marrë me këtë punim. Dhrimo (1965: 139) nxjerr në pah problemin e mungesës së trajtimit të reksionit në gramatikat e gjuhës shqipe, e sidomos të reksionit të foljes. Sipas Spahiut (2002) termat reksioni dhe valenca përdoren rrallë në gjuhësinë shqiptare, herë-herë përmenden në ndonjë studim, trajtesë, artikull etj., nga studiuesit shqiptarë, por nuk gjetëm gjurmë në gramatikat universitare. Disa nga punimet e fundit në këtë fushë janë këto: Sadiku Teichmann (2019) shkroi për valencën emërore; Xhaferri (2006) u mor me valencën e foljes në gjermanishte dhe në shqipe; Dhima (2002) u mor me klasifikimin e foljeve sipas valencës; Binaj-Ejupi, Sejdiu-Rugova (2022) me valencën foljore, etj.

¹ marija.hrkalovic@fil.bg.ac.rs

Spahiu (2002: 1) pohon se: “Në gjuhësinë shqiptare termi reksion është përdorur dhe përkufizuar qysh më 1966 nga S. Riza në studimin *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*.” Sipas Rizës, “reksion (lat. rectionem=qeverisje, sundim, drejtim) i një foljeje veprimi quhet raporti i vetë foljes si skaj drejtues ndaj kundrinës së saj si skaj i drejtuar” (në Dhrimo, 1965: 141; Spahiu, 2002: 1, 2). Dimë se me nocionin e reksionit u mor dhe Ali Dhrimo më 1965 në studimin *Një vështrim mbi foljet me më se një reksion në shqipen e sotme letrare*. Në këtë studim, Dhrimo (1965: 139) jep disa përkufizime të reksionit të autorëve të ndryshëm botërorë, kurse ai vetë reksionin e përkufizon kështu (Dhrimo, 1965: 140): “Reksioni i një fjale të dhënë është sundimi a drejtimi i një fjale tjetër nga fjala e dhënë.” Fjalën që sundon, Dhrimo (1965: 139, 140) e quan *fjalë sunduese* dhe shpjegon se kjo fjalë mund të jetë emër, mbiemër, parafjalë dhe folje, kurse *e sunduara* zakonisht mund të jetë një emër ose një fjalë tjetër me vlerë emri, por edhe një folje në paskajore, e madje një fjali e tërë e varur. Dhrimo, më tej, pohon se fjalët rregullisht kanë nga një reksion të vetëm, por në gjuhët indoevropiane nuk shfaqen rrallë emrat, mbiemrat, parafjalët dhe foljet me më se një reksion dhe pohon se mjaft folje të gjuhës shqipe i njohin nga dy apo tri reksione të ndryshme me domethënie leksikore pjesërisht të ndryshme (1965: 141).

Në librin *Синтакса савременога српског сезика - проста реченица* (Sintaksa e gjuhës së sotme serbe - fjalia e thjeshtë) sipas Piperit et al. (Пипер et al., 2005: 483) reksioni është një formë specifike e marrëdhënies gramatikore në të cilën hyjnë folja (ose emri, mbiemri apo ndajfolja) dhe fjalët emërore në një rasë të caktuar, ku e para, fjala kryesore apo fjala drejtuese, e sundon atë lidhje sepse e kushtëzon paraqitjen e formës së përshtatshme të fjalës tjetër emërore. Piperi et al. (2005: 537) shpjegojnë se çdo ndërtim ku folja kërkon a kushtëzon një formë të caktuar të fjalës ose shprehjes emërore me ose pa parafjalë konsiderohet sintagmë reksionale. Marrëdhëniet reksionale janë aq të zhvilluara dhe të llojllojshme në gjuhët flektive siç është serbishtja sa krijimi i një regjistri shterues me të gjitha kuptimet e foljeve me forma emërore përkatëse është gati i pamundur. E kjo punë është aq më e vështirë pasi që një folje, me pozita të ndryshme dhe forma të ndryshme semantike, mund t’i sundojë format e ndryshme të fjalëve emërore (Пипер et al., 2005: 537). Në atë marrëdhënie reksionale, fjalët kryesore (që sundojnë, sipas Dhrimos) mund të jenë edhe ndajfolje, ndonjë numëror (përmbledhës), mbiemri dhe dy fjalë emërore të ndryshme për nga forma (*mnogo ljudi / shumë njerëz, petoro dece / pesë fëmijë, slična tebi / e ngjashme me ty, kolo devojkа / valle vajzash*) (Пипер et al., 2005: 536).

Në monografinë *Глаголска рекција у савременом српском језику* (Reksioni foljor në gjuhën bashkëkohore serbe) Jeliqi (Јелић, 2020: 20, 32) pohon se reksioni i fjalëve paraqet marrëdhënie brenda sintagmës ku fjala sunduese

(folje, emri, mbiemri) kërkon fjalën emërore në formë të caktuar. Sipas tij, plotësi reksional mund të jetë sintagmë ose fjalë emërore.

Në fjalorin *Enciklopedijski rječnik lingvističkih naziva* (Fjalori enciklopedik i emërtimeve gjuhësore) (Rikard, 1969: 277), Simeon Rikardi thotë se reksioni përcaktohet në mënyra të ndryshme nga autorët e ndryshëm: “reksioni është varësia sintaksore e një fjale nga tjetra, ku një fjalë kërkon plotësin në një rasë të caktuar; përcaktimi i marrëdhënies së varësisë së një fjale nga tjetra me ndihmën e fleksionit; aftësia e një fjale që ta përcaktojë rasën e fjalës tjetër në fjali që varet prej saj; mundësia e një fjale që ta bashkojë plotësin me vete...”

Darinka Gortan-Premk në studimin *О неким питањима двојакe глаголске рекује* (Rreth disa çështjeve të reksionit foljor të dyfishtë) (Гортан-Премк, 1977: 237) shkruan se reksionin foljor e kuptojmë si pjesë të vlerës së përgjithshme foljore që kushtëzon marrëdhëniet e mundshme të drejtpërdrejta semantiko-sintaksore të fjalëve emërore të varura ndaj foljes si fjalës kryesore, sunduese në sintagmë. Sipas saj, reksioni i dyfishtë e nënkupton tiparin semantiko-sintaksor të foljes i cili ia mundëson të shfaqet me kuptim të njëjtë apo të afërm dhe në funksion të njëjtë apo të ngjashëm në dy lloje të ndryshme të sintagmave rasore, përkatësisht në ndërtime me dy forma të ndryshme rasore. Ajo dha disa shembuj të foljeve të tilla, mes tyre edhe foljet *ndihmoj* dhe *shërbej* (служити - për të cilën do të flasim me një rast tjetër) si foljet që marrin plotësin në dhanore dhe kallëzore (Гортан-Премк, 1977: 238).

Me nocionin *plotës (foljor)*, ashtu si në *Речник глагола са граматичким и лексичким допунама* (Fjalori i foljeve me plotës gramatikorë dhe leksikorë) të autoreve Petroviq dhe Dudiq (Петровић, Дудић, 1989: 1) i cili regjistron dhe ilustron me shembuj format më frekvente standarde të fjalëve emërore në funksionin e plotësit, e nënkuptojmë çdo kategori semantiko-sintaksore në formë të leksemës emërore, sintagmës apo fjalisë, realizimi i së cilës është i kushtëzuar me kuptimin e foljes.

Në këtë punim do ta shqyrtojmë reksionin e dyfishtë të foljes *ndihmoj* (pomagati) e cila, me sa duket, tregon oscilime në zgjidhjen e plotësit në gjuhën serbe, kurse në gjuhën shqipe do ta tregojmë një situatë mjaft të ndryshme nga ajo në gjuhën serbe. Në gjuhën shqipe gjetëm se rasa e parapëlqyer e përdorur si plotës i foljes *ndihmoj* është kallëzorja. Do të provojmë t’i zbulojmë faktorët që ndikojnë në përdorimin e plotësit në dhanore, përkatësisht në kallëzore, dhe nëse përdorimi i këtyre rasave në këto ndërtime është shkaktuar nga arsye të njëjta në shqip dhe serbisht.

2. Korpusi

Në punim do të prezantojmë shembujt nga gramatikat, fjalorët, punimet dhe studimet e tjera që u morën me këtë çështje dhe librat shkollorë të disa botuesve. Tërë korpusin do ta japim në fund të punimit.

3. Reksioni i foljes *ndihmoj*

Sa u përket plotësve që paraqiten me foljen *ndihmoj*, mund të gjejmë shembuj në dhanore dhe në kallëzore, sidomos në serbisht, kurse shqipja, sa vërejtëm, e kërkon kallëzoren.

Sipas fjalorit *Речник глагола са граматичким и лексичким допунама* (Fjalori i foljeve me plotës gramatikorë dhe leksikorë) (Петровић, Дудић, 1989: 77) folja *pomagati* në kuptimin e saj të parë do të thotë: t'i japësh çdo lloj ndihme dikujt; përdoret me dhanore² si në këta shembuj:

a) Dhanore: ~ **некоме** ~ (dikujt): *повређеном детету / fëmijës së plagosur; институту за физику / institutit për fizikë; учеснику квиза / pjesëmarrësit të kuizit.*

b) Dhanore + vendore ~ *у, при*³: ~ **некоме у, при нечему** ~ (dikujt në, për diçka): *ученици у решавању школских задатака / nxënës në zgjidhjen e detyrave shkollore; раднику при истовару робе / punëtorit me rastin e shkarkimit të mallit.*

Dhanore + fjali (*да + презент* (të + koha e tashme)): *Помогли су колективу да стане на своје ноге. / I ndihmuan kolektivit të ngritet në këmbë të veta; Помаже радницама да истоваре циглу. / U ndihmon punëtorëve t'i shkarkojnë tullat.*

Në kuptimin e dytë në këtë fjalor, folja *pomagati* do të thotë: të bësh diçka që ta përmirësosh gjendjen financiare të dikujt dhe përdoret me kallëzore si në shembuj:

Kallëzore: ~ **некога** ~ (dikë): *сиромашног рођака / kushëririn e varfër; земље у развоју / shtetet në zhvillim.*

Kallëzore + instrumental⁴: ~ **некога нечим** ~ (dikë me diçka): *одличног ученика стипендијом / nxënësin e shkëlqyer me bursë.*

Sipas Zečević-Krnet (Зечевић-Крнета, 2010: 60), bazuar në të dhëna nga korpusi i gjuhës së sotme serbe⁵, përdorimi i kallëzores dhe i dhanores me këtë folje është mjaft i barazuar, qoftë për të treguar domethënien e dhënies së çdo lloj ndihme, qoftë për të vërë në pah segmentin e përkrahjes materiale apo ndonjë tjetër lloj ndihme më të përhershme. Po ashtu Zečević-Krnet pohon se dhanorja gjendet më shpesh në kombinim me plotës të tjerë, sidomos në ndërtime *у, при* (në, me) + vendore, kurse kallëzoren e gjejmë në kombinim me instrumentalin kur kjo shënon anën materiale të ndihmës. (Зечевић-Крнета, 2010: 61).

² Për ta ilustruar më qartë reksionin e foljes *pomagati* në gjuhën serbe, për të gjithë shembujt nga serbishtja dhamë ekuivalente përkthimore në gjuhën shqipe duke përdorur rasta të njëjta të cilat ishin të përdorur në gjuhën serbe.

³ Ekuivalenti më i afërt llokativit (rasës vendore) serb me parafjalët *у* dhe *при* është kallëzorja me parafjalët *нë* dhe *ме* (diçka) në gjuhën shqipe.

⁴ Ekuivalenti më i afërt instrumentalit serb është kallëzorja me parafjalën *ме* në gjuhën shqipe.

⁵ МАТФ 2002: Корпус савременог српског језика

● Dh.: 17010734: *Kuzeljeviću će u radu pomagati Risto Pavić, Mirko Radulović.* (Зечевић-Крнета, 2010: 61) / *Kuzeleviqit në punë do t'i ndihmojë Risto Paviqi, Mirko Radulloviqi.*

● K.: 14203761: *Predstavnici nemačke vlade su juče naglasili da će i ubuduće Srbiju pomagati lekovima i sanitetskim materijalom, kao i da će obezbediti deo novčanih sredstava* (Зечевић-Крнета, 2010: 61) / *Përfaqësuesit e qeverisë gjermane theksuan dje se edhe në të ardhmen do ta ndihmojnë Serbinë me barna dhe material mjekësor, si edhe që do të sigurojnë një pjesë të mjeteve financiare.*

Darinka Gortan-Premk (1977: 241) shpjegon se është mjaft vështirë t'i përgjigjet në një mënyrë të përgjithshme pyetjes a kanë domethënie të njëjta në sintagma me dhanore dhe me kallëzore foljet me dy reksione, dhe konstaton se diferencimi semantik midis sintagmave me dhanore dhe kallëzore ekziston, por ai s'është as i detyrueshëm e as i përgjithshëm - te disa folje është shprehur më mirë, e te disa ky dallim është më i dobët. Një folje ku dallimi semantik, sipas saj, është shprehur qartë është pikërisht folja *pomagati*.

Gortan-Premk (1971: 42) pohon se dallimi semantik midis përdorimit të foljes *pomagati* me dhanore dhe me kallëzore vërtet ekziston. Sipas A. Beliqit (1951: 81), kjo folje me dhanore përdoret kur e kemi ndër mend qëllimin e ndihmës (*ja mu dajem, ja mu pružam, ja mu upućujem pomoć* / unë i jap, unë i ofroj, unë i drejtoj ndihmë), kurse kur përdoret me kallëzore, personi përkatës konsiderohet si objekti i ndihmës sime (*ja ga branim, čuvam, podižem, novcem, sredstvima ili čime drugim, održavam i sl.* / unë e mbroj, ruaj, rrit, me të holla, mjete apo diçka tjetër, e mbaj në këmbë etj.). Kuptime të njëjta Gortan-Premk jep edhe në punimet e veta të mëvonshme (1977: 242), duke konfirmuar se në reksion me dhanore folja *pomagati* do të thotë *davati, pružati, namenjivati pomoć nekome* / t'i japësh, t'i ofrosh, t'i caktosh ndihmë dikujt; kurse në reksion me kallëzore do të thotë *pomagati trajnije ili svestranije ili obuhvatati nekoga u potpunosti svojom pomoću* / ta ndihmosh dikë në mënyrë më të qëndrueshme ose të gjithanshme, që ta përfshish dikë plotësisht me ndihmën tënde:

● Dh.: *Лијењом Бог не помаже* (Вук, Српске народне пословице, 206, në Гортан-Премк, 1977: 242). / *Dembelit Zoti nuk i ndihmon.*

● Dh.: *Дошао сам к вама да ми помажете, ако можете* (И. Ћипико, За крухом, Нови Сад 1904, 225, në Гортан-Премк, 1977: 242). / *Erdha te ju të më ndihmoni, nëse mundeni.*

● K.: *Гладне године помагао цар народ сиромашан давајући . . . жита свакој кући* (В. Врчевић, Српске народне приповијетке, II, Дубровник 1882, 186, në Гортан-Премк, 1977: 242). / *Gjatë vitit të urisë perandori e ndihmonte popullin e varfër duke i dhënë...grurë çdo shtëpie.*

● K.: *Али није га помогло, морао је да врати паре* (Ј. Ђоновић, Хронике и путописи, Цетиње 1950, 114, në Гортан-Премк, 1977: 242). / *Por nuk e ndihmoi, U detyrua t'ia kthente të hollat.*

Kur flasim për foljen *ndihmoj* në gjuhën shqipe, situata është mjaft e ndryshme. Një prej autorëve të rrallë që u mor me reksionin e kësaj foljeje, sipas dijenisë sonë, është Ali Dhrimo, i cili iu referua kësaj çështjeje më 1965. Dhrimo (1965: 142, 143) foljet me më se një reksion i ndau në dy grupe:

A. Foljet me dy reksione, duke pohuar se foljet e këtij grupi përfshijnë numrin më të madh të foljeve plurireksionale të gjuhës shqipe, dhe

B. Foljet me tri reksione.

Foljet me dy reksione Dhrimo (1965: 143) i ndau në tri nëngrupe:

I. Folje me reksion: 1) intranzitiv dhe 2) tranzitiv të drejtë;

II. Folje me reksion: 1) intranzitiv dhe 2) tranzitiv të zhdrejtë, dhe

III. Folje me reksion: 1) tranzitiv të zhdrejtë dhe 2) tranzitiv të drejtë.

Me interes për ne është nëngrupi i tretë: foljet me reksion tranzitiv të zhdrejtë dhe tranzitiv të drejtë. Sipas Dhrimos (1965: 147), ky nëngrup përfshin foljet që në disa bashkime sintaksore kanë reksion tranzitiv të zhdrejtë e në disa të tjera reksion tranzitiv të drejtë. Dhrimo shpjegon se është vështirë të përcaktohet se cila nga këto reksione është më e përhapur, sepse për të kryer një punë të tillë do të na duhej një gjurmim statistikor mbi gjendjen e sotme, por edhe mbi zhvillimin historik të këtij fenomeni në gjuhën shqipe, në gjuhën letrare aq sa edhe nëpër dialektet e shqipes. Në këtë nëngrup, sipas tij, hyjnë foljet si: *besoj*, *ndihmoj*, *përballoj*, *kundërshtoj*, *interesoj* etj.

These restrictions were reflected in the quality of the Czechoslovak-Albanian cultural cooperation. The functioning of the Albanian seminar had great political implications for the Albanian side. Albanian diplomacy perceived the existence of Albanian studies in Prague as a prestigious matter. Even though the seminar was not officially connected with the Albanian embassy or directly with the Albanian Ministry of Education and Culture, the Albanian diplomats perceived the Seminar as their “own” institution, which needed to be supported and at the same time controlled to fulfill the task of promoting Albania according to the Hoxha’s regime interests. This approach was reinforced by the inclusion of the Albanian seminar’s functioning in annual cultural plans and by close contacts between Dhimitër Pilika and the Embassy in Prague during the 1950s. The Albanian side was therefore easily offended by any adjustments affecting the existence of Albanian Studies in Prague.²⁵

Considering the nature of the regime in Tirana and the political context of the time, the Embassy in Prague reacted to the changes at the faculty with paranoia about Yugoslav influence in the Czechoslovak Ministry of Education and among graduates of Albanian studies. At the same time, the Embassy pointed to the underestimation and undervaluation of Albanian interests by the Czechoslovak authorities. This reaction to the situation with Albanian studies at Charles University illustrates the Albanian regime’s more general approach to the need for self-representation vis-à-vis the other socialist state. The authorities in Tirana were sensitive to the question of the perception of Albania’s position within the Soviet bloc by the other socialist country. It was very important for the Hoxha regime to be perceived as an equal partner by other socialist countries in political, cultural, and social terms.

After the replacement of Dhimitër Pilika by Pavel Novák in the position of lecturer of the Albanian language in 1959, the Embassy of Albania in Prague sent a comprehensive report to Tirana criticizing the Czechoslovak side for neglecting Albanian interests and turning a blind eye to the influence of Yugoslav revisionists in the Ministry of Education and on the faculty in Prague. Albanian ambassador Siri Çarçani recalled the previous conduct of Czechoslovak students in Albania and the fact that they were allowed to finish their studies even after their deportation from Albania. Furthermore, Pavel Novák’s proposal to translate banned Albanian authors were mentioned and Siri Çarçani noticed Novák’s brief stay in Belgrade in 1957, during which, according to the ambassador, he switched sides with Yugoslavia’s enemies. What was a logical course of action for the Czechoslovak side to handle the situation with a very small scientific field became in the eyes

²⁵ AMEPJ, 1958, file 25, Analysis of the work of the Embassy in Prague in 1957 (23. 1. 1958). AMEPJ, 1959, file 123, Report from the Ministry of Foreign Affairs to the Central Committee of the Party of Labour of Albania and the Ministry of Education and Culture (31. 12. 1959).

of Tirana a manifestation of the enemy's action. The embassy in Prague explained everything as the influence of the Yugoslav revisionists and the laxity of the Czechoslovak party.²⁶

Thus, in 1959, the Albanian seminar and some of its graduates began to be regarded by Albanians as dangerous and bad elements within Czechoslovakia, disrupting Czechoslovak-Albanian cultural relations. In particular, Pavel Novák was regularly referred to directly as the enemy of Albania. The animosity between the Embassy of Albania and Pavel Novák was a characteristic element of the reports on the cultural development in Czechoslovakia and local Albanian studies. The embassy continuously labeled him as an enemy of the state.²⁷

Conclusion

We would not be far from the truth in stating that the concept of Albanian Studies and the Albanian Seminar at Charles University as a means to strengthen fraternal ties between the two allied socialist states largely failed. The inception of Albanian Studies at Charles University can be viewed as a politically motivated experiment by both communist regimes. It began with high ambitions and was bolstered by the ideological and political context of the time but ultimately faced the reality of limited interest in Albanian Studies within Czechoslovakia. The disparity in how the Albanian and Czechoslovak parties perceived the role of the Albanian Seminar further contributed to its failure. As a result, the first Czech lecturer in Albanian, along with two other graduates of the program, was labeled an enemy element by the Albanian Embassy in Prague. Given the small number of graduates, this was a significant concern for the Albanian authorities.

Moreover, the Albanian Studies program did not fully achieve its objectives from the Czechoslovak perspective either. During the 1950s, there was a notable lack of translations from Albanian, and even into the early 1960s, Czechoslovak diplomacy struggled to find a suitable interpreter for the Czechoslovak embassy in Tirana. Consequently, the Trade Representation in Tirana had to rely on the services of a current Albanian Studies student from Charles University, who was still in the midst of her studies.²⁸

²⁶ AMEPJ, 1959, file 123, Report from the Ministry of Foreign Affairs to the Central Committee of the Party of Labour of Albania and the Ministry of Education and Culture (31. 12. 1959).

²⁷ Ibid. AMEPJ, 1960, file 98, Report from the Embassy in Prague to the MFA and the Committee on Cultural Relations with Foreign Countries (15. 3. 1960). AMEPJ, 1960, file 42, Analysis of the work of the Embassy in Prague during 1959 (20. 3. 1960). AMEPJ, 1962, file 100, Telegram from the Embassy in Prague to the MFA (13. 4. 1962); Report of the Embassy in Prague to the MFA about albanologist Pavel Novák (4. 6. 1962).

²⁸ AMZV, TO-O 1960-64, k. 1, file 10, record of the meeting of the diplomatic staff of the Embassy in Tirana (17. 11. 1962). AMZV, fond Consultations of the advisory body to the Minister for Foreign Affairs, book 82 (25. 4. 1963). Interview conducted by the author with the contemporary witness M. Škardová (12. 11. 2021).

Even before the peak of the Soviet-Albanian split in 1961, which exacerbated the deterioration of relations between Tirana and Prague, there were notable issues in the implementation of mutual cultural exchanges. These problems, though distinct in scope and nature from those that led to the suppression of Czechoslovak-Albanian relations post-1961, were entirely separate from the propagandistic slogans about strengthening fraternal ties and cordial socialist relations. The reality of interactions between these two peripheral states within the Soviet bloc was thus more complex than mere adherence to ideological mandates.

From a short-term perspective, the challenges faced in the official relations between Czechoslovakia and Albania, and Czechoslovakia's policy towards Albania, were not insignificant. However, there is another perspective that reveals a more positive outcome.

In terms of the discipline itself, the contributions of Dhimitër Pilika, Václav Polák, and Pavel Novák have left a lasting legacy. Their work established a foundation for Czech albanology that continues to be valuable today. The Faculty of Arts at Charles University in Prague boasts a notable collection of albanological materials, including many books from Pavel Novák's estate. Additionally, one of the graduates from the early Czechoslovak Albanian Studies program, Hana Tomková, has become a leading Czech translator from Albanian.

Thus, despite its brief existence, the Albanian Studies program of the 1950s had a significant long-term impact, contributing to the development of Czech albanology and fostering a lasting appreciation for Albanian culture and language in the Czech Republic.

References

Archival Sources

Archive of Charles University (AUK), Faculty of Arts/Faculty of Philology, personnel files

Archive of the Ministry of Foreign Affairs of the Czech Republic (AMZV), Political Reports 1918-1975, Emb. Tirana 1958-1962

Archive of the Ministry of Foreign Affairs of the Czech Republic (AMZV), Territorial departments - common (TO-O) 1945-1959, 1960-1964

Archive of the Ministry of Foreign Affairs of the Czech Republic (AMZV), Territorial departments - secret (TO-T) 1955-1959, 1960-1964

Diplomatic-historical archive of the Ministry for Europe and Foreign Affairs of Albania (AMEPJ), inventory of 1952 - 1961²⁹

National Archive of the Czech Republic (NAČR), Central Committee of the Communist Party of Czechoslovakia - International Department

National Archive of the Czech Republic (NAČR), Central Committee of the Communist Party of Czechoslovakia – Antonín Novotný, Part II

Security Services Archive (ABS), Counterintelligence Operational Agenda

Security Services Archive (ABS), Secretariat of the Federal Ministry of the Interior
Published Archival Sources:

Joura, L. (1953). Činnost albánského semináře na Filologické fakultě Karlovy Univerzity. In: *Časopis pro moderní filologii, ČSAV*, 2, 122–250.

List of lectures at the Faculty of Arts 1950/51, Prague, 1950.

List of lectures at the Faculty of Philology in the academic year 1953/54, Prague 1953.

Literatura

Surovčák, M. (2013). Jan Urban Jarník (1848–1923): zakladatel české albanistiky. In: *Porta Balkanica*. 2013, no. 2/5, (9–17). Online: <https://digilib.phil.muni.cz/cs/handle/11222.digilib/135373> (29.03.2023)

Surovčák, M. (2013). *Základy albanistiky*. Brno: Masarykova univerzita.

²⁹ All archival material that has been made available for consultation at the Diplomatic and Historical Archives of the Albanian Ministry for Europe and Foreign Affairs is declassified pursuant to the relevant law of the Republic of Albania.

Matěj Křepinský

Universiteti Charles, Fakulteti i Arteve, Instituti i Historisë Botërore

STUDIMET SHQIPTARE NË UNIVERSITETIN CHARLES NË PRAGË SI PJESE E MARRËDHËNIEVE KULTURORE ÇEKOSLLOVAKE-SHQIPTARE GJATË VITEVE 1950

Rezyme

Nga fundi i viteve 1940 dhe fillimi i viteve 1950 u krijua një program i ri i studimeve albanologjike në Fakultetin filozofik të Universitetit të Karlit në Pragë. Ky program u themelua kryesisht nga nevojat politike dhe ideologjike të asaj kohe. Çekosllovakia dhe Shqipëria ishin pjesë e bllokut sovjetik, dhe mësimdhënia e gjuhës shqipe simbolizonte zgjerimin e marrëdhënieve kulturore me aleatin socialist. Zbatimi i marrëveshjeve dypalëshe kulturore gjithashtu kërkonte ardhjen e një grupi albanologësh. Për Shqipërinë, krijimi i programit të albanologjisë në Universitetin e Karlit ishte një çështje prestigji, që reflektonte rëndësinë e gjuhës, letërsisë dhe historisë së saj në arenën ndërkombëtare. Gjatë viteve 1950 u krijua një bashkëpunim i ngushtë mes Dhimitër Pilikës, pedagogut të gjuhës shqipe, dhe ambasadës shqiptare në Pragë. Megjithatë, duke nisur nga mesi i viteve 1950, dolën disa probleme. Një mungesë e dukshme e interesit të studentëve për studimet albanologjike çoi në përpjekjet e palës çekosllovake për të kufizuar programin, pasi nevoja e menjëhershme në këtë fushë ishte plotësuar. Kjo u perceptua/u konsiderua nga diplomacia shqiptare si një shenjë e nënvlerësimit të rëndësisë së Shqipërisë si aleat socialist nga autoritetet çekosllovake. Në raportet e saj ambasada shqiptare theksonte se burimi i problemit ndodhej në mospëlqimin e palës çekosllovake duke paralajmëruar për ndikimin armiqësor nga ana jugosllave. Kështu, edhe para krizës së marrëdhënieve sovjeta-shqiptare, programi i studimeve albanologjike në Pragë kishte shkaktuar tensione në kontaktet kulturore midis dy shteteve të Bllokut Lindor.

Fjalët kyçe: Albanologjia, Universiteti i Karlit, Çekosllovakia, Shqipëria, Marrëdhëniet kulturore, Këmbim socialist, vitet 1950

Mimoza PRIKU¹

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Fakulteti i Shkencave Shoqërore

Departamenti i Gjuhësisë

 <https://orcid.org/0000-0002-9574-3063>

ARHIV ZA ARBANSKU STARINU, JEZIK I ETNOLOGIJU -TRIBUNË E PROMOVIMIT TË ALBANOLOGJISË

Ballkanologjia në përgjithësi e albanologjia si pjesë e këtyre studimeve kanë tërhequr vëmendjen e linguistëve të njohur, të cilët rezultatet e punës së tyre i kanë publikuar në organe të rëndësishme. Një prej tyre është edhe revista *Arhiv za arbansku starinu, jezik i etnologiju* e themeluar nga albanologu H. Barić (1888-1957) një studiues i njohur për kontributet e tij në botën albanologjike. Ky Arkiv për vite me radhë (1923-1928) u bë tribunë e ballkanologjisë dhe e studimeve albanologjike. Në faqet e kësaj periodiku kanë botuar emra të njohur të gjuhësisë, por edhe studiues të cilët falë kësaj reviste jo vetëm që u afirmuan edhe si albanologë, por që me aftësitë e tyre dijen albanologjike e ngritën në një dimension të ri. Të bien në sy edhe punimet e glotologut dhe albanistit italian Carlo Tagliavini (1903-1982), të cilat do të jenë edhe objekt i punës sonë. Studimet e këtij lingusti nisin me disa përjasje e ndikime mes shqipes e rumanishte, për të vijuar me analizimin e kontributeve albanologjike në revistën *Dacoromania* (organ i Universitetit të Cluj-it, Museului Limbei Române), kontribut i botuar në zërin “Kritika” që çel edhe një historik të bibliografisë të arsyetuar si interes me rëndësi i albanologut italian. Në punim do të trajtohen edhe punime që kanë si objekt probleme të etimologjisë shqipe. Gjithashtu do të tregojmë rolin e kësaj reviste në studimet albanologjike dhe jehonën që ka ende sot ky organ. Në fund do të bëhen disa propozime në lidhje me vazhdimsinë e kësaj reviste.

Fjalët kyçe: Ballkanologji, Arkiv albanologjik, etimologji

Studimet gjuhësore kontrastive në arealin ballkanik janë bërë objekt i hulumtimeve të filologëve të ndryshëm, kohë më parë se K. Sandfeld ta zyrtarizonte ballkanologjinë si një disiplinë me objekt më vete studimi (1926), të cilën N. S.

¹ mimoza.priku@unishk.edu.al

Trubeckoi më pas e pati pagëzuar si *Balkan Sprachbund*. Sigurisht ky territor ka zgjuar vëmendjen e interesin në plan multidisiplinor, por ne do të na interesojë në këtë rast vetëm qasja linguistike. Sipas gjuhëtarit amerikan Joseph D. Brian: “*The Balkans, as this area is generally known, is the most thoroughly studied contact area in the world, and thus occupies a special place in contact linguistics as one of the most important regions for understanding the mechanisms and results of language contact*” (Joseph D. Brian, 2010: 618). Në studimet ballkanistike shqipja është parë e trajtuar si një nyjë lidhëse e për këtë arsye ka qenë vazhdimisht në fokusin e ballkanologëve.

Përveç studimeve lingusitike të përfshira në manuale të veçanta, një ndihmesë me vlerë në këtë drejtim kanë dhënë sidomos organet që qarkulluan në gjatë shek. XX, një pjesë e të cilave e patën gjenezën e tyre pikërisht në Ballkan. Një prej këtyre revistave është edhe *Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju* e themeluar nga albanologu i njohur kroat Henrik Barić (1888-1957). Ky nuk qe i vetmi organ me natyrë ballkanologjike, sepse “në pjesën e dytë të shekullit XX u themeluan revista të ndryshme për studimet ballkanike, gjuhësore, kulturore, historike, etnologjike si *Zeitschrift für Balkanologie, Linguistique balkanique, Südost Forschungen, Revue des études sud-est-européennes*, etj., u zhvilluan qendra hulumtimi dhe bërthama studimi në vende të ndryshme, si p. sh. në München, në Berlin, në Vjenë, në Napoli, në Amsterdam, në Chicago, në Varshavë, në Poznanj, në Sankt Peterburg, në Bukuresht, në Sofje, në Beograd, në Selanik, etj. U themelua Asociacioni i Studimeve të Europës Juglindore, që u bë bartës i organizimit të kongreseve ndërkombëtare përkrye 4 vjetësh duke filluar nga viti 1966, u ndërmorën projekte të ndryshme gjithandej.” (R. Ismajli, 2015: 19).

Në revistën *Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju* gjatë kohës që ajo qarkulloi dhanë kontributin e tyre personalitete të njohura nga fusha e gjuhësisë, si H. Barić, P. Skok, W. Meyer-Lübke, Milan Sufflay, K. Treimer, E. Nahtigal etj. Por të binë në sy edhe kontributet e lingustëve të njohur italianë, të cilët i janë përkushtuar çështjeve të ballkanologjisë, si Alfredo Trombeti (1866-1929) e Carlo Tagliavini (1903-1982)². A. Trombeti botoi në faqet e kësaj reviste një studim të gjatë dhe mjaft interesant për onomastikën mesdhetare (“*Saggio di antica onomastica mediterranea*”, 1926, 1-2, f. 1-116).

Në numra të ndryshëm të kësaj reviste janë shtjelluar përkimet e shqipes me rumanishten, lidhjet e shqipes me ilirishten, pellazgjishten, sllavishten etj., por me interes janë edhe zërat e kritikës apo recensionet për botimet e reja me kah ballkanologjik, rubrikë ku bie në sy ndjeshëm kontributi i H. Barić-it, por në disa raste edhe ajo e Carlo Tagliavinit. Të dy këto studiues i lidhin disa drejtime kërkimore të përbashkëta, si studimi i rumanishes, bashkëpërkimet e saj me shqipen dhe në veçanti *albanistika*. Barić-i dhe Tagliavini e kanë ndjekur punën e

² Më gjerësisht shih: Priku, M. (2011). *Carlo Tagliavini dhe studimet albanologjike rreth shqipes*. Shkodër: Camaj-Pipa.

njëri-tjetrit në këto fusha dhe e kanë vlerësuar atë. Në një prej rubrikave të *Arkivit* vetë H. Barić-i (H. Barić, 1926: 304) tërheq vëmendjen e lexuesit për një botim me interes të gjuhëtarit të ri italian. Bëhet fjalë për manualin *Grammatica della lingua rumena*, një gramatikë voluminoze, me rreth 410 faqe e botuar nga Carlo Tagliavini në vitin 1923, të cilën Barić-i e vlerëson shumë.

Publikimi i revistës *Arhiv za arbansku starinu, jezik i etnologiju* nuk kaloi në heshje, po ajo u bë pjesë e manualeve të ndryshme që përshkruajnë historinë e zhvillimit të albanologjisë. Në lidhje me këtë organ studiuesi arbëresh G. Petrotta shkruan: “Fra le riviste scientifiche che si sono occupate di studi albanesi si deve annoverare quella di Belgrado diretta dal prof. H. Barić di quella Università: *Archiv za urbânasku starinu, jezik i etnologijn*, 1923 [...]. Collaboratori per la filologia e l’etnologia albanese sono stati oltre il Barić stesso, H. Pedersen, Skok, N. Jokl e altri”³. Siç e cekëm më lart qëllimi i këtij kumtimi është të përqendrohem tek linguistika dhe në disa prurje të albanologut dhe linguitit të njohur Carlo Tagliavini në revistën *Arkiv...* Kontributi i parë në këtë revistë i gjuhëtarit italian mban titullin “L’arumeno râmân, rrâmân č influenzato dall’albanese rîmînj”⁴ dhe ka marrë shkas nga një artikull⁵ i gjuhëtarit rumun Theodor Capidan (1979-1953), profesor i njohur i universitetit të Cluj-it. Ai emrin e Arumunëve e lidhte me format *armân* apo edhe *arumân* e *rumân* duke e interpretuar atë që si influks nga shqipja. Sipas Capitan-it “In afară de aceste trei: Armân-Arumân-Rumân, se mai aude și forma *Râmân* sau *Rră-nân*. Aceasta se întrebuintează aproape exclusiv la tulpina de Aromâni cunoscută sub numele de Fărșeroși și, în special, la Românii din Albania, Ea poate reprezenta sau un singular românesc refăcut după pluralul albanez *rîmînj* de la *rîmîr*, derivat regulat din lat. *Romanus*, cu trecerea lui n intervocalic în r și cu însemnarea de «Valache, Hirt, Bauer» (cf. G. Meyer. EWA. 365), sau, și mai sigur, forma mai veche Rumân, supt influența formelor albanezești. Și ea se întâlnește în literatura populară” (Th. Capidan, 1926: 93).

Që në fillim të parashtrimit të tezave të gjuhëtarit rumun, Tagliavini është i mendimit se “*la cosa debba essere speigata diversamente*” (C. Tagliavini, 1926a: 207) duke lënë të kuptohet për një këndëvshtrim tjetër të barazimeve të bëra nga Capidan. Duke e zgjeruar edhe më tej panoramën e përgjithshme të të folmeve ku mund të evindentohen format e lartpërmendura Tagliavini shënon: “*La forma râmân non č limitata solo ai parlari macedo-rumeni ciu accena il Capidan, ma si trova anche in alcuni dialetti daco-rumeni*” (C. Tagliavini, 1926a: 207). Ndërsa në lidhje me ndikimin mbi zanoren *ă* tek *râmân*, Tagliavinit është i mendimit se duhet

³ Petrotta, G. ([1931] 2003). *Popolo, lingua e letteratura albanese*. Palermo: Saggio Monografico, tip. Pontificia, pp. 421.

⁴ Tagliavini, C. (1926a). “L’arumeno râmân, rrâmân è influenzato dall’albanese remenj”?, *Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju*, III (1-2). Beograd, pp. 206-208.

⁵ Capidan, Th. (1924). Românii din Peninsula Balcanică. *Anuarul Institutului de Istorie Natională*, II (1923). Universitatea din Cluj. București: Cartea Românească S. A., pp. 92-118.

kërkuar nga një ndim i përbashkët i dy bashkëtingëlloreve, *r-* që e paraprin dhe *-m* që e ndjek pas këtë zanore (C. Tagliavini, 1926a: 208), një ndërrim ky zanor jo fort i shpeshtë, por i mundur sipas tij. Prandaj ai konkludon: “mi sembra quindi superfluo ricorrere all’ influsso albanese per spiegare l’ *ă* di *rămân* soccorrendo benissimo in questo caso la fonetica rumena” (C. Tagliavini, 1926a: 208).

Edhe kontributi i parë i drejtpërdrejtë i gjuhëtarit C. Tagliavini për gjuhën shqipe është është botuar pikërisht në organin *Arhiv za arbansku starinu, jezik i etnologiju* dhe është një recension për punimet me karakter albanologjik në revistën *Dacoromania*. Me shkrimin “Gli studi albanesi nella *Dacoromania*”⁶ gjuhëtari italian hyri në fushën e albanistikës drejtpërsëdrejti dhe këtë e pohon ai vetë kur shënon se “si occuperemo di proposito solo di quanto riguarda direttamente il campo linguistico albanese” (C. Tagliavini, 1926b: 250). Revista *Dacoromania* nisi të botohej për herë të parë në vitin 1920-1921, nën drejtimin e gjuhëtarit Sextil Pușcariu-t (1877-1948) dhe ishte një organ i Universitetit të Cluj-it (Museului Limbei Române), i cili luajti një rol të rëndësishëm si për diskutimin, ashtu edhe zgjidhjen e shumë problemeve që lidheshin jo vetëm me rumanishten, por edhe me gjuhë të tjera ballkanike. Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe mjaft çështje që kishin të bënin tërthorazi ose drejtpërdrejtë me shqipen dhe sidomos për lidhjet e saj me rumanishten. Kjo revistë vazhdoi të botohet për shumë vite me radhë, deri më 1948, vit në të cilin ndahet nga jeta themeluesi i saj. Ajo pati interesin e gjuhëtarëve që në vitet e para që qarkulloi e nuk i shpëtoi vëmendjes së Norbert Jokl-it⁷ dhe as Bariç-it, i cili në faqet e *Arkivit* botoi disa informacione në lidhje me të. Që nga viti 1994 ka nisur të qarkullojë seria e re e kësaj reviste duke na treguar edhe jehonën që pati seria e parë në rrethin e lingistikëve dhe ballkanologëve.

Recensioni i Tagliavinit “Gli studi albanesi nella *Dacoromania*” përkon me 5- vjetorin e botimit të kësaj reviste, e cila sipas gjuhëtarit italian “*ka zhvilluar [...] një aktivitet me të vërtetë të jashtëzakonshëm dhe të merituar*” (C. Tagliavini, 1926b: 250). Një meritë e padiskutueshme e Tagliavinit në këtë artikull nuk lidhet vetëm me faktin se ai i kushtoi vëmendje dhe bëri të njohura çështjet e diskutuara edhe për gjuhën shqipe, por ajo që të bi në sy është metodologjia sistematike e punës së tij, serioziteti dhe shqyrtime të goditura në lidhje me shqipen. Interesimi për shqipen nga ana e gjuhëtarit italian në këtë revistë vihet re në rubrikat: “Studi”, “Etimologie e note leksikografike”, “Brevi articoli” dhe “Recensioni”. Në rubrikën “Studi” Tagliavini ndalet në punimet që lidhen me onomastikën, ku janë diskutuar edhe lidhjet e shqipes me rumanishten. Shquhet kontributi i Nicolae

⁶ Tagliavini, C. (1926b). Gli studi albanesi nella “Dacoromania”, *Arhiv za Arbansku Starinu, Jezik i Etnologiju*, III (1-2). Beograd, pp. 249-258.

⁷ Jokl, N. (1912): Beiträge zur albanesischen Grammatik. *Indogermanische Forschungen* vol. 30, no. 1, pp. 192-210.

Drăganu-t⁸ ku janë trajtuar tre toponime rumune: *Tămpă*, *Chicera* dhe *Bârsa*. Për toponimin *Tămpă* të rumanishtes, i cili zakonisht shënon majat e larta të maleve, Tagliavini i jep të drejtë autorit i cili tërhiqet nga një burim prej shqipes *timp*, *timbi*, meqenëse “questa é forma solo calabro-albo proviene dai dialetti dell’ Italia meridionale” (C. Tagliavini, 1926b: 250). Toponimin tjetër rumun të përhapur në emrat e maleve a përrenjve *Chicera*, Drăganu e lidh sërish me shq. *k’ikl’l’í*, por për Tagliavinin kjo bazë është e dyshimtë. Edhe në studimet e sotme vetë zëri *kikël* i shqipes mbetet për t’u diskutuar. Gjuhëtari K. Topalli bën këtë interpretim për burimin e kësaj lekseme:

“**KÍKĚ**₁ f. “maja e mprehtë e një mali, maja e gjilpërës ose e një sendi tjetër, kulm”, “kalli-ri i grurit, i thekrës etj.”. Fjalë me përhapje krahinore në të dy dialektet (Hahn, Kavalioti, Gazulli, Rrota), për burimin e së cilës nuk ka-në dhënë rezultat përpjekjet për ta nxjerrë me origjinë indoeuropiane (Jokl, Vasmer, Çabej). Mund të jetë krijim i brendshëm me burim onomatopeik për një gjë me majë kur e prekim, njëlloj si *cik* e *çik*. Rrjedhoja: *kikël* e *ki-këz*, të dyja me prapashitesa zvogëluese, duke marrë e dyta kuptimet “gilcë, qafa e shtambës, fikthi i burrave”; *kikërr* “majë e zhveshur” (geg. VL, Kosovë), *kikthi* “lart, me krenari” (Fier).” (K. Topalli, 2017: 765).

Në vitin e dytë të botimit në po këtë sesion Tagliavini përmend një punim shumë të rëndësishëm të Capidan-it në lidhje me marrëdhëniet e shqipes me rumanishten, të cilit gjuhëtari italian i kushton një vëmendje të veçantë. Marrëdhëniet shqiptaro-rumune Capidan-i i ka parë në dy periudha dhe në secilën prej tyre ka interpretuar disa veçori leksikore dhe gramatikore të ngjashme për të dyja gjuhët. Tagliavini ka përmbledhur konkluzionet në të cilat ka arritur autori, që ai i konsideron si shumë të rëndësishme për albanologjinë. Sipas Capidan-it, shqiptarët dhe rumunët në periudhën romane kanë qenë në kontakt me njëri-tjetrin dhe kanë pasur një ndikim në leksik nga fondi indigjen i përbashkët. Ai ka dhënë edhe një numër fjalësh të cilat kanë hyrë nga rumanishtja në gjuhën shqipe dhe anasjelltas. Për Tagliavinin “*pjesa më e re, më interesante dhe më e pasur*” (C. Tagliavini, 1926b: 254) është ajo në të cilën Capidan-i prezanton disa fjalë arumune me origjinë shqiptare, si shq. *gëlbaza* në arom. *gălbază*, “sëmundja e mëlçisë te delet” etj. Tagliavini ka tërhequr vëmendjen se “Capidan-i nuk kufizohet për të treguar etimonin shqiptar, dhe zgjidh kënaqshëm në disa raste, probleme etimologjike të shqipes, duke u prezantuar si i mirëinformuar rreth rezultateve gjuhësore të fundit” (C. Tagliavini, 1926b: 254).

⁸ Drăganu, N. (1921). Din vechea noastră toponimie. *Dacoromania*, I (1920-1921). Buletinul Muzeului Limbe i Române. Cluj: Editura Institutului de Arte Grafice «Ardealul», pp. 109-146.

Në recensionin e tij Tagliavini ka cekur edhe artikujt e Puşçariu-t⁹, Bogrea-s e të tjerë. Ky i fundit në një artikull të tij të botuar në faqet e kësaj reviste ka bërë objekt diskutimi një hipotezë të re në lidhje me prapavendosjen e nyjes, një problem ky i rëndësishëm për shqipen dhe i trajtuar edhe nga vetë Tagliavinit¹⁰.

Po në rubrikën “Studi”, Tagliavini shënon një tjetër artikull të rëndësishëm për shqipen shkruar nga Capidan “Raportet gjuhësore sllavo-rumene” (të botuara në volumnin tretë, 1924) që përbën një vazhdimësi të artikullit të botuar në numrat e mëparshëm të kësaj reviste. Sipas Tagliavinit “*Shumë fjalë shqipe janë konsideruar në këtë punim shumë të rëndësishme; tek disa diskutohet etimoni, në disa flitet vetëm për formën, si paralele me atë rumune*” (C. Tagliavini, 1926b: 256).

Nga rubrika “Etimologjie e note lessicografiche”, tërheq vëmendjen artikulli i V. Bogreas “Originea rom. sat”¹¹. Autori i këtij punimi është në mes të dy etimonëve, lat. *satus* dhe shq. *fşat*, por zgjedh dhe mbron “*me arsye të shkëlqyera dhe informacion të pasur*”, sipas Taliavinit, etimonin e shqipes, shq. *fşat* < *fossatum* (C. Tagliavini, 1926b: 251).

Edhe në rubrikën “Brevi articoli” Tagliavini ka vënë re se gjuhëtarët interesohen mjaft për marrëdhëniet shqiptaro-rumune. Një prej këtyre studiuesve është edhe Capidan, i cili në punimin e tij “Calques linguistiques” (viti I, f. 331-336) ka renditur disa kalke gjuhësore të shqipes të cilat, sipas tij, kanë një bazë rumune. Kështu merret në studim fjala shq. *lulë*, bullg. *čvëtie*, sebr. *cvijet* “*menstruacione*”, e cila është ndërtuar sipas modelit të fjalës rumune *flori* < *flurores*. Por, megjithëse kjo fjalë rumune gjen paralele edhe në gjuhë të tjera si prov. *flors*, span. *Flor*, për Tagliavini “in italiano é raro trovare, “fiori” nel “sénso di mestruazione, e comune “fiori bianchi” per “leucorrea”” (C. Tagliavini, 1926b: 252). Ndërsa kalku i dytë është bullg. *kniga*, shq. *kartí* nga rum. *carte*. Studimet më të mëvonshme në albanologji e sjellin këtë fjalë të ardhur nga italishtja *carta*:

KÁRTĚ₁ f. “letër (shkrimi, kumari, poste etj.)”. Huazim i ri nga it. *carta*, me origjinë prej gr. ἀράοις. (K. Topalli, 2017: 727).

Autori tjetër është edhe Puşçariu, me studimin “Alcuni casi di assimilazione e dissimilazione in rumeno”¹² ku autori i shkrimit tenton që të shënojë ndryshimin

⁹ Puşçariu, S. (1924). *Contributiuni fonologice, Dacoromania*, III (1922-1923). Buletinul Muzeului Limbe i Române. Cluj: Editura Institutului de Arte Grafice «Ardealul», pp. f. 378-397.

¹⁰ Tagliavini, C. (1924). Sulla questione della postposizione dell'articolo. *Dacoromania*, III (1922-1923). Buletinul Muzeului Limbe i Române. Cluj: Editura Institutului de Arte Grafice «Ardealul», pp. 515-522.

¹¹ Bogreas V. (1921). Originea rom. sat. *Dacoromania*, I (1920-1921). Buletinul Muzeului Limbe i Române. Cluj: Editura Institutului de Arte Grafice «Ardealul», pp. 253-257.

¹² Puşçariu, S. (1921). Câteva cazuri de asimilare şi disimilare in limba română, *Dacoromania*, I (1920-1921). Buletinul Muzeului Limbe i Române. Cluj: Editura Institutului de Arte Grafice «Ardealul», pp. 322-330.

midis rum. -ar dhe shq. -ar përmes krahasimeve, si *fšat-ar*, *katund-ar* e kështu me radhë. Sërish edhe këtu Tagliavini jep disa shënime bibliografike mjaft të domosdoshme, duke na parashtruar edhe mendimet e kundërshtarëve.

Tagliavini vëren se shqipja është bërë objekt shembëllzimi dhe diskutimi edhe në recensione të ndryshme, gjë e cila nuk pritej, mes të cilave linguisti italian ka dalluar ato të Puškariu-t, Capidan-it etj. të ealizuar për organe të ndryshme apo volume me karakter lingusitik.

Tagliavini ka arritur në përfundimin se në këto tre volume të marra në shqyrtim të revistës *Dacoromania* “gjenden një material shumë i rëndësishëm për filologjinë romane e rumune në veçanti, por edhe një sasi e konsiderueshme shënimesh e studimesh relativë për shqipen e në veçanti për marrëdhëniet shqiptaro-rumune, të cilat nuk mund t’i shpëtojë asnjë albanologu e që parashtron një kontribut të rëndësishëm për mbarëvajtjen e studimeve e filologjisë ballkanike në përgjithësi” (C. Tagliavini, 1926b: 258).

Filologu italian Carlo Tagliavini, megjithëse ishte relativisht i ri në kohën kur shkroi në revistën *Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju*, fama që ai pati më vonë dhe referimi herë pas herë i këtij organi, ndikoi pozitivisht në promovimin e tij jo vetëm në botën albanologjike, por edhe më gjerë. Kjo revistë nuk pati një jetë shumë të gjatë, por produktiviteti dhe sidomos cilësia e punimeve e bëri të njohur dhe u kthye në një shkollë filologjike e komperativiste, jo vetëm për shqipen po për ballkanologjinë, rezultatet e së cilës vazhdojnë të zgjojnë interesin e studiueve ende sot. Shpresojmë që së shpejti të kemi në dorë serinë e re të kësaj reviste.

Literatura

- Capidan, Th. (1924). *Românii din Peninsula Balcanică. Anuarul Institutului de Istorie Natională*, II (1923). Universitatea din Cluj. București: Cartea Românească S. A.,. 92–118.
- Ismajli, R. (2015). *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve.
- Joseph D., B. (2010). The Languages and Their Convergent Character. Introducing the “Sprachbund”. *The Handbook of Language Contact*, R. Hickey (Ed.). Blackwell Publishing Ltd, 618–633.
- Petrota, G. ([1931] 2003). *Popolo, lingua e letteratura albanese*. Palermo: Saggio Monografico, tip. Pontificia.
- Sandfeld, Kristian. ([1926] 1930). *Linguistique balkanique*. Paris: Klincksieck.
- Tagliavini, C. (1926a). “L’arumeno rămân, rămân č influențato dall’albanese rîmînj”?, *Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju*, III (1-2), 206–208.

- Tagliavini, C. (1926b). Gli studi albanesi nella "Dacoromania, *Arhiv za Arbansku Starinu, Jezik i Etnologiju*, III(1-2), 249–258.
- Topalli, K. (2017). *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*. Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë: Botimet Jozef.
- Priku, M. (2011). *Carlo Tagliavini dhe studimet albanologjike rreth shqipes*. Shkodër: Camaj-Pipa.

Mimoza Priku
Luigj Gurakuqi University of Shkodra,
Faculty of Social Sciences, Department of Linguistics

ARHIV ZA ARBANSKU STARINU, JEZIK I ETNOLOGIJU
-PLATFORM FOR THE PROMOTION OF ALBANOLOGY

Summary

Balkanology studies and especially Albanology have caught the attention of well-known linguists, who have published the results of their work in important journals. One of them is the magazine "Arhiv za arbansku starinu, jezik i etnologiju" founded by the albanologist H. Barić (1888-1957), a scholar known for his contributions to the albanological world. This Archive for years (1923-1928) became the tribune of Balkanology and Albanian studies. In the pages of this magazine, well-known names of linguistics have been published, but also researchers who, thanks to this journal, not only affirmed themselves as albanologists, but who raised the albanological knowledge to a new dimension thanks to their skills.

The works of the Italian linguist and Albanist Carlo Tagliavini (1903-1982) are also noteworthy, which will also be the subject of our work. The studies of this linguist start with some influences from Albanian and Romanian and continue with the analysis of the Albanological contributions in the magazine "Dacoromania (organ of the University of Cluj, Museului Limbei Române), contributions published in the section "Kritika" which also presents a history of the bibliography as an important interest of the Italian albanologist.

We will also show the role of this journal in Albanian studies and the echoes that this organ still has today.

Key words: Balkanology, Albanological Archive, etymology

Orkida BACKUS BORSHI¹

Katedra jihoslovanských a balkanistických studií

Filozofická fakulta

Univerzita Karlova v Praze

 <https://orcid.org/0000-0003-3330-1726>

JAN URBAN JARNIKU DHE KONTRIBUTI I TIJ NË LIDHJE ME ALBANOLOGJINË E PRAGËS

Filologu Jan Urban Jarniku (1848-1923) është parë gjithnjë si një ikonë e ballkanistikës në trojet çeke në shekullin e 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të. Kontributi i tij gjuhësor është me shumë peshë dhe shkencëtari vetë njihet si themeluesi i specializimit të rumanishtes dhe shqipes në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Karlit në Pragë. Fillimisht, Jarniku i çel humultimet e tij shkencore me gjuhën rumune dhe gjuhët latine në përgjithësi. Gjatë kësaj kohe ai haset me një gjuhë tjetër, e cila ka disa ngjashmëri mahnitëse gramatikore me rumanishten (megjithëse nuk bën pjesë në familjen e gjuhëve latine), kjo gjuhë është shqipja.

Jarniku vetë me ndihmën a Mark Shantojës e mësoi shqipen në një mënyrë të përsosur pa shkuar asnjë herë në Shqipëri. Ky fakt mbështetet mbi hartimin a autobiografisë së tij në shqip (përfunduar më 1 maj 1919 në Bukuresht, Rumania) dhe shkrimeve të tjera mbi gjuhën shqipe, si p.sh. Za jazykem albánským², Příspěvky ku poznání nářečí albánských (1883), etj. Kontributi i tij në gjuhësinë shqipe dhe në tërë albanologjinë e Pragës është me të vërtetë i paparë. Jarniku vendosi themelet për Seminarin e gjuhës shqipe të viteve 50-të të shekullit të kaluar, nga i cili dolën emra të shquar gjuhëtarësh si Václav Polák ose Pavel Novák.

Ky i fundit tentoi disa herë ta rinovonte specializimin e shqipes në vitet 90-të të shekullit të kaluar dhe më së fundi shqipja në Universitetin e Karlit u rikthye përfundimisht pas vdekjes së Novakut në vitin akademik 2011/2012. Ajo është tashmë e integruar në kuadrin e Katedrës të studimeve sllavo-jugore dhe ballkanike dhe trajtohet në mënyrë të barabartë krahas gjuhëve të tjera, si p.sh. greqishtes, serbishtes, rumanishtes, etj.

Fjalët kyçe: Jarnik, gjuhësi shqipe, Pragë, Universiteti i Karlit, studime albanologjike.

¹ Orkida.Borshi@ff.cuni.cz

² JARNÍK, J.U. Za jazykem albánským. Vzpomínka z let (1879-81) . *Osvěta*, roč. 46/1916, č.3.

Jan Urban Jarniku (më tej JUJ) lindi më 25 maj 1848 në Potštejn të Çekisë, asokohe pjesë e Austro-Hungarisë dhe vdiq në 1923 (Gosturani, 173)³. Vitin që vjen, pra me 2023 mbushen plot 100 vjet nga vdekja e tij. Vinte nga një familje mjaft e varfër dhe konditat e tij parapraake familjare e predestinuan Jarnikut të bëhej klerik - historikisht, njerëzit studiozë dhe me një fare shkolle merreshin me fenë (përshkrimi vjen nga vetë Jarniku). Rreth moshës 13-vjecare, ai dhe nëna e tij filluan dhe panë një pasion të pazakontë për gjuhët e huaja. Nga gjithë familja e tij, Jarniku ishte i vetmi fëmijë i studiuar, pra që nuk u mor me një zanat te mirëfilltë. Megjithatë, meqenëse vjen nga një familje e thjeshtë, Jarniku mbeti gjithnjë i interesuar të studionte lidhjen/raportin mes gjuhës dhe kulturës popullore. Midis dorëshkrimeve të Jarnikut u gjet në Pragë një vëllim i panjohur i Mitkos me lëndë folkloristike që mbledhësi i kishte gati për shtyp më 1889⁴. - ky është një nga shembujt e shumtë që tregojnë interesin e Jarnikut në lidhje me folklorin. Në gjimnaz vendosi të merrej me studime gjuhësore, konkretisht të gjuhëve moderne.

JUJ si gjuhëtar

Për sa u përket gjuhëve dhe gjuhësisë, Jarniku fillimisht studion gjuhët latine, kryesisht gjuhën rumune, ku në fakt më vonë merr edhe titullin profesor sipas arkivave të Universitetit të Karlit⁵. Sipas materialeve arkivore, Jarniku vetë zotëronte në mënyrë të përsosur disa gjuhë të huaja: anash çekishtes dhe disa gjuhëve të tjera sllave, të cilat nuk janë të specifikuara më tej në fond, Jarniku dinte gjermanisht, frëngjisht, italisht, rumanisht dhe hungarisht. Përveç këtyre gjuhëve klasike, ai njihnte sanskritishten, gotisht dhe gjermanishte të mesme e të vjetër.

Në përgjithësi ishte autodidakt, ky është edhe rasti i shqipes, ai filloi ta mësonte gjuhën vetë pa pasur asnjë mbështetje dhe pa mundur të konsultohet me dikë për gabimet gramatikore dhe leksikore.

Interesi i tij për shqipen vjen nga fakti se gjatë studimeve të tija universitare, të cilat patën si synim rumanishten, u has edhe me shqipen dhe si gjuhëtar me përvojë profesionale në fushën e tij, konstatoi se rumanishtja kishte disa tipare gramatikore shumë të ngjashme me shqipen.

Historiku i studimeve të tija gjuhësore është pak a shumë ky⁶: Në moshën 22 vjeçare Jarniku pasi përfundoi gjimnazin, pra maturën, në Çeki, u nis për në Vjenë. Aty mori pjesë në leksionet e sllavistëve të shquar si: Miklosich dhe Shembera, germanistit: Tomaschek dhe romanistit: Mussafias.

³ Gosturani, Xh. *Historia e albanologjisë* (Tiranë: 1999), 173.

⁴ Jarnik, J.U. Kus ze života chudého českého studenta ve Vídni v letech sedmdesátých. In: Karásek J. (ed.) *Sborník Čechů dolnorakouských*. Vídeň: Národopisný odbor dolnorakouský, 1895, s. 121.

⁵ Fond Univerzity Karlovy, č. evidenční NAD 37, č. inventární 340.

⁶ Jarnik, J.U. *Si e kam fillue me msue gjuhën shqyp*. (dokument i pa botuar).

Pasi mbaroi studimet universitare më 1849, u nis me një bursë studentore shkëmbimi për në Paris. Këtu takoi dhe vizitoi leksionet e romanistëve me të mirë të asaj kohe në Evropë, mbase edhe në botë: aty u takua me studentin rumun Constantin Georgianin, me të cilin e vazhdoi kontaktin studimor me korrespondencë pasi u kthye në Vjenë, ku u punësua si mësues gjimnazi për frëngjishten dhe gjermanishten në Leopoldstadt.

Megjithatë, fokusi i tij kryesor mbeti tek gjuha rumune, të cilën më vonë e studioi edhe në Bukuresht, doktoraturën dhe më pas habilitimin e kreu pikërisht për gjuhën dhe gjuhësinë rumune. Kjo tregon se JUJ megjithëmend u bë një njohës - ekspert i gjuhës dhe kulturës rumune, megjithatë, siç ndodh shpesh në raste të këtilla të pazakonta të filologëve gjeni edhe në rastin e Jarnikut, gjuhëtarit nuk i mjaftoi vetëm njohuria dhe specializimi i thellë kundrejt një gjuhe.

Për të kuptuar më mirë se çfarë e shtyu Jarnikun të mësonte shqip, duhet të mermen parasysht edhe disa momente dhe përçasje politike të kohës në fjalë. Pas Lidhjes së Prizrenit më 1878 dhe kohëve të trazuara, Austro-Hungaria i njihte shqiptarët në lidhje me revoltat dhe kryengritjet kundër Turkut, sa u perkët gjuhëtarëve filologë të shquar të asaj kohe, mund të permendim Johann Georg von Hanhin dhe Franz Boppin. Në qoftë se e shohim kontributin e tyre si nga më të mëdhenjtë e kohës, duhet marrë parasysht, se paraprakisht të gjithë pak a shumë janë marrë fillimisht me gjuhë latine ose gjuhë të tjera dhe krahasimin me gjuhën shqipe e kanë parë shpesh herë si një kontribut për të kuptuar më mirë sistemin gramatikor, eventualisht edhe leksikor të gjuhëve në fjalë.

Ky është edhe rasti i JUJ. Jarniku filloi të merrej me shqipen si me një shtojcë, le të themi, për të kuptuar më mirë se si funksionte sistemi gramatikor i gjuhës rumune, në të cilën u përqëndrua edhe interesi i tij primar. Atij iu deshën më shumë se 20 vjet të tjerë për ta profiluar dhe specializuar albanologjinë si një disiplinë më vete në Universitetin e Karlit në Pragë. Pra, ndodhi diçka që as vetë Jarniku nuk e kishte planifikuar në asnjë aspekt në momentin kur vetë filloi studimet e shqipes.

Këndvështrimi i tij është, mund të themi, i kuruar, shumë modern dhe vizioner. Faktikisht, metoda krahasuese, pra komparatiste, ose më saktë kontrastive, është një nga bazat e indoeuropeanistikës, ashtu siç e njohim në ditët e sotme.

Autobiografia e Jarnikut e shkruar në shqip

Autobiografia e Jarnikut e shkruar në shqip konsiderohet si një raritet. Këtu duhet marrë parasysht fakti se Jarniku e mësoi gjuhën shqipe pa shkruar asnjë herë në Shqipëri. Nga korrespondenca e kohës që mbante me Gustav Meyerin është më se e qartë që të dy profesorët patën planifikuar një udhëtim nëpër Shqipëri, gjë, që fatkeqësisht nuk u realizua asnjë herë, sepse ndërkohë Meyeri vdiq.

Gjithsesi sipas burimeve, Jarniku filloi ta mësonte shqip në Vjenë gjatë periudhës kur përmirësonte njohuritë e rumanishtes. Për mësuesin e tij, Mark Shantojën, të cilin Jarniku e takoi po aty, dihej se kishte lindur në Shkodër dhe ishte mësues i gjuhës shqipe për të huajt e interesuar në këtë gjuhë. Edith Durham⁷ e ka fotografuar Mark Shantojën diku rreth viteve 1903-1913 dhe këtë fotografi mund ta gjejmë sot në *Photo Collection of Edith Durham: Albania, Montenegro and Kosovo*.

Aty ai përshkruhet thjesht si shkodran katolik.

Për sa i përket autobiografisë së JUJ të shkruajtur shqip, nga dokumenti është e qartë se teksti është shkruajtur me shkrim latin, gjë që tregon se Jarniku duhet të ketë qenë në dijeni për konkluzionin e Kongresit të Manastirit më 1908. Për sa i përket dialektit, një pjesë e mirë e autobiografisë së tij është gegërisht apo më saktë gegnisht, kuptohet, se aty ka pasur ndikim mësuesi i tij Shantoja me prejardhje nga Shkodra vetë, siç u përmend edhe më lart. Para vendimit të Kongresit të Manastirit, Jarniku kishte krijuar një sistem shkrimi të vetin për anën grafike të gjuhës shqipe, ku kishte vënë në përdorim diakritikën e çekishtes të përzier me digrafet dhe hapjen e zanoreve në gegërisht, këto dy të fundit janë pjesërisht të pranishme në alfabetin çek. Kështu që sistemi i tij grafematik për ta dokumentuar shqipen është një përzierje dialektore, intergjuhësore si dhe një sistem fonetik, në fakt, si një prejardhës i IPA-së së sotme, sigurisht jo në kuptimin e plotë të fjalës, por pjesërisht patjetër.

Megjithatë, Jarniku nuk i referohet vetëm dialektit geg, dhe përveç formave geqe, hasim në këtë autobiografi edhe forma toske: si p.sh. kohën e ardhshme të shkruajtur me *do të*⁸, etj.

Përveç kësaj, ka edhe disa gabime gramatikore, të cilat i ka korrigjuar dhe meqenëse autobiografia është shkruajtur me shkrim dore, është më se e qartë se çfarë e ka korrigjuar vetë autori. Sidomos, përsëriten gabimet në lidhje me nyjën e përparme tek mbiemrat ose tek emrat në rasën gjinore të numrit njëjës, ku (si në fakt shumë çekë të tjerë edhe më vonë, nga përvoja profesionale) në vend të *e* vendosin *i* - në, sepse këtu nisen nga fakti që nyja diktohet nga gjinia, në përgjithësi.

Interesante janë edhe disa aspekte të tjera të kësaj vepre, si p.sh. një farë purizimi ose pastrimi leksikor nga greqizmat dhe turqizmat, që me siguri është bërë në periudhën post, pra në redaktim: si p.sh *hyzmetqar* - *shërbëtor* ose *apofasis* - *vendos*⁹, etj.

Për më tepër pastaj, njohuria e gjuhëve të tjera të huaja e ka ndihmuar Jarnikun të huazojë disa elemente grafike në lidhje me diakritikën, të cilat nuk ka ditur ose mbase nuk ka dashur t'i shënonte ndryshe.

⁷ Durham, E. *Photo Collection of Edith Durham: Albania, Montenegro and Kosovo*. (1903-1913).

⁸ Jarnik, J.U. Si e kam fillue me msue gjuhën shqyp. (dokument i pa botuar).

⁹ Po aty.

Pra, p.sh., shkruan Potshtejn me çengel poshtë shkronjës “s”, si në gjuhën rumune, etj.

Për një kontekst më të gjerë, Evropa Qendrore në shekullin e 19-të sapo njihet me Shqipërinë dhe botën shqiptare në pergjithësi. Nuk ndodh shumë shpesh që një shkencëtar i huaj, sidomos gjuhëtar të shfaqë interesim për këtë gjuhë ose edhe për të gjithë kombin shqiptar. Jarniku në këtë këndvështrim merret si një njeri dhe shkencëtar i rrallë.

Për më tepër, arkivat e Universitetit të Karlit tregojnë me qartësi¹⁰ se në kohën e tij JUJ me gjithë mend ishte një njeri shumë i respektuar, jo vetëm për njohuritë gjuhësore praktike dhe teorike, por edhe për aspektin e tij njerëzor. Në këshillin e tij gjatë procesit të habilitimit dhe më tej të profesurës, figuron emri Jan Gebauer, një nga gjuhëtarët - shkencëtarët më të njohur të shekullit të 19-të në tokën çeke, i cili specializohej për gjuhët sllave, konkretisht për çekishten.

Një tjetër fakt që tregon respektin e gjithëanshem ndaj Jarnikut është edhe kondolenca (1923) me shkrim e dërguar pas vdekjes së tij drejtuar Senatit akademik dhe këshillit të profesorëve të Fakultetit Filozofik nga vetë presidenti çek, Tomash G. Masaryku.

Kontributi i JUJ për albanologjinë e Pragës

Megjithëse, si mirëfillje nuk u mor direkt me shqipen, por me rumanishten dhe me gjuhë të tjera latine, është tashmë më se e qartë se Jarniku shkrepri shkëndijën e parë për hapjen e specializimit në Pragë, kjo është pa asnjë diskutim.

Një specializim, i cili ka qenë gjithnjë në rrezik të mbylljes, hapet dhe mbyllet vazhdimisht që nga vitet 50-të të shekullit të kaluar, duke vazhduar me vitet 90-të po në të njëjtin shekull dhe duke prodhuar emra të famshëm si Pavel Novaku ose Vaclav Polaku.

Më së fundi, specializimi i shqipes hapet në vitin akademik 2011/2012 në mënyrë oficiale dhe të patundshme në kuadër të Katedrës të studimeve Sllavo-jugore dhe Ballkanike ku krahas shqipes qëndron në mënyrë të barabartë greqishtja, serbishtja, kroatishtja, sllovenishtja dhe rumanishtja. Humulti dhe mësimdhënia në të gjitha gjuhët e përmendura më lart përfshirë shqipen janë në të njëjtin nivel shkencor.

Pra, ndërsa (ndërkohë që) shqipja në Beograd ka më shumë se një shekull në mënyrë kontinuale, ne kemi tani për tani pak më shumë se një dekadë.

¹⁰ Fond Univerzity Karlovy, č. evidenční NAD 37, č. inventární 340.

Literatura

Jarník, J. U. (1895): Kus ze života chudého českého studenta ve Vídni v letech sedmdesátých. In: J. Karásek (ed.) Sborník Čechů dolnorakouských. Vídeň: Národopisnýarník, J.U. *Si e kam fillue me msue gjuhën shqyp* (dokument i pabotuar).

Jarník, J.U. Za jazykem albánským. Vzpomínka z let (1879-81) . *Osvěta*, roč. 46/1916, č.3.

Burimet

Durham, E. *Photo Collection of Edith Durham: Albania, Montenegro and Kosovo*. (1903-1913).

Fond Univerzity Karlovy, č. evidenční NAD 37, č. inventární 340.

Orkida Backus Borshi
*Department of South Slavic and Balkan Studies, Faculty of Arts,
Charles University in Prague*

JAN URBAN JARNIK AND HIS CONTRIBUTION TO THE ALBANIAN STUDIES AT CHARLES UNIVERSITY IN PRAGUE

Summary

Jan Urban Jarník (1848-1923) was a professor of Romanian and Albanian language and linguistics at Charles University, Faculty of Arts in Prague. He is considered, without a doubt, the first academic scholar who established the teaching of Albanian language and linguistics in the above-mentioned institution. Despite being self -taught, he was able to master Albanian at such a degree that enabled him to write his own autobiography in the respective language. Moreover, JUJ had written papers focused on Albanian grammar, lexicology and dialectology. Above all, we value his contribution in research on Albanian linguistics and folklore. It is exactly his multifocal approach that enabled the existence and the continuation of the Albanian specialization up to these days.

Keywords: Jarník, Albanian linguistics, Prague, Charles University, Albanian Studies

Rezearta MURATI¹

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Departamenti i Gjuhësisë

 <https://orcid.org/0000-0001-7084-9614>

“HYLLI I DRITËS” PËR INSTITUCIONET ZYRTARE ME NDIKIM NË PLANIFIKIMIN GJUHËSOR TË SHQIPES

Revista “Hylli i Dritës”, botuar në Shkodër në vitet 1913-1914, 1921-1924, 1930-1944, ka shfaqur përherë një program të qartë atdhetar, politik dhe kulturor, duke u bërë kështu tribunë e një plejade letrarësh, gjuhëtarësh e studiuesish të çështjes shqiptare. Institucionet zyrtare që kanë në përbërjen e tyre personalitete të gjuhësisë e të kulturës shqiptare dhe që kanë aftësinë e mundësinë të marrin vendime të rëndësishme në lidhje me gjuhën e përbashkët shqipe, kanë qenë një kërkesë e vazhdueshme dhe e mirëpritur në faqet e revistës “Hylli i Dritës”. Në disa artikuj parashtrohet kërkesa e krijimit të një institucioni të tillë e në disa të tjerë është përshëndetur një iniciativë e institucionalizimit të çështjes së gjuhës së përbashkët letrare. Por në ndonjë rast është shprehur zhgënjimi për rezultatet e një ndërmarrjeje të tillë. Në punimin tonë synojmë të paraqesim në mënyrë kronologjike një panoramë të plotë të tezave dhe të kërkesave që kanë parashtuar artikuj dhe autorë të veçantë për këtë çështje të rëndësishme dhe jetike për krijimin dhe modernizimin e gjuhës letrare. Sqarojmë se këto shqyrtime janë bërë rreth 100 vjet më parë dhe kanë një shtrirje kohore rreth 30-vjeçare.

Fjalët kyçe: revista “Hylli i Dritës”, institucion zyrtar, akademi, institut, planifikim gjuhësor, politikë gjuhësore.

1. HYRJE

“Hylli i Dritës” ka qenë e para revistë e botuar në Shqipëri, me një program të qartë atdhetar, politik dhe kulturor, duke u bërë kështu tribunë e një plejade letrarësh, gjuhëtarësh e studiuesish të çështjes shqiptare. Gjatë kohës së botimit pati mbështetjen e vlerësimit të shumicës së intelektualëve shqiptarë të kohës, të cilët u bënë shpeshherë edhe bashkëpunëtorë të saj. Ajo u vlerësua edhe nga studiues të huaj për seriozitetin e treguar dhe për cilësinë e artikujve të botuar në

¹ rezearta.murati@unishk.edu.al

të. Vetë redaksia e revistës “Hylli i Dritës” i ka deklaruar disa herë në mënyrë të hapur qëllimet dhe misionin e saj, të cilat mund të paraqiten me përkufizimin “*Pro cultura*” (Hylli i Dritës, 1932/2:3).

Kjo revistë në mënyrë të veçantë kërkoi të ruajë e të zhvillojë karakteristikën e jetës shqiptare, e cila shfaqej në gjuhë, në doke e në shpirtin e popullit. Që nga dita kur ka dalë për herë të parë i ka hapur faqet e saj për gjithë ata që janë marrë me çështjen shqiptare, në të kanë shkruar toskë e gegë, myslimanë e ortodoksë, shqiptarë dhe të huaj. Për sa i përket dialektit dhe ortografisë, redaksia deklaronte se nuk mendonin të imponoheshin, por donin vetëm të paraqisnin bashkëpunimin e tyre për pasurimin e gjuhës dhe letërsisë shqiptare. Prandaj çdo shqiptar i çdo besimi dhe në çfarëdo dialekti dhe ortografie mund të shkruante në këtë revistë, mjafton të shkruante për çdo fushë të jetës shqiptare, përveç besimit dhe politikës, të shkruante me kompetencë e shkrimi i tij të mos ishte në kundërshtim me parimet filozofike dhe kulturore të revistës. Në këtë mënyrë revista u bëri thirrje intelektualëve shqiptarë të dërgonin shkrimet e tyre, të cilat do ta pasuronin larmishmërinë e tematikave dhe pikëvështrimeve të realitetit shqiptar dhe të traditës shqiptare.

Revista filloi botimin e saj në tetorin e vitit 1913, duke pasë si themelues dhe drejtues të saj të parë Gjergj Fishtën. Botimin e saj mund të ndajmë në tri periudha:

Periudha e parë përfshin botimet e bëra vetëm në vitin e parë, nga tetori i vitit 1913 deri në korrikun e vitit 1914, vit në të cilin u pezullua me urdhër të autoriteteve të atëhershme. Gjatë kësaj periudhe të parë revista u bë tribunë e atdhedashurisë dhe pasqyrë e zhvillimeve të brendshme të jashtme, në të cilat përshtjellohej jeta politike, shoqërore e kulturore e Shqipërisë, si një vend në vitet e para të rilindjes së pavarur. Ishte një periudhe prove pasi për herë të parë në Shqipëri botohej një revistë periodike me një nivel të tillë kulturor. Në ato pak numra që arriti të botojë në këtë periudhë një vend të rëndësishëm zuri edhe çështja e gjuhës shqipe, si një mjet i fuqishëm bashkimi e unifikimi i shqiptarëve, të ndarë e të përçarë në dialekte e të folme, në besime e në orientime politike. Mbrojtja e gjuhës, pastrimi dhe pasurimi i saj ishin jo vetëm problematika, që trajtoi revista, por ishin edhe qëllime të saj.

Periudha e dytë filloi në maj të vitit 1921 dhe vijoi deri në dhjetor të vitit 1924. Gjatë kësaj periudhe revista vazhdoi me të njëjtin program dhe qëllim. Janë vitet kur u shënuar një zhvillim në fushën kulturore dhe jo vetëm. Tashmë bëhen objekt artikujsh të veçantë studime në fusha të ndryshme, si: gjuhë, arsim, hartime tekstesh, studime historike etj. Artikujt e botuar në këtë periudhë paraqesin qartë gjendjen e atëhershme të kombit. Gjatë kësaj periudhe drejtimin e revistës e mori përsipër Vinçens Prendushi (Hylli i Dritës, 1941/3-5:105), i cili dëshmoi se kishte cilësitë e nevojshme jo vetëm për ta mbajtur në lartësitë e saj, por edhe për të

krijuar klimë bashkëpunimi. Me pendën e tij shpreh dëshirën e zjarhtë të një atdhetari, i cili do që kombi të zhvillohet e të përparojë.

Periudha e tretë fillon në janar të vitit 1930 dhe vazhdon deri në majin e vitit 1944. Kjo periudhë karakterizohet nga zhvillime të mëdha në jetën politike dhe kulturore të Shqipërisë. Këto ngjarje dhe risi u pasqyruan gjerësisht të faqet e revistës, që tashmë kishte krijuar një traditë të mirë. Çështja e gjuhës letrare zuri një vend të rëndësishëm mes çështjeve të tjera politike, ekonomike, shoqërore e sidomos teologjike e ideologjike. Gjatë kësaj periudhe drejtues të revistës ishin: Anton Harapi, Antonin Fishta, Gjon Shllaku dhe Benedikt Dema (Hylli i Dritës, 1941/3-5:108).

2. Roli i institucioneve zyrtare në ravijëzimin dhe zbatimin e planifikimit gjuhësor

Institucionet zyrtare kanë një rol parësor në formësimin dhe zbatimin e një politike dhe planifikimi të qartë gjuhësor të një vendi. Ky fakt është theksuar në vijimësi nga studiues të fushës duke risjellë në vëmendjen e planifikuesve të gjuhës rëndësinë e institucioneve përfaqësuese që kanë në përbërjen e tyre personalitete kombëtare dhe specialistë të gjuhës dhe të kulturës.

Në Larousse² me termin planifikim gjuhësor përkufizohet tërësia e masave të rregullta të marra nga shteti për normalizimin e një gjuhe ose të qëndrimit ndaj saj (Larouse, 1994: 367).

Ricento³ e konsideron planifikimin gjuhësor si një nënkategori të politikës gjuhësore që ka si objekt jo vetëm veprimet zyrtare dhe jozyrtare të qeverisë dhe institucioneve të tjera, por edhe proceset historike dhe kulturore që kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë sjelljen dhe praktikën sociale në lidhje me përdorimin, marrjen dhe statusin e gjuhës (Ricento, 2000: 209).

Përkufizimi i Weinstein na ka dhënë një pikënisje të dobishme, sepse për të planifikimi gjuhësor është një përpjekje afatgjatë e autorizuar nga shteti për të ndryshuar një funksion të gjuhës në një shoqëri, me qëllimin e zgjidhjes së problemeve të komunikimit (Weinstein, 1980: 56).

Kurse për Neustupný⁴ *planifikimi gjuhësor* i referohet vëmendjes sistematike, të bazuar në teori racionale dhe të organizuar të shoqërisë mbi problemet gjuhësore (Cooper, 1989: 31).

² Ky fjalor paraqitet si punim konsultativ edhe si manual studimor. Jep informacion të qartë dhe të saktë për të gjithë leksikon gjuhësor dhe përfshin, nëpërmjet shënimeve biografike, së bashku me një bibliografi të rëndësishme, emrat e mëdhenj të shkencave gjuhësore. Gjerësia e fushës së mbuluar dhe saktësia e analizave e bëjnë këtë fjalor një vepër referimi unike në llojin e tij.

³ Thomas Ricento është profesor dhe kryetar kërkimi në Universitetin e Calgary, Kanada. Ai ka botuar gjerësisht në fushën e politikës gjuhësore dhe mbi politikën e gjuhës në Amerikën e Veriut.

⁴ Jiří Václav Neustupný (1933-2015) studioi Japonisht dhe Historinë e Lindjes së Largët në Fakultetin e Filologjisë, Universiteti Charles, Pragë, Çekosllovakia. Në vitin 1964 ai mori CSc. (Ph.D.) nga Instituti Oriental i Akademisë së Shkencave Çekoslloake dhe filloi të punojë atje si studiues.

Christian⁵ është e mendimit se planifikimi gjuhësor është një përpjekje eksplicite dhe sistematike për zgjidhjen e problemeve gjuhësore dhe për arritjen e qëllimeve përmes ndërhyrjeve të organizuara në mënyrë institucionale në dobi dhe në përdorim të gjuhëve (Christian, 1988: 197).

3. Revista “Hylli i Dritës” për institucionet zyrtare në fushë të planifikimit gjuhësor

Institucionet zyrtare që kanë në përbërjen e tyre personalitete të gjuhësisë e të kulturës shqiptare dhe që kanë aftësinë e mundësinë të marrin vendime të rëndësishme të lidhje me gjuhën e përbashkët shqipe, kanë qenë një kërkesë e vazhdueshmen dhe e mirëpripur në faqet e revistës “Hylli i Dritës”. Në disa artikuj kemi ndeshur kërkesën e krijimit të një institucioni të tillë e në disa të tjerë është përshëndetur një iniciativë e institucionalizimit të çështjes së gjuhës së përbashkët letrare. Por në ndonjë rast është shprehur zhgënjimi për rezultatet e një ndërmarrjeje të tillë. Në vijim po paraqesim në mënyrë kronologjike artikujt dhe autorët që kanë parashtruar këtë çështje të rëndësishme dhe jetike për krijimin dhe modernizimin e gjuhës letrare.

Sali Nivica⁶ vjen në revistë me artikullin “*Nevoja e një Akademis letrare*”, i cili është tepër të veçantë, si për mënyrën se si është hartuar, ashtu edhe për temën që trajton me mjeshtërinë e një njohësi të situatës, në të cilën ndodhesh gjuha shqipe dhe të politikave gjuhësore në shtete të ndryshme të Europës. Teksti është ndërtuar në formën e një dialogu, ku njëri pyet për gjendjen e gjuhës shqipe e tjetri përgjigjet herë me ironi e herë edhe me sarkazëm për situatën, në të cilën ndodhet ajo. Ai shprehet se: “*Gega është tue folë Gegnisht, Toska Toskërisht... m’fal, se deshta me t’thânë: Shkodrani po flet shkodrançe; Mirditasi Mirditçe; Elbasani Elbasançe...Qe! Se shka janë tue folë Shqyphtarët...*” (Hylli i Dritës, 1921/5: 37), sepse shqiptarët sot kanë dialekte e jo gjuhë, e nëse dikush thotë se di shqip “*t’rrën ditën m’drekë*”. Problemi nuk qëndron vetëm tek të folurit, por situata është edhe më e vështirë në të shkruar, sepse secili shkruan sipas mënyrës së tij, ndaj, për shembull, një tekst i shkruar nga një shkodran është thujasë e pamundur të lexohet nga toskët, si edhe e kundërta. Autori ironizon mendimin e vendimin e Kongresit të Elbasanit që “urdhëron” shqiptarët të shkruajnë në dialektin e Elbasanit, sepse, sipas tij, një vendim i tillë nuk mund të merret aq lehtë. Në këtë dialekt nuk ka mjaftueshëm vepra të botuara e si rrjedhojë nuk ka leksik, që të plotësojnë nevojat e përdorimit shumëplanësh të gjuhës.

⁵ Donna Christian është një anëtare e lartë në Qendrën për Gjuhësinë e Aplikuar (CAL) pasi shërbeu si presidente e CAL nga 1994 deri në 2010.

⁶ Sali Nivica (Rexhin, 15 maj 1890 - Shkodër, 10 janar 1920) ka qenë publicist shqiptar, Anëtar i Komissë Letrare Shqipe, i dekoruar pas vdekjes me titullin “Nderi i Kombit”.

Pasi bën një paraqitje të shkurtër të historisë së Akademive në botë, autori sjell në vëmendjen e lexuesit rastin e Akademisë së Italisë “L’Accademia della Crusca”⁷. Autori shprehet se edhe në Itali ka dialekte, por një nxënës italian në shkollë mëson gjuhën italiane, po ashtu edhe një shkrimtar italian veprat e tij (sidomos ato didaktike) i shkruan në gjuhën italiane dhe jo në dialektin e tij. Për trajtimin e çështjeve të tilla dhe për marrjen e vendimeve të pranueshme nga të gjithë ai propozon ngritje e një **Akademie Letrare**, në të cilën të parashtrohen e të përkrahen të gjithë dialektet, të studiohet secili mirë dhe thellësisht, të veçohet ç’është e mirë dhe me vlerë dhe prej përzierjes të përftohet ajo, që “*kishte me kjenë n’ajo gjuhë qi lypim ne*” (Hylli i Dritës, 1921/5: 39), kurse pastaj terminologjia teknike të huazohet prej gjuhëve të tjera ose të krijohet e re.

Qëndrimin, se nuk kemi nevojë për një gjuhë të përbashkët, sepse dialektet e shqipes nuk janë shumë të ndryshëm dhe se shqiptarët mund të merren mirë merr vesh me njëri-tjetrin, edhe pse janë folës të krahinave të ndryshme, autori i kundërvihet, duke përmendur se, nëse duam të bëjmë një fjalor të shqipes, jemi para dyshimit se cilën prej fjalëve ose formave do të përfshijmë për një kuptim të dhënë, për shembull: *e përkohëshme, e përtashme, e tanishme, e sot për-sotshme, e dorë-për-dorëshme, e hë-për-hërshme* etj. ose *këce, kërce, kërxe, sbritë, xërbritë, xërmo, sdrypë* etj.

Dhe për ata pesimistë, që mendojnë se në Shqipëri nuk mund të themelohet një Akademi e tillë si në shtete të tjera Europiane, autori u propozon që ajo mund të jetë edhe më e vogël, por e përbërë nga shkrimtarë e filologë të vërtetë, që jo vetëm të njohin mirë gjuhën shqipe, por edhe të jenë “*të armatosur*” me gjuhë të huaja e sidomos latinishten e greqishten e vjetër, në mënyrë që të jenë të aftë të krahasojnë shqipen në ato. Këto anëtarë të Akademisë duhet të dinë të përcaktojnë se cila fjalë e cilit dialekt është më e drejtë dhe atë të vendosin në fjalor. Nivica kësaj Akademie i përcakton detyra themelore:

- Një fjalor të thjeshtë në përdorim dhe gjithëpërfshirës për të gjitha fushat e përdorimit të shqipes.
- Një gramatikë të thjeshtë e të përbashkët për të gjithë shqiptarët, pra shqipe.
- Përkthimin e veprave të poetëve dhe filozofëve të huaj më në zë. (Hylli i Dritës, 1921/5: 40)

Numri i korrikut të vitit 1922 hapet me artikullin e redaksisë “*Rreth Kongresit arësimuer të Tiranës*” (Hylli i Dritës, 1922/7: 4), i cili ka tone optimiste për gjendjen, në të cilën ishte Shqipëria në fillim të viteve 20’. Ku pohohet se ndërkohë që gjendja e brendshme dhe rrethanat e jashtme të shtetit të ri shqiptar

⁷ Accademia della Crusca (shpesh edhe vetëm Crusca) është një institucion italian dhe evropian, i cili mbledh së bashku studiues dhe ekspertë të gjuhësisë dhe filologjisë së gjuhës italiane.

janë duke u përmirësuar, jeta shqiptare, në më pak kohë se mund të mendohet, po përshkon lëvizje të evolucionit të saj, kështu që nga ditë në ditë mendjes po i shfaqen horizonte të reja dhe pikëpamjet e shqiptarëve, përherë duke u zmadhuar, marrin drejtime gjithmonë e më të sigurta e më të mbara për të gjitha rrethanat dhe nevojat e jetës. Zhvillimi i shpejtë i mentalitetit të shqiptarit, në ato pak vite lirie kombëtare, hapi shteg, që tashmë shqiptarët të punojnë dhe të marrin në dorë fatin e Shqipërisë për të ardhmen. Ndaj dhe redaksia e paraqet **Kongresin Arsimit**, që do të mbahej brenda pak kohësh në Tiranë, si një moment shumë të rëndësishëm për të ardhmen e Shqipërisë⁸. Theksohet se të gjithë ato që i përkasin inteligjencës shqiptare do t’i bëjnë shtetit dhe kombit një shërbim shumë të madh, nëse ia dalin mbanë të themelojnë jetën mendore dhe morale të shqiptarit mbi parime të sigurta dhe të shëndosha. Si shembull të një kongresi të tillë sillet rasti i atij të Austrisë në vitin 1867, kur pa dallim krahine e besimi u ftuan të gjithë pjesëtarët e arsimit, për të dhënë kontributin e tyre për zhvillimin e arsimit kombëtar. Redaksia është e sigurt që pjesëmarrësit në këtë kongres do ta kryejnë këtë detyrë patriotike e do të bashkëveprojnë për të mëkëmbur dhe përforcuar shtetin, sepse shteti është i fortë, kur të mëkëmbet dhe të lartësohet gjendja arsimore dhe kjo ndodh, kur shkollat do të jenë të organizuara më së miri dhe të veprojnë me gjithë energjinë e tyre. Këtij Kongresi redaksia i parashtron këto kërkesa dhe detyra:

- Në Shqipëri të ketë tri kategori shkollash: shkolla të ulëta, shkolla të mesme e shkolla të ndryshme (profesionale), shpërndarja e këtyre shkollave duhet të bëhet në përpjestim me numrin e popullsisë.
- Programi shkollor duhet të jetë i bazuar mbi një princip për të gjitha shkollat, nga më të ulëtat deri tek më të lartat.
- Mbledhja e fjalëve, gojëdhënave, këngëve popullore, përrallave dhe dokeve nga mësuesit fshatrave, me qëllim që ky material i mbledhur të shërbejë si themel i gjuhës dhe literaturës, është një ide interesante e paraqitur në këtë artikull këshillues.
- Librat e shkollës do të punohen sipas programit të përcaktuar.
- Shkollat fillore *“për nevojë psikologjike”* duhet t’i përshtaten sa më shumë dialektit të nxënësit, në të kundërt mësuesi do ta ketë shumë të vështirë, sepse gjuha fëmijës do t’i duket si gjuhë e huaj e do t’i bëhet barrë. *“Po nuk ju shijue gjuha fëmijës ç’në vocri, kurr së kà me muejtë me ja pershtatë shpirtin e mendimit të vet”* (Hylli i Dritës, 1922/7: 12). Ky qëndrim, që mund të duket si utopi sot, gjen mbështetje edhe nga disa studiues bashkëkohorë, të cilët përkrahin idenë, që tekstet e abetares

⁸ Kongresi Arsimit i Tiranës zhvilloi punimet në vitin 1922. Në të morën pjesë 40 delegatë, që përfaqësonin forcat më përparimtare të arsimit kombëtar. Kongresi synonte t’i jepte shkollës shqiptare frymë laike dhe sa më masive.

dhe në përgjithësi ato të shkollës fillore të jenë në dialekt, në mënyrë që fëmijët mësimet e para t'i marrin në variantin, që është i njohur tashmë prej tyre, kurse përballja me standardin të bëhet në klasa më të larta, njësoj siç mësohet një gjuhë e huaj.

Modernizimi i gjuhës shqipe dhe pasurimi i saj me terminologji të fushave të ndryshme të shkencës nuk na vjen si një kërkesë e gjuhëtarëve dhe studiuesve të gjuhës, por si kërkesë e specialistëve të fushave përkatëse. Përmendim këtu Injac Gj. Ndojën, i cili në artikullin e tij *“Relacion mbi një shetë studimi (në zonen peridotitike-serpentinoze të Pukës, t’lballes me rrethe)”* (Hylli i Dritës, 1940/7-9: 39), që trajton çështjen e pasurive minerale të zonës, shprehet me shqetësim se ka ndeshur shumë vështirësi në përdorimin e terminologjisë shkencore të fushës. Disa terma tregojnë se është munduar t'i përkthejë në shqip, por ka dyshimet e tij se a ka bërë një përshtatje të saktë. Kurse disa terma të tjerë deklaron se i ka përdorur në italisht, sepse nuk ka arritur t'i gjejë ose t'i përshtasë në gjuhën shqipe.

Në vijim Ndoja vë në dukje, se do të ishte e nevojshme ngritja e një **Komisioni Teknik** për *“fjalët shkencore”* pranë Ministrisë së Arsimit. Ky Komision të mos jetë i formuar vetëm prej specialistëve të gjuhës letrare, por edhe prej njerëzve që kanë njohuri në fushën së cilës i përkasin termat ose përkufizimet në fjalë. Autori e parasheh vështirësinë e punës së një komisioni të tillë, por ka besim se një veprimtari e tillë do të jetë me vlerë për studiuesit shqiptarë të të gjitha fushave. Ai pohon se: *“Në çdo gjuhë në fillim termat e rí tingëllojnë vrazhdë, por me kohë fillon e mësohet veshi e fjala bâhet e rrjedhëshme.”* (Hylli i Dritës, 1940/7-9: 39). Në fakt ky shqetësim i specialistit të gjeologjisë është i përbashkët për shumë specialistë të tjera të fushave të ndryshme të shkencës, sepse përparimi shkencor dhe teknik i Shqipërisë në ato vite duhej të kishte një mbështetje edhe nga gjuhësia. Dhe qëllimi i krijimit të një komisioni të tillë të përbërë jo vetëm nga gjuhëtarët por edhe nga specialistët përkatës do të ishte hartimi i fjalorëve terminologjikë, në shërbim të shkencës dhe teknikës shqiptare.

Në rubrikën *“Lajme rrokull Shqypnis”* (Hylli i Dritës, 1935/10: 45) të numrit të tetorit të vitit 1935 zë vend njoftimi për themelimin e **Komisjonit per Orthografin Shqype** nga zëvendësministri i Arsimit, Dhimitër Berati. Theksohet fakti se ky komision është i përbërë nga lëvruet të shquar e me vlerë të gjuhës shqipe, konkretisht nga: *Mati Logoreci, Aleksandër Xhuvani, Anton Paluca, Karl Gurakuqi, Kolë Kamsi, Eqerem Çabej, Beqir Sinani, Gjergj Kokoshi e Namik Resuli*. Sipas revistës, qëllimi i këtij komisioni të kryesuar nga ministri Berati është caktimi i një ortografie të përgjithshme për të gjithë Shqipërinë, duke formuluar rregullat kryesore, të cilat duhet t'i ndjekë çdo shkrimtar. Në këtë mënyrë shpresohet që të plotësohet ajo mungesë e madhe e vënë në dukje nga shqiptarët vullnetmirë, që

nuk mund të shihnin tek shkruhej me ortografi të ndryshme jo vetëm në librat e botuar nga privatët, por edhe në librat e botuar nga Ministria e Arsimit. Njoftimi bën të ditur se vendimet e komisionit do të botohen në një broshurë të veçantë që do t’u dërgohet të gjitha zyrave dhe shkollave të mbretërisë.

Në dhjetor të vitit 1938 me artikullin *“Instituti ‘Albanologjik’ i zotit Lumo Skendo*”⁹ revista, bazuar në një artikull të fletores “Demokracia”, paraqet një pohim të Mithat Frashërit se: *“Diten 4 Mars 1929 me numer 163 kam depozituar në Noterin e Gjykatores, këtu në Tiranë (sot Noter publik Z. Jonus Tafaj), testamentin t’im per ngrehjen e nji Instituti Albanologjik konsakruar studimeve shqiptare, histori, gjuhë, folklorë, literaturë...Që nga ajo ditë po perpiqem të plotsoj dhe të pasuroj mjetet e punimit s’asaj qendrre, t’asaj foleje.”* (Hylli i Dritës, 1938/12: 75). Lajmi se një shqiptar po e thyente akullin e kopracisë shpirtërore i gëzoi të gjithë dashamirësit e kulturës dhe ata që tashmë e kishin humbur shpresën se në tokën tonë kishte bamirës. Artikulli vlerëson Mithat Frashërin si një ndër atdhetarët më të flaktë, si një ndër punëtorët më të palodhur e si një ndër shqiptarët me nder më të pastër, i cili po bëhej gati t’i falte Shqipërisë një çerdhe e një tempull kushtuar kultit të shqiptarizmit. Frashëri ishte shprehur se *“Sa të pres vdekjen, e cilla s’di edhe une vetë kur do të vije, me mirë ta ngrehi çerdhen sa jam gjallë”* (Hylli i Dritës, 1938/12: 76). Prandaj në fillim të vitit 1938 i kishte paraqitur Ministrisë së Financave një kërkesë për të marrë një copë tokë, e cila ishte e caktuar për *“godina të bobisë publike”*. Këtë tokë e kishte kërkuar si një kontribut simbolik, për të siguruar se do të ketë përkrahjen e qeverisë. Tashmë në fund të vitit, ai akoma nuk kishte marrë përgjigje nga autoritetet. Revista *“Hylli i Dritës”* shprehet me indinjatë për heshtjen, që ka shoqëruar këtë fakt kaq të rëndësishëm dhe kuptimplotë për kulturën shqiptare. Kjo heshtje u vu re jo vetëm nga autoritetet, që nuk po i japin përkrahje dhe po e zvarrisin realizimin e kësaj nisme, por edhe nga gazetatat e botuara në atë kohë, të cilave ndoshta ky fakt iu duk diçka e parëndësishme.

Benedikt Dema¹⁰ shkruan në vitin 1940 artikullin *“Per nji ‘Atlant Gjuhsuer’ të shqypes”*. Në hyrje ai citon një pohim të albanologut të famshëm Reinhold: *“Kaq jam dhënë mbas gjûhës s’ambel të tyne, e kaq më ka kapë nji dishir i madh per visare të saja, sa njatë kohë pushimi, qi më tepron prej punvet mjeksore, e kaloi tue studjue gjuhen elegante të shokvet, e qyshë tash më këthehet n’ande shi tinglli i gjuhës shqype”* (Hylli i Dritës, 1940/3-4: 16). Më tej me kënaqësi vë në

⁹ Lumo Skëndo, alias Mithat Frashëri (1880-1949), u takon atyre personaliteteve të botës shqiptare, që me veprën e tyre të gjithanshme u bënë shtylla të kulturës sonë kombëtare në dekadat e para të shekullit të njëzetë.

¹⁰ Benedikt Dema (Shkodër, 28 prill 1904 - 22 mars 1971) ka qenë frat françeskan, arsimtar dhe leksikograf shqiptar. Më 2005 fjalori enciklopedik i Demës u botua me titullin “Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe”.

dukje se kohët e fundit ka pasur një nxitje dhe përparim të veçantë në trajtimin e çështjeve të ndryshme të gjuhës shqipe, si nga autorë shqiptarë ashtu edhe të huaj.

Në vazhden e kësaj fryme, me 12 Prill, si mbyllje e Kuvendit të Parë të Studimeve Shqiptare do të inaugurohej madhërisht në një sallë të Mëkëmbësit të Mbretit, **Instituti i Studimeve Shqiptare të Fondacionit “Skanderbeg”**¹¹. Në përbërjen e këtij Instituti do të kishte komisione të ndryshme dhe ishte paraparë krijimi i një **Komisioni Gjuhësor**, që do të kishte për detyrë të rrahë problemet më të ngutshme që i përkisnin drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Më tej njofton se ky komision do të fillonte së shpejti botimin e një reviste tremujore *“Gjuha shqipe”*, që do të trajtonte çështje shkencore e praktike të gjuhës shqipe.

Një synim tjetër i këtij komisioni do të ishte edhe botimi i veprave më të mëdha, që do të ndihmonte realizimin e objektivave të tij.

Një nga problemet thelbësore që do të shqyrtoheshin në këtë komision do të ishte paraqitja e një gramatike të mirë shqipe dhe e një fjalori të madh të gjuhës shqipe. Ky fjalor do të përmbledhë të gjitha visaret e gjuhës sonë, e cila edhe pse nuk ka traditat letrare të gjuhëve të tjera, ka një pasuri të madhe shprehjesh.

B. Dema risjell në vëmendjen e lexuesve se edhe Akademia Mbretërore në Itali ka shfaqur prej kohësh interesin e saj për kulturën shqiptare, ndaj ka themeluar një Qendër Kulture Shqiptare.

Duke i uruar sukses të plotë në veprimtarinë e tyre me shumë vlerë për popullin dhe gjuhën amtare këtyre dy Instituteve, autori paraqet edhe iniciativën e fundit të *“Hyllit të Dritës”* për krijimin e një rubrike të *“Atlantit gjuhsuer të shqypes”* më të cilën fton autorë vendas e të huaj, që duan dhe janë në gjendje të trajtojnë çështje të gjuhës shqipe. Hartimi i një **Atlasi Gjuhësor të Shqipes** fillimisht ka qenë një inisiativë e Prof. M. Bartolit e më pas u mor përsipër nga Akademia Mbretërore e Italisë. Autori shpreh dëshirën, që kjo vepër e madhe të fillojë të plotësohet sa më parë, me një gjykim dhe metodologji shkencore, në mënyrë që të përjashtohet çdo element i panatyrshëm për gjuhën shqipe. Sipas Demës, si bazë të studimeve për një Atlas Gjuhësor të Shqipes duhet të vendoset çështja e origjinës së popullit shqiptar e të gjuhës shqipe. Ndaj ai bën një paraqitje dhe analizë të studimeve të deriatëhershme në këtë fushë. Kjo analizë dëshmon njohuritë shkencore Demës dhe njohjen e tij me botimet më të reja në këtë fushë kaq të vështirë, por edhe me shumë interes jo vetëm për shqiptarët, por edhe për studiues të huaj. Në vijim ai bën një pasqyrim të thjeshtësuar të gjendjes aktuale të gjuhës shqipe, duke bërë një renditje të zonave ku flitet shqip jashtë kufijve

¹¹ Instituti Mbretnuer i Studimeve Shqiptare, shkurt Instituti i Studimeve Shqiptare (1940-1944) ka qenë një institut shkencor e kulturor i vendosur përgjatë Mbretërisë Shqiptare që i parapriu Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

të Shqipërisë politike, si dhe bën një ndarje të territoreve dhe krahinave ku flitet secili dialekt. Në fund ai shprehet se, megjithëse ka ndryshime, nganjëherë edhe të mëdha, mes dialekteve të një gjuhe, ato në tërësi janë një pasuri e përbashkët e mbarë kombit, i cili përfiton prej tyre. Ndaj një gjuhë e lëvruar dhe e përbashkët e një kombi të qytetëruar, nuk mund të lindë e nuk mund të ketë jetëgjatësi, nëse krijohet mbi bazën e një dialekti të vetëm. Sipas tij “...të gjitha djalektet zbashkut do të perpunohen harmonisht prej glotologvet e filologvet, me baze veç gjithmonë në gjuhsin e gjallë të popullit, qi i ep jetë e njerere të ndryshme gjuhës si mbas rrethanave të ndryshme të jetës.” (Hylli i Dritës, 1940/3-4: 33). Ky shkrim i tij synon të jetë një parathënie e shkrimeve të autorëve të tjerë, pra një orientim për studimin e çështjeve themelore të gjuhës shqipe me qëllim hartimin e Atlasit Gjuhësor Shqiptar.

“Një kushtrim për kulturë” titullohet ligjërata e Anton Harapit¹² e mbajtur në selinë e **Institutit të Studimeve Shqiptare**, në prani të Këshillit të Lartë dhe të pjesëtarëve të Institutit. Kjo ligjërata botohet e plotë në revistën “Hylli i Dritës” në numrin e shkurtit të vitit 1944. Me leximin e saj Harapi hapi mbledhjen e parë, duke dhënë udhëzimet e para për bazat e reja me frymë krejtësisht shqiptare të këtij institucioni. Në hyrje ai shpreh indinjatën dhe shqetësimin e tij për situatën e ndjerë kulturore, në të cilën ndodhej Shqipëria. Por me një fije shprese shprehet se: “Në mes të këtij tufani të tmerrshëm qi po e trandë anë e kand jetën shqiptare... rrij e përgjoj, e me kënaqësi të madhe ndiej një zâ zemre, gjamën e shpirtit të disa Shqiptarëve vërtë fisnikë, të cilët tue u naltnue mbi këtë shemtim, mbërrijnë aty ku janë vlerët e visaret e jetës njerzore e shqiptare, dhe me të tana ndiesit nuk flasin, por si vigâj ulurojnë; zâni i tyne âsht kushtrimi për kulturën e shpirtit shqiptar.” (Hylli i Dritës, 1944/2: 6). Për Harapin misioni i parë i këtij Instituti, si një organ i kulturës shqiptare, është të vendosë në vendin që i takon faktorin shpirtëror, duke synuar lartësimin e jetës njerëzore shqiptare. Si program të sajën vetjak dhe kolektiv duhet të ketë lëvrimin e mendjes, e vullnetit dhe e ndjesive në të mirë të së vërtetës, të së mirës dhe të bukurisë. Më tej, duke bërë një përshkrim historik, shënon se para vitit 1939 në fushë të diturisë e të artit në Shqipëri veprohej individualisht, edhe sepse nuk kishte një institucion shtetëror, i cili t’i bashkonte fuqitë dhe përpjekjet e veçanta në një veprimtari të ndërgjegjshme kolektive. Prandaj ai bën thirrje, që në kushtet e një situatë të re dhe me vetëdijen e një pavarësie të plotë, të kontribuojmë për ngritjen e një Enti Kulturor Shqiptar të pastër. Për të ky do të jetë një organ thjeshtësisht shqiptar, një organizëm i gjallë e veprues, si shembull e arsye jete e përparimi.

¹² Anton Harapi (Shkodër, 5 janar 1888 - Tiranë, 20 shkurt 1946) është klerik dhe intelektual i spikatur, autor i disa librave të karakterit filozofik, estetik dhe në prozë. Atë Anton Harapi shkroi veprat “Andrra e Pretashit”, “Vlerë shpirtnore”, “Shqiptari dhe bota e tij” dhe “Valë mbi valë”.

Në vijim Anton Harapi bën disa propozime para pjesëtarëve të Institutit, të cilat shpreson se do të gjejnë një përkrahje të gjerë. Ne po radhisim këtu disa prej tyre:

- Propozon ky institut të quhej **Instituti Shqiptar për Studimet dhe Artet**;
- Parashtron se fizionomia dhe statuti i deritanishëm i tij nuk përshtatej me gjendjen dhe aspiratat e reja, prandaj duhej hartuar një statut i ri e për këtë detyrë përzgjedh A.Xhuvanin, Xh.Korçën, K.Gurakuqin dhe O.Paskalin;
- Instituti do të vepronte si në fushën letrare ashtu edhe shkencore dhe artistike;
- Instituti nuk ishte një vend ku do të pasqyroheshin meritat e njërës apo të tjetrit, por do të peshoheshin dhe do të vlerësoheshin fuqitë e veprat e dijes dhe të artit shqiptar;
- Nuk do të përjashtohej asnjë faktor shqiptar, në mënyrë që vepra të ishte sa më e plotë;
- Do të përgatiste elementet fillestarë të nevojshëm për rimëkëmbjen e Akademisë Shqiptare dhe kryefjala e tij do të ishte *“Pro cultura”*.

4. Përfundime

Revista “Hyll i Dritës” e marrë në shqyrtim, sigurisht nuk gëzonte një status vendimarrës në lëmi të planifikimit gjuhësor të gjuhës shqipe, por u bë aktor dhe faktor në këtë proces. Ajo ngriti me bindje e me forcë çështjen e themelimit dhe e formësimit të gjuhës së përbashkët, si një nevojë e ngutshme e situatës historike dhe politike që po kalonte vendi. Si qëllim kishte nxitjen e ndërgjegjësimit kombëtar për gjuhën e përbashkët. Duheshin mënjeluar dasitë krahinore dhe fetare, të cilat e mjegullonin gjykimin objektiv të problematikave.

Krijoi një traditë të shkrimit, të cilën e ndoqën me ndryshime të vogla, për vite me radhë. Kështu arritën të formësojnë modele edhe për autorë e botime të tjera. I dha gjuhës funksione të reja në përqasje me tematikat e trajtuar në artikuj. Tashmë shqipja dalëngadalë po bëhej e aftë të plotësonte nevojat e një shoqërie që ishte në ndryshim e sipër.

I kushtoi rëndësi njohjes së leksikut të shqipes, duke risjellë në përdorim fjalë të humbura ose duke gjurmuar në pasurinë leksikore dialektore të shqipes. Pasuroi fjalorin me fjalë të reja duke dhënë shembuj dhe modele të përshtatshme fjalëformimi. Mbajti një qëndrim kritik kundrejt përdorimit të fjalëve të huaja.

Përgjithësisht mbështeti ndërmarrjet institucionale apo gjysëm institucionale për politikë e planifikim të gjuhës. Por nuk munguan dhe qëndrimet kundër, të cilat u argumentuan nga autorët.

Burimet

Kolana e plotë e revistës “Hylli i Dritës”, (1913-1914; 1921- 1924; 1930-1944). Shkoder: Botime Françeskane.

Literatura

- Christian, D. (1988). Language planning: The view from linguists. In F. J. Newmeyer (ed.) *Language: The socio- cultural context*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Cooper, R.L. (1989). *Language planning and social change*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Dubois, J. et al., (1994). *Dictionnaire de linguistique et des sciences du langage*. Paris: Larousse.
- Omari, A., (2013), Kontributi i “Hyllit të Dritës” në studimet filologjike shqiptare, *Hylli i Dritës*, nr 3-4. Shkodër: Botime Françeskane. f. 63-74.
- Paci, E. (2013) “Hylli i Dritës”, një tribunë e përrurimit të studimeve albanologjike, *Hylli i Dritës*, nr 3-4. Shkodër: Botime Françeskane. f. 95-106.
- Pllumi, Z., (2013). Një biografi e shkurtër e “Hyllit të Dritës”, *Hylli i Dritës*, nr 3-4. Shkodër: Botime Françeskane. f. 10-30.
- Ricento, Th., (2000). In introduction to language policy. *Theory and method*. Oxford: Blackwell Publishing. pp. 10-23.
- Weinstein, B., (1980). Language planning in francophone Africa. *Language Problems and Language Planning 4*. Texas: University of Texas Press. pp. 55-77.

Rezearta Murati

“HYLLI I DRITËS” FOR OFFICIAL INSTITUTIONS WITH INFLUENCE ON THE LINGUISTIC PLANNING OF THE ALBANIAN LANGUAGE

Summary

The “Hylli i Dritës” magazine had the support and appreciation of most of the Albanian intellectuals of the time, who often became its collaborators. It was praised for the seriousness it had shown and the quality of its articles published by the foreign scholars. The idea of national unification took an important part in the pages of the magazine “Hylli i Dritës.” There was pointed out that one of the most important points of

a national unification was undoubtedly the language. The issue of the common language was not addressed solely in the general plan, and as a need for a literary language, but occasionally the authors also presented their thoughts on the manner this language was formed.

Some discussions have to do with the establishment and shaping of state institutions that would enable an Albanian planning. The official institutions, which would feature personalities of the Albanian linguistics and culture and that would have the ability to make important decisions regarding the common Albanian language, have been a persistent and well-made requirement on the pages of magazine.

Keywords: “Hylli i Dritës” magazine, official institution, academy, institute, linguistic planning, language policy.

Valbona KARAKAÇI¹

Universiteti i Shkodrës

Rrezarta DRAÇINI²

Universiteti i Shkodrës

 <https://orcid.org/0009-0006-2509-4797>

ANTON ÇETTA: INTELEKTUALI DHE MISIONARI I PAQES

Çetta është figura që bashkon lëvizjen për pajtimin e gjaqeve dhe çrrënjosjen e këtij fenomeni me mbledhjen, studimin e publikimin e letërsisë gojore të Kosovës, kryesisht Dukagjinit, por edhe të shqiptarëve të Maqedonisë e Malit të Zi.

Në këtë punim ne kemi bërë një trajtim të përmbledhur të figurës së Anton Çettës, duke e parë në dy këndvështrime: si intelektual dhe misionar. Kemi marrë në shqyrtim pajtimin e gjaqeve në Kosovë. Kjo nisëm, në krye të së cilës në vitin 1990 vihet Anton Çetta, arriti të kthejë shpresën e jetës mes mijëra familjeve shqiptare. Anton Çetta u kthye në “plakun e urtë” që dëgjohej nga të gjithë. Si njohës shumë i mirë i letërsisë gojore, ai e dinte mjaft mirë se plaku i urtë është imazhi mental me anë të të cilit mund të lexohej dhe të ndryshohej mendja e individit duke përdorur kodet etnografike të të folurit dhe ritualet e ngulitura në kulturën kolektive të kallzimeve që janë transmetuar përmes mekanizimit gojor nga njëri brez në tjetrin. Çetta dukej se kishte ardhur nga krijimtaria popullore, për një mision historik, siç ishte pajtimi i gjaqeve.

Fjalë kyçe: Anton Çetta, intelektual, folklor, pajtim gjaqesh.

Origjina dhe jeta

Origjina e familjes së Anton Çettës është nga Fani i Mirditës. Gjyshi i tij në moshën 24 vjeç largohet nga vendlindja për t’u shpërngulur në Prizren, ku punoi si zyrtar në Konsullatën austrohungareze për 15 vjet, më pas në Selanik ku punoi për 5 vite në të njëjtën detyrë.

Njihet për punën e tij patrotike, pasi bashkëpunoi me figura të rëndësishme të çështjes kombëtare.

Lazer Çetta, i ati i Antonit lindi në Prizren në 1895. Pasi mori arsimin e duhur në Prizren, Shkup dhe Selanik ai iu bë krah të atit në ndihmë të çështjes

¹ valbona.karakaci@unishk.edu.al

² rrezarta2009@gmail.com

kombëtare. Kishte funksione në disa ministri duke dhënë kontribut për ngritjen e shtetit shqiptar, i cili ishte në vitet e para të ekzistencës së tij. U dekurua dy herë nga shteti francez.

Anton Çetta lindi më 3 janar 1920 në Gjakovë.

Arsimi që mori që në vogëli ishte një shtyllë shumë e mirë që paracaktoi dhe jetën intelektuale dhe patriotike të Çettës.

Për shkak të lëvizjes së familjes së tij nga Gjakova drejt Tiranës, Çetta bëri në Gjakovë vetëm shkollën fillore, vazhdoi studimet në Tiranë, në Korçë e më pas në Milano, Itali. Pas kthimit nga Italia nisi punë në Post-telegrafën e Tiranës për të vazhduar më pas si përgjegjësi i Postës së Prizrenit.

Në vitin akademik 1945-1946 punoi në Gjimnazin e Prizrenit si dhe u bë anëtar e më pas kryetar i shoqërisë kulturore-artistike "Agimi". Në vitin 1946 nisi studimet në Universitetin e Beogradit në Fakultetin e Filologjisë për romanistikë, studime që i mbaroi në vitin 1950. Pikërisht në këtë vit emërohet asistent në Seminarin e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe, i cili ishte pjesë e Fakultetit Filologjik të Universitetit të Beogradit. Pas 10 vitesh në këtë detyrë, në vitin 1961 bëhet pjesë e Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, si lektor i letërsisë së vjetër shqipe.

Për disa vite ka qenë drejtues i Departamentit të Folklorit në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Që në vitin 1968 e deri sa doli në pension ka dhënë kontributin e tij në Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe në botimin e revistës "Gjurmime albanologjike". Në vitin 1992 zgjidhet deputet si përfaqësues i LDK-së në Parlamentin e Kosovës. Si vlerësim për punën e bërë gjatë gjithë jetës së tij, Çetta u nderua me shumë çmime dhe dekorata. Ndër to veçohet medalja e Artë e Lidhjes së Prizrenit. Për nder të figurës së tij është krijuar medalja e Paqes dhe Pajtitimit Anton Çetta e cila i jepet individëve që kanë dhënë kontribut për pajtimin mes njerëzve.

Është autor apo bashkëautor i 20 vëllimeve të cilat kanë vlerë të jashtëzakonshme për studimin e fjalorit.

Çetta njihet edhe si shkrimtar për fëmijë si dhe përkthyes nga frëngjishtja, italishtja dhe serbo-kroatishtja. Përmendim përkthimet e autorëve Edmond D'Amici, Alberto Morava, Alfons Dode, Gi Mopasan. Përkthyu në shqip veprën e Pashko Vasës "Trëndafil e gjemba".

Anton Çetta u nda nga jeta në vitin 1995 në Prishtinë, por la një kontribut të pashoq për çështjen kombëtare, u bë modeli i intelektualit dhe atdhetarit që vazhdon të frymëzojë breza.

Anton Çetta si studiues

Formimi filologjik që kishte Anton Çetta, dija mbi letërsinë gojore bënë që në mënyrë të natyrshme, ai të merrej edhe me studimin e letërsisë popullore, duke mos mbetur kështu thjeshtë një mbledhës i saj.

Në punimin tij “Disa të dhëna mbi zhvillimin struktural të baladës shqipe”, botuar fillimisht në “Gjurmime albanologjike-folklor dhe etnologji V” në vitin 1975, Çetta vë në dukje se në popull termi baladë nuk është i njohur. Në zona të ndryshme baladat kishin emërtime të ndryshme si “kangë t’moçme” apo “kangë t’përmallshme. (Çetta, 2011: 9)

“Edhe pse këto dy emërtime nuk janë të përhapura në të gjitha viset e të folurit shqip, prapëseprapë ato përforcojnë caktimin e karakterit të vetë baladës, si këngë popullore me brendi të prekshme, që na trondit” (Çetta, 2011: 10).

Ndërsa trajton përcaktimin e baladave Çetta vë në dukje se edhe atëherë kur fundi nuk është tragjik, por kemi dasëm apo festë: mbyllje të lumtur, sërish nuk mund të bëjmë ndonjë dallim mes tyre. Këtë e justifikon duke analizuar rastet e krijimeve popullore që mund të konsiderohen të lumtura, siç është balada e Isuf Agës i cili vret të shoqen për tradhëti dhe familja e gruas e shpërblen duke i dhënë për nuse vajzën e vogël, motrën e gruas së vvarë prej tij. A është kjo mbyllje e gëzueshme?

Nisur nga ky arsyetim Çetta pohon se nuk mund të bëjmë dallim në balada dhe romanca, duke u bazuar vetëm nëse mbyllen me nota pikëllimi apo të gëzueshme. “Ata do t’i konsiderojmë balada për atë fill të përbashkët që lidh episodet e dhimbshme të tyre, për atë notë dramatike ..” (Çetta, 2011: 10). Si origjinë të baladave shqipe, Çetta mendon se është e hershme, ndërkohë që në mesjetë, më konkretisht në shekullin XV kishin përhapje dhe shumë zhvillim dhe për të vërtetuar këtë përfundim ndalet tek baladat e arbëreshëve të Italisë.

Pasi analizon baladat, Çetta bën ndarjen e tyre në dy grupe. Në grupin e parë fut baladat që janë besnike të tipit të vjetër të baladave shqipe dhe në grupin e dytë përfshin baladat strukturalisht më të reja të cilat kanë ardhur deri në ditët tona. Në punim ai bën dhe një argument sesi u bë kalimi nga grupi i parë në të dytin, duke e trajtuar gjerësisht periudhën e mesjetës.

Studimi i Çettës për pasurinë popullore në folklor pasqyrohet dhe në punimin “Për një ndarje më të plotë të prozës popullore dhe emërtimin e ca llojeve të saj” mbajtur fillimisht si kumtesë në sesionin shkencor pranë Institutit Albanologjik të Prishtinës në maj 1973. Sipas Çettës, është domosdoshmëri periodizimi i letërsisë gojore, pasi kështu do të lehtësohej studimi i letërsisë gojore në mënyrë sistematike. (Çetta, 2011: 43).

Pasi vë në dukje ndryshimet që janë mes tipologjisë së periodizimit të letërsisë artistike dhe letërsisë popullore gojore, Çetta sqaron se “Vetë nocionin e periodizimit në letërsinë gojore do ta zgjerojmë dhe me kuptimin e klasifikimit të saj, ndarjes së saj duke u nisur nga dy format kryesore të kësaj ndarjeje, në poezi

dhe në prozë popullore, gjer në llojet e ndryshme që përfshihen në to” (Çetta, 2011: 44).

Klasifikimi dhe emërtimet e llojeve të prozës sonë popullore, sipas Çettës, u bënë gradualisht gjatë viteve, pa një qëllim të caktuar, jo si kërkesë shkencore, por u plotësuan gradualisht, ashtu siç mbledheshin shkallë-shkallë materialet folklorike. Në këtë punim Çetta bën një pasqyrim të detajuar të përpjekjeve të para për ndarjen dhe botimin e krijimeve popullore duke nisur që në vitin 1635 me Frang Bradhin i cili mbledhi 113 njësi që i quajti proverba dhe sentenca, për të kaluar dy shekuj më vonë me 6 përralla, që njihen si “Përralla popullore toskërishte”, të mbledhura nga Hahn dhe ca gjëegjeza, fjalë të urta dhe frazeologji të cilat Hahn i quante fraza. Çetta ndalet tek puna që ka bërë Th. Mitko, Pedersen, Majeri, Lambert, Spiro Dine, Shtjefen Gjeçovi, Marin Sirdani, etj.

Pasi vë në dukje problematikat që ka ndarja dhe emërtimet e llojeve të prozës popullore, Çetta sqaron se për një ndarje të saktë duhet të mbështetemi në disa elemente që veçojnë njësitë e ndryshme folklorike si lloje më vete, pikërisht tek:

- forma
- përmbajtja
- mënyra e të treguarit

Çetta këshillon që nuk duhet të ngurojmë të largohemi nga forma e vjetër, pasi disa materiale të reja të zbuluara vonë na imponojnë krijimin e llojeve të ndryshme në prozën popullore.

Çetta bën këtë ndarje për krijimet folklorike në prozë: (Çetta, 2011: 51).

1- Tregime popullore, ku përfshihen proza popullore që kanë veprim, kulminacion, peripeci, p.sh., përrallat dhe kallëzimet, gojëdhënat, fabulat, anekdotat popullore, pleqnia.

2- Llojet minore të prozës popullore ku mungojnë veprimet, kulminacionet, peripecitë etj. Ata paraqiten si formula të shkurtra e koncize, për të shprehur një mendim, gjykim apo ndonjë enigmë. Si të tilla përcakton fjalët e urta, urtitë popullore (proverbat), gjëegjezat, enigmat popullore, probleme apo enigma problemore, pyetjegegje, frazeologjizmat, proza zbavitëse fëmijësh, përshëndetjet, dollitë, urimet, ngushëllimet, betimet, kërcënimet, mallkimet, eufemizmat popullore.

Sipas Çettës kjo ndarje do të shërbente si orientim për bashkëpunëtorët në terren që të mbledhin me insistim të gjitha këto lloje të prozës popullore dhe të pasurohet fondi me të gjitha këto lloje, pasi çdo krijim folklorik ka rëndësinë e vet shumëplanëshe.

Si njohës shumë i mirë i përrallave Anton Çetta është ndalur dhe ka analizuar këtë pasuri popullore, pasi si tregimet më të gjata popullore, ata paraqesin interes shume të madh për studiuesit e folklorit në dy drejtime:

1- për brendinë e tyre të pasur me motive, episode, me personazhe dhe përjetime,

2- për strukturën e tyre të formës, për stilin dhe pasurinë gjuhësore.

Në punimin e tij “Mbi përrallat” i cili është botuar fillimisht si parathënie e botimit “Përralla, I” në Prishtinë më vitin 1979, Çetta vë në dukje se në popull këto krijime janë quajtur “Prralla, prralla t’moçme ose prralla t’vjetra”. Duke kaluar nga njëra periudhë në tjetrën, vë në dukje Çetta, ka ndryshuar edhe mënyra e të treguarit, pasi dikur tregoheshin edhe nga burrat, ndërsa sot i tregojnë të rinjtë dhe gratë. Gjatësia e përrallave është një nga arsyet që sipas Çettës, nuk tregohen në tubime burrash në oda, madje edhe nënçmohen, ndërkohë që anekdota e shkurtër pëlqehet më shumë për të tilla raste.

Sipas Çettës origjina e përrallave duhet të jetë më e lashtë se llojet e tjera të prozës popullore. Si argument për tezën e tij Çetta përmend frymën e tyre johistorike si dhe elementet e shumta të politeizmit, të totemizmit, të magjisë, të animizmit, të metamorfozës, etj. (Çetta, 2011: 70).

“Zanafillën duhet ta kërkojmë krahas me mitet dhe në vetë mitet e lashtësisë. Gjurmët e besimeve të vona (kristianizmit dhe të islamizmit) që dalin aty-këtu, në mënyrë të drejtë apo të zhdrejtë ndër këto krijime, janë shtesa, mveshje të mëvonshme të fondit të stërlashtë pagan.” pohon Çetta. (Çetta, 2011: 70).

Pse përralla u përhap kaq shumë? Këtë e shpjegon Çetta i cili pohon se përgjigjen duhet ta gjejmë tek karakteri përgjithësues, pasi përralla merr për bazë të veçantën, por gjithnjë atë e ngre në nivelin përgjithësues, madje sa më shumë largohet nga e veçanta dhe shkon drejt të përgjithshmes aq më popullor bëhet krijimi.

Në punimin “Mbi përrallat”, Çetta bën një analizë të plotë të tyre nga ana teorike si pjesë e krijimtarisë popullore duke cituar dhe pasqyruar mendimet e studiuesve më me zë të kohës, duke i dhënë kështu vlera të veçanta shkencore punimit.

Duke qenë një orator shumë i mirë, ai i kushton shumë vëmendje jo vetëm rëndësisë që ka rrëfimtari në mënyrën sesi ai e përcjell krijimin, por ndalet edhe tek dëgjuesi “Dëgjuesit nuk i intereson se kush është autori i një përralle, por si e tregon tregimtari përrallën, sa është në gjendje ai të tërheqë vëmendjen e atyre që e degjojnë.”

Teoritë e sotme të komunikimit dhe psikolinguistikës i kushtojnë shumë rëndësi këtij momenti, pasi aftësia që ka folësi për të tërhequr apo mostërhequr vëmendjen e dëgjuesve është elementi kryesor që e bën të suksesshëm apo të mërzitshëm folësin, sado interesante të jetë përmbatja e asaj që rrëfëhet prej tij. (Çetta, 2011: 70).

Anton Çetta dhe letërsia gojore

Sipas vetë kujtimeve të Çettës (1997) “Anton Çetta dhe vepra e tij”, të botuara nga Sulejman Dërmaku, mësojmë se Instituti i Albanologjisë në vitet 1950-1951 nisi punën për mbledhjen e folklorit. Çetta më së shumti në këtë nismë mori pjesë në redaktimin e materialeve. Në bashkëpunim me profesorët Vojislav Dançetoviq dhe Kadri Halimin hartuan tre vëllime (1952-1953) me këngë popullore të Kosovë-Metohisë.

Ndërsa punonte si asistent në katedrën e Albanologjisë në Universitetin e Beogradit dhe bënte redaktimin e materialeve folklorike për botim, Anton Çetta nisi të krijonte një lidhje të veçantë me pasurinë folklorike popullore.

Në vitin 1954 nisi punën si mbledhës i folklorit në Shalë të Bajgorës ku për dy muaj mblodhi këngë kreshnikësh. Vazhdoi me zonën e Drenicës ku mblodhi tregime popullore dhe botoi në 1963 të parën përmbledhje “Tregime popullore nga Drenica”. Ky botim përfshinte 371 njësi në prozë, 72 fjalë të urta, 85 gjëgjëza. Suksesi i këtij botimi e nxiti në vazhdimin e punës dhe nuk vonoi shumë që të botohej “ Prozë popullore nga Drenica I-II”.

Një moment shumë i rëndësishëm për vazhdimësinë e punës së Çettës , është takimi me lahutarët. Në ekspeditën e Rrafshit të Dukagjinit, më 1972, organizuar në bashkëpunim me Instituti i Folklorit të Tiranës, Çetta takoi mes të tjerësh edhe lahutarin e madh Shaban Groshi të cilin e cilësoi si lahutar të tipit homerik.(Neziri, 2011: 112)

Prof. Zymer Neziri pohon se Çetta në periudhën 1972-1975 bashkëpunoi me 10 lahutarë të zonës së Rugovës dhe incizoi 20 këngë kreshnikësh, dukë dhënë kështu një kontribut shumë të madh në mbledhjen e këngëve të kreshnikëve.

Anton Çetta kishte mbledhur këngë kreshnikësh në shumë krahina, por Rugovën e veçonte, pasi pohonte se në zonën e Rugovës ruhen të gjitha motivet dhe temat e mëdha të Eposit. Madje këtu Çetta gjen edhe fillet e para kur kreshnikët marrin fuqi nga zanat, martesat mes tyre, etj. Sipas tij qeniet mitike që qëndrojnë në themel të Eposit të Kreshnikëve, janë të pranishme në repertorin e lahutarëve rugovas. Çetta pohon se Rugova është mjedis i jashtëzakonshëm etnokulturor, është fole e rrallë e lahutës dhe lahutarëve, vendi i legjendave ku kanë shtegtuar kreshnikët, vendi ku Muji i kishte nëmur bjeshkët që nuk e kanë marrë ndore kreshnikun para vdekjes. (Neziri, 2011: 119).

Çetta ka bërë një punë kolosale për formimin e Arkivit të Degës së Folklorit, ku u sistemuan materialet e grumbulluara për vite të tëra.

Dalja në tërren jo vetëm shërbeu si mundësi për të mbledhë pasurinë folklorike të popullit, por sipas Çettës i shërbeu njohjes së njerëzve, mentalitetit të tyre, gjendjes së tyre materiale dhe shpirtërore. (Dermaku, 1997: 243).

Qenësia e punës së Çettës si mbledhës dhe botues i materialeve të letërsisë gojore bazohej në dy çështje:

1- T'i mbledhë e t'i botojë krijimet që kishin një kuptimësi të qenësishme për botën shpirtërore dhe materiale.

2- Krijimet e mbledhura të ishin në rrafshin letrar e shprehës artistik, sa më të plota e më të pasura.

Sipas prof. Myzaferre Mustafa rëndësia e materiale të mbledhura nga Çetta qëndron edhe në mënyrën sesi ato janë grumbulluar, duke treguar kujdes në ruajtjen e autencitetit e rrëfimit të krijuesit gojor si dhe në trajtat fonetike të të folmeve të viseve përkatëse. (Mustafe, 2011: 126)

Disa nga botimet e Anton Çettës

